



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 63, Datë 11.04.2022

MBI

SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË OST SH.A., PËR MIRATIMIN E KODIT TË
TRANSMETIMIT

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.04.2022, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 382 dhe 382/1 prot., datë 04.04.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Inspektiveve, “Mbi shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a., për miratimin e kodit të transmetimit”.

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendim nr. 160, datë 02.07.2021, vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a., për miratimin e kodit të transmetimit.
- ERE në zbatim të vendimit nr. 160, datë 02.07.2021 dhe në përmbushje të detyrimeve ligjore nëpërmjet shkresës nr. 828 prot., datë 15.07.2021, ka kërkuar nga palët e interesit dhënie të mendimit lidhur me draftin e kodit të transmetimit të përgatitur nga OST sh.a.
- Në vijim të komunikimit Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) nëpërmjet shkresës nr. 5737/2 prot., datë 21.09.2021, ndër të tjera parashtroi se shprehet dakord për vijimin e procedurës në zbatim të ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe të akteve nënligjore të dala në zbatimin e tij.
- Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) me shkresën nr. 1086/1 prot., datë 26.07.2021, ka sugjeruar mbi përmbajtjen e nenit 314, pika 5, të draftit të kodit të transmetimit duke sugjeruar që inspektimi të kryhet në laboratorin e matjeve elektrike në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë pasi laboratorit elektrik i DPM, nuk ofron shërbime në terren.
- Lidhur me komentin e DPM, ERE vlerëson se qëllimi i realizimit të inspektimit është kryerja e tij në terren në kushtet dhe në gjendjen në të cilat matësi është duke kryer funksionin e vet. Në të njëjtën kohë procesi i inspektimit në terren është një aktivitet që realizohet në mënyrë periodike dhe është i ndryshëm nga ai që kryhet në kushte laboratorike. Nëse gjatë inspektimit në terren gjykohet dhe vlerësohet për egzaminime të mëtejshme atëherë vendoset rast pas rasti sipas nevojës për këto vlerësime laboratorike.
- AREA nëpërmjet shkresës nr. 1810/211 prot., datë 19.08.2021, ka paraqitur komentet përkatëse për draftin e kodit të transmetimit.
 - **Neni 42.2 “Procedurat për menaxhimin e sistemit”** i Kodit të ri të Transmetimit, parashikon lidhjen e marrëveshjes së operimit mes përdoruesit dhe OST, marrëveshje e cila duhet të përcaktojë disa elementë që evidentohen në këtë dispozitë. Një dispozitë e ngjashme nuk gjendet në Kodin ekzistues të Transmetimit. Mendojmë që mund të qartësohet dhe të shtohet një fjali që parashikon që kjo marrëveshje përgatitet nga OST. Për t'u vlerësuar nëse mendohet që kjo marrëveshje duhet të miratohet edhe nga ERE, në kushtet kur Kodi i ri i Transmetimit parashikon në mënyrë të përgjithshme vetëm disa nga elementët kyç që do të

përmbajë marrëveshja e operimit. Mund të vlerësohet në aspektin teknik shtimi i elementëve të tjerë në marrëveshje për të bërë sa më praktik, transparent dhe të vlefshme.

- Lidhur me këtë koment, ERE bazuar në aktet ligjore në fuqi respektivisht në “Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016 dhe në “Rregulloren mbi procedurat e njoftimit dhe konsultimit publik të akteve të miratuara nga ERE”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 162, datë 20.10.2020, realizon procesin e konsultimit publik të akteve nënligjore ku përfshihen dhe marrëveshjet të cilat miratohen nga ERE. Në këtë kontekst nëse marrëveshja e operimit e sugjeruar nga AREA do të duhet të miratohet nga ERE ajo do të kalojë procesin e konsultimit publik sipas përcaktimeve të akteve ligjore në fuqi. Në të njëjtën kohë OST sh.a. duhet të marrë masa që të rishikojë të gjitha aktet e tjera të cilat ndikohen nga ndryshimet në Kodin e Transmetimit dhe për rrjedhojë edhe marrëveshjen e operimit. Të gjitha aktet që janë subjekt i miratimit nga ERE duhet të përcillen në ERE konform përcaktimeve ligjore dhe rregullave në fuqi për këtë qëllim.
- **Neni 282 “Rregullat për shlyerjet në rast të pezullimit të aktiviteteve të tregut” i Kodi i ri i Transmetimit parashikon tagrin e OST sh.a. për të hartuar rregullat mbi disbalancat, kapacitetin balancues dhe energjinë balancuese të cilat zbatohen për periudhat e shlyerjes së disbalancës gjatë të cilave aktivitetet e tregut ishin pezulluar. Tek neutraliteti financiar i OST sh.a. në përcaktimin e këtyre rregullave mund të shtohet dhe të përforcohet koncepti i vendosjes së çmimit të disbalancave me koston reale për OST sh.a. për balancimin e sistemit. Për referencë mund të shikohet parashikimi i nenit 191/1/f/vi i Kodit ekzistues të Transmetimit.**
- ERE vlerëson se Kodi i Transmetimit në vetvete nuk është një dokument specifik i cili trajton tregun e balancimit të energjisë elektrike në vendin tonë. Tregu i balancimit të energjisë elektrike në vendin tonë funksionon bazuar në rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e ERE-s nr. 106, datë 02.07.2020. Në pikën 4.1.1.4, të rregullave të tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike, të miratuara me vendimin e ERE-s nr. 106, datë 02.07.2020, është përcaktuar se: “OST sh.a. është e detyruar të mbajë në balancë sistemin elektroenergjitik duke mos shkaktuar diferencë në rezultatin neto me qëllim garantimin e neutralitetin të saj financiar të rregulluar lidhur me shërbimet e balancimit në përputhje me përcaktimet e Metodologjisë së Llogaritjes të Tarifave të Transmetimit të Energjisë Elektrike”.
- **Neni 298 "Rolet e OT, DST, OSSH dhe përdoruesve të sistemit të transmetimit sipas Modelit të Tregut" ...i Kodit të ri të Transmetimit në pikën 3, parashikon se "Pale përgjegjëse balancuese (PPB) Jane të gjitha subjektet juridike, që zotërojnë njësi të prodhimit dhe konsumit, të lidhura në rrjet dhe mbi një kapacitet të caktuar nga OST sh.a. dhe të miratuar nga ERE. Duke përfshirë:**
 - a. çdo tregtar që tregton në Shqipëri apo që furnizon energjinë nëndërkufitare.
 - b. çdo palë që ushtron aktivitetin e furnizuesit.

Mendojmë se kjo duhet të jetë në linjë me kushtet për t'u cilësuar si PPB
- ERE vlerëson se: ligji është akti juridik me i lartë dhe prevalon mbi aktet e tjera nënligjore, për rrjedhojë përkufizimi i PPB duhet të jetë konform përcaktimeve të nenit 99 dhe nenit 3, pikës 60 dhe pikës 54, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike i ndryshuar”. Vlerësojmë se formulimi i pikës 3, të nenit 298, të Kodit të Transmetimit të jetë i njëjtë me pikën 54, të nenit 3, të ligjit nr. 43/2015, i ndryshuar, si vijon: **“Pala përgjegjëse për balancimin” është një pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike ose përfaqësuesi i zgjedhur prej tij, përgjegjës përballë Operatorit të Sistemit të Transmetimit për disbalancat e krijuara gjatë operimit të tij.**
- Rregullimi i pikës 3, të nenit 298, të Kodit të Transmetimit në përputhje me pikën 54, të nenit 3, të ligjit nr. 43/2015 i ndryshuar, bën të nevojshme dhe rishikimin e pikës 4, të nenit 298, të Kodit të Transmetimit, e cila ishte pikë plotësuese e pikës 3, të mëparshme. Duke ndjekur të njëjtin arsyetim si për rastin e pikës 3, të nenit 298 dhe për pikën 4, e nenit 298, të Kodit të Transmetimit duhet të ketë përcaktimin e me atë të shprehur në ligjin nr. 43/2015 i ndryshuar,

kjo pikë propozohet të jetë e njëjtë me përkufizimin e pikës 60, të nenit 3, të ligjit nr. 43/2015, i ndryshuar, si më poshtë vijon: “Pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike” është një person juridik, i regjistruar si pjesëtar i tregut të energjisë elektrike, që përfshin prodhuesit, tregtarët, furnizuesit, klientët, Operatori i Sistemit të Transmetimit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, sistemet e mbyllura të shpërndarjes dhe operatori i tregut. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes janë pjesëmarrës të tregut të energjisë elektrike vetëm për qëllim të sigurimit të energjisë elektrike të nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjet, balancimin dhe shërbimet ndihmëse.

- OSSH sh.a. nëpërmjet shkresës nr. 6807/prot., datë 19.08.2021, ka paraqitur një sërë komentesh për draftin e kodit të transmetimit paraqitur si në vijim:
 - *Statusi i OSSH, i cili trajtohet si një prej përdoruesve të rrjetit të Transmetimit, duhet të ndryshojë dhe ti referohet statusit tashmë të miratuar në Ligjin 43/2015 të ndryshuar, si person juridik, përgjegjës për operimin e sigurt, të besueshëm dhe të efektshëm të rrjetit të shpërndarjes, duke siguruar mirembajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, të shtrirë në një zone të caktuar dhe, kur është e aplikueshme, lidhjet e tij me sisteme të tjera për të siguruar aftësi afatgjatë të sistemit për të përmbiushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë, në harmoni me mjedisin dhe eficientësin e energjisë.*
 - Duke qenë se OSSH sh.a. lidhet me sistemin e transmetimit të operuar nga OST sh.a. për të siguruar kryerjen e funksioneve të sistemit të shpërndarjes për të përmbushur kërkesat për shpërndarjen e energjisë të përdoruesve të lidhur në rrjetin e OSSH sh.a., në përputhje me përcaktimet e ligjit të nr. 43/2015, të ndryshuar dhe në kontekstin e çështjeve që trajton Kodi i Transmetimit, OSSH sh.a. përcaktohet si një përdorues i sistemit të transmetimit pa anashkaluar apo minimizuar statusin e përcaktuar nga ligji, të përmendur në komentin e OSSH sh.a..
 - **Neni 30 “Kostoja e të dhënave dhe informacionit”** - *OST sh.a. ka të drejtë të kërkojë pagesë për të dhënat apo informacionet për rrjetin e Transmetimit dhe do të njoftojë përdoruesin për këto kosto”. OSSH sh.a. është e interesuar të behet ne dijeni se:*
 - a. Sa do të jenë keto kosto?
 - b. Në bazë të kujt reference përlllogariten ato?
 - c. Besojmë se përdoruesit e rrjetit si dhe OSSH sh.a. duhet t’i dijë paraprakisht, pasi ato do të futen, në procesin e vlerësimit të projekteve dhe më pas në buxhetim e secilit përdorues.
 - ERE vlerëson se në çdo rast që OST sh.a. ka kosto për përgatitjen e informacionit të kërkuar nga palë të treta, kosto të cilat nuk janë parashikuar në akte të tjera, këto kosto duhet të llogariten në mënyrë transparente dhe të publikohen në faqen web të OST sh.a. Në këtë mënyrë përdoruesit e rrjetit të transmetimit do të kenë dijeni për këto kosto dhe do të mund t’i marrin në konsideratë në buxhetimin e projekteve respektive. Për rrjedhojë me miratimin e këtij Kodi Transmetimi, OST sh.a. të marrë masa për të krijuar një rubrikë të veçantë në faqen e vet web, ku të bëje publike kostot dhe mënyrën e llogaritjes së tyre, për përgatitjen e informacionit për palët e treta.
 - **Të dhëna për t’u plotësuar sipas kërkesës së OST sh.a.** - *Parashikimi i ngarkesës - Në tabelën e përshkruar për këtë kërkesë ku kërkohen grafikët e ngarkesës deri 10 vjecare për të gjithë kategoritë, kërkojmë nëse mund të specifikohen më saktë cilat janë kategoritë dhe çfarë përfshijnë ato. Sic kemi bërë me dije në mënyrë të vazhdueshme, OSSH sh.a. në gjendjen aktuale teknike me mungesë të të dhënave të sakta historike të rrjetit; mungesë të sistemit SCADA për gjithë N/stacionet; mos kompletim të të gjithë kategorive të përdoruesve të rrjetit me matje smart nuk mund të përmbushë këtë detyrim në një të ardhme të afert.*
 - Lidhur me pamundësitë e shprehura nga OSSH sh.a. për të përmbushur disa kërkesa të Kodit të Transmetimit, ERE vlerëson se Kodi i Sistemit të Transmetimit sikurse evidentuar në ligjin nr. 43/2015, i ndryshuar, në nenin 3, pika 33, se: *“Kodi i Transmetimit” është tërësia e rregullave teknike, të cilat rregullojnë operimin e sistemit të transmetimit, si dhe përcaktojnë kushtet e shërbimit që ofrohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit ndaj përdoruesve të sistemit të transmetimit, në përputhje me rregullat e ENTSO-E. Pra ligji përcakton qartë se*

Kodi i Transmetimit përcakton kushtet për të gjithë përdoruesit e sistemit të trasmetimit dhe këto kushte duhet të jenë të barabarta dhe jo diskriminuese për asnjë nga përdoruesit e sistemit të transmetimit. Nëse në kodin e sistemit të transmetimit do të reflektoheshin përjashtimet për cdo përdorues sipas kërkesave të tyre do të prishej kuptimi i këtij kodi dhe do të binim ndesh me përcaktimin e dhënë në nenin 3, pika 33, të ligjit nr. 43/2015, i ndryshuar.

- Në piken 1, të nenit 13, të Kodit është përcaktuar se: *Nëse përdoruesi nuk mund t'i përmbushë plotësisht dhe/ose pjesërisht kërkesat e kodit është i detyruar të kërkojë dhe aplikojë menjëherë për derogim në lidhje me kërkesën përkatëse sipas kuadrit ligjor në fuqi për procedurat e derogimit.*
- Lidhur me kërkesën për ndryshimin në kod të trajtimit të OSSH sh.a. dhe jo nëpërmjet procesit të derogimit vlerësojmë se: Në kodin e transmetimit përcaktohen rregulla të cilat nuk janë diskriminuese apo favorizuese për asnjë nga përdoruesit e rrjetit të transmetimit, neni 56, i ligjit nr. 43/2015, i ndryshuar, në gjermën (g), përcakton detyrimin e OST sh.a. për hartimin e kodit të transmetimit, në të njëjtën kohë në gjermen (ç) përcakton se OST sh.a. siguron ofrimin e shërbimeve të sistemit në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese, në bazë të parimit të kostos dhe ndikimit mjedisor më të ulët, gjithashtu edhe në gjërma të tjera të këtij neni gjërma (gj) dhe (h) vihet theksi tek realizimi i funksioneve të OST sh.a. në mënyrë jodiskriminuese.
- **Kodi i Lidhjes me Sistemin e Transmetimit. Neni 37; Pika/Vendi - Vlen për t'u theksuar se OSSH ka bërë komentet e veta në lidhje me Kodin e Rrjetit dhe më specifikisht me gjeneruesit e tipit A, B, C dhe ka sqaruar se në rrjetin aktual të OSSH nuk mund të lidhen Gjenerues me fuqi më të madhe se 10 MW, pra gjenerues të tipit A, B. Ky koment shumë i rëndësishëm i OSSH sh.a., prezantuar edhe në ERE dhe shoqëruar me një analizë të plotë të pamundësisë së lidhjes së gjeneruesve të tjerë në rrjetin e OSSH sh.a., vërejmë se nuk është marrë parasysh në Kodin e Lidhjes. I njëjti koment vlen edhe për detyrimet që parashikohen nga draft Kodi i Transmetimit dhe që e ngarkon OSSH sh.a. në ruajtjen e diapazonit të Tensionit, shkycjeve, tarimeve dhe mbrojtjes rele për gjeneruesit A, B, C të lidhur në rrjetin e Shpërndarjes.**
- Në lidhje me këtë çështje OST sh.a. parashtron se Kodi për Kërkesat për Lidhjen e Gjeneruesve i miratuar me vendimin e ERE nr. 129, dt. 04/06/2018, i cili praktikisht është transpozim i Rregullores së Komisionit (BE) nr. 2016/631, dt. 14/05/2016, specifikon në preambulën e tij, pika 10, se duke pasur parasysh nivelin e ndryshem të tensionit në të cilin janë lidhur gjeneratorët dhe kapacitetin e tyre maksimal gjenerues, kjo rregullore ben dallimin (kategorizimin A, B, C, D) midis llojeve të ndryshme të gjeneratorëve duke vendosur nivele të ndryshme kërkesash. Kjo rregullore nuk përcakton rregullat për përcaktimin e nivelit të tensionit të pikës së lidhjes në të cilën do të lidhet moduli gjenerues.
- ERE vlerëson se Kodi i Transmetimit në vetëvete është një dokument i cili përcakton marrëdhëniet dhe kriteret teknike ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesve të rrjetit të transmetimit. Në rastin konkret përcakton marrëdhëniet dhe kriteret teknike ndërmjet OST dhe OSSH sh.a.. Marrëdhëniet ndërmjet përdoruesve të sistemit të shpërndarjes dhe të OSSH sh.a. përcaktohen në dokumenta të tjerë respektivisht në kodin e Rrjetit të shpërndarjes. Në këto rrethana propozimi i bërë nga OSSH sh.a. se në rrjetin e shpërndarjes nuk mund të lidhen gjenerues me fuqi më të madhe se 10 MW duhet të adresohet në Kodin e Shpërndarjes dhe jo në Kodin e Transmetimit.
- Nëse OSSH sh.a. e gjykon të nevojshme rishikimin e akteve të tjera, respektivisht Kodit për Kërkesat për Lidhjen e Gjeneruesve i miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 129, datë 04.06.2018, duhet të bëjë propozimet përkatëse të argumentuara në ERE. Në këto rrethana gjykojmë që kjo problematikë e referuar nga OSSH sh.a. është adresuar jo në dokumentin e duhur dhe për rrjedhojë nuk mund të merret në konsideratë. OSSH sh.a. ka gjithë mundësinë dhe hapsirat ligjore për të propozuar në mënyrë të argumentuar këtë shqetësim me procesin e shqyrtimit të Kodit të Shpërndarjes në ERE, si dhe të vlerësojë mundësinë për propozime në akte të tjera nëse e gjykon të nevojshme.

- **Shkëmbimi i të dhënave. Neni 125** “Nëse nuk përcaktohet ndryshe. OSSH sh.a. duhet t’i sigurojë në kohë reale OST sh.a. informacionin që lidhet me zonat e vëzhgimit të OST sh.a. “Eshtë e qartë që duhet të ridiskutohet ky nen me OST sh.a. dhe të merret parasysh që në gjendjen aktuale, par edhe në një periudhë të afërt kjo mënyrë shkëmbimi informacioni nuk mund të jetë e disponueshme.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 85, datë 12.05.2020, miratoi “Kriteret për të vendosur derogime për modulet gjeneruese të energjisë elektrike”. Në këtë akt rregullator parashikohet se në kuptim të nenit 60, të “Kodit të Rrjetit mbi Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin e Gjeneruesve” si transpozim i Rregullores KE 2016/631, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 129, datë 04.06.2018, autoriteti rregullator (ERE) mundet t’i japi gjeneruesve egzistues ose gjeneruesve të ardhshëm, derogime sipas një ose më shumë dispozitave kodit. Në të njëjtën kohë e drejta për të kërkuar derogime/pezullim është përcaktuar edhe në Kodin e Transmetimit miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017, ndryshuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 129, datë 04.06.2018, respektivisht neni 12. Pezullimet e Përkohshme pika (1): *Në rastet kur një përdorues i Rrjetit të Transmetimit nuk mund t’i përmbushë plotësisht dhe/ose pjesërisht kërkesat e Kodit është i detyruar të kërkojë dhe aplikojë menjëherë për pezullim të përkohshëm pranë OST-së, duke informuar edhe ERE-n.*
- **Sa i takon nivelit të tensionit të paraqitur në Aneksin II, vlerat janë paraqitur në p.u. dhe variojnë në 0.9 p.u. - 1.118 p.u. (Në ndryshim nga Kodi aktual i Shpërndarjes) dhe koha është "pa kufizim.** *Mbajtja e këtyre niveleve të tensionit - pa kufizim, e vendos OSSH sh.a. në gjendje të vështirë në shfrytëzimin e transformatorëve të fuqisë, pasi duhet të jenë të pajisur me tap changers dhe teknologji monitorimi në kohë reale dhe në distancë (SCADA/SCADA lokale) në mënyrë që t’ju përgjigjen niveleve të tensionit në nivelet e tjera të transformimit më poshtë. Ndërkohë që sipas Rregullores së treguesve të cilësisë së furnizimit, i miratuar nga ERE, OSSH sh.a. penalizohet sa i takon Sigurisë së ruajtjes së nivelit të tensionit në konsumatorët fundorë.*
- Vlerësojmë se vlen të përmendim që Kodi i Shpërndarjes është miratuar me vendimin nr. 100, datë 26.08.2008, të bordit të ERE. Sikurse evidentohet Kodi i shpërndarjes është miratuar rreth 14 vjet më parë dhe nuk reflekton gjendjen dhe statusin aktual të zhvillimit të rrjetit. OSSH sh.a. bazuar në nenin 73, të ligjit nr. 43/2015, të ndryshuar, respektivisht pikës (2), të këtij ligji e cila përcakton se: “Kodi i Shpërndarjes miratohet nga ERE, me propozim të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, i cili bashkëpunon me të gjithë pjesëmarrësit e sektorit të energjisë elektrike, me qëllim hartimin, rishikimin apo përshtatjen e tij”.
- Kodi i Shpërndarjes të cilit i referohet OSSH sh.a. për çështjet që lidhen me nivelin e tensionit është miratuar me vendim të bordit të ERE-s nr. 100, datë 26.08.2008 dhe reflekton një stad tjetër të zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike në vendin tonë dhe nuk pasqyron gjendjen aktuale apo dhe detyrimet ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 43/2015 i ndryshuar, i cili ka dalë më vonë dhe ka zëvendësuar ligjin nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, që ka shërbyer si bazë për hartimin e kodit të shpërndarjes së energjisë elektrike me vendimin e bordit të ERE-s nr. 100, datë 26.08.2008. OSSH sh.a. nuk ka percjellë ne kohe ne ERE draftin e Kodit të Shpërndarjes, për shqyrtim dhe miratim, sipas përcaktimeve të ligjit 43/2015, “Për sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e Kodit të Transmetimit, sipas tekstit bashkëlidhur:

2. OST sh.a. duhet të rishikojë dhe të plotesoje të gjitha aktet që ndikohen nga ndryshimet në Kodin e Transmetimit përfshirë marrëveshjen e operimit dhe t'i përcejellë ato në ERE konform përcaktimeve ligjore në fuqi deri më 30 Prill 2023.
3. OST duhet të raportoje në ERE cdo 3 muaj mbi permbushjen e pikes 2, te ketij vendimi.
4. Shfuqizimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017, me hyrjen ne fuqi te ketij vendimi.
5. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Inspektimeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqimë datë 1 Korrik 2022.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

KODI I TRANSMETIMIT

Tirane 2022

Përkufizime

Në këtë kod janë përdorur termat që përkufizohen si më poshtë:

siguria operationale - do të thotë aftësia e sistemit të transmetimit për të mbajtur një gjendje normale ose për t'u kthyer në një gjendje normale sa më shpejt të jetë e mundur dhe që karakterizohet nga kufijtë e sigurisë operationale;

kufizim - nënkupton situatën në të cilën ekziston nevoja për përgatitjen dhe aktivizimin e një veprimi përmirësues në mënyrë që të respektohen kufijtë e sigurisë së operimit;

situata N - nënkupton situatën ku (pasi janë hequr elementet e planifikuara për remont) asnjë element (tjetër) i transmetimit nuk është i pa-disponueshem, kur konsiderohet ndodhja e një kontingjence (stakimi);

listë e kontingjencave - do të thotë lista e elementeve të rrjetit që duhet të simulohen në analizën e kontingjencave (ngjarjeve të paparashikuara) për të provuar pajtueshmërinë me kufijtë e sigurisë operationale;

gjendje normale - nënkupton një situatë në të cilën sistemi është brenda kufijve të sigurisë operationale në situatën N edhe pas ndodhjes së çdo kontingjence nga lista e kontingjencave, duke marrë parasysh edhe efektin e veprimeve përmirësuese në dispozicion;

rezervat e mbajtjes së frekuencës (FCR) - nënkupton rezervat e fuqisë aktive të disponueshme për të mbajtur frekuencën e sistemit pas shfaqjes së një disbalance;

rezervat e restaurimit të frekuencës (FRR) - nënkupton rezervat të fuqisë aktive në dispozicion për të rivendosur frekuencën e sistemit në frekuencën nominale dhe për rajonin tonë që përbëhet nga më shumë se një zonë LFC, për të rivendosur ekuilibrin e energjisë në vlerën e skeduar;

rezerva zëvendësuese (RR) - nënkupton rezervat aktive të energjisë që janë në dispozicion për të rivendosur ose mbështetur nivelin e kërkuar të FRR që të përgatitet për disbalanca shitesë të sistemit, duke përfshirë rezervat e gjenerimit;

siguruesi i rezervës - nënkupton një person juridik me një detyrim ligjor ose kontraktual për të furnizuar FCR, FRR ose RR nga të paktën një njësi siguruese rezerve ose grup i sigurimit të rezervës;

njësi siguruese e rezervës - do të thotë një njësi ose një bashkim i moduleve gjeneruese të energjisë dhe / ose njërive të ngarkesës të lidhura me një pikë lidhjeje të përbashkët që plotëson kërkesat për të siguruar FCR, FRR ose RR;

grup i sigurimit të rezervës - do të thotë një grumbullim i moduleve gjeneruese të energjisë, njërive të ngarkesës dhe / ose njërive të sigurimit të rezervës të lidhura me më shumë se një pikë lidhjeje që plotësojnë kërkesat për të siguruar FCR, FRR ose RR;

zona e kontrollit fuqi - frekuencës ose 'zona e LFC-së' - nënkupton një pjesë të një zone sinkrone ose një zone të tërë sinkrone, e përcaktuar fizikisht nga pikat e matjes në interkonektorët me zona të tjera të LFC-së, të operuara nga një ose më shumë OST që përmbushin detyrimet e kontrollit fuqi-frekuencë;

koha për rivendosjen e frekuencës - do të thotë koha maksimale e pritshme pas shfaqjes së një disbalance të menjëhershme të fuqisë, me madhësi më të vogël ose të barabartë me incidentin reference, në të cilin frekuenca e sistemit kthehet në intervalin e restaurimit të frekuencës për zonat sinkrone me vetëm një zonë LFC, dhe në rastin e zonave sinkrone me më shumë se një zonë LFC (rajoni jone), do të thotë koha maksimale e pritshme pas shfaqjes së një disbalance të menjëhershme të fuqisë të një zone LFC brenda së cilës disbalanca kompensohet;

kriteri (N-1) - do të thotë rregulli sipas të cilit elementet që mbeten në operim brenda zonës së kontrollit të OST-se pas ndodhjes së një kontingjence janë të afta për të akomoduar situatën e re operative pa shkelur kufijtë e sigurisë operationale;

situata (N-1) - nënkupton situatën në sistemin e transmetimit në të cilën ka ndodhur një kontingjence nga lista e kontingjencave;

rezerva e energjisë aktive - nënkupton rezervat balancuese të disponueshme për mbajtjen e frekuencës;

gjendje alarmi - nënkupton gjendjen e sistemit në të cilin sistemi është brenda kufijve të sigurisë operative, por është konstatuar një kontingjence nga lista e kontingjencave, që në rast të ndodhjes së saj, veprimet përmirësuese në dispozicion nuk janë të mjaftueshme për të mbajtur gjendjen normale;

bllok kontrolli i fuqi frekuencës ose "bllok LFC" - nënkupton një pjesë të një zone sinkrone ose të një zone të tërë sinkrone, e përcaktuar fizikisht nga pikat e matjes në interkonektorët me blloqe të tjera të LFC, të përbërë nga një ose më shumë zona LFC, të operuara nga një ose më shumë OST që përmbushin detyrimet e kontrollit të fuqi - frekuencës;

gabim i kontrollit të zonës' ose 'ACE' - nënkupton shumën e gabimit të kontrollit të fuqisë (ΔP), domethënë ndryshimi në kohë reale ndërmjet vlerës së matur të shkëmbimit të fuqisë aktive (P) dhe programit të kontrollit (P_0) të një zone të veçantë LFC ose blloku LFC, dhe gabimi i kontrollit të frekuencës ($K * \Delta f$), që është produkti i faktorit K dhe devijimit të frekuencës së asaj zone specifike LFC ose blloku LFC, pra, gabimi i kontrollit të zonës është i barabartë me $\Delta P + K * \Delta f$;

programi i kontrollit - nënkupton një sekuencë të vlerave të vendosura për shkëmbimin e fuqisë neto të një zone LFC ose blloku LFC, për interkonektorët e rrymës alternative. Rezulton si shumë e programit të shkëmbimit të nominuar me programin e kompensimit dhe shërben si input për LFC;

kontrolli i tensionit - nënkupton veprimet manuale ose automatike të kontrollit në nyjen e prodhimit, në nyjet fundore të linjave AC ose sistemeve HVDC, në transformatorë ose mjete të tjera, të dizajnuara për të ruajtur nivelin e caktuar të tensionit ose vlerën e vendosur të fuqisë reaktive;

gjendje e rënies së sistemit - nënkupton gjendjen e sistemit në të cilin ndërpritet operimi i një pjese ose të gjithë sistemit të transmetimit;

kontingjencë e brendëshme - nënkupton një kontingjencë brenda zonës së kontrollit të OST-së, duke përfshirë interkonektorët;

kontingjencë e jashtme - nënkupton një kontingjencë jashtë zonës së kontrollit të OST-së dhe përjashton interkonektorët, me një faktor ndikimi më të lartë se pragu i ndikimit të kontingjencës;

faktori i ndikimit - nënkupton vlerën numerike të përdorur për të përcaktuar efektin më të madh të stakimit të një elementi të sistemit të transmetimit që ndodhet jashtë zonës së kontrollit të OST-së duke përjashtuar interkonektorët, në kuptimin e një ndryshimi në rrjedhat e fluksit të fuqisë ose tensionit të shkaktuar nga stakimi në fjalë, në çdo element të sistemit. Sa më e lartë është vlera aq më i madh është efekti;

pragu i ndikimit të kontingjencës - nënkupton një vlerë kufi numerike përkundrejt së cilës kontrollohen faktorët e influencës, dhe ndodhja e një kontingjence të vendosur jashtë zonës së kontrollit të OST-së me një faktor ndikimi më të lartë se pragu i ndikimit të kontingjencës konsiderohet të ketë një ndikim të rëndësishëm në zonën e kontrollit të OST duke përfshirë interkonektorët;

analiza e kontingjencave - nënkupton një simulim kompjuterik të rasteve të kontingjencave nga lista e kontingjencave;

koha kritike për pastrimin e defekteve - do të thotë kohëzgjatja maksimale e defektit për të cilën sistemi i transmetimit mbetet në operim të qëndrueshëm;

avari/defekt - nënkupton të gjitha llojet e lidhjeve të shkurtra (një, dy dhe tre fazore, me dhe pa kontakt me tokën), një përcjellës i këputur, qark i hapur, ose një lidhje e paqëndrueshme që rezulton në daljen nga puna të elementit të prekur të sistemit të transmetimit;

element i sistemit të transmetimit - nënkupton çdo element të sistemit të transmetimit;

shqetësim - nënkupton një ngjarje të paplanifikuar që mund të shkaktojë që sistemi i transmetimit të devijojë nga gjendja normale;

stabiliteti dinamik - është një term i përbashkët që përfshin stabilitetin e këndit të rotorit, stabilitetin e frekuencës dhe stabilitetin e tensionit;

vlerësimi i stabilitetit dinamik - nënkupton vlerësimin e sigorisë operationale në aspektin e stabilitetit dinamik;

stabiliteti i frekuencës - nënkupton aftësinë e sistemit të transmetimit për të ruajtur frekuencën e qëndrueshme në situatën N edhe pasi i është nënshtruar një shqetësimi;

stabiliteti i tensionit - nënkupton aftësinë e një sistemi transmetimi për të ruajtur tensione të pranueshme në të gjitha nyjet e sistemit në situatën N dhe pasi i është nënshtruar një shqetësimi;

gjendje e sistemit - nënkupton gjendjen operationale të sistemit të transmetimit në lidhje me kufijtë e sigorisë operationale, që mund të jenë gjendje normale, gjendje e alarmi, gjendje emergjente, gjendje e ndërprerjes (rënies) dhe gjendja e restaurimit;

gjendje emergjente - nënkupton gjendjen e sistemit në të cilin janë shkelur një ose më shumë kufij të sigorisë operationale;

gjendje restaurimi - nënkupton gjendjen e sistemit në të cilin objektivi i të gjitha veprimtarive në sistemin e transmetimit është rivendosja e funksionimit të sistemit dhe mirëmbajtja e sigorisë operationale pas gjendjes së ndërprerjes ose gjendjes emergjente;

kontingjencë e jashtëzakonshme - nënkupton shfaqjen e njëkohshme të shumë kontingjencave me një shkak të përbashkët;

devijimi i frekuencës - nënkupton diferencën midis frekuencës aktuale dhe asaj nominale të zonës sinkronike e cila mund të jetë negative ose pozitive;

frekuenca e sistemit - nënkupton frekuencën elektrike të sistemit që mund të matet në të gjitha pjesët e zonës sinkronike nën supozimin e një vlere koherente për sistemin në kornizën kohore të sekondave, me dallime të vogla ndërmjet vendndodhjeve të ndryshme të matjes;

proces i restaurimit të frekuencës (FRP) - nënkupton një proces që synon rivendosjen e frekuencës në frekuencën nominale dhe për zonat sinkrone që përbëhen nga më shumë se një zonë LFC, një proces që synon rivendosjen e balancës së fuqisë në vlerën e planifikuar;

gabimi i kontrollit të restaurimit të frekuencës (FRCE) - do të thotë gabimi i kontrollit për FRP i cili është i barabartë me ACE të një zone LFC ose e barabartë me devijimin e frekuencës kur zona LFC gjeografikisht korrespondon me zonën sinkrone;

skedulim - nënkupton një grup referencë të vlerave që përfaqësojnë prodhimin, konsumin ose shkëmbimin e energjisë elektrike për një periudhë kohore të dhënë;

faktori K i një zone LFC ose blloku LFC - do të thotë një vlerë e shprehur në megavat për hertz (MW/Hz), e cila është aq e afërt sa është e mundur praktikisht ose më e madhe se shuma e kontrollit automatik të gjenerimit, vetë-rregullimit të ngarkesës dhe i kontributit të rezervës së mbajtjes së frekuencës në lidhje me devijimin maksimal të frekuencës në situatë të qëndrueshme;

gjendje lokale - nënkupton kualifikimin e një gjendje alarmi, emergjence ose ndërprerjeje kur nuk ka rrezik për zgjerimin e pasojave jashtë zonës së kontrollit përfshirë interkonektorët e lidhur me këtë zonë kontrolli;

devijimi maksimal i frekuencës në situatë të qëndrueshme - nënkupton devijimin maksimal të frekuencës së pritshme pas shfaqjes së një disbalance të barabartë ose më të vogël se incidenti referues në të cilin frekuenca e sistemit është projektuar të stabilizohet;

zonë e observimit - nënkupton sistemin e transmetimit të OST-së dhe pjesët relevante të sistemit të shpërndarjes dhe sistemeve transmetuese të OST-ve fqinjë, në të cilat OST zbaton monitorim dhe modelim në kohë reale për të ruajtur sigurinë operationale në zonën e saj të kontrollit duke përfshirë interkonektorët;

OST-të fqinje - do të thotë OST-të të lidhura direkt përmes të paktën një interkonektori AC ose DC;

analiza e sigurisë operationale - do të thotë gjithë fushëveprimi i aktiviteteve kompjuterike, manuale dhe automatike të kryera për të vlerësuar sigurinë operationale të sistemit të transmetimit dhe për të vlerësuar veprimet përmirësuese të nevojshme për ruajtjen e sigurisë operationale;

tregues të sigurisë operationale - nënkupton treguesit e përdorur nga OST për të monitoruar sigurinë operationale në aspektin e gjendjeve të sistemit, si dhe avaritë dhe shqetësimet që ndikojnë në sigurinë operationale;

rendi operativ i sigurisë - do të thotë renditja e përdorur nga OST për të monitoruar sigurinë operationale në bazë të treguesve të sigurisë operationale;

testet operationale - nënkupton testet e kryera nga OST ose OSSH për mirëmbajtjen, zhvillimin e praktikave të operimit të sistemit dhe trajnimin dhe për të marrë informacion mbi sjelljen e

sistemit të transmetimit në kushte anormale të sistemit dhe testet e kryera nga përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit për qëllime të ngjashme në objektet e tyre;

kontingjencë e zakonshme - do të thotë ndodhja e një kontingjence në një dege (linje) ose injektim (gjenerim) të vetëm;

kontingjencë jashtë diapazonit - nënkupton shfaqjen e njëkohshme të kontingjencave të shumta pa një shkak të përbashkët ose humbjen e moduleve gjeneruese të energjisë me një humbje totale të kapacitetit prodhues që tejkalon incidentin referues;

shkalla e pjerrësisë - nënkupton shkallën e ndryshimit të fuqisë aktive nga një modul gjenerues i energjisë, një objekt i kërkesës ose i sistemit HVDC;

rezervë e fuqisë reaktive - është fuqia reaktive e cila është e disponueshme për mbajtjen e tensionit;

incidenti referencë - do të thotë devijimi maksimal i fuqisë, pozitive ose negative, që ndodh menjëherë midis gjenerimit dhe kërkesës në një zonë sinkrone, e konsideruar në dimensionimin e FCR;

stabiliteti i këndit të rotorit - do të thotë aftësia e makinave sinkrone që të mbeten në sinkronizëm në situatën N dhe pasi të jenë subjekt i një shqetësimi;

plan sigurie - nënkupton planin që përmban një vlerësim të riskut të aseteve kritike të OST-së ndaj skenarëve kryesorë të kërcënimit fizik dhe kibernetik me një vlerësim të ndikimeve të mundshme;

kufijtë e stabilitetit - nënkupton kufijtë e lejuar për funksionimin e sistemit të transmetimit në drejtim të respektimit të kufijve të stabilitetit të tensionit, stabilitetit të këndit të rotorit dhe stabilitetit të frekuencës;

gjendja me shtrirje në shkallë të gjerë - nënkupton kualifikimin e një gjendje alarmi, gjendjes së emergjencës ose gjendjes black-out kur ekziston rreziku i përhapjes në sistemet e transmetimit të ndërlydhura;

plani i mbrojtjes së sistemit - nënkupton masat teknike dhe organizative që duhet të ndërmerren për të parandaluar përhapjen ose përkeqësimin e një shqetësimi në sistemin e transmetimit, me qëllim që të shmangët shtrirja e gjerë e situatës së shqetësimit ose e black-out;

topologji - nënkupton të dhënat që kanë të bëjnë me lidhjen e elementeve të ndryshme të transmetimit ose të shpërndarjes në një nënstacion dhe përfshin konfigurimin elektrik dhe pozicionin e çelësave dhe të ndarësve;

mbingarkesat e lejuara kalimtare - nënkupton mbingarkesat e përkohshme të elementeve të sistemit të transmetimit të cilat lejohen për një periudhë të kufizuar dhe të cilat nuk shkaktojnë dëm fizik të elementëve të sistemit të transmetimit për aq kohë sa të respektohen kohëzgjatja dhe pragu i përcaktuar;

interkonektor virtual - nënkupton një input shtesë në kontrollorët e LFC-se (rregullimi sekondar) të zonave të përfshira në LFC, që kanë të njëjtin efekt si një vlerë matëse e një interkonektori fizik dhe lejon shkëmbimin e energjisë elektrike ndërmjet zonave përkatëse;

sisteme fleksibile të transmetimit të rrymës alternative (FACTS) - do të thotë pajisje për transmetimin e rrymës alternative të energjisë elektrike, me qëllim të rritjes së kontrollit dhe rritjes së kapacitetit transmetues të fuqisë aktive;

njaftueshmëria - nënkupton aftësinë e furnizimit (gjenerimit) në një zonë për të plotësuar ngarkesën (kërkesën) në atë zonë;

skedulimi i jashtëm neto i grumbulluar - nënkupton një skedulim që përfaqëson grumbullimin e netuar të të gjitha skeduleve të jashtme të OST-se dhe skedulet e tregtisë së jashtme komerciale midis dy zonave të skedulimit ose midis një zone skedulimi dhe një grupi të zonave të tjera të skedulimit;

plani i disponueshmërisë - nënkupton kombinimin e të gjitha gjendjeve të disponueshmërisë të planifikuara për një aset të rëndësishëm për një periudhë të dhënë kohe;

gjendja e disponueshmërisë - nënkupton aftësinë e një moduli gjenerues të energjisë, elementi të rrjetit ose objekti të kërkesës për të siguruar një shërbim për një periudhë kohore të caktuar, pavarësisht nëse është në operim ose jo;

afër kohës reale - nënkupton kalimin e kohës prej jo më shumë se 15 minuta ndërmjet mbylljes së fundit të portës brenda ditës (intraday) dhe kohës reale;

skedulimi i konsumit - nënkupton një skedul që përfaqëson konsumin e një objekti ngarkese ose të një grupi të objekteve të ngarkesës;

platforma e të dhënave të planifikimit operacional të energjisë elektrike të ENTSO-E - do të thotë grupi i programeve të aplikimit dhe pajisjeve të zhvilluara për të lejuar ruajtjen, shkëmbimin dhe menaxhimin e të dhënave të përdorura për proceset e planifikimit operativ ndërmjet OST-ve;

skeduli komercial i tregtisë së jashtme - nënkupton një skedul që përfaqëson shkëmbimin tregtar të energjisë elektrike ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në zona të ndryshme skedulimi;

skedulimi i jashtëm i OST-së - nënkupton skedulim që përfaqëson shkëmbimin e energjisë elektrike ndërmjet OST-ve në zona të ndryshme skedulimi, për ndarjen, shkëmbimin e rezervave për qëllime balancimi;

ndërprerje e detyruar - nënkupton daljen e paplanifikuar nga shërbimi te një aseti të rëndësishëm për ndonjë arsye urgjente që nuk është nën kontrollin operacional të operatorit përkatës (OST, OSSH ose SGU);

skedulimi i gjenerimit - nënkupton një skedulim që përfaqëson prodhimin e energjisë elektrike të një moduli gjenerues të energjisë ose të një grupi të moduleve gjeneruese të energjisë;

skedulimi i tregtisë së brendshme komerciale - nënkupton një skedul që përfaqëson shkëmbimin komercial të energjisë elektrike brenda një zone skedulimi ndërmjet pjesëmarrësve të ndryshëm të tregut;

aset i rëndësishëm i brendshëm - nënkupton një aset të rëndësishëm i cili është pjesë e zonës së kontrollit të OST ose një aset i rëndësishëm që ndodhet në një sistem shpërndarje, përfshirë një sistem të mbyllur shpërndarje, i cili është i lidhur direkt ose indirekt me zonën e kontrollit të OST-se;

pozicioni neto AC i zonës - nënkupton shumën neto të të gjitha skeduleve të jashtme të zonës së kontrollit të OST;

rajoni i koordinimit të ndërprerjeve - nënkupton një kombinim të zonave të kontrollit për të cilat OST-të përcaktojnë procedurat për të monitoruar dhe kur është e nevojshme të koordinojnë statusin e disponueshmërisë të aseteve të rëndësishme në të gjitha afatet kohore;

objekt konsumator i rëndësishëm - nënkupton një objekt ngarkese që merr pjesë në koordinimin e ndërprerjeve dhe statusin e disponueshmërisë, i cili ndikon në sigurinë operacionale ndërkufitare;

aset i rëndësishëm - nënkupton çdo objekt konsumator të rëndësishëm, modul gjenerues të rëndësishëm, ose element të rëndësishëm të rrjetit që marrin pjesë në koordinimin e ndërprerjeve;

element i rëndësishëm i rrjetit - nënkupton çdo komponent të sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkonektorët, ose një sistem shpërndarjeje, duke përfshirë një sistem të shpërndarjes së mbyllur, si një linjë e vetme, një qark i vetëm, një transformator i vetëm, ose një instalim kompensimi të tensionit, i cili merr pjesë në koordinimin e ndërprerjeve dhe statusi i disponueshmërisë së të cilave ndikon në sigurinë operacionale ndërkufitare;

pa-pajtueshmëria e planifikimit të ndërprerjeve - nënkupton gjendjen në të cilën një kombinim i statusit të disponueshmërisë së një ose më shumë elementeve të rëndësishëm të rrjetit, module të rëndësishëm të gjenerimit të energjisë dhe/ose objekte të rëndësishëm të kërkesës, dhe vlerësimi më i mirë i gjendjes së parashikuar të rrjetit të energjisë elektrike çon në shkelje të limiteve të sigurisë duke marrë parasysh veprimet korrigjuese pa kosto që janë në dispozicion të OST-së;

agjent i planifikimit të ndërprerjeve - nënkupton një entitet me detyrën e planifikimit të statusit të disponueshmërisë së një moduli të rëndësishëm gjenerues të energjisë, një objekti të rëndësishëm të ngarkesës ose një elementi të rëndësishëm të rrjetit;

modul i rëndësishëm gjenerues i energjisë - nënkupton një modul gjenerues të energjisë që merr pjesë në koordinimin e ndërprerjeve dhe statusi i disponueshmërisë i të cilit ndikon në sigurinë operacionale ndërkufitare;

koordinator rajonal i sigurisë (RSC) - nënkupton entitetin ose entitetet, të zotëruara ose të kontrolluara nga OST-të, në një ose më shumë rajone të llogaritjes së kapaciteteve që kryejnë detyra që lidhen me koordinimin rajonal të OST-ve;

agjent skedulimi - nënkupton entitetin ose entitetet me detyrën e sigurimit të skeduleve nga pjesëmarrësit e tregut tek OST, ose në palët e treta aty ku është e zbatueshme;

zonë skedulimi - nënkupton zonën brenda së cilës zbatohen detyrimet e OST në lidhje me skedulimin për shkak të nevojave të operimit ose organizative;

java në avancë - nënkupton një javë para javës kalendarike të operimit;

viti në avancë - nënkupton një vit para vitit kalendarik të operimit;

OST e ndikuar - nënkupton një OST, për të cilin nevojitet informacion mbi shkëmbimin e rezervave dhe/ose ndarjen e rezervave dhe/ose procesin e netimit të disbalancës dhe/ose procesin e aktivizimit ndërkufitar për analizimin dhe mirëmbajtjen e sigurisë së operimit;

kapaciteti rezervë - nënkupton sasinë e FCR, FRR ose RR që duhet të jetë e disponueshme për OST;

shkëmbimi i rezervave - nënkupton mundësinë e një OST-je për të hyrë në kapacitetin rezervë të lidhur me një zonë/bllok tjetër të LFC-së, ose zone tjetër sinkrone, për të plotësuar kërkesat e rezervës që rrjedhin nga procesi i saj i dimensionimit të FCR, FRR ose RR, dhe ku kjo rezervë kapaciteti është ekskluzivisht për atë OST dhe nuk merret parasysh nga ndonjë OST tjetër për të përmbushur kërkesat e saj për rezervë që rezultojnë nga proceset përkatëse të dimensionimit të rezervës;

ndarja e rezervave - nënkupton një mekanizëm në të cilin më shumë se një OST kanë të njëjtin kapacitet rezervë, që mund të jetë FCR, FRR ose RR, për të përmbushur kërkesat e tyre përkatëse për rezervë që rezultojnë nga proceset e tyre të dimensionimit të rezervës;

koha e lëshimit të gjendjes së alarmit - nënkupton kohën para se të bëhet aktivizimi i situatës së alarmit;

FRR automatike (aFRR) - do të thotë FRR që mund të aktivizohet nga një pajisje automatike e kontrollit;

vonesa e aktivizimit të FRR automatike - nënkupton periudhën kohore midis vendosjes së një vlere të re të caktuar nga rregullatori i restaurimit të frekuencës dhe fillimit të livrimit fizik automatik të FRR;

koha e plotë e aktivizimit të aFRR - nënkupton periudhën kohore ndërmjet vendosjes së një vlere të re të caktuar nga rregullatori i restaurimit të frekuencës dhe aktivizimit ose çaktivizimit përkatës të aFRR;

të dhënat mesatare të FRCE (ACE) - nënkupton grupin e të dhënave që përbëhet nga vlera mesatare e vlerave të çastit të ACE të regjistruara në një zonë/bllok LFC brenda një periudhe kohe të caktuar;

OST që ofron aftësinë e kontrollit - do të thotë OST-ja që bën aktivizimin e kapacitetit të saj rezervë për një OST (tjetër) që merr aftësinë e kontrollit, në kushtet e një marrëveshje për ndarjen e rezervave;

OST që merr aftësinë e kontrollit - nënkupton OST-ne që llogarit kapacitetin duke marrë parasysh kapacitetin rezervë i cili është i arritshëm nëpërmjet një aftësie kontrolli që ofrohet nga OST-ja siguroese (dhënëse), në kushtet e një marrëveshje për ndarjen e rezervave;

procesi i aplikimit të kriterëve - nënkupton procesin e llogaritjes së parametrave të synuar për zonën sinkrone, bllokun LFC dhe zonën LFC, bazuar në të dhënat e marra në procesin e grumbullimit dhe shpërndarjes së të dhënave;

procesi i mbledhjes dhe i shpërndarjes së të dhënave - nënkupton procesin e mbledhjes së grupit të të dhënave të nevojshme për të përmbushur kriteret e vlerësimit të cilësisë së frekuencës;

procesi i aktivizimit ndërkufitar të FRR - do të thotë një proces i dakorduar midis OST-ve pjesëmarrëse në procesin që lejon aktivizimin e FRR të lidhur në një zonë tjetër të LFC duke korrigjuar inputin e FRP-ve të përfshira;

procesi i aktivizimit ndërkufitar të RR - do të thotë një proces i dakorduar midis OST-ve pjesëmarrëse në procesin që lejon aktivizimin e RR të lidhur në një zonë tjetër të LFC duke korrigjuar inputin e RRP të përfshira;

incidenti i dimensionuar - nënkupton disbalancën e fuqisë aktive më të lartë të pritshme që shfaqet menjëherë brenda një blloku LFC në të dy drejtimet pozitive dhe negative;

devijimi i kohës elektrike - nënkupton mospërputhjen kohore midis kohës sinkrone dhe kohës së koordinuar universale ('UTC');

devijimi i frekuencës për aktivizimin e plotë të FCR - nënkupton vlerën nominale të devijimit të frekuencës në të cilën FCR në një zonë sinkrone është aktivizuar plotësisht;

koha e plotë e aktivizimit të FCR - nënkupton periudhën kohore ndërmjet ndodhjes së incidentit referues dhe aktivizimit të plotë të FCR;

detyrimi i FCR - nënkupton atë pjesë të totalit të FCR (për zonën sinkrone) që bie nën përgjegjësinë e një OST-je;

procesi i mbajtjes së frekuencës (FCP) - nënkupton një proces që synon stabilizimin e frekuencës së sistemit duke kompensuar disbalancat me anë të rezervave të përshtatshme;

procesi i çiftimit të frekuencës - nënkupton një proces të dakorduar midis të gjitha OST-ve të dy zonave sinkrone që lejon lidhjen e aktivizimit të FCR me anë të përshtatjes së flukseve të HVDC ndërmjet zonave sinkrone;

parametri përcaktues i cilësisë së frekuencës - nënkupton variablet kryesore të frekuencës së sistemit që përcaktojnë parimet e cilësisë së frekuencës;

parametri i synuar i cilësisë së frekuencës - nënkupton objektivin kryesor të frekuencës së sistemit në të cilin vlerësimi i sjelljes së proceseve të aktivizimit të FCR, FRR dhe RR është në gjendje normale;

kriteri i vlerësimit të cilësisë së frekuencës - nënkupton një sërë llogaritjesh duke përdorur matjet e frekuencave të sistemit që lejojnë vlerësimin e cilësisë së frekuencës së sistemit kundrejt parametrave të synimit të cilësisë së frekuencës;

të dhënat e vlerësimit të cilësisë së frekuencës - do të thotë grupi i të dhënave që lejon llogaritjen e kriterëve të vlerësimit të cilësisë së frekuencës;

parametri i synuar i FRCE (ACE) - nënkupton variablet kryesore target të bllokut LFC, në bazë të të cilave përcaktohen dhe vlerësohen kriteret e dimensionimit për FRR dhe RR të bllokut LFC dhe përdoren për të reflektuar sjelljen e bllokut LFC në funksionimin normal;

shkëmbimi i fuqisë së restaurimit të frekuencës - nënkupton fuqinë e cila shkëmbehet ndërmjet zonave LFC brenda procesit të aktivizimit ndërkufitar të FRR;

pika e punës së frekuencës - nënkupton vlerën e synuar të frekuencës të përdorur në FRP, e përcaktuar si shuma e frekuencës nominale të sistemit dhe një vlere kompensimi e nevojshme për të reduktuar devijimin e kohës elektrike;

kërkesat e disponueshmërisë të FRR - nënkupton një sërë kërkesash të përcaktuara nga OST-të e një blloku LFC lidhur me disponueshmërinë e FRR;

rregullat e dimensionimit të FRR - nënkupton specifikimet e procesit të dimensionimit të FRR të një blloku LFC;

procesi i netimit të disbalancave - do të thotë një proces i rënë dakord midis OST-ve që lejon shmangien e aktivizimit të njëkohshëm të FRR në drejtime të kundërta, duke marrë parasysh ACE-t përkatëse, si dhe FRR-në e aktivizuar dhe duke korigjuar sipas rastit inputet e FRP-ve të përfshira;

shkëmbimi i fuqisë së netimit të disbalancës - nënkupton fuqinë e cila shkëmbehet ndërmjet zonave LFC brenda procesit të netimit të disbalancës;

detyrimi fillestar për FCR - nënkupton sasinë e FCR të alokuar për një OST mbi bazën e një algoritmi të ndarjes së FCR për gjithë zonën sinkrone;

të dhëna të frekuencës së çastit - nënkupton një sërë matjesh të të dhënave të frekuencës së përgjithshme (mesatare) të sistemit për zonën sinkrone me një periudhë matjeje të barabartë ose më të shkurtër se një sekondë, e përdorur për qëllime të vlerësimit të cilësisë së frekuencës së sistemit;

devijimi i çastit i frekuencës - nënkupton një set matjesh të të dhënave të devijimeve të përgjithshme të frekuencës së sistemit për zonën sinkrone me një periudhë matjeje të barabartë ose më të shkurtër se një sekondë, e përdorur për qëllime të vlerësimit të cilësisë së frekuencës së sistemit;

të dhënat e çastit të ACE - nënkupton një grup të dhënash të ACE të një blloku LFC me një periudhë matjeje të barabartë ose më të shkurtër se 10 sekonda, të përdorur për qëllime të vlerësimit të cilësisë së frekuencës së sistemit;

diapazoni i ACE i nivelit 1 - nënkupton diapazonin e parë të përdorur për qëllimet e vlerësimit të cilësisë së frekuencës së sistemit në nivelin e bllokut LFC brenda të cilit ACE duhet të mbahet për një përqindje të caktuar të kohës;

diapazoni i ACE i nivelit 2 - nënkupton diapazonin e dytë të përdorur për qëllimet e vlerësimit të cilësisë së frekuencës së sistemit në nivelin e bllokut LFC brenda të cilit ACE duhet të mbahet për një përqindje të caktuar të kohës;

marrëveshje operationale e bllokut LFC - nënkupton një marrëveshje shumëpalëshe midis të gjithë OST-ve të një blloku LFC nëse blloku LFC operohet nga më shumë se një OST;

shkëmbimi i fuqisë zëvendësuese - nënkupton fuqinë e cila shkëmbehet ndërmjet zonave LFC brenda procesit të aktivizimit ndërkufitar të RR;

disbalanca e bllokut LFC - nënkupton shumen e ACE, aktivizimin e FRR dhe RR brenda bllokut LFC, shkëmbimin e fuqisë së netimit të disbalancës, shkëmbimin e fuqisë për rivendosjen e frekuencës dhe shkëmbimin e fuqisë zëvendësuese të këtij blloku LFC me blloqe të tjera LFC;

monitorimi i bllokut LFC - nënkupton një OST e ngarkuar për mbledhjen e të dhënave të kritereve të vlerësimit të cilësisë së frekuencës dhe zbatimin e kritereve të vlerësimit të frekuencës për bllokun e LFC;

struktura e kontrollit fuqi - frekuencë - nënkupton strukturën bazë duke marrë parasysh të gjitha aspektet relevante të kontrollit fuqi – frekuencë, në veçanti lidhur me përgjegjësitë dhe detyrimet përkatëse, si dhe llojet dhe qëllimet e rezervave të fuqisë aktive;

struktura e procesit të përgjegjësisë - nënkupton strukturën për të përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrimet në lidhje me rezervat aktive të energjisë bazuar në strukturën e kontrollit të zonës sinkrone;

struktura e aktivizimit të procesit - nënkupton strukturën për kategorizimin e proceseve që lidhen me llojet e ndryshme të rezervave të fuqisë aktive në kuptim të qëllimit dhe aktivizimit;

koha e aktivizimit të plotë të mFRR - nënkupton periudhën kohore midis ndryshimit të pikës së tarimit (set-point) dhe aktivizimit ose çaktivizimit përkatës manual të FRR;

devijimi maksimal i frekuencës së çastit - nënkupton vlerën absolute maksimale të pritshme e një devijimi të frekuencës së çastit pas shfaqjes së një disbalance të barabartë ose më të vogël se incidenti i referencës, përtej së cilës aktivizohen masat emergjente;

zonë monitorimi - nënkupton një pjesë të zonës sinkronike ose të gjithë zonën sinkronike, të përcaktuar fizikisht nga pikat e matjes në interkonektorët me zona të tjera monitorimi, të operuara nga një ose më shumë OST që përbushin detyrimet e një zone monitorimi;

parakualifikimi - nënkupton procesin për verifikimin e pajtueshmërisë së një njësie siguroese të rezervës ose një grupi sigurues të rezervës me kërkesat e përcaktuara nga OST;

periudha ramping (e ndryshimit) - nënkupton një periudhë kohore të përcaktuar nga një pikë fillestare fikse dhe një gjatësi kohe gjatë së cilës input dhe/ose output i fuqisë aktive do të rritet ose zvogëlohet;

OST udhëzuese e rezervës - nënkupton OST-në përgjegjëse për udhëzimin e njësisë ose grupit sigurues të rezervës për aktivizimin e FRR dhe/ose RR;

OSSH lidhëse të rezervës - nënkupton OSSH-ne përgjegjëse për sistemin e shpërndarjes në të cilin është lidhur një njësi ose grup sigurues i rezervës, që i bëhet disponibël OST-se;

OST lidhëse e rezervës - nënkupton OST-në përgjegjëse për zonën e monitorimit në të cilën është lidhur një njësi ose grup sigurues i rezervës;

OST marrëse e rezervës - nënkupton OST-ne të përfshirë në një shkëmbim të rezervës me OST-ne lidhëse dhe/ose me një njësi ose grup të sigurimit të rezervës që lidhet me një zonë tjetër të monitorimit të LFC;

procesi i zëvendësimit të rezervës RRP - nënkupton një proces për të rivendosur vlerën e FRR të e aktivizuar tashmë;

kërkesat për disponueshmërinë e RR - nënkupton një grup kërkesash të përcaktuara nga OST-të e një blloku LFC lidhur me disponueshmërinë e RR;

rregullat e dimensionimit të RR - nënkupton specifikimet e procesit të dimensionimit të RR të një blloku LFC;

diapazoni i frekuencave standarde - nënkupton një interval simetrik të përcaktuar rreth frekuencës nominale brenda së cilës duhet të mbahet frekuenca e sistemit të një zone sinkrone;

devijimi standard i frekuencës - nënkupton vlerën absolute të devijimit të frekuencës që kufizon intervalin standard të frekuencës;

devijimi i frekuencës të gjendjes së qëndrueshme - nënkupton vlerën absolute të devijimit të frekuencës pas shfaqjes së një disbalance, pasi është stabilizuar frekuenca e sistemit;

monitorimi i zonës sinkrone - nënkupton një OST përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave të kriterit të vlerësimit të cilësisë së frekuencës dhe zbatimin e kriterit të vlerësimit të cilësisë së frekuencës për zonën sinkrone;

procesi i kontrollit të kohës - nënkupton një proces për kontrollin e kohës, për të kthyer në zero devijimin e kohës elektrike, pra devijimin ndërmjet kohës sinkrone dhe kohës UTC.

ofruesi i shërbimit të mbrojtjes - është personi juridik me detyrimin ligjor ose kontraktual për të siguruar një shërbim që kontribuon në një ose disa masa të planit të mbrojtjes së sistemit;

ofruesi i shërbimit të rivendosjes - është personi juridik me detyrimin ligjor ose kontraktual për të ofruar një shërbim që kontribuon në një ose disa masa të planit të rivendosjes;

përdoruesi i rëndësishëm i rrjetit me prioritet të lartë - është përdoruesi i rëndësishëm i rrjetit për të cilin zbatohen kushte të veçanta për shkyçjen dhe ri-energizimin;

kërkesë e netuar - nënkupton vlerën neto të fuqisë aktive të parë nga një pikë e caktuar e sistemit, e llogaritur si (ngarkesë - gjenerim), e shprehur përgjithësisht në kilovat (kW) ose megavat (MW), në një çast të dhënë ose mesatarja mbi çdo interval të caktuar kohe;

plani i rivendosjes - nënkupton të gjitha masat teknike dhe organizative të nevojshme për rivendosjen e sistemit në gjendjen normale;

ri-energizim - nënkupton rilidhjen e gjenerimit dhe kërkesës për të energjizuar pjesët e sistemit që janë shkyçur;

strategjia e ri-energizimit nga lart-poshtë - nënkupton një strategji që kërkon ndihmën e OST-ve të tjera për të ri-energizuar pjesët e sistemit të një OST;

strategjia e ri-energizimit nga poshtë-lart - nënkupton një strategji ku pjesë të sistemit të një OST mund të ri-energizohen pa ndihmën e OST-ve të tjera;

ri-sinkronizimi - nënkupton sinkronizimin dhe lidhjen në pikën e risinkronizimit të dy rajoneve të sinkronizuara;

lider i frekuencës - do të thotë OST i caktuar dhe përgjegjës për menaxhimin e frekuencës së sistemit brenda një rajoni të sinkronizuar ose një zone sinkrone me qëllim që të rikthejë frekuencën e sistemit përsëri në frekuencën nominale;

rajon i sinkronizuar - nënkupton fraksionin e një zone sinkrone që mbulohet nga OST-të e ndërlidhura me një frekuencë të përbashkët të sistemit dhe që nuk është e sinkronizuar me pjesën tjetër të zonës sinkrone;

lideri i ri-sinkronizimit - nënkupton OST-në e caktuar dhe përgjegjëse për ri-sinkronizimin e dy rajoneve të sinkronizuara;

pika e ri-sinkronizimit - nënkupton pajisjen e përdorur për të lidhur dy rajone të sinkronizuara, zakonisht një çelës;

(N-2) - kriteri i planifikimit të sistemit sipas të cilit humbja e një elementi shtese mbi kriterin N-1 lejon që elementet që mbeten në operim të akomodojnë situatën e re operationale pa shkelur kufijtë e sigurisë operationale;

NTC - është kapaciteti maksimal për shkëmbimin e energjisë midis dy zonave, në përputhje me standardet e sigurisë të zbatueshme në të dy zonat dhe duke marrë parasysh pasiguritë teknike për kushtet e ardhshme të rrjetit;

(N-1) - kriteri i planifikimit të sistemit sipas të cilit elementët që mbeten në operim brenda zonës së kontrollit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) pas ndodhjes së një defekti janë të aftë të akomodojnë situatën e re operationale pa shkelur kufijtë e sigurisë operationale;

modelet e rrjetit - një grup të dhënash që përshkruan karakteristikat e sistemit (gjenerimi, topologjia e ngarkesës dhe rrjetit) dhe rregullat përkatëse për të ndryshuar këto karakteristika gjatë llogaritjes së kapacitetit, të përgatitur nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST), për t'u bashkuar me komponentët e tjerë individualë të modelit të rrjetit në mënyrë që të krijohen modeli i rrjetit të përbashkët;

modelet e tregut - një grup të dhënash që përshkruan karakteristikat e tregut individual të energjisë elektrike;

parashikimi i mjaftueshmërisë - vlerësimi mbi mundësitë e furnizimit dhe infrastrukturën e transmetimit nëse janë të mjaftueshme për të siguruar mbulimin e kërkesës për energji elektrike në mënyrë të përshtatshme brenda afateve të shkurtra kohore dhe në rrethana kur mund të ekzistojë një rrezik për sigurinë e furnizimit;

planet rajonale të investimeve (RgIP) - planet që analizojnë zhvillimin e sistemit të energjisë nga një perspektivë rajonale, bazuar në udhëzimet e përbashkëta dhe identifikimin e nevojave për investime të lidhura me një sërë projektesh të propozuara;

Plani Dhjetë Vjeçar i Zhvillimit të Rrjetit Evropian ENTSO-E (TYNDP) - plani që ofron një përmbledhje të infrastrukturës evropiane të energjisë elektrike dhe zhvillimet e saj në të ardhmen, dhe harton rrjetin e integruar të energjisë elektrike sipas një sere skenarësh zhvillimi. TYNDP gjithashtu përfshin një perspektivë evropiane të mjaftueshmërisë së furnizimit dhe një vlerësim të qëndrueshmërisë së rrjetit;

plani i investimeve - një analizë të investimeve të planifikuara për periudhën rregullatore përkatëse i cili paraqitet çdo vit në ERE për miratim

plani i zhvillimit afatgjatë - planifikimi i nevojave për investime në kapacitetet prodhuese, transmetuese dhe shpërndarëse në baza afatgjata, me qëllim përmbushjen e kërkesës së sistemit për energji elektrike dhe sigurinë e furnizimit të klientëve;

akses në sistemin e transmetimit - e drejta e një subjekti për të përdorur sistemin e transmetimit për tu lidhur në të dhe/apo për të transmetuar energji elektrike nëpërmjet lidhjes në këtë sistem

dhe/apo për të ofruar apo marrë shërbime sipas kuadrit ligjor në fuqi në lidhje me tregun e energjisë elektrike;

aktet e aplikueshme nga ENTSO-E - kodet, rregulloret, udhëzuesit, marrëveshjet dhe /apo çdo akt tjetër i cili hartohet nga dhe/apo zbatohet nga ENTSO-E por pa rënë ndesh me detyrimet ligjore nacionale;

burimeve të rinovueshme të energjisë elektrike - burime të rinovueshme jofosile, konkretisht era, dielli, energjia aerotermike, energjia gjeotermike, energjia hidrotermike dhe energjia e oqeanëve, energjia hidrike, biomasa, gazi i grumbulluar në landfille, gazi, që grumbullohet nga trajtimi i ujërave të zeza dhe biogazet;

de-energizimin - heqja e tensionit në pikën e kyçjes së lidhjes me sistemin e transmetimit dhe nga rrjeti i tij brendshëm dhe pajisjet ndihmëse të përdoruesit të sistemit të transmetimit;

derogim - pezullimi i pjesshëm i një apo disa dispozitave të kodit dhe/apo shtyrja e zbatimit të tyre për një afat të caktuar kohor, apo lejimi i mos zbatimit të një dispozite specifike për shkak të rrethanave, me miratim të rregullatorit;

dispeçerim - veprimtaria e kryer nga OST, që konsiston në menaxhimin në kohë reale të flukseve të energjisë elektrike dhe zbatimin e masave të nevojshme për operimin e bashkërenduar të komponentëve të sistemit elektroenergjetik, përfshirë centralet prodhuese, rrjetin e transmetimit dhe shërbimet ndihmëse të nevojshme për operimin e sistemit;

forcë madhore - një akt ose ngjarje natyrore apo shoqërore, si tërmetet, rrufetë, ciklonet, përmbytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret ose luftërat, konfliktet e armatosura, kryengritjet, veprime terroriste ose ushtarake, të cilat pengojnë të licencuarin të përmbushë detyrimet e tij sipas licencës, si dhe akte apo ngjarje të tjera që janë përtej kontrollit të arsyeshëm dhe që nuk kanë ardhur për faj të të licencuarit dhe i licencuari nuk ka pasur mundësi të shmangë një akt ose ngjarje të tillë nëpërmjet ushtrimit të vullnetit, përpjekjeve, aftësive dhe kujdesit të tij të arsyeshëm;

Kodi i Transmetimit - tërësia e rregullave teknike, të cilat rregullojnë operimin e sistemit të transmetimit, si dhe përcaktojnë kushtet e shërbimit që ofrohen nga OST ndaj përdoruesve të sistemit të transmetimit, në përputhje me rregullat e ENTSO-E;

ENTSO-E - (European Network of Transmission System Operators for Electricity) është Rrjeti Europian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike;

Operatori i Sistemit të Transmetimit ose OST - është personi juridik, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkoneksionet me sistemet e tjera ndërkuftare, për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike;

përdorues - janë personat fizikë ose juridikë, të cilët furnizojnë ose furnizohen me energji elektrike nëpërmjet sistemit të transmetimit ose të shpërndarjes;

rregullatori - autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjet përkatës;

shkëputjen e lidhjes - akti fizik i ndarjes-shkyçjes së sistemeve/objekteve të përdoruesit të rrjetit të transmetimit nga sistemi i transmetimit;

sistemi elektroenergjetik - një sistem i ndërlidhur, i përbërë nga centralët elektrike, linjat elektrike, nënstationet dhe pajisjet e transmetimit e shpërndarjes, me qëllim transmetimin apo shpërndarjen e energjisë elektrike te klientët;

sistemi i transmetimit - sistemi i përdorur për transmetimin e energjisë elektrike në tension të lartë dhe shumë të lartë, i lidhur në paralel me sistemet e vendeve të tjera, që përfshin midis të tjerave linjat, strukturat mbështetëse, pajisjet transformuese dhe kyçëse/shkyçëse për lëvrimin e energjisë elektrike te klientët ose në rrjetin e shpërndarjes, pa përfshirë furnizimin;

Shkurtime dhe akronime

Shkurtimi, akronimi	
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit
ENTSO-E	Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit për Energjinë Elektrike
EU; BE	Bashkimi Evropian
SOGL	Udhëzuesi i Operimit të Sistemit
OSSH	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes
OSMSH	Operatori i Sistemit të Mbyllur të Shpërndarjes
SGU	Përdorues i Rëndësishëm i Rrjetit
RES, BRE	Burimet e Rinovueshme të Energjisë
LFC	Zona e Kontrollit Fuqi-Frekuencë
HVDC	Tension i Lartë i Rrymës së Vazhduar
FCR	Rezervat e Mbajtjes së Frekuencës
FRR	Rezerva e Restaurimit të frekuencës
aFRR	Rezerva Automatike e Restaurimit të Frekuencës
mFRR	Rezerva Manuale e Restaurimit të frekuencës
RR	Rezerva Zëvendësuese
ACE	Gabim i Zonës së Kontrollit
FRP	Procesi i Restaurimit të Frekuencës
FRCE	Gabimi i Kontrollit të Restaurimit të Frekuencës
RSC	Koordinator Rajonal i Sigurisë
FCP	Procesi i Mbajtjes së Frekuencës
RRP	Procesi i Zëvendësimit të Rezervës
FCA	Alokimin i kapaciteteve në Avance
CCRs	Rajonet e Llogaritjes së kapacitetit
KORP	Kërkesat Organizative, Rolet dhe Përgjegjësitë për Shkëmbimin e të Dhënave
RAOCM	Metodologjia për vlerësimin e rëndësisë së aseteve për koordinimin e ndërprerjeve
CACM	Alokimi i Kapaciteteve dhe Menaxhimi i Konxhestioneve
FACTS	Sistemet Fleksibil të Transmetimit të Rrymës Alternative
VQD	Vlerësimi i Qëndrueshmërisë Dinamike
NRA	Autoritetin Rregullator Kombëtar (ERE)
MIRr	Modeli Individual i Rrjetit
MPRr	Modelin i Përbashkët i Rrjetit
MMPRr	Metodologjia e Modelit të Përbashkët të Rrjetit
NKGj	Ndryshimi Kryesor i Gjenerimit
AGC	Kontrolli Automatik i Gjenerimit
ERE	Enti Rregullator i Energjisë
Kodet e Lidhjes	Nënkuptojnë tre kodet e lidhjes: <ul style="list-style-type: none"> • Kodi “Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin të Objekteve të Ngarkesës” i miratuar me Vendimin ERE Nr. 128 Datë 04.06.2018

	<ul style="list-style-type: none"> • Kodi “Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin të Gjeneruesve” i miratuar me Vendimin ERE Nr. 129 Datë 04.06.2018 • Kodi “Kërkesat Për Lidhjen Me Rrjetin Të Sistemeve Me Tension Të Lartë Me Rrymë Të Vazhduar Dhe Parqet Me Module Të Energjisë Të Lidhur Me Rrymë Të Vazhduar” i miratuar me Vendim të ERE Nr.127, datë 04.06.2018
Black-out	Ndërprerje (rënie e pjesshme ose e plotë e sistemit)
LFSM-U	Frekuencë e limituar në modalitetin sensitiv-nënfrekuenca (Limited frequency sensitive mode – underfrequency)
LFSM-O	Frekuencë e limituar në modalitetin sensitiv- mbifrekuenca (Limited frequency sensitive mode – overfrequency)
NEMO	Operatori i Emëruar i Energjisë Elektrike
DA	Ditë në avancë (day ahead)
ID	Brenda ditës (intraday)

KODI I DISPOZITAVE TË PËRGJITHSHME

Neni 1. Qëllimi dhe objekti

1. Ndërsa çdo kod i veçantë, tërësia e të cilëve përbën Kodin e Transmetimit, përmban rregulla dhe dispozitat që lidhen posaçërisht me atë kod/çështje në veçanti, Kodi i Dispozitave të Përgjithshme përcakton rregullat të cilat aplikohen në mënyrë të përgjithshme për të gjithë Kodin e Transmetimit.
2. Kodi i Dispozitave të Përgjithshme siguron, për aq sa është e mundur, që kodet e veçanta, sipas kuptimit në paragrafin më sipër pjesë përbërëse të Kodit të Transmetimit, të funksionojnë së bashku dhe të jenë të zbatueshëm në praktikë, duke përcaktuar kuadrin rregullues i cili vendos kushtet për mirë - funksionimin e sistemit të transmetimit të energjisë dhe përdoruesve të tij në veçanti, si dhe të gjithë sistemit elektroenergjetik në tërësi.
3. Kodi i Dispozitave të Përgjithshme përcakton një serë dispozitash që rregullojnë çështje që lidhen me interpretimin, zbatimin, situatat të paparashikuara në dokument, rishikimin dhe aprovimin e dokumentit, marrëdhënien ndërmjet palëve, etj.

Neni 2. Fushëveprimi

1. Kodi i Dispozitave të Përgjithshme zbatohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (në vijim OST) dhe përdoruesit, në interpretimin e të gjithë Kodit të Transmetimit për të gjithë përdoruesit aktual të sistemit të transmetimit apo subjektet që synojnë të përdorin sistemin e transmetimit si përdorues apo në një status tjetër, si dhe në lidhje me ndërveprimin me institucione dhe subjekte të tjera në sektorin e energjisë elektrike.

Neni 3. Kodi i Transmetimit, qëllimi, objekti dhe struktura

1. Kodi i Transmetimit është tërësia e rregullave të cilat kanë për qëllim të përcaktojnë në mënyrë të hollësishme normat që shërbejnë për të siguruar mbarëvajtjen e operimit dhe zhvillimit të sistemit të transmetimit, përcaktojnë kushtet e shërbimit që ofrohen nga OST ndaj përdoruesve të sistemit të transmetimit, si dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet reciproke për OST dhe përdoruesit në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe aktet e aplikueshme nga ENTSO-E.
2. Kodi i Transmetimit parashikon:
 - a. metodat dhe kriteret për planifikimin dhe zhvillimin e sistemit;
 - b. kushtet dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikimin për akses në sistemin e transmetimit;
 - c. specifikimet minimale teknike dhe funksionale për dhënien e aksesit dhe lidhjen me sistemin e transmetimit të centraleve prodhuese, shoqërive shpërndarëse, konsumatorëve fundorë, si dhe linjave të interkoneksionit;

- d. afatin në të cilin OST duhet t'i përgjigjet aplikimit të paraqitur, si dhe pasojat në rast se përgjigjja nuk jepet brenda afatit të parashikuar;
 - e. shërbimet e balancimit dhe ato ndihmëse
 - f. planin operacional dhe rregullat e planifikimit;
 - g. administrimin dhe kontrollin e sistemit në kushtet normale dhe emergjente të operimit;
 - h. rregullat e matjes;
 - i. kriteret e aplikuara nga OST për dispeçerimin e instalimeve prodhuese në dispozicion, si dhe për përdorimin e linjave të interkoneksionit;
 - j. mënyrën, afatin, kushtet dhe detyrimet, sipas të cilave OST dispeçeron energjinë e prodhuar prej burimeve të rinovueshme të energjisë elektrike;
 - k. çdo veprimtari tjetër të nevojshme për administrimin e qëndrueshëm dhe të sigurt të sistemit të transmetimit;
 - l. mënyrën e funksionimit dhe të operimit të operatorit të tregut.
3. Kodi i Transmetimit është i organizuar si tërësi kodesh të veçantë të cilët adresojnë një ose disa çështje sipas pikës (2) më sipër duke përcaktuar dispozitat, parametra, procedurat, etj. të zbatueshme sipas rastit.

Neni 4. Hartimi, miratimi dhe amendimi i Kodit të Transmetimit

1. Kodi i Transmetimit hartohet dhe amendohet nga OST në përputhje me ndryshimet në kuadrin ligjor në fuqi që ndikojnë në Kodin e Transmetimit apo me qëllim arritjen e pajtueshmërisë me kuadrin e akteve të aplikueshme nga ENTSO-E si dhe në çdo rast kur kryerja e aktivitetit dhe funksioneve të ngarkuara me ligj apo kushtet konkrete e diktojnë.
2. Në çdo rast, kur parashikohet të kryhen amendime, OST informon dhe ju ofruar përdoruesve të sistemit të transmetimit dhe publikut, mundësinë për të paraqitur pikëpamjet e tyre mbi ndryshimet e parashikuara, nëpërmjet një procesi publik konsultimi prej të paktën 30 ditësh, para paraqitjes për miratim tek rregullatori të ndryshimeve në fjalë.
3. Përdoruesit kanë të drejtë të propozojnë amendime në Kodin e Transmetimit, të cilat do të paraqiten fillimisht pranë OST dhe me pas i paraqiten për miratim rregullatorit si propozim i përbashkët pasi i nënshtrohen konsultimit publik sipas përcaktimeve në pikën më sipër.

4. Nëse OST dhe përdoruesi nuk bien dakord mbi ndryshimet e propozuara secila palë mund të drejtohet pranë rregullatorit në mënyrë të njëanshme për adresimin e çështjes sipas kuadrit rregullator në fuqi.
5. Kodi i Transmetimit apo çdo amendim në lidhje me të, i propozuar nga OST sipas procedurës së përshkruar më lart apo të propozuara nga përdoruesit apo OST në mënyrë të njëanshme, i nënshtrohen procedurës së miratimit nga rregullatori.
6. OST publikon Kodin e Transmetimit në website dhe e përditëson publikimin pas çdo ndryshimi të miratuar nga rregullatori.

Neni 5. Interpretimi dhe hierarkia

1. Interpretimi i secilës dispozitë të kodit kryhet nga OST kur kërkohet nga përdoruesit, institucione apo një palë e tretë, si dhe në çdo rrethanë në komunikimet dhe ndërveprimet ndërmjet OST dhe përdoruesit.
2. OST ka të drejtë të hartojë dhe nxjerrë udhëzime me efekt të përkohshëm të detyrueshme për përdoruesit duke interpretuar dispozitat e Kodit të Transmetimit me qëllim adresimin e situatave apo rrethanave të paparashikuar në kod apo të rasteve të cilat nuk gjejnë pasqyrim në mënyrë të drejtpërdrejtë në dispozitat e kodit dhe që përndryshe pengojnë funksionimin normal të një pjese apo të të gjithë sistemit dhe përdoruesve të sistemit të transmetimit.
3. Në rast të ndonjë mospërputhje ndërmjet parashikimeve të ndonjë dispozite të Kodit të Transmetimit dhe ndonjë kontrate ose marrëveshje ndërmjet OST dhe përdoruesit, dispozitat e Kodit të Transmetimit janë mbizotëruese.
4. Në çdo rast OST do të ofrojë dhe nëse duhet do të publikojë kërkesën për interpretim dhe përgjigjen së bashku me një argumentim të plotë në lidhje me qëllimin e dispozitës përkatëse dhe zbatimin e saj.
5. Nëse interpretimi i OST konsiderohet jo i plotë apo joshterues apo nuk ka dakordësi me interpretimin e OST, subjekti i cili ka kërkuar interpretimin mund ti drejtohet rregullatorit për adresimin e çështjes sipas kuadrit rregullator në fuqi.
6. Pavarësisht sa më sipër, subjektet që kundërshtojnë interpretimin e OST për një çështje të caktuar dhe në veçanti përdoruesit, nuk do të pengojnë përmbushjen e funksioneve përkatëse në përputhje me përcaktimet e Kodit të Transmetimit dhe kuadrit përkatës ligjor si dhe nuk do të ndërmarrin veprime apo do të refuzojnë kryerjen e tyre duke cënuar sigurinë dhe funksionimin e sistemit të transmetimit.
7. Përdoruesit që kanë interpretime të ndryshëm në lidhje me dispozitat e kodit, do të zbatojnë kodin përfshirë dispozitën për të cilën nuk ka dakordësi si dhe interpretimin përkatës nga OST deri në një vendim përfundimtar të rregullatorit në lidhje me mosmarrëveshjen.

Neni 6. Monitorimi dhe zbatimi i Kodit të Transmetimit

1. Kodi i Transmetimit është i detyrueshëm për OST, të gjithë përdoruesit e sistemit të transmetimit si dhe çdo subjekt apo palë të tretë e cila ndërvepron me OST dhe sistemin e transmetimit në ndonjë rrethanë apo çështje të caktuar.
2. Të gjithë përdoruesit janë të detyruar të zbatojnë urdhrat dhe udhëzimet e lëshuara nga OST si dhe të kërkojnë miratimin nga OST për kryerjen e veprimeve operacionale, veçanërisht për veprime që lidhen me ndryshimin e regjimit të punës së sistemeve të tyre, në përputhje me dispozitat përkatëse të përcaktuara në kod.
3. OST monitoron zbatimin e Kodit të Transmetimit nëpërmjet kryerjes së inspektimeve, testimit të sistemeve dhe proceseve apo mbledhjes së informacionit të nevojshëm nga përdoruesit e sistemit të transmetimit për të mbikëqyrur zbatimin e Kodit të Transmetimit nga këta përdorues.
4. OST ka të drejtë të kërkojë nga përdoruesi dhe ky i fundit duhet ti sigurojë OST të gjitha informacionet e nevojshme, përfshirë dhe aksesin në pronën dhe dokumentacionin e përdoruesit për të hetuar pajtueshmëritë e sistemeve dhe praktikave të tij me Kodin e Transmetimit.
5. Përdoruesi i sistemit të transmetimit që dështon në zbatimin e ndonjë dispozite të Kodit të Transmetimit, informon menjëherë OST për rastin dhe arsyet e dështimit.
6. Bazuar në të dhënat e disponueshme, gjetjet nga monitorimet apo informacion i përcjell nga përdoruesi, OST verifikon dhe vlerëson pajtueshmërinë e përdoruesit me këtë kod.
7. Në çdo rast papajtueshmërie, OST paralajmëron përdoruesin dhe informon rregullatorin për:
 - a. përshkrimin e papajtueshmërisë së konstatuar;
 - b. informacionin/shpjegimin e përdoruesit në lidhje me papajtueshmërinë e konstatuar;
 - c. afatet kohore të nevojshme për zbatimin e detyrimeve nga përdoruesi, të domosdoshme për të zgjidhur situatën e papajtueshmërisë me dispozitat e kodit.
8. Rastet e përsëritura të papajtueshmërisë, të konstatuara nga OST gjatë kryerjes së funksioneve të saj apo të raportuara nga përdoruesi dhe për të cilat nuk janë marrë masa për eliminimin e tyre, apo për të cilat nuk ka një vendim për derogim nga rregullatori raportohen nga OST tek rregullatori me propozimin për penalizim sipas legjislacionit në fuqi, deri në de-energizimin apo shkëputjen e lidhjes së përdoruesit përkatës nga sistemi i transmetimit.
9. Një përdorues i cili në mënyrë të përsëritur nuk zbaton dispozitat e kodit, mban të gjitha përgjegjësitë dhe pasojat e de-energizimit apo shkëputjes së lidhjes, përfshirë koston

e dëmtimeve dhe kompensimin e pasojave për OST dhe të tretë si dhe çdo lloj detyrimi tjetër që rrjedh nga dispozitat e këtij kodi dhe/apo legjislacionit në fuqi.

10. OST përgatit një raport të detajuar vjetor në lidhje me zbatimin e Kodit të Transmetimit dhe pajtueshmërinë, bazuar në gjetjet e saj nga monitorimet si dhe informacionet nga përdoruesit, i cili i paraqitet rregullatorit brenda muajit janar të vitit në vijim.

Neni 7. Aktiviteti dhe pronësia e Operatorit të Sistemit të Transmetimit

1. OST ushtron veprimtarinë e tij i ndarë nga aktivitetet e tjera në sektorin e energjisë elektrike, si prodhimi, shpërndarja, tregtimi dhe furnizimi me energji elektrike, në përputhje me parimet dhe kërkesat e përcaktuara në ligj.
2. OST ka në pronësi sistemin e transmetimit të energjisë elektrike, që përfshin linjat 400 kV, 220 kV dhe 110 kV, nënstationet e transformimit të energjisë elektrike me nivele të transformimit të tensionit të lartë 400 kV, 220 kV dhe zbarat 110 kV në të gjitha nënstationet 110/TM kV, deri në pikën e matjes së energjisë në anën 110 kV të transformatorëve 110/TM kV, përfshirë pajisjet kyçëse/shkyçëse të linjave 110 kV.
3. OST operon infrastruktura të tjera të ngjashme të këtij niveli tensioni, të cilat nuk janë në pronësi të tij, që shërbejnë për lëvrimin e energjisë tek operatori i shpërndarjes dhe/ose klientët e lidhur direkt me sistemin e transmetimit.

Neni 8. Akses reciprok dhe siguria teknike

1. Përdoruesit i garantojnë OST të drejtën për hyrjen fizike në objektet e tyre dhe dokumentacionin teknik përkatës, si dhe lehtësira të tjera të nevojshme për kryerjen e shërbimeve të ndryshme në zbatim të përgjegjësive të OST.
2. OST dhe përdoruesit kanë detyrim për lejimin reciprok të hyrjes së personelit në pronësitë përkatëse, sipas një liste personash të autorizuar, për të kryer punime në pronësitë përkatëse të palëve.
3. OST dhe përdoruesit përcaktojnë në marrëveshjen e lidhjes ose kur është e nevojshme me marrëveshje të veçanta një listë të pajisjeve në pronësi të njërit palë, të instaluar në pronësinë e palës tjetër (p.sh. pajisjet e matjes, të telekomunikacionit, SCADA, kabllot e fuqisë etj.) përfshirë informacionin teknik të nevojshëm të instalimit sipas rastit, si dhe planimetritë e pronësisë, vendndodhjes së pajisjeve dhe rrugëve të kalimit.
4. OST dhe përdoruesit janë respektivisht përgjegjës për sigurinë dhe zbatimin e rregullave të sigurimit teknik gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre përfshirë rastet kur punojnë brenda pronësive të palës tjetër.
5. Pajisjet/grup pajisjesh vihen në punë dhe operim pasi palët konfirmojnë përfundimin e punimeve dhe shërbimeve dhe respektimin e masave të sigurimit teknik në përputhje me normave dhe rregullat në fuqi të sigurimit dhe shfrytëzimit teknik.

Neni 9. Komunikimi ndërmjet OST dhe përdoruesve

1. Të gjithë komunikimet ndërmjet OST dhe përdoruesve do të bëhen me shkrim ndërsa komunikimet verbale do të pasqyrohen me shkrim sa më shpejt. Aty ku kodi specifikon dhënien e informacioneve me shkrim ose konfirmim me shkrim, çdo lloj mjeti i transferimit elektronik që lejon marrësin ta ruajë këtë informacion, si posta elektronike, mesazhet kompjuterike të sistemit SCADA, telefaksi, e përmbushin këtë dispozitë të komunikimit me kusht që të garantohet siguria e informacionit dhe ruajtja e fshehtësisë, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Neni 10. Konfidencialiteti

1. OST ka të drejtë të marrë, përpunojë dhe ruaj informacion dhe të dhëna nga përdoruesit, me qëllim kryerjen e funksioneve të ngarkuara me ligj, duke zbatuar parimet e konfidencialitetit.
2. OST nuk publikon dhe nuk u jep palëve të treta informacionet dhe të dhënat në zotërim, pa miratim me shkrim të zotëruesit të informacionit, përveç rasteve kur kjo kërkohet nga kuadri ligjor në fuqi.
3. Të dhënat dhe informacionet e shkëmbyera për një qëllim të caktuar duhet të përdoren vetëm për atë qëllim, përveç rasteve kur të dyja palët japin miratim për përdorimin e tyre për një qëllim tjetër. OST lirohet prej detyrimeve sipas këtij neni kur të dhënat duhet të publikohen ose nëpërmjet raportimit të rregullt ose me kërkesë nga institucione bazuar në kuadrin ligjor përkatës.
4. OST, duke respektuar në çdo rast përcaktimet e detyrimit të shërbimit publik, apo ndonjë detyrim tjetër ligjor për dhënien e informacionit, ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar, të siguruar gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe parandalon përhapjen në mënyrë diskriminuese të informacionit për veprimtarinë e tij, me qëllim që të krijojë avantazh tregtar te një palë tjetër.
5. OST nuk përhap informacionin e ndjeshme tregtare te çdo i licencuar tjetër, përveçse kur kjo është e nevojshme për kryerjen e një transaksioni tregtar. Për të siguruar respektimin e plotë të rregullave të përhapjes së informacionit dhe ndarjes së veprimtarive, OST zbaton masa që shmangin përdorimin e shërbimeve të përbashkëta, të tilla si shërbime të përbashkëta ligjore, përveç funksioneve të thjeshta administrative apo të teknologjisë së informacionit.
6. OST, gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij, nuk keqpërdor informacionin e ndjeshëm tregtar të siguruar nga palët e treta, në kuadër të ofrimit apo negocimit të aksesit në sistem.
7. Informacioni i nevojshëm që garanton konkurrencën dhe funksionimin normal të tregut bëhet publik në përputhje me kuadrin rregullator për transparencën e tregut të energjisë.

8. Të dhënat përmbledhëse në lidhje me konsumin, gjenerimin dhe shkëmbimin e energjisë elektrike në nivelin e sistemit të energjisë elektrike, të dhënat mbi ngarkesën e sistemit si dhe informacioni për funksionimin e sistemit të transmetimit, përfshirë informacionin për shqetësimet dhe situatat e tjera emergjente nuk konsiderohen si konfidenciale.
9. OST shkëmben të dhëna përkatëse me operatorët fqinj, të cilat mund të përfshijnë të dhëna tregtare konfidenciale ose të ndjeshme. Për të parandaluar keqpërdorimin eventuale të këtyre të dhënave, OST nënshkruan me operatorët fqinj marrëveshje për konfidencialitetin e të dhënave në dispozicion, ku të dhëna të tilla përcaktohen si konfidenciale dhe palët marrin përsipër detyrimin të respektojnë konfidencialitetin e tyre.

Neni 11. Ngjarjet e paparashikuara

1. OST ka të drejtë të marrë masa emergjente në rast të ndodhjes së ngjarjeve që nuk janë parashikuar në dispozitat e këtij kodi, ose ndodhja e të cilave ishte e pamundur të parandalohej dhe efekti i ngjarjeve të tilla mund të provokojë ndryshimin e kushteve teknike për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit dhe të çojë në pasoja për OST dhe përdoruesit e sistemit të transmetimit.
2. OST informon rregullatorin dhe palët që preken nga situata ose ngjarja e paparashikuar, sa më shpejt që të jetë e mundur.
3. Në rast ngjarjesh të paparashikuara OST përcakton veprimet që ndërmerren në funksion të ruajtjes së sigurisë operationale të sistemit elektroenergjetik dhe të përmbushjes së funksioneve të caktuara me ligj, në përputhje me rrethanat e krijuara dhe përdoruesit kanë detyrimin të respektojnë udhëzimet e OST.
4. OST, në rrethana të veçanta të paparashikuara në këtë kod, të cilat mund të çojnë në cenimin e sistemit të transmetimit, sigurisë apo të përdoruesve, vepron vendosmërisht për të bërë të mundur operimin e sistemit të transmetimit, pavarësisht nga kundërshtitë nga përdoruesit apo të tretë.
5. OST harton një raport për ngjarjen e paparashikuar dhe zbatimin e masave për adresimin e ngjarjes së paparashikuara si dhe informon në kohën dhe mënyrën e përshtatshme palët dhe në veçanti rregullatorin në lidhje rrethanën që shkaktoi ngjarjet e paparashikuara, masat e marra, veprimet dhe/apo udhëzimet përkatëse të lëshuara, zbatimin e tyre, si dhe efektet dhe pasojat bazuar në rezultatet e analizës dhe vlerësimit të ngjarjes së paparashikuar.
6. Kur sipas analizës së përmendur më lart vlerësohet e nevojshme, OST harton dhe paraqet ndryshimet e nevojshme në kod apo akte të tjera apo kryhen ndërhyrjet e nevojshme si është e përshtatshme.

Neni 12. Dështimi i pajisjeve dhe impianteve

1. Në rast të defekteve ose dështimeve të pjesshëm të një impianti dhe/ose aparati që shoqërohet me mosrespektim të dispozitave të kodit, por që nuk pengon impiantet dhe / ose pajisjet e tjera për të operuar në mënyrë të sigurt, atëherë përdoruesi do të njoftojë menjëherë OST duke paraqitur edhe planin për eliminimin e defektit/dështimit dhe pajtueshmërinë.
2. Përdoruesi dhe OST duhet të sigurojnë se plani sipas pikës së mësipërme do të pengojë përkeqësimin e situatës apo kushteve të operimit të sistemit të transmetimit dhe nuk do të krijoj pasoja për të tretë, për sistemin apo për vetë përdoruesin.
3. Nëse plani i propozuar nuk përmbush kërkesën sa më sipër, OST i kërkon përdoruesit rishikimin e planit në mënyrë të përshtatshme.

Neni 13. Derogimet

1. Nëse përdoruesi nuk mund t'i përmbushë plotësisht dhe/ose pjesërisht kërkesat e kodit është i detyruar të kërkojë dhe aplikojë menjëherë për derogim në lidhje me kërkesën përkatëse sipas kuadrit ligjor në fuqi për procedurat e derogimit .
2. OST zbaton vendimin e rregullatorit në lidhje me derogimin dhe sipas rastit monitoron përmbushjen e tij nga ana e përdoruesit duke informuar rregullatorit në mënyrë të përshtatshme.

Neni 14. Harmonizimi me kërkesat e Kodit të Transmetimit

1. Me hyrjen në fuqi të këtij kodi, OST dhe përdoruesit kanë detyrimin të përmbushin pajtueshmërinë me dispozitat e këtij kodi duke marrë parasysh të gjitha karakteristikat dhe funksionimin e sistemit të transmetimit dhe impianteve të përdoruesve, brenda një afati prej 24 muajsh.
2. Brenda 2 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij kodi, OST i kërkon përdoruesve të sistemit të transmetimit të deklarojnë pajtueshmërinë me dispozitat e këtij kodi sipas një formati të përcaktuar nga OST dhe duke ofruar të gjithë informacion mbështetës të nevojshëm për të provuar deklarinimet e tyre.
3. Përdoruesit kanë për detyrim t'i paraqesin OST informacione të plota lidhur me kërkesën sipas paragrafit (2), brenda 2 muajsh pas marrjes së kërkesës.
4. Pas dorëzimit të të dhënave nga përdoruesit, OST kryen monitorime verifikuese kur e vlerëson të nevojshme.
5. Në bazë të informacionit të mbledhur, kur është e nevojshme, brenda 2 muajsh nga verifikimi i pajtueshmërisë, përdoruesit dhe/apo OST përgatisin planet për arritjen e pajtueshmërisë të cilat adresojnë dhe përcaktojnë afatet dhe hapat që ndërmerren për arritjen e pajtueshmërisë së sistemit të transmetimit dhe përdoruesve me dispozitat e këtij kodi.

6. Kur e vlerëson të nevojshme OST udhëzon ndryshime të afateve apo hapave të planit të paraqitur nga përdoruesit.

Neni 15. Periudhat e Forcës Madhore

1. Në periudhat e forcës madhore, dispozitat e kodi të cilat bien ndesh me kushtet dhe aktet e lëshuara në kuadër të forcës madhore, do të trajtohen si përkohësisht të pezulluara për aq kohë sa zgjat forca madhore.

Neni 16. Dispozita kalimtare

1. Brenda 24 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij kodi, kur është e nevojshme, OST dhe përdoruesit kanë detyrimin të harmonizojnë të gjitha marrëveshjet, kontratat, terma dhe kushtet e përgjithshme me dispozitat e kodit.
2. Deri në përfundim të afatit sipas paragrafit (1) të këtij neni, rregullat, marrëveshjet dhe kontratat ekzistuese mbeten në fuqi.

KODI I PLANIFIKIMIT

Neni 17. Objekti

1. Objektivi kryesor i planifikimit të sistemit të transmetimit është të sigurojë zhvillimin e duhur të sistemit të transmetimit në terma afatmesëm dhe afatgjatë i cili duhet të ketë në konsideratë kriteret kryesore të mëposhtme:
 - a. Të garantojë operimin e sigurtë të sistemit;
 - b. Të ofrojë një nivel të lartë të sigurisë së furnizimit me energji elektrike;
 - c. Të kontribuojë në një zhvillim të qëndrueshëm;
 - d. Lehtësojë lidhjen me sistemin e transmetimit për të gjithë pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike;
 - e. Të sigurojë zhvillimin dhe funksionimin e duhur të tregut të brendshëm të energjisë elektrike;
 - f. Të rrisë efikasitetin e përdorimit të rrjetit.
2. Kodi i Planifikimit specifikon dhe përcakton normat (standartet, kushtet, kriteret, afatet kohore) për planifikimin e zhvillimit të sistemit të transmetimit nga OST.
3. Përdoruesit e rrjetit të transmetimit bëjnë planifikimin e zhvillimit ose modifikimit të rrjeteve të tyre në koherencë me përgatitjen e Planit të Zhvillimit Afatgjatë dhe Afatmesëm të sistemit të transmetimit të OST.

4. Planifikimi sipas dispozitave të kodit, shkëmbimi i informacionit të nevojshëm për planifikimin, përgjegjësitë për planifikimin dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit dhe standardet e përcaktuara në këtë kod janë të detyrueshme për përdoruesit dhe pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike.
5. Planifikimi i zhvillimit të sistemit të transmetimit (pikat e lidhjes në kufijtë e pronësisë, linjat dhe/ose pajisjet, nënstacionet) dhe atij elektroenergjetik në tërësi merr në konsideratë por pa u kufizuar, faktorët dhe kushtet e mëposhtme:
 - a. Rikonfigurimin, rikonstruksionin apo optimizimin e pjesëve ekzistuese të sistemit të transmetimit; zhvillimin/modifikimin e sistemit/objektit të përdoruesve; lidhjet e përdoruesve të rinj; zgjerimin, rritjen e kapacitetit dhe ruajtjen e standardeve të sigurisë në përputhje me rritjen e parashikuar të kërkesës për energji elektrike dhe/apo futjen në punë të një elementi të ri në sistem;
 - b. Legjislacionin dhe kuadrin rregullator kombëtar;
 - c. Politikat dhe objektivat e Komunitetit të Energjisë, BE dhe organizatave të tjera me fokus energjinë elektrike në të cilat Shqipëria aderohet apo ka detyrime për respektimin e politikave dhe objektive;
 - d. Sigurinë e njerëzve dhe të infrastrukturës energjetike;
 - e. Ligjet, rregulloret dhe kërkesat mjedisore të infrastrukturave të sektorit të energjisë elektrike;
 - f. Sigurimin e transparencës në procedurat e aplikuara;
 - g. Efikasiteti ekonomik;
 - h. Efektin e përbashkët të një sërë zhvillimesh si këto të përmendura më lart.
6. Planifikimi i zhvillimit të sistemit të transmetimit duhet të jetë në koordinim me Planin Dhjetë Vjeçar të Zhvillimit të Rrjetit Evropian ENTSO-E (TYNDP), dokumente të tjera të ENTSO-E si Planet Rajonale të Investimeve (RgIP), perspektivën e sistemit të transmetimit dhe Parashikimit të Mjaftueshmërisë (AF) si dhe përcaktimet e ratifikuara nga Rregullorja KE 714/2009.

Neni 18. Zbatimi i Kodit të Planifikimit

1. Kodi i Planifikimit do të zbatohet qartësisht nga OST dhe përdoruesit e sistemit të transmetimit aktual dhe të perspektivës si vijon:
 - a. Modulet gjeneruese të lidhura në sistemin e transmetimit, konform këtij kodi dhe vendimit të ERE nr.129, dt.04/06/2018;
 - b. Objektet e shpërndarjes të operatorit të sistemit të shpërndarjes konform këtij kodi dhe vendimit të ERE nr.128, dt.04/06/2018;

- c. Objektet e kërkesës të lidhur në sistemin e transmetimit, konform këtij kodi dhe vendimit të ERE nr.128, dt.04/06/2018;
- d. Sistemet HVDC të lidhur me sistemin e transmetimit konform këtij kodi dhe vendimit të ERE nr.127, dt.04/06/2018;
- e. Pronarët e linjave dhe interkonjeksioneve;
- f. Furnizuesit;

Neni 19. Kriteret e planifikimit

1. OST dhe përdoruesit e sistemit të transmetimit do të planifikojnë zhvillimin e sistemeve/objekteve të tyre në përputhje me kriterin (N-1) të sigurisë operationale, në baza deterministe pa kufizime, justifikime/argumentime financiare, duke marrë në konsideratë modelin më pak të favorshëm të profilit të gjenerimit brenda kufizimeve përkatëse, ndërsa për situata më pak të mundshme (N-2) do të përdoret një model mesatar.
2. Llogaritjet do të kryhen për jetëgjatësi tipike të projektit prej 35 vjetësh, përveç kur diktohet ndryshe nga jetëgjatësia e impiantit apo jetëgjatësia e projektit.
3. Qëndrueshmëria kalimtare nuk duhet të çënohet në kushtet e veprimit me sukses të mbrojtjes pas një defekti/lidhje të shkurtër njëfazore si dhe në kushtet e qarkut të shkurtër tre-fazor apo defekti në zbarë, i shkrytur brenda kohës normale të veprimit të mbrojtjes, pa dëmtime në sistemin elektroenergetik.
4. Kriteret e kostos më të ulët ekonomike do të zbatohen në kushtet kur planifikohet lidhja e përdoruesve të rinj në sistem dhe kur planifikohen investime në drejtim të përmirësimit të besueshmërisë dhe/ose cilësisë së furnizimit për të siguruar arritjen e kufijve apo objektivave të përcaktuara, si dhe për të përcaktuar dhe/ose verifikuar nivelin e dëshiruar të rezervës së sistemit dhe/ose pajisjeve të tij.
5. Planifikimi do të marrë në konsideratë vlerën e ngarkesës dhe gjenerimit në vendet fqinje, reduktimin e kostove të shërbimeve me cilësi, udhëzimet e rregullatorit, të dhënat historike mbi ndërprerjet, reduktimin e ngarkesës, kufizimet e sistemit dhe cilësinë e furnizimit për treguesit e pa përmbushur.
6. Planifikimi afatgjatë i kryer nga OST do të zbatohet dhe kriteret që lidhen me sigurimin e qëndrueshmërisë afatgjatë në ofrimin e shërbimit, të cilat konsistojnë në:
 - a. Të drejtën e servitutit/shpronësimit;
 - b. Zëvendësimin e aseteve në funksion të planit të menaxhimit të ciklit të jetës së aseteve në përputhje me praktikatat e mira të menaxhimit të aseteve;
 - c. Projektet e zgjerimit dhe fuqizimit të sistemit të transmetimit të cilat nuk mund të justifikohen me kriterin (N – 1).

Neni 20. Planifikimi i Zhvillimit Afatgjatë (10 vjeçar) i Sistemit të Transmetimit

1. OST harton një Plan Afatgjatë 10 vjeçar të zhvillimit të sistemit të transmetimit në konsultim me palët e interesuara dhe e paraqet për miratim në ERE. Ky plan afatgjatë 10 vjeçar i zhvillimit koordinohet dhe me Planin Afatgjatë 10 vjeçar të ENTSO-E (TYNDP), duke zbatuar kriteret dhe metodologjitë e tij për planifikimin afatgjatë të sistemit të transmetimit.
2. OST do të kryejë analizën kosto-përfitim të projekteve që kanë një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e sistemit të transmetimit sipas “Metodologjisë së Vlerësimit Kosto-Përfitim të Projekteve të Sistemit të Transmetimit” të hartuar nga OST dhe miratuar nga rregullatori.
3. Plani afatgjatë 10 vjeçar i zhvillimit të sistemit të transmetimit do të përditësohet çdo 2 vjet. Ky përditësim, përveç të tjerash, do të lejojë që përdoruesit të bëjnë planifikimet për zgjerimin dhe zhvillimin e sistemeve/objekteve të tyre.
4. Çdo përdorues i sistemit të transmetimit duhet ti japë OST informacionin dhe të dhënat strukturore që kanë të bëjnë me sistemin/objektin e tij si dhe çdo informacion apo të dhënë tjetër të kërkuar nga OST të nevojshme për procesin e planifikimit.
5. Të dhënat që do ti dërgohen OST nga përdoruesit e sistemit të transmetimit do të jenë në formatet e përcaktuara nga OST në aneksin 1 të këtij kodi.

Neni 21. Planifikimi dhe zhvillimi i sistemit të transmetimit

1. Planifikimi i gjenerimit, sistemit të shpërndarjes, ngarkesës konsumatore dhe furnizuesve të energjisë, do të bëhen bazuar në Planin Afatgjatë 10 vjeçar të Zhvillimit të Sistemit të Transmetimit.
2. Plani afatgjatë i zhvillimit do të përfshijë parashikimet për:
 - a. kërkesën për energji elektrike;
 - b. ngarkesën në MW;
 - c. ngarkesën maksimale dhe minimale në sistemin elektroenergjetik;
 - d. kapacitetet shtesë të gjenerimit;
 - e. linjat dhe kapacitetet transmetuese;
 - f. nënstacionet dhe kapacitetet transformuese të tyre, humbjet teknike të energjisë elektrike në sistemin e transmetimit;
 - g. kërkesat për lidhje të përdoruesve me sistemin e transmetimit në bazë të informacionit të zotëruar;

- h. parametrat e tjerë të rëndësishëm të sistemit të transmetimit.
3. Plani afatgjatë përmban dhe planifikimin e zhvillimit të interkonjeksioneve me rrjetin rajonal për:
 - a. nevoja të eksporteve dhe importeve;
 - b. rritjes së sigurisë operacionale;
 - c. reduktimin e kufizimeve të energjisë elektrike të pa furnizuar;
 - d. rritjen e aksesit të përdoruesve të sistemit të transmetimit si dhe
 - e. eficientë të tregut të energjisë elektrike.
 4. OST do të vlerësojë nevojat për energji elektrike bazuar në të dhënat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe përdoruesve të tjerë të sistemit të transmetimit. Megjithatë, OST kryen edhe analiza studimore të caktuara të përcaktimit të nevojave për energji elektrike dhe ngarkesave, bazuar në të dhënat historike që OST disponon.
 5. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mbi bazën e analizës së detajuar të ngarkesës për të gjithë kategoritë e përdoruesve të vet, do të paraqesë në OST kërkesat dhe nevojat e tij për zgjerim, zhvillim të sistemit dhe ngarkesës. Në mënyrë të ngjashme do të veprojnë të gjithë përdoruesit e tjerë të sistemit.
 6. Përdoruesit e sistemit të transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes janë përgjegjës për dhënien e informacionit të detajuar teknik sipas formatit të të dhënave në aneksin 1, përfshirë çdo përdorues të lidhur në sistemin e shpërndarjes dhe që mund të ketë ndikim të veçantë në sigurinë operacionale.
 7. Të dhënat do të vihen në dispozicion OST nga përdoruesit sipas afateve të përcaktuara nga OST në mënyrën që lejon përdorimin e tyre për hartimin e planit afatgjatë. OST duhet të informohet në mënyrën e duhur për çdo ndryshim të konsiderueshëm të të dhënave në parashikimet e dorëzuara.
 8. OST do të vlerësojë humbjet teknike të energjisë elektrike në përqindje dhe në vlerë për sistemin e transmetimit në tërësi dhe elemente të veçantë si më poshtë:
 - a. Duke u bazuar në vlerësimin e humbjeve të fuqisë në pikun (max) e ngarkesës në sistemin e transmetimit. Ky vlerësim do të kryhet nga analizat dhe studimet e shpërndarjes së flukseve të fuqisë me ndihmën e programeve kompjuterike të përshtatshme;
 - b. Duke kryer analiza dhe studime pilot në elemente të veçantë të sistemit të transmetimit dhe me anën e matjes së energjisë elektrike në të dy anët e elementit përkatës në përputhje me standardet dhe rregullat përkatëse të Kodit të Matjes.

- c. Në përputhje me shtrirjen e implementimit të sistemit SCADA dhe teknologjive të tjera të avancuara, OST do të kryej vlerësimin dhe parashikimin e humbjeve duke aplikuar teknologjinë e rrjetave neurale, bazuar në të dhëna mbi gjenerimin, ngarkesat, flukset dhe shkëmbimet e energjisë, faktorët konstruktive të elementeve të sistemit dhe topologjinë e tij.
9. OST merr në konsideratë edhe dinamikën e zhvillimit ekonomik të vendit (në bazë të parashikimit të rritjes së produktit kombëtar bruto, investimeve, punësimit dhe konsumit), ndryshimin e konsumit të energjisë elektrike në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, shkallën aktuale dhe të pritshme të përdorimit të gazit natyror në vend, në mënyrë që të krijojë lidhjen mes zhvillimit të ekonomisë dhe kërkesës për energji elektrike.
 10. OST merr në konsideratë edhe zhvillimin e projekteve ekzistuese dhe të reja të planifikuara nga operatorë e sistemeve fqinjë të transmetimit.

Neni 22. Planifikimi i gjenerimit dhe sistemit të shpërndarjes

1. Çdo prodhues i energjisë elektrike duhet të hartojë dhe të paraqesë një plan afatmesëm (çdo 2 vjet) dhe një plan afatgjatë (10 vjeçar) për zhvillimin e sistemit/objektit të tij duke integruar çështje të optimizimit të regjimit operativ të sistemit elektroenergjetik.
2. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes në mënyrë të pavarur do të hartojë planin e tij afatgjatë dhe afatmesëm dhe do ta paraqesë në OST, në koherencë të plotë me horizontet kohore përkatëse duke patur parasysh dhe çështjet e optimizimit të sistemit elektroenergjetik.

Neni 23. Modelimet e sistemit të transmetimit për çështjet e planifikimit afatgjatë

1. OST përgatit një bazë të dhënash për krijimin e modeleve të tregut që përmban parametra teknike, ekonomike dhe financiare të gjenerimit, njësive të kërkesës, vlerat e pritshme të rezervës së sistemit, kapacitetet e lejuara kufitare të transmetimit etj., duke mbuluar horizonte të ndryshme kohore sipas specifikave dhe formatit të kërkuar nga ENTSO-E për studimet e mjaftueshmërisë afatmesme dhe afatgjatë të sistemit që ajo realizon.
2. OST përgatit modelet e rrjetit që pasqyrojnë konfigurimin e sistemit të transmetimit sipas formatit, afateve kohore dhe kriterëve të kërkuara nga ENTSO-E.
3. Në varësi të llojit të analizave, modelet e rrjetit ndërtohen me shkallë të caktuara të paraqitjes së detajeve të sistemit dhe mbështeten në një bazë të dhënash të sistemit të elektroenergjetik në një horizont të caktuar kohor, që përmbajnë elementet si vijon:
 - a. Topologjia e ndërtimit dhe parametrat e sistemit;
 - b. Informacion mbi njësitë gjeneruese;
 - c. Informacion mbi njësitë e kërkesës;

- d. Mbulimi i horizonteve të ndryshme kohore dhe skenarëve të zhvillimit të sistemit.
- 4. OST përgatit modelin individual/kombëtar për sistemin e transmetimit që përmban të gjithë elementët me nivele tensioni 110 kV, 150 kV, 220 kV, 400 kV. Modelet ndërtohen në bazë të skenarëve operacional dhe horizonteve kohore të zhvillimit të ndryshëm, në përputhje me qëllimin e analizës dhe studimit për të cilat do të shfrytëzohen.
- 5. Modeli rajonal përbëhet nga modelet e rrjeteve kombëtare të transmetimit të vendeve të Evropës Jug-Lindore dhe merr parasysh të gjitha projektet rajonale (të përcaktuara në grupin rajonal për planifikimin e sistemeve në Evropën Kontinentale Juglindore të ENTSO-E) dhe ekuivalenti i pjesës tjetër ndërlidhëse të ENTSO-E. Modeli individual/kombëtar për rrjetin e sistemit të transmetimit integrohet në këtë model rajonal.

Neni 24. Përgatitja e skenarëve për planifikimin e sistemit të transmetimit

- 1. OST përgatit skenarë për planifikimin e zhvillimit në bazë të:
 - a. Rritjes së kërkesës (pasiguritë në parashikimin e shpërndarjes dhe kërkesës së OSSH dhe përdoruesve të lidhur në sistemin e transmetimit);
 - b. Vendndodhjes dhe fuqisë së instaluar të gjeneruesve të rinj;
 - c. Ndryshimit të kushteve hidrologjike që shkaktojnë ndryshime në importin/eksportin e energjisë elektrike;
 - d. Kapaciteteve rajonale tranzit NTC në drejtime të ndryshme të linjave të interkoneksionit;
 - e. Integritit të burimeve të rinovueshme të energjisë.

Neni 25. Studimet për planifikimin e sistemit të transmetimit

- 1. OST harton planin afatgjatë të zhvillimit të sistemit të transmetimit duke marrë në konsideratë edhe planifikim-zhvillimet të sistemeve/objektet e përdoruesve të sistemit të transmetimit bazuar në:
 - a. Studimet për shpërndarjen e flukseve të fuqisë;
 - b. Studimet dhe analizat për lidhjet e shkurtra në nyjet dhe degët e sistemit;
 - c. Studimet për qëndrueshmërinë statike dhe dinamike të sistemit elektroenergjetik;
 - d. Studimet mbi energjinë e mosfurnizuar, për sasinë dhe koston e saj;
 - e. Studime për qëndrueshmërinë e tensioneve;

- f. Studimet për regjimet optimale të punës në sistemin elektroenergjetik të vendit;
- g. Studimet për regjimin optimal të flukseve tregtare të energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit.
- h. Studimet për perspektivën afatmesme dhe afatgjatë të mjaftueshmërisë së sistemit.

Neni 26. Analiza e mjaftueshmërisë

1. Në kuadër të studimeve të hartuara nga ENTSO-E, OST realizon në përputhje me metodologjinë e përcaktuar nga ENTSO-E, analizën e mjaftueshmërisë së sistemit për perspektivën afatmesme dhe afatgjatë të zhvillimit të rrjetit.
2. Analiza e mjaftueshmërisë realizohet duke përdorur modelet e tregut të krijuara në përputhje me percaktimet e kodit dhe duke shfrytëzuar programet llogaritëse kompjuterike të dedikuara.
3. OST realizon analizën e mjaftueshmërisë duke shfrytëzuar të dhënat më të fundit të disponueshme rreth:
 - a. Parametrave tekniko-ekonomike të njësive gjeneruese ekzistuese dhe perspektive;
 - b. Profilin e pritshëm të ngarkesës totale në sistem;
 - c. Profilin e mundshëm të faktorëve orarë të shfrytëzimit të burimeve të rinovueshme të energjisë;
1.
 - d. Nivelin aktual dhe të pritshëm të kërkesës së sistemit për rezerva të fuqisë aktive;
 - e. Kapacitetet transmetuese ndërkufitare të rrjetit të transmetimit;
 - f. Disponueshmërinë e pritshme të njësive të gjenerimit (remonte të parashikuara ose jo);
4. Analiza e mjaftueshmërisë afatgjatë kryhet në bazë deterministike ose probabilitare, duke simuluar regjimet e mundshme për çdo orë të secilit vit të analizuar, duke pasqyruar kështu karakterin probabilitar të kërkesës orare për energji elektrike dhe të profilit të gjenerimit të burimeve të rinovueshme të energjisë.
5. OST vlerëson për çdo rast mjaftueshmërinë e gjenerimit dhe sistemit të transmetimit për plotësimin e kërkesës totale të vendit në përputhje me kriteret e sigurisë së operimit të rrjetit dhe vlerëson probabilitetin, kohëzgjatjen dhe energjinë e mosfurnizuar për rastet e mundshme të mungesës së mjaftueshmërisë në sistem.

6. Mjaftueshmëria afatmesme dhe afatgjatë vlerësohet në përputhje me skenarët e përgatitur nga OST për planifikimin e zhvillimit të rrjetit të transmetimit sipas kërkesave të Nenit 20.
7. Në rastet e kryerjes së analizës kosto-përfitim të projekteve me impakt të konsiderueshëm në zhvillimin e rrjetit të transmetimit, OST shfrytëzon analizën e mjaftueshmërisë afatgjatë për të identifikuar dhe vlerësuar indikatorë shtesë të impaktit të projektit, në përputhje me udhëzimet e metodologjisë kosto-përfitim të përcaktuar nga ENTSO-E.

Neni 27. Koordinimi i planifikimit të zhvillimit të sistemit të transmetimit

1. OST do të koordinojë planifikimin e përdoruesve të sistemit të transmetimit bazuar në të dhënat e planifikimit sipas aneksit 1, në mënyrën dhe horizontet kohore të përshkruara në Kodin e Transmetimit.
2. OST do të verifikojë vlefshmërinë dhe do të modifikojë planet, nëse është e nevojshme, pas studimit dhe analizës së metodologjisë, krahasimit me të dhënat faktike dhe historike dhe në koherencë me metodologjitë e planifikimit afatgjatë të ENTSO-E me qëllim konsolidimin dhe paraqitjen e Planit Afatgjatë të integruar për të gjithë përdoruesit dhe pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike.

Neni 28. Miratimi i planit afatgjatë të zhvillimit të rrjetit

1. Drafti i planit të zhvillimit afatgjatë të rrjetit i hartuar nga OST, i paraqitet rregullatorit për shqyrtim dhe miratim.
2. Plani afatgjatë i zhvillimit të rrjetit do të bëhet i detyrueshëm për zbatim për OST, të licencuarit, përdoruesit e sistemit të transmetimit dhe aplikuesit për lidhje në këtë sistem pas miratimit nga rregullatori.
3. Modelet, parashikimet dhe konkluzionet kryesore të studimit të OST paraqiten në institucionet përkatëse në mënyrë që të integrohen si pjesë e planit të investimit rajonal të EJK (RgIP-Plani i Investimeve Rajonale për Evropën Juglindore), Planin Dhjetëvjeçar për Zhvillimin e Rrjetit të Transmetimit ENTSO-E (TYNDP).
4. OST do të përgatisë planin e investimeve në sistemin e transmetimit, bazuar në planin afatgjatë të zhvillimit i cili duhet të rishikohet për çdo vit dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në vendimin e ERE Nr.135, datë 06.09.2017 për “Procedurat e Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve nga Operatorët e Transmetimit dhe Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”.
5. OST do të rishikojë prioritetin e implementimit të projekteve, mbështetur në planin afatgjatë të zhvillimit të sistemit të transmetimit, që lidhen me fuqizimin e këtij sistemi dhe në përputhje me nevojat dhe kërkesat potenciale të përdoruesve të sistemit të transmetimit.

6. OST publikon planin afatgjatë të zhvillimit të sistemit të transmetimit brenda 30 ditëve nga miratimi në ERE në faqen e saj web .

Neni 29. Të dhëna të përgjithshme të planifikimit të siguruara nga OST

1. Të dhënat e sistemit të transmetimit konsistojnë në paraqitjen e sistemit të transmetimit ekzistues dhe sistemit të transmetimit të planifikuar për zhvillim në të ardhmen, ashtu si përshkruhet në planin e afatgjatë dhe afatmesëm të zhvillimit. Të dhëna të tilla përfshijnë:
 - a. Skemën e planimetrisë të sistemit të transmetimit të paraqitur në hartën gjeografike të shtetit që tregon elementet ekzistues të sistemit të transmetimit dhe ato të planifikuara. Harta gjeografike dhe skema e rrjetit (përfshirë formatin e digjitalizuar) duhet të jetë me shkallën e duhur për të lejuar paraqitjen e qartë të detajeve të nevojshme;
 - b. Skemën elektrike një fazore të rrjetit të sistemit të transmetimit që tregon elementët ekzistues të rrjetit dhe ato të planifikuara si dhe pikat përkatëse ku janë lidhur apo do të lidhen gjeneruesit.
2. OST, me kërkesë të përdoruesit të sistemit të transmetimit apo çdo pale të tretë të interesuar, jep informacione dhe të dhëna në lidhje me një pjesë të sistemit të transmetimit, që t'iu krijojë atyre mundësi, akses për lidhjen dhe përdorimin e sistemit të transmetimit.
3. Nëse kërkohet, OST gjithashtu do të ofrojë studimet, raportet dhe analizat e veta mbi gjendjen e pjesës së sistemit të transmetimit të specifikuar në kërkesën përkatëse.

Neni 30. Kostoja e të dhënave dhe e informacionit

1. OST ka të drejtë t'iu kërkojë përdoruesve të sistemit të transmetimit pagesë për të dhënat apo informacionin për sistemin e transmetimit dhe do të informojë përdoruesin për këtë kosto brenda 15 ditëve pas marrjes së kërkesës specifike nga përdoruesi i sistemit të transmetimit. Të dhënat e sistemit të transmetimit do të jepen brenda 2 muajve pas kërkesës së përdoruesit, në varësi të natyrës dhe kompleksitetit të të dhënave të kërkuara.
2. Kostot për dhenien e informacionit për përdoruesit duhet të llogariten nga OST sh.a. në mënyrë transparente dhe të publikohen në faqen web të OST sh.a. Për këtë qëllim OST sh.a. do të marrë masa për të krijuar një rubrikë të vecantë në faqen e vet web, ku të bëjë publike kostot dhe mënyrën e llogaritjes së tyre, për përgatitjen e informacionit për palet e treta.

Neni 31. E drejta e OST për rezervim e të dhënave dhe informacionit

1. OST do të ketë të drejtë të mbajë konfidenciale çdo të dhënë të sistemit të transmetimit, nëse në opinionin e arsyetuar nga OST, nxjerrja apo publikimi i këtyre informacioneve do të ndikojë seriozisht në interesin e aktivitetit të biznesit të shoqërisë OST. Megjithatë

- OST do të japë një minimum të dhënash kur është e qartë që përdoruesit nuk mund të kryejnë aktivitetin e biznesit të tyre pa këto të dhëna.
2. Të dhënat dhe informacioni i marrë do të trajtohen si konfidencial dhe nuk do të ekspozohet për palët e treta.

Neni 32. Planifikimi për përmirësimin dhe modifikimin e pajisjeve të sistemit

1. Planifikimin për përmirësimin e sjelljes së sistemit elektroenergjetik ekzistues dhe pajisjeve/instalimeve të tij përfshin modifikimin dhe/ose zëvendësimin total të pajisjeve/instalimeve duke kryer një seri punimesh, por pa ndërhyrë në pajisjen kryesore.
2. Objektivat e planeve të tilla që përfshijnë investime të vogla, janë: përmirësimi i sjelljes së pajisjeve, i cilësisë dhe shkallës së sigurisë së furnizimit me energji elektrike, i qëndrueshmërisë statike dhe dinamike të sistemit, i sigurisë operacionale të sistemit, i kriterit ekonomik, i reduktimit të humbjeve të energjisë elektrike dhe përmirësimit të treguesve të shërbimit të sistemit të transmetimit, i përmirësimit të standardeve të sigurisë së jetës njerëzore dhe pajisjeve, i përmirësimit mjedisor.
3. Të gjitha palët në bashkëpunim me OST, identifikojnë zonat ku do të kryhen ndërhyrjet modifikuese duke kryer investime të cilat do të përmirësojnë cilësinë dhe/ose sasinë e përfitimeve dhe do të zhvillojnë planet për përmirësimin cilësor dhe bashkëkohor të sjelljes së sistemeve/objekteve të tyre.
4. OST do të zhvillojë programe të përmirësimit të regjimit operacional të sistemit të transmetimit. Ndërhyrjet përkatëse në zonat ku përmirësime të tilla janë planifikuar përcaktohen nga OST kohë pas kohe.

Neni 33. Afatet kohore për planet dy vjeçare të rinovimit dhe modifikimit të përdoruesve

1. Planet dy vjeçare për rinovimin dhe modifikim të përdoruesve të sistemit do të paraqiten OST deri me 30 Shtator të çdo viti, për dy vitet pasardhës dhe do të përmbajë të dhënat sipas formateve të aneksit 1.
2. Zbatimi i modifikimeve dhe rinovimeve mund të shtyhet me miratim reciprok të palëve. Një palë mund të kërkojë shtyrje afati për arsye teknike ose vështirësi të tjera të qenësishme. Nëse nuk arrihet asnjë marrëveshje ndërmjet palëve për programin e modifikimeve dhe rinovimeve, çështja zgjidhet nga sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Aneksi I

Të dhënat e planifikimit

1. Të dhënat e planifikimit nga përdoruesit e sistemit të transmetimit, do të kategorizohen si më poshtë:
 - a. Të dhëna standarte të planifikimit;
 - b. Të dhëna të detajuara të planifikimit;
 - c. Të dhëna për punimet në proces;
 - d. Të dhëna përfundimtare
2. Në të gjitha rastet të dhënat paraqiten në formatet e përshkruara në kod dhe përndryshe ato shoqërohen me shënimet dhe sqarimet e pershtatshme.
3. Të dhënat dhe informacioni paraqiten fillimisht në kohën/datën e aplikimit për lidhjen e re ose modifikimin e lidhjes ekzistuese apo dhe përdorim të sistemit të transmetimit nga përdoruesit dhe do të përmbajnë vetëm të dhënat standarte të planifikimit, derisa të kërkohen në mënyrë specifike të dhëna të detajuara të planifikimit nga OST.
4. Pas lidhjes me sistemin e transmetimit, çdo përdorues i sistemit të transmetimit do të paraqesë këto të dhëna deri në 30 shtator të çdo viti, për vitin/vitet pasardhës të planifikimit.
5. Informacioni dhe gjithë të dhënat e paraqitura dhe të marra nga OST, duke u bazuar në Kodin e Planifikimit, janë të detyrueshme dhe do të formojnë bazën për planifikimin e sistemit elektroenergjitik të vendit.
6. Të dhënat e detyrueshme do të trajtohen me nivelin e duhur të konfidencialitetit, në mënyrë që OST të mund ti përfshijë këto të dhëna në sistemin e tij të të dhënave, në pajtueshmëri me dispozitat e këtij Kodi.

Të dhënat standarde të planifikimit

Gjeneruesit

Tipi	TEC; HEC; EOLIK
Emri i aplikuesit	
Personi kontaktues	
Adresa dhe detaje të aplikuesit	
Lidhja	
Pika e lidhjes	Skemë një fazore e lidhjes së propozuar me sistemin e transmetimit
Vendndodhja gjeografike	Zona gjeografike të vendndodhjes së objektit/objekteve në hartë të lexueshme dhe jo më e vogël se formati A3
Tensioni nominal	Niveli i tensionit në pikat e lidhjes me sistemin e transmetimit në kV
Koha e planifikuar për fillimin e operimit	
Kapaciteti gjenerues	
Fuqia aktive nominale e instaluar e gjeneruesit	Fuqia aktive totale për gjeneruesit egzistues. Fuqia për gjeneruesit e rinj sipas fazave të investimit, në MW.

Numri i njësive gjeneruese dhe fuqia aktive e tyre	$n \times MW$
Njesia	
Njësi gjeneruese	Tipi, fuqia aktive nominale
Regjimet e punës	Maksimal, Minimal, Mesatar. Parametrat e punës në regjimet maksimal, minimal, mesatar.
Gjeneratori	Tipi
	Karakteristika nominale (S_n , P_n në MVA dhe MW)
	Fuqia minimale që mund të prodhojë gjeneratori (P_{min} në MW)
	Kufijtë e prodhimit të fuqisë reaktive të gjeneratorit (Q_{max} , Q_{min} në MVA _r)
	Tensioni Nominal (U_n në kV)
	Frekuenca Nominale (f_n në Hz)
	Rryma Nominale e Fazës (I_n në A)
	Faktori Nominal i Fuqisë ($\cos\phi$)
	Fuqia e Qarkut të Shkurtër(MVA)
	Reaktanca sinkrone gjatësore, X_d (në p.u të MVA)
	Reaktanca sinkrone tërthore X_q (në p.u. të MVA)
	Reaktanca Kalimtare Gjatësore, $X'd$ (në p.u. të MVA)
	Reaktanca Kalimtare Tërthore ($X'q$ në p.u të MVA)
	Reaktanca Superkalimtare Gjatësore, $X''d$ (në p.u. të MVA)
	Reaktanca Superkalimtare Tërthore, $X''q$ (në p.u. të MVA)
	Reaktanca e Renditjes së kundërt, X_2 (në p.u. të MVA)
	Reaktanca e Renditjes Nulare, X_0 (në p.u. të MVA)
	Rezistenca e Statorit për faze në 75 grade C (R_a në om)
	Numri i Rrotullimeve nominale n_n (rrotullime/min)
	Momenti i Volantit-GD2(T_m2) apo Konstantja e Intercise-H (sek)
	Konstantja mekanike e kohës, $T'm$ (në sek)
	Konstantja e kohës kalimtare gjatësore për pështjellë të hapur në stator, $T'do$ (në sek)
	Konstantja e kohës superkalimtare gjatësore për pështjellë të statorit të hapur, $T''do$ (në sek)
	Konstantja e kohës kalimtare tërthore për qark të hapur ($T'qo$ në sek)
	Konstantja e kohës superkalimtare tërthore për pështjellë të statorit të hapur, $T''qo$ (në sek)
	Konstantja e kohës kalimtare gjatësore për pështjellë të statorit të lidhur në të shkurter, $T'd$ (në sek)
Konstantja e kohës superkalimtare gjatësore për pështjellë të statorit të lidhur në të shkurtër, $T''d$ (në sek)	
Konstantja e kohës superkalimtare tërthore për pështjellë të statorit të lidhur në të shkurtër, $T''q$ (në sek)	

	Konstantja e kohës e pështjellës së statorit të lidhur në të shkurtër, Ts (ne sek)
	Koeficienti i Lidhjes së Shkurtër (Kc)
	Kërkesa për Fuqi Ndihmëse (Nevojat Vetiake) në MW
	Kurba e Aftësisë së Gjeneratorit
	Kurba e Ngopjes së Qarkut të Hapur
	Kurba e Ngopjes së Lidhjes së Shkurtër
Transformatori i fuqisë i bllokut	Tipi
	Fuqia e plotë Nominale në MVA
	Niveli i Tensionit (HV/LV) në kV
	Rrymat nominale (HV/LV) në A
	Rregullimi i Tensionit (Numri i shkallëve dhe hapat $\pm\%$);
	Tipi i Rregullimit të Tensionit (off-load/on-load)
	Grupi i lidhjes së pështjellave
	Impedanca e lidhjes shkurtër në %
	Humbjet e punimit në ngarkesë në kW
	Humbjet e punimit pa ngarkesë në kW
	Rryma e punimit pa ngarkesë në %
	Lloji i ftohjes (ONAN/ONAF)
Të dhëna për rrjetin TM	Skema e lidhjes së njërive gjeneruese midis tyre në tension të mesëm
	Tensionin nominal të rrjetit TM
	Gjatësitë e linjave lidhëse
	Seksionet e përcjellësave elektrike (kabllorë/ajrore)
Fuqia për nevojat vetiake	Fuqia totale e kërkuar për paisjet vetiake të gjeneruesit në MW dhe MVA
	Fuqia e jashtme totale e kërkuar për Black-Start në MW (nuk aplikohet për gjeneruesit eolik dhe HEC run of river)

Tipi	FOTOVOLTAIK
Emri i aplikuesit	
Personi kontaktues	
Adresa dhe detaje të aplikuesit	
Lidhja	
Pika e lidhjes	Skemë një fazore e lidhjes së propozuar me sistemin e transmetimit në hardcopy dhe në soft
Vendndodhja gjeografike	Zona gjeografike të vendndodhjes së objektit/objekteve në hartë të lexueshme dhe jo më e vogël se formati A3
Tensioni nominal	Niveli i tensionit në pikat e lidhjes me sistemin e transmetimit në kV
Koha e planifikuar për fillimin e operimit	

Tipi i Gjeneruesit Solar	Përshkrimi teknik i gjeneruesit, tipi i tij. Informacion mbi rrezatimin në kWh/m ² në vit. Këndi i Azimuthit. Rendimenti në kWh/kWp (DC) në vit
Kapaciteti gjenerues	
Fuqia totale e Gjeneruesit në MW _p (DC)	Fuqia nominale aktive në MW në pik, sipas fazave të investimit, në MW _p .
Fuqia totale e Gjeneruesit në MW (AC)	Fuqia nominale aktive në MW pas konvertimit DC/AC sipas fazave të investimit
Nr. i njësive gjeneruese/moduleve dhe paneleveve FV sipas ndarjes	
Numri i orëve vjetore të punës	
Njesia	
Karakteristika e gjenerimit	Kurba e prodhimit të energjisë elektrike - ditore
Lloji i modulit dhe kapaciteti në kW (DC)	Maksimal, Minimal, Mesatar. Parametrat e punës në regjimet maksimal, minimal, mesatar.
Karakteristika nominale të modulit	U _n në V dhe I _n në A
Konvertuesi (Inverteri)	Tipi, kapaciteti, tensioni, performanca
Transformatori	Tipi
	Fuqia e plotë Nominale në MVA
	Niveli i Tensionit (HV/LV) në kV
	Rrymat nominale (HV/LV) në A
	Rregullimi i Tensionit (Numri i shkallëve dhe hapat ±%);
	Tipi i Rregullimit të Tensionit (off-load/on-load)
	Grupi i lidhjes së pështjellave
	Impedanca e lidhjes shkurtër në %
	Humbjet e punimit në ngarkesë në kW
	Humbjet e punimit pa ngarkesë në kW
	Rryma e punimit pa ngarkesë në %
Lloji i ftohjes (ONAN/ONAF)	
Rryma e lidhjes së shkurtër trefazore në zbarën e TM në kA	Të jepet kontributi i parkut fotovoltaik në rrymën e lidhjes së shkurtër në nyjen e TM të Nënstacionit ngritës TL/TM
Të dhëna për rrjetin TM	Skema e lidhjes së njësive gjeneruese midis tyre në tension të mesëm
	Tensionin nominal të rrjetit TM
	Gjatësitë e linjave lidhëse
	Seksionet e përcjellësave elektrike (kabllorë/ajrore)
Fuqia për nevojat vetiake	Fuqia totale e kërkuar për paisjet vetiake të gjeneruesit në MW dhe MVA
	Fuqia e jashtme totale e kërkuar për Black-Start në MW

Shenim: Për tipet e Gjeneruesve që nuk përfshihen në tipet me sipër, të dhënat do të paraqiten sipas kërkesave të veçanta të specifikuara nga OST në zbatim të plotë të dispozitave të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/631.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes

Zona e shtrirjes gjeografike për shoqërinë e Sistemit të Shpërndarjes dhe plan vendosja për klientët, në hartë	Paraqet zonën gjeografike në të cilën ushtron aktivitetin e biznesit shoqëria e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Klientët sipas licensës përkatëse, të paraqitur në hartën shtetërore. Kjo hartë duhet të jetë e lexueshme dhe jo më e vogël se formati A3).
Të dhënat për ngarkesat e tyre	Te dhënat si konsumatorë të energjisë elektrike, në MW, MVA.
Pikat e lidhjes	Skemë një fazore që tregon pikat e lidhjes me sistemin e transmetimit
Tensioni nominal	Niveli i tensionit në pikat e lidhjes me sistemin e transmetimit në kV
Të dhënat e nënstacioneve elektrike	Jepet skema primare e nënstacionit lidhës me rrjetin e transmetimit
	Jepen detajet (fuqia transformuese, konfigurimi i të gjithë elementeve primare dhe sekondare, planimetria, harta, etj.) e nënstacioneve që lidhen direkt me sistemin e transmetimit dhe
Transformatorët e fuqisë	Tipi Fuqia e plotë Nominale në MVA Niveli i Tensionit (HV/LV) në kV Rrymat nominale (HV/LV) në A Rregullimi i Tensionit (Numri i shkallëve dhe hapat $\pm\%$); Tipi i Rregullimit të Tensionit (off-load/on-load) Grupi i lidhjes së pështjellave Impedanca e lidhjes shkurtër në % Humbjet e punimit në ngarkese në kW Humbjet e punimit pa ngarkese në kW Rryma e punimit pa ngarkese në % Lloji i ftohjes (ONAN/ONAF)
Detaje të instalimeve kompesuese të instaluar	(kapacitive ose induktive)
Lloji i pajisjes	(statik /dinamik)
Ngarkesën nominale kapacitive dhe/ose induktive	brezin i operimit në MVar;
Detajet e çdo kontrolli automatik që mundëson përcaktimin e karakteristikave të operimit	

Ngarkesat

Detaje të ngarkesave që lidhen ne sistemin e transmetimit	Jep emrin e klientit,
	Proçesin teknologjik të punës
	Kërkesën për energji elektrike sipas kontratës
Harta gjeografike e zonës	Tregon zonën ku është vendosur klienti, ngarkesa, si dhe linjat eletriqe. Jep hartën dhe planimetrinë e vendit ku parashikohet/është vendosur të realizohet lidhja e objektit. Harta dhe planimetria duhet të jenë të lexueshme dhe në formatin jo më të vogël se A3
Emërtimi i nënstacionit nga i cili furnizohet klienti	Emri i nënstacionit të sistemit të transmetimit
	Linja qe e furnizon
	Gjatësinë e linjës
	Skema e primare e nënstacionit dhe parametrat kryesore të pajisjeve primare, linjat elektrike hyrëse dhe dalëse;
	Tensionin e furnizimit
	Faktorin e fuqisë, $\cos\phi$
Detaje të instalimeve kompesuese të instaluar	(kapacitive ose induktive)
Lloji i pajisjes	(statik /dinamik)
Ngarkesën nominale kapacitive dhe/ose induktive	brezin i operimit në MVar;
Detajet e çdo kontrolli automatik që mundëson përcaktimin e karakteristikave të operimit	
Ngarkesat në pikat e lidhjes	Ngarkesat dhe detajet e ngarkesave të vendosura në pikën e lidhjes, në MW
Të dhëna të parashikimit të ngarkesës	
Ndjeshmëria e ngarkesës nga tensioni dhe frekuenca	
Maksimumi i harmonikave të ngarkesës	
Mesatarja dhe maksimumi i disbalancës së fazave të ngarkesës	

Parashikimi i ngarkesës (plotesohen nga operatori i sistemit te shperndarjes dhe ngarkesa)

Ngarkesa maksimale pik dhe minimum	Profili i ngarkesës sipas kategorive, parashikimi i ngarkesës për çdo kategori të ngarkesës për 10 vitet e ardhshme, planifikimi afatgjatë i kërkesës;
Detaje të metodologjisë dhe baza e të dhënave në të cilën janë bazuar parashikimet	

Parashikimet e ngarkesës	Për çdo kategori dhe në total të ngarkesës për 10 vitet e ardhshme, të shoqëruara me kurbat ditore të ngarkesës të përafëruara
---------------------------------	--

Linjat e transmetimit dhe te perdoruesve (*plotesohen nga te gjithë perdoruesit*)

Emri i linjës	(nënstacioni në fillim të linjës dhe nënstacioni në mbarim të linjës)
Tensioni i linjës	(kV)
Gjatësia e linjës	(km)
Përcjellësit e linjës	(Tipi, Seksioni (mm ²))
Parametrat e linjës (në p.u. dhe vlerat Ohmike për km të linjës)	Rezistenca/Induktanca
	Përcjellshmëria/konduktanca (B/2 në p.u. dhe μS)
	Aftësia transmetuese në temperaturë ambiente 20°C (Rryma e lejuar termike në A)
	Përcaktimi i densitetit j-ekonomik në A/mm ²
Tipet e shtyllave që do të përdoren dhe parametrat përkatës	
Terreni ku kalon linja	(informacion mbi terrenin natyror ku kalon linja elektrike)
Harta e linjës	(informacion për topografinë planimetrike të linjës në hartën gjeografike që tregon linjën e propozuar dhe linjat egzistuese)
Koha e vënies në punë	dd/mm/vv

Të dhënat e detajuara të planifikimit

Gjeneruesit

Studimet teknike	Studime për shpërndarjen e flukseve Studime për lidhjet e shkurtra Studime të qëndrueshmërisë statike dhe dinamike Propozim për lidhje me sistemit e transmetimit Numri i linjave, tensioni, pika/pikat e lidhjes Vlerësimi i ndikimit ne mjedis
Të dhënat teknike për turbinat dhe burimin primar te energjise	Karakteristikat kryesore (Tipi i rezervuarit, grafiket e operimit, portat shkarkuese dhe aftësitë e tyre, konsumi i ujit për nivele të ndryshme të rezervuarit)
	Kaldaja (temperatura e avullit/ presioni i avullit) Lloji i lëndës djegëse, të dhënat kryesore të pompave të furnizimit me ujë dhe të burimit të furnizimit me ujë teknik
Skemë elektrike primare një fazore e Gjeneruesit	
Skemat principiale elektrike të kontroll-monitorimit, mbrojtjes	

rele dhe matjes, telekomunikacionit, SCADA, etj.	
Statusi i neutrit të statorit të gjeneratorëve (i tokëzuar apo jo), skema e tokëzimit dhe vlera e rezistencës së tokëzimit	
Statusi i neutrit të transformatorëve ngritës të fuqisë të gjeneruesit në anën e lidhjes me rrjetin e transmetimit dhe vlerat e rezistencës së tokëzimit	
Detaje të sistemit të kontroll-monitorimit, SCADA lokale e gjeneruesit, telekomunikacioni, RTU (njësia e kontrollit në distance), etj.	
Skemë elektrike primare një fazore e gjeneruesit	
Për paisjet komutuese ku përfshihen çelsat, ndarësat-thikat e vendosura në pikat e lidhjes	Tensioni nominal (kV)
	Tipi i çelsit, ndarësit-thikës dhe parametrat kryesore të tyre
	Rryma e lidhjes së shkurtër 3 fazore dhe 1 fazore, (kA)
	Të dhënat të pajisjes të rikyçjes automatike dhe tarimet përkatëse
Niveli i izolacionit (kV)	Zbarat
	Paisjet Komutuese (çelsat, ndarsat-thikat)
	Transformatorët e rrymës dhe tensionit
	Degëzimet e rregullimit të tensionit në transformator
	Pështjellat e transformatorëve;
Të dhëna të tjera teknike të nevojshme me kërkesë të arsyetuar nga OST, për problemet e operimit, dispecimit, kontrollit të frekuencës, rezervat rregulluese, të rregullimit të tensionit, për Black- Startin, e tjera.	
Parametrat e sistemit të eksitimit dhe rregullatorit automatik të tensionit (RAT)	Tipi i Eksituesit
	Rryma nominale e punës së eksituesit (In në A)
	Tensioni nominal i punës së eksituesit (Un në V)
	Rryma maksimale e eksituesit gjatë kohës kalimtare (Imax. Në A)
	Tensioni maksimal i eksituesit (U max. Në V)
	Përgjigja kalimtare e sistemit të eksitimit (ne sek)

	Karakteristika e përgjigjes së sistemit të eksitimit me lak të hapur	
	Karakteristika e përgjigjes së sistemit të eksitimit me lak të mbyllur	
	Karakteristika dinamike të mbieksitimit dhe kufijtë	
	Karakteristika dinamike të nëneksitimit dhe kufijtë	
	Skema strukturore e detajuar e të gjithë sistemit të eksitimit, ku tregohen në detaje funksionet transmetuese të elementeve të tij dhe parametrat e elementeve transmetues bazuar në tipin e sistemit të eksituesit dhe skema strukturore, funksionet transmetues dhe parametrat e elementeve të tij	
Parametrat e rregullimit dhe rregullatorit të shpejtësisë	Tipi i rregullatorit të shpejtësisë	
	Koeficienti “k” i përcaktimit të shkallës së futjes në punë të rregullatorit të shpejtësisë (në MW/Hz) siç përcaktohet në standartet	
	Marrja e shpejtësisë dhe konstantja e kohës e tij (TSR)	
	Konstante kohës së servomotorit dhe aparatit drejtues (TSM)	
	Valvola e hapjes së rregullatorit të shpejtësisë me numër limit (CV. OPEN)	
	Valvola e mbylljes me numër limit e rregullatorit të shpejtësisë (CV. CLOSE)	
	Kufiri i valvolës së rregullatorit të shpejtësisë (CVmax. dhe CVmin)	
	Skema strukturore e sistemit të rregullimit dhe rregullatorit të shpejtësisë duke treguar funksionet transmetues të elementëve të veçantë dhe të rekomanduar në standartet përkatëse	
	Shpejtësia e rregullimit të RASH	
	Shpejtësia e lëshimit normal	
	Shpejtësia e lëshimit në emergjence	
	Konstante e kohës së inercisë (Tw)	
	Mbrojtja Rele	Përshkrim i plotë i mbrojtjes rele që përfshin tarimet për gjithë reletë dhe sistemet e mbrojtjes rele të instaluar në Gjeneratorët dhe Transformatorët e njëjësive gjeneruese, Transformatorët e Nevojave Vetjake dhe motorët elektrik të paisjeve ndihmëse.
		Përshkrim i plotë i mbrojtjes rele që përfshin tarimet për gjithë reletë e instaluar në të gjitha linjat dalëse nga nënstacionet ngritës të gjeneruesve
Përshkrim të plotë të çelësave të fuqisë në pikën ose pikat e Lidhjes me rrjetin e Sistemit të Transmetimit dhe të dhënat e çelësave të fuqisë për veprimet komutuese (fuqia e ckyçjes, koha e kycjes, koha e çkyçjes).		

	Kohëzgjatja më e mundshme e defekteve elektrike në sistemet/objektet e Gjeneruesve (njësi gjeneruese, linja, transformatorë e tjera).
	Detajimi i funksionimit të mbrojtjes rele, automatikës dhe matjes së energjisë elektrike që përfshin transformatorët matës dhe kabllot në anën sekondare.
Specifikimet teknike të pajisjeve të telekomunikacionit	Specifikimet për OPGW, që duhet të instalohet në linjën që do të lidhë objektin e ri me nënstationin dhe konfigurimi i lidhjes së fibrave optike ku do të bëhet ndërfaqja, sipas çdo rasti specifik dhe impaktit në rrjetin ekzistues të OPGW te OST
	Specifikimet e detajuara për radrizatorët, kabinetet industriale, bateritë dhe paisjet e tjera ndihmëse
	Telefonia dixhitale dhe analoge
Parametrat për linjën elektrike	Emërtimi i linjës dhe kodi i identifikimit
	Gjatësia e linjës (km);
	Numri i qarqeve të linjës
	Aftësi transmetuese termike për çdo qark në A ose në MVA
	Tensioni kV;
	Reaktanca fazore e renditjes së drejtë (p.u. në 100 MVA), X1
	Rezistenca fazore e renditjes së drejtë (p.u. në 100 MVA), R1
	Përcjellshmëria fazore e renditjes së drejtë (p.u. në 100 MVA), B1
	Reaktanca fazore e renditjes nulare (p.u. në 100 MVA), X0
	Rezistenca fazore e renditjes nulare (p.u. në 100 MVA), R0
	Përcjellshmëria fazore e renditjes nulare (p.u. Në 100 MVA), B0

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe Ngarkesa

Të dhënat historike	nivelit të humbjeve teknike në bazë vjetore
	monitorimit ditor për ditët karakteristike të vitit të humbjeve teknike në rrjetin sistemet/objektet e tyre
Ngarkesa e lidhur	(Tipi/Kategoria, detajet e ngarkesës, e konsumatorit, regjimi i tyre i operimit dhe shfrytëzimit)
Grafikun ditor në 24 ore	(për ditë karakteristike/specifike të vitit (e mërkura e tretë dhe e djela e tretë, përpara të mërkurës, për çdo muaj) të ngarkesës për çdo nënstation te Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe/ose ngarkeses, ose sipas kërkesës së

	veçantë të OST për ditën dhe orët e nevojshme të horizontit kohor të studimit apo analizës së nevojshme
Grafikun me bazë ditore	(sezonal dhe vjetor) për ngarkesën në tërësi të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe/ose perdoruesin e sistemit të transmetimit
Detaje të ngarkesës si dhe parashikimin për 5 vitet e ardhshme	Instalimi dhe shpërndarja e ngarkesave në nënstacionet e projektuar
	Ngarkesave kryesore që do të kontraktohen
Paraqitje dhe analizë e vlerësimit të humbjeve teknike të fuqisë dhe energjisë	Linja të reja
	Përmirësim i linjave egzistuese
	Nënstacione të rinj dhe përmirësimi i atyre ekzistues
	Rishpërndarjen e ngarkesave dhe të regjimit të shfrytëzimit dhe operimit
	Instalimi i instalimeve kompesuese të fuqisë reaktive të nevojshme

Të dhëna për punimet në proces

1. Keto të dhëna/informacione paraqiten nga të gjithë përdoruesit e sistemit të transmetimit të pakten në baze vjetore deri në 30 shtator të çdo viti, për vitin/vitet pasardhës të planifikimit.
2. Informacioni do të përmbajë:
 - a. Raport mbi punimet që kryhen nga përdoruesit që lidhen me sistemin e transmetimit;
 - b. Grafiku për punimet e kryera;
 - c. Grafiku për punimet deri në përfundimin e projektit;

Të dhëna përfundimtare

1. Të dhënat Përfundimtare dorezohen nga të gjithë përdoruesit e sistemit të transmetimit dhe paraqesin datën e përfundimit të punimeve dhe datën e energjizimit për tu lidhur me rrjetin e Sistemit të Transmetimit të sistemeve/objekteve me faza, të Përdoruesit të këtij rrjeti, që ndikojnë në sjelljen operationale të Sistemit të Transmetimit dhe në tërësi të sistemit Elektroenergjitik të vendit.

KODI I LIDHJES ME SISTEMIN E TRANSMETIMIT

Pjesa I – Procedura, dokumentacioni dhe energjizimi i lidhjes

Neni 34. Qëllimi dhe objekti

1. Kodi i Lidhjes me Sistemin e Transmetimit specifikon kushtet dhe parametrat teknike, procedurat, rregullat dhe afatet kohore në baza jodiskriminuese për aplikimin për një lidhje të re me sistemin e transmetimit ose për të modifikimin e lidhjeve ekzistuese në këtë rrjet.
2. Dispozitat e këtij kodi janë të detyrueshme për çdo përdorues dhe për të tretë të lidhur në sistemet e përdoruesve, me qëllim sigurimin e mbrojtjes së sistemit të përdoruesve si dhe të sistemit të transmetimit në tërësi duke garantuar projektimin, kontrollin dhe operimin e sigurtë dhe të qëndrueshëm reciprok.
3. Çdo subjekt që aplikon për lidhje me sistemin e transmetimit duhet të zbatojë dhe dokumentojë sipas dispozitave përkatëse përmbushjen e kërkesave të VKM nr.482 dhe 483 dt.17/06/2020 dhe vendimet e ERE nr.127, 128 ose 129, dt.04/06/2018 sipas tipologjisë së përdoruesit.
4. Lidhja me sistemin e transmetimit rregullohet nëpërmjet një marrëveshje lidhje mes OST dhe përdoruesit për secilën pikë lidhje në veçanti, pa përjashtuar dhe duke përfshirë lidhjen e një marrëveshje operimi.

Neni 35. Procedurat e aplikimit për lidhje të re dhe/ose modifikim të lidhjes

1. Çdo subjekt që kërkon të lidhet në sistemin e transmetimit ose çdo përdorues ekzistues që kërkon të modifikojë lidhjen dhe marrëveshjen ekzistuese, duhet të zbatojë kërkesat dhe procedurat e vendosura në këtë kod.
2. Subjektet sipas pikës (1) paraqesin një aplikim për lidhje, sipas formularëve përkatës të aplikimit për lidhje të re apo modifikim të lidhjes ekzistuese në sistemin e transmetimit të hartuar dhe publikuar nga OST, në zbatim të rregullores në përputhje me nenin 27 të ligjit Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.
3. Çdo aplikim për lidhje të re ose modifikim të lidhjes ekzistuese do të nënshtrohet tarifave përkatëse, procedurave dhe afatet kohore të specifikuara në zbatim të kërkesave të nenit 27, 28 dhe 29 të ligjit Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.

Neni 36. Dokumentacioni i përgjithshëm dhe teknik i aplikimit

1. Aplikuesi paraqet në OST informacionin dhe dokumentacionin si vijon:
 - a. Të dhëna identifikuese dhe të aktiviteti ekonomik/ligjor (emri i shoqërisë, përfaqësuesi ligjor, adresa, telefoni, faktsi, e- mail, web e tjera);

- b. Të dhëna teknike të përdoruesit, sistemi/objekti që do të lidhet (njësi gjenerimi, sistem/objekt i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, sistem/objekt klientë/konsumatorë të ndryshëm) duke përfshirë edhe koordinatat në hartën e sistemit të transmetimit për pikën/vendin e lidhjes;
 - c. Studimin e lidhjes së njësive gjeneruese, operatorit të sistemit të shpërndarjes, konsumatorit (sipas përkatësisë) apo studimin për modifikimin e lidhjes ekzistuese dhe të dhënat sipas planifikimit standard të Kodit të Planifikimit;
 - d. Të dhënat për instalimet dhe pajisjet që gjenerojnë /absorbojnë fuqi reaktive;
 - e. Të dhënat për fazat përkatëse, sipas studimit tekniko-ekonomik të përdoruesit, për realizimin e treguesve të projektit investues (horizontet kohore: fazat e projektimit teknik, fazat e zbatimit, kolaudimi-testimi, komisionimi/marrja në dorëzim dhe energjizimi);
 - f. Projektin teknik i cili i nënshtrohen shqyrtimit dhe miratimit nga institucionet përkatëse në lidhje me konformitetin me standardet e harmonizuara shqiptare;
 - g. Dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifave të lidhjes;
 - h. Listën e dokumentacionit të përgjithshëm dhe teknik që i bashkëlidhet formularit të aplikimit për lidhje të re ose për modifikim të lidhjes ekzistuese.
2. Studimi për lidhjen në rrjetin e transmetimit sipas pikes 1, germa c, përfshin:
- a. zgjidhjen teknike për lidhjen në sistemin e transmetimit;
 - b. analizën e ndikimit në sistemin e transmetimit për shkak të lidhjes së re apo modifikimit të asaj ekzistuese;
 - c. karakteristikat teknike të infrastrukturës së objektit të përdoruesit të sistemit të transmetimit;
 - d. plotësimi i kërkesave të kuadrit teknik në fuqi;
 - e. çështje operationale dhe menaxhimi i objektit të përdoruesit.

Neni 37. Pika/vendi optimal i lidhjes

1. Për çdo aplikim OST do të miratojë një pikë/vend lidhje që teknikisht është më optimal, ku aplikuesi mund të lidhë sistemet/objektet e tij me sistemin e transmetimit.
 - a. Pikat e lidhjes për gjeneruesit do të jenë në sistemin e transmetimit me tension nominal 110 kV, 220 kV ose 400 kV;
 - b. Pikat e lidhjes për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes do të jenë në sistemin e transmetimit me tension nominal 110 kV;

- c. Pikat e lidhjes për ngarkesën do të jenë në sistemin e transmetimit me tension nominal 110 kV dhe 220 kV.
2. Në qoftë se pas studimit të “Pranueshmërisë së lidhjes së re apo modifikimit të lidhjes ekzistuese”, rezulton se lidhja e re duhet të bëhet në sistemin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes në tension < 110 kV, atëherë kërkesa për aplikim i kthehet zyrtarisht aplikuesit me informacionin dhe sqarimet e përkatëse.

Neni 38. Procesi dhe afatet e aplikimit

1. Për çdo aplikim për lidhje të re ose modifikim të lidhjes ekzistuese me sistemin e transmetimit subjekti paraqet pranë OST formatin e aplikimit të shoqëruar me dokumentacionin për aplikim.
2. Aplikuesi paraqet të dhënat standarde të planifikimit, sipas përcaktimeve të këtij kodi. Kur është e nevojshme nga pikëpamja teknike, OST mund të përcaktojë kritere/kërkesa teknike shtesë nga ato të përcaktuara në Kodin e Transmetimit, por në të gjitha rastet do të njoftojë palën tjetër brenda afateve të përcaktuara në këtë kod.
3. OST shqyrton nëse dokumentet e depozituara dhe informacioni i paraqitur nga aplikuesi janë të plotë dhe në përputhje me kërkesat e kuadrit në fuqi.
4. Në rastet kur në aplikim mungon ndonjë nga dokumentet ose informacionet e parashikuara në këtë kod apo nëse OST kërkon të dhëna apo informacion shtesë nga aplikuesi, sipas pikës (2) aplikuesi është i detyruar të paraqesë dokumentacionin e kërkuar brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e njoftimit për plotësimin e tij.
5. Nëse aplikuesi nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar brenda periudhës së specifikuar në pikën (4) të këtij neni, OST refuzon aplikimin.
6. OST i komunikon aplikuesit përgjigjen e tij për pranimin ose refuzimin e aplikimit brenda 60 ditëve kalendarike nga data e plotësimit të gjithë kërkesave të aplikimit ose brenda 90 ditëve në rastet e parashikuara në pikën (4).

Neni 39. Oferta e lidhjes së re dhe/apo modifikimit të lidhjes ekzistuese

1. Pas paraqitjes nga aplikuesi i të gjithë informacionit të kërkuar, OST do të verifikojë, shqyrtojë dhe vlerësojë të gjithë aplikimin sipas kërkesave të Kodit të Transmetimit. OST kryen studimin e “Pranueshmërisë së lidhjes së re ose modifikimit të lidhjes ekzistuese” sipas pikave më poshtë por pa u kufizuar:
 - a. të dhënat e aplikimit dhe dokumentacionit të përgjithshëm dhe teknik të lidhjes të protokolluara;
 - b. mundësinë për shfrytëzimin e kapacitetit të sistemit të transmetimit dhe nëse nuk ekziston kjo mundësi, aplikuesi do të marrë masa teknike dhe do të investojë vetë deri në mbulimin e plotë të investimit, brenda kushteve teknike të specifikuara në Kodin e Transmetimit dhe të ligjit Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”,

VKM-te nr.482 dhe 483 dt.17/06/2020 dhe vendimit e ERE nr.127, 128 ose 129, dt.04/06/2018;

- c. përcaktimin dhe përzgjedhjen e vendit të lidhjes së re në vendin e duhur, sipas shkallës së sigurisë së furnizimit, qëndrueshmërisë statike dhe dinamike, madhësive të lidhjeve të shkurtra 3 dhe 1 fazore, ndikimit në humbjet teknike në sistemin e transmetimit me lidhjen e re dhe furnizimin me energji elektrike për nevojat vetjake sidomos për rastet e lidhjes se njëjësive gjeneruese, analizën e flukseve të energjisë, analiza e cilësisë së energjisë;
- d. parametrat e funksionimit të sistemit të transmetimit në kufijtë e përcaktuar operacional për të siguruar lidhjen dhe funksionimin e përdoruesit pa efekte negative në sistemin e transmetimit dhe cënimin e funksionimit normal të përdoruesit apo te te treteve;
- e. kostot e lidhjes së aplikuesit, konform me Nenin 27 dhe 28 të ligjit Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, dhe rregullores përkatëse;
- f. përmbushjen e kërkesave të kodit dhe harmonizimin e studimit të lidhjes të propozuar/kërkuar të përdoruesit me planin e aprovuar për zhvillimin e sistemit të transmetimit;
- g. plotësimin e të gjitha kushteve dhe standardeve teknike për lidhjen e përdoruesit posaçërisht për sa vijon:
 - i. Punimet që duhet të kryhen për realizimin e lidhjes me sistemin e transmetimit;
 - ii. Punimet e nevojshme për zgjerimin dhe forcimin e sistemit të transmetimit, si parakusht për realizimin e lidhjes;
 - iii. Kapaciteti për tu lidhur në sistemin e transmetimit;
 - iv. Koordinimi i izolimit;
 - v. Sistemi i mbrojtjes rele (koordinimi i mbrojtjes së sistemit të transmetimit dhe mbrojtjes së përdoruesit);
 - vi. Fuqia maksimale dhe minimale e qarkut të shkurtër;
 - vii. Kushtet për sinkronizimin automatik;
 - viii. Lidhja e pikës neutrale;
 - ix. Tensioni operativ maksimal dhe minimal i vazhdueshëm, dhe kohëzgjatja dhe niveli i devijimeve afatshkurtra nga vlerat maksimale dhe minimale;

- x. Zbatimi i parimit të faktorit minimal të fuqisë, $\cos \varphi = 0.9$, në pikën e lidhjes së konsumatorëve në sistemin e transmetimit;
- xi. Sigurimin e shërbimeve ndihmëse për sistemin energjetik;
- xii. Sjellja në rastet me ndërprerje në shkallë të gjerë (plani për uljen e ngarkesës) dhe në rastet me shqetësime;
- xiii. Matja e energjisë elektrike;
- xiv. Sistemi për monitorimin dhe menaxhimin në distancë të lidhjes;
- xv. Procedurat për menaxhimin operativ të lidhjes;
- xvi. Koordinimi i mirëmbajtjes me OST;
- xvii. Përbushjen e kërkesave për sigurinë në objekt;
- xviii. Kryerjen e inspektimit teknik të objekteve;
- xix. Komunikimet dhe procedurat në kushte normale dhe emergjente të funksionimit;
- xx. Trajnimi i stafit (stafi i punësuar nga përdoruesi duhet të jetë i kualifikuar/trajnohet në mënyrë të përshtatshme).

2. Bazuar në sa më sipër, brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën (6) të nenit 38, OST:
 - a. i paraqet aplikuesit ofertën e lidhjes duke përcaktuar një pikë/vend lidhje ose zgjidhjen që teknikisht është më optimale dhe duke koordinuar teknikisht aplikimet për lidhje me Sistemin/modifikim të paraqitura nga aplikues të tjerë; ose
 - b. në qoftë se pas studimit të “Pranueshmërisë të lidhjes së re apo modifikimit të lidhjes ekzistuese”, rezulton se zgjidhja optimale nuk parashikon lidhje në sistemin e transmetimit, atëherë kërkesa për aplikim i kthehet zyrtarisht aplikuesit me këtë argumentim; ose
 - c. në rast të një përgjigje negative, njofton aplikuesin për refuzimin e aplikimit, duke dhënë argumentimin përkatës për arsyet e këtij vendimi.
3. Aplikuesi brenda 60 ditëve kalendarike nga marrja e ofertës së lidhjes, duhet të informoj zyrtarisht OST për pranimin ose jo të saj nëpërmjet deklaratës së pranimit.
4. Në rast se oferta e lidhjes sipas pikës (1), germa (a) me sipër nuk pranohet nga aplikuesi ose aplikuesi nuk informon OST brenda afatit kohor të caktuar, atëherë procesi i aplikimit rifillon nga e para.

5. Nëse aplikuesi e pranon ofertën e lidhjes, periudha kohore e vlefshmërisë të ofertës së lidhjes është 18 muaj nga pranimi i ofertës së lidhjes nga aplikuesi.
6. Aplikuesi, brenda 16 muajve nga pranimi i ofertës së lidhjes nga OST, paraqet kërkesën për lidhjen e marrëveshjes së lidhjes dhe marrëveshjes së operimit.
7. OST dhe aplikuesi do të nënshkruajnë marrëveshjen e lidhjes së bashku me anekset përkatëse brenda 18 muajve nga pranimi i ofertës së lidhjes, duke patur në konsideratë kushtet dhe kërkesat teknike.
8. Përveç marrëveshjes së lidhjes aplikuesi do të nënshkruajnë një marrëveshje operimi me OST pas lëshimit të njoftimit operacional përfundimtar (FON) sipas vendimit të ERE nr.127, 128 ose 129, dt.04/06/2018.

Neni 40. Kushtet dhe kërkesat teknike për pajisjet e lidhjes së re apo të modifikimit

1. Përdoruesit duhet të sigurojnë se të gjitha impiantet dhe aparaturat në pikën e lidhjes do të jenë në përputhje me standardet relevante sipas VKM-ve nr.482 dhe 483 dt.17/06/2020 dhe vendimeve të ERE nr.127, 128 ose 129, dt.04/06/2018 duke garantuar në vijueshmëri operimin dhe mirëmbajtjen me cilësi të lartë teknike të sistemit/objektit të tyre, sipas dispozitave të këtij kodi.
2. Lidhjet e reja dhe/apo modifikimet e atyre ekzistuese nuk duhet të shkaktojnë asnjë efekt negativ tek përdoruesit ekzistues të sistemit të transmetimit dhe anasjelltas.
3. Kërkesat teknike të pajisjeve për lidhjet në sistemin e transmetimit janë:
 - a. Pajisjet, aparaturat, instalimet dhe kushtet teknike në pikat e lidhjes duhet të jenë konform me normat dhe standardet në fuqi sipas kategorive përkatëse të përdoruesve;
 - b. Lidhjet ndërmjet instalimeve të përdoruesit dhe sistemit të transmetimit duhet të realizohen nëpërmjet çelësave të fuqisë të aftë për t'u shkyçur me veprim të shpejtë, sipas kërkesave dhe standardeve në aktet e sipërpërmendura;
 - c. Zgjedhja dhe përcaktimi i aftësive shkyçëse të pajisjeve komutuese dhe qëndrueshmërisë ndaj rrymave të lidhjeve të shkurtra, duhet të jetë brenda vlerave dhe standardeve në fuqi të përcaktuar për secilën pikë lidhje;
 - d. Mbrojtjet rele të instalimeve në pikat e lidhjes ndërmjet sistemit të transmetimit dhe përdoruesit të këtij rrjeti, duhet të plotësojnë qartësisht kërkesat dhe standardet teknike në fuqi, për të reduktuar në minimum teknik ndikimin negativ tek përdoruesit e tjerë të sistemit të transmetimit;
 - e. Pajisjet e telekomunikacionit duhet të plotësojnë qartësisht kërkesat dhe standardet teknike për të eliminuar ndikimin negativ reciprok, humbjen apo cenimin e sigurisë së informacionit;

- f. Pajisjet që mundësojnë monitorimin dhe kontrollin e përdoruesve të sistemit të transmetimit duhet të plotësojnë kërkesat teknike të sistemit të transmetimit në mënyrë për tu standardizuar dhe për t'ju përshtatur logjikës së sistemit SCADA/EMS.

Neni 41. Marrëveshja e lidhjes

1. Marrëveshja e lidhjes vendos detyrimin për palët për zbatimin e rregullave, procedurave, specifikimeve teknike dhe kërkesave për pajisjet dhe instalimet, siç parashtrohet në këtë kod, si dhe sipas përcaktimeve specifike në marrëveshjen e lidhjes relevante.
2. Marrëveshja e lidhjes ndër të tjera specifikon kushtet e përgjithshme të lidhjes dhe çdo kusht specifik teknik dhe financiar të aplikuar për çdo lidhje në veçanti.
3. Marrëveshjes së lidhjes i bashkëlidhet deklarata e pranimit, dokumentacioni (përfshirë një kopje elektronike) që aplikuesi paraqet në OST, si dhe sa vijon:
 - a. Plan-vendosjen në hartë të linjës elektrike, trasenë dhe planimetrinë e saj në shkallë të tillë që lejon paraqitjen e detajeve të saj;
 - b. Skemën principale të përdoruesit, n/stacionit ngritës dhe lidhjes me sistemin e transmetimit;
 - c. Skemën principale të mbrojtjes rele dhe matjes (pjesa TL përfshirë transformatorin TL/TM);
 - d. Diagramin e telekomunikacionit dhe lidhja me sistemin SCADA të OST;
 - e. Diagramin e mbrojtjes rele;
 - f. Diagramin e kontroll-monitorimit;
 - g. Specifikimet teknike të pajisjeve kryesore (pjesa TL dhe transformatorin TL/TM);
 - h. Formularin me të dhëna për përdoruesin sipas tipologjisë dhe kategorisë;
 - i. Formularin me të dhënat për linjën e transmetimit;
 - j. Formularin me të dhënat për n/stacionin TM/TL;
 - k. Planimetrinë e n/stacionit TM/TL;
 - l. Harta me plan vendosjen e n/stacionit dhe pika e lidhjes në sistemin e transmetimit;
 - m. Deklaratën mbi përgjegjësitë për kontrollin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve, për operimin e pajisjeve dhe përgjegjësitë për sigurimin teknik të personelit;
 - n. Dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifave të lidhjes;

Neni 42. Procedurat për menaxhimin e sistemit

1. Procedurat dhe parimet e menaxhimit të sistemit në kushte operimi normal dhe në avari përcaktohen në marrëveshjen e operimit e cila nënshkruhet mes OST dhe përdoruesit.
2. Marrëveshjen e operimit përcakton:
 - a. përgjegjësitë e palëve për të kryer veprime operationle në përputhje me kushtet e sistemit në funksionimin normal dhe në rast defektesh;
 - b. të drejtën e OST për të dhënë urdhra për regjimin e funksionimit të pajisjeve të përdoruesit (fuqia aktive dhe reaktive) dhe operimi i pajisjeve komutuese;
 - c. përshkrim i hollësishëm i përgjegjësive për menaxhimin e sistemit dhe pajisjeve, ndërmjet përdoruesit dhe OST;
 - d. zbatimimi i masave legislative dhe masave të sigurisë.

Neni 43. Njoftimet operationale dhe energjizimi i lidhjes nga OST

1. Aplikuesi është i detyruar të paraqesë një raport periodik dhe një certifikatë finale performance të sistemit të tij të lidhjes me sistemin e transmetimit, duke shpjeguar përmbushjen në terma sasior dhe cilësor të kërkesave teknike dhe kriterëve operationale të specifikuar në Kodin e Transmetimit, VKM-ve nr.482 dhe 483 dt.17/06/2020 dhe vendimeve të ERE nr.127, 128 ose 129, dt.04/06/2018 si dhe të kërkesave shtesë të parashikuara me ligj, marrëveshje bilaterale dhe/ose siç kërkohet nga OST.
2. Procedura për lidhjen me sistemin e transmetimit për çdo përdorues deri në energjizimin final dhe fillimin e operimit si përdorues i sistemit të transmetimit, kryhet në përputhje me dispozitat përkatëse të VKM-ve nr.482 dhe 483 dt.17/06/2020 dhe vendimeve të ERE nr.127, 128 ose 129, dt.04/06/2018. dhe detajohet si vijon:
 - a. Njoftimi operational i energjizimit;
 - b. Njoftimi operational i përkohshëm;
 - c. Njoftimi operational përfundimtar, dhe
 - d. Njoftimi operational i kufizuar.
3. Aplikuesi/përdoruesi do të ofrojë asistencën dhe gjithë informacionin e nevojshëm për OST për të mbledhur të dhëna për të verifikuar përmbushjen e kërkesave teknike dhe të performancës.
4. Rekomandohet që aplikuesi/përdoruesi të këshillohet dhe kontrollojë me OST çështje relevante në një fazë të hershme të projektit në mënyrë që të mundësohen korrigjimet e nevojshme para se projekti i realizimit të lidhjes/modifikimit të nënshtrohet

verifikimit të pajtueshmërisë së plotë për efekt të komisionimit dhe energjizimit final të lidhjes.

PJESA II – Parametrat e kërkesave jo shteruese

Titulli 1 – Parametrat për modulet gjeneruese

Kapitulli 1 – Kërkesat në lidhje me tensionin

Neni 44. Aftësia e operimit në kushte avarie

1. *Profilet e tensionit kundrejt kohës në pikën e lidhjes, në kushte avarie (simetrike dhe asimetrike), të cilat përshkruajnë kushtet në të cilat një modul gjenerues i tipit D është në gjendje të qëndrojë i kyçur me rrjetin dhe të vazhdojë të operojë qëndrueshëm edhe pasi sistemi është ngacmuar nga avari në transmetim, jepen në Aneksin 1.*
2. *Modulet gjeneruese të parkut të energjisë të tipit C dhe D për të cilët kërkohet aftësia e operimit në avari do të sigurojnë që kontributi i fuqisë aktive ka prioritet gjatë avarisë dhe sigurimi i saj do të bëhet jo më vonë se 150 msec. nga fillimi i avarisë.*
3. *Operatoret e sistemit të shpërndarjes ose të sistemit të mbyllur të shpërndarjes që janë përdorues të sistemit të transmetimit dhe kanë të lidhur në sistemet e tyre gjenerues të tipit B dhe/ose C do të sigurohen që këto gjenerues respektojnë profilet e tensionit kundrejt kohës në pikën e lidhjes për kushte avarie siç jepen në Aneksin 1.*
4. *Parametrat e konsideruar për llogaritjet e aftësisë së operimit në kushte avarie (p.sh. kapaciteti i qarkut të shkurtër para dhe pas avarisë, pika e operimit para avarisë të fuqisë aktive dhe reaktive të modulit gjenerues në pikën e lidhjes dhe tensionit në pikën e lidhjes; llogaritjet e kapacitetit minimal të lidhjes së shkurtër pas avarisë në pikën e lidhjes) i komunikohen nga OST aplikuesit/përdoruesit me kërkesë të këtij të fundit gjatë procesit të lidhjes.*

Neni 45. Kontrolli i fuqisë aktive dhe diapazoni i kontrollit

1. Periudha minimale për të arritur pikën referuese të fuqisë aktive do të përcaktohet rast pas rasti në marrëveshjen e lidhjes/operimit sipas aftësive teknike të fleksibilitetit (ramping) në varësi të teknologjisë dhe do të jetë pjesë e kërkesave individuale të lidhjes me operatorin përkatës të sistemit.
2. Në rastet kur pajisjet automatike të kontrollit në distancë janë jashtë shërbimit, koha maksimale për arritjen e pikës së caktuar të punës është e barabartë me 15 minuta për një tolerancë prej $-/+5%$ kundrejt pikës referuese të fuqisë aktive. Kur kërkesa me strikte aplikohen në akte të tjera ato do të mbizotërojnë.

Neni 46. Diapazonet e tensionit

1. Një modul gjenerues i tipit D i lidhur në nivel tensioni ndërmjet 110 kV dhe 300 kV duhet të jetë në gjendje të qëndrojë i lidhur me rrjetin dhe të operojë në intervalet e tensionit për periudha kohore si vijon:

Niveli i tensionit	Koha
0.85 pu – 0.90 pu	60 minuta
0.90 pu – 1.118 pu	Pa limit
1.118 pu – 1.15 pu	20 minuta

2. Një modul gjenerues i tipit D i lidhur në rrjet me tension mbi 300 kV duhet të jetë në gjendje të qëndrojnë i lidhur me rrjetin dhe të operojë në intervalet e tensionit për periudha kohore si vijon:

Niveli i tensionit	Koha
0.85 pu – 0.90 pu	60 minutes
0.90 pu – 1.05 pu	Pa limit
1.05 pu – 1.10 pu	20 minuta

3. Diapazonet e mësipërme janë të zbatueshme edhe për modulet e parkut të energjisë offshore të lidhur në me instalime me rrymë alternative.
4. Nëse vlerësohet si teknikisht e nevojshme diapazone më të gjëra tensioni për kohë më të gjatë minimale të periudhës së operimit duhet të dakordohen gjatë procesit të lidhjes me sistemin në koordinim me aplikuesin/përdoruesin përkatës rast pas rasti dhe të dokumentohen në marrëveshjen e lidhjes/operimit.
5. Çdo lidhje e re e instalimeve me rrymë të vazhduar, duhet të projektohet në mënyrë që të mos krijojë efekte negative (rezonancë nën-sinkrone, variacione të shpejta të tensionit, harmonika të tensionit dhe ndërhyrje me telekomunikacionin) në pajisjet ekzistuese të lidhura me rrjetin apo efekte negative (pamjaftueshmëri për mundësinë e uljes së tensionit apo input /output i tepërt i fuqisë reaktive) në funksionimin/operimin e sistemit të transmetimit.
6. Një lidhje bipolare e instalimeve me rrymë të vazhduar duhet gjithashtu të projektohet në mënyrë që rreziku i humbjes për të dy polet, për të njëjtën arsye, të jetë sa më i ulët që të jetë e mundur.

Neni 47. Shkyçja automatike për shkak të nivelit të tensionit

1. Modulet gjenerues të tipit D duhet të jenë në gjendje të shkyçen automatikisht kur tensioni në pikën e lidhjes arrin nivelin e specifikuar nga OST.
2. Aktivizimi, vlerat dhe parametrizimet e këtij funksionaliteti duhet të dakordohen gjatë procesit të lidhjes nga OST në koordinim me aplikuesin përkatës rast pas rasti dhe të dokumentohen në marrëveshjen e lidhjes/operimit. Përdoruesi i rrjetit do të duhet të vërtetojë parametrat e shkyçjes të releve nëpërmjet testeve. Rilidhja automatike në rrjet pas një shkëputjeje nuk lejohet dhe duhet të koordinohet me OST.
3. Operatorët e sistemit të shpërndarjes ose të sistemit të mbyllur të shpërndarjes që janë përdorues të sistemit të transmetimit do të sigurohen se kërkesat e mësipërme aplikohen edhe për gjeneruesit e tipit C të lidhur në sistemet e tyre.

Neni 48. Aftësia për fuqi reaktive

1. Një modul gjenerues sinkron do të jetë në gjendje të sigurojë fuqi reaktive në kapacitetin e tij maksimal në kushtet e tensionit të ndryshueshëm brenda kufijve sipas karakteristikës U-Q/Pmax siç jepen në Aneksin 2.
2. Operoret e sistemit të shpërndarjes ose të sistemit të mbyllur të shpërndarjes që janë përdorues të sistemit të transmetimit dhe kanë të lidhur në sistemet e tyre gjenerues të tipit C do të sigurohen që këto gjenerues respektojnë karakteristikat U-Q/Pmax siç jepen në Aneksin 2.
3. Modulet gjenerues sinkronë do të jenë në gjendje të lëvizin në çdo pikë operimi brenda karakteristikës U-Q/Pmax në afate kohore të përshtatshme për të përmbushur vlerat e kërkuara nga operatori i sistemit, sipas aftësive teknologjike të gjeneruesit, pa vonesë kohe të pajustificuar dhe brenda 20 s.
4. Moduli i parkut të energjisë do të jetë në gjendje të sigurojë fuqi reaktive në kapacitetin e tij maksimal në kushtet e tensionit të ndryshueshëm brenda kufijve sipas karakteristikës U-Q/Pmax siç jepen në Aneksin 2.
5. Operoret e sistemit të shpërndarjes ose të sistemit të mbyllur të shpërndarjes që janë përdorues të sistemit të transmetimit dhe kanë të lidhur në sistemet e tyre module të parkut të energjisë të tipit C do të sigurohen që këto gjenerues respektojnë karakteristikat U-Q/Pmax siç jepen në Aneksin 2.
6. Moduli i parkut të energjisë do të jetë në gjendje të sigurojë fuqi reaktive nën kapacitetin e tij maksimal në kushtet e tensionit të ndryshueshëm brenda kufijve sipas karakteristikës U-Q/Pmax siç jepen në Aneksin 2.
7. Moduli i parkut të energjisë do të jenë në gjendje të lëvizin në çdo pikë operimi brenda karakteristikës U-Q/Pmax në afate kohore të përshtatshme për të përmbushur vlerat e kërkuara nga operatori i sistemit, sipas aftësive teknologjike të gjeneruesit, pa vonesë kohe të pajustificuar dhe brenda 20 s.
8. Operoret e sistemit të shpërndarjes ose të sistemit të mbyllur të shpërndarjes që janë përdorues të sistemit të transmetimit dhe kanë të lidhur në sistemet e tyre module të parkut të energjisë të tipit C do të sigurohen që këto gjenerues respektojnë karakteristikat U-Q/Pmax siç jepen në Aneksin 2.
9. Kërkesa për qëndrueshmërinë e tensionit të zbatueshme në modulet e parkut të energjisë offshore të lidhur me instalime me rrymë alternative në lidhje me aftësinë e fuqisë reaktive për kapacitet nën atë maksimal do të jenë të njëjta si për modulet e parkut të energjisë onshore sipas pikave 4 - 7 me sipër.

Neni 49. Sistemi i kontrollit të tensionit për modulet gjenerues sinkron

1. OST në bashkëpunim me aplikuesin/përdoruesin, përcakton për çdo modul gjenerues të tipit D parametrat, tarimet e komponentëve të sistemit të kontrollit të tensionit dhe

specifikimet e rregullatorit automatik të tensionit, rast pas rasti për secilin projekt dhe i dokumenton në marrëveshjen e lidhjes/operimit.

Neni 50. Stabiliteti i tensionit për modulet sinkrone

1. Modulet gjenerues të tipit D do të instalojnë sistem stabilizatorësh të fuqisë.
2. Kërkesa për sistemin e stabilizatorit të fuqisë specifikohen dhe dokumenton në marrëveshjen e lidhjes/operimit ndërmjet aplikuesit dhe OST.

Neni 51. Modalitetet e kontrollit të fuqisë reaktive për modulet e parkut te energjisë

1. Pas një ndryshimi me hap të tensionit, moduli i parkut të energjisë duhet të jetë në gjendje që brenda kohës së vonesës fillestare $t1 \leq 2$ sekonda, të arrijë 90% të ndryshimit të fuqisë reaktive.
2. Moduli i parkut të energjisë duhet të jetë në gjendje që brenda kohës për aktivizim të plotë $t2 = 30$ sekonda, të arrijë 100% të ndryshimit të fuqisë reaktive.
3. Në mënyrën e kontrollit të faktorit të fuqisë, faktori i fuqisë së synuar do të jetë në kufijtë nga $\cos\phi = +0,85$ në dhënie (injektim) në $\cos\phi = -0,95$ në marrje (absorbim) të njësisë gjeneruese; periudha kohore për të arritur pikën e caktuar dhe toleranca do të dakordohen gjatë procesit të lidhjes nga operatori përkatës i sistemit në koordinim me aplikuesin rast pas rasti dhe do të dokumentohen në marrëveshjen e lidhjes/operimit me operatorin përkatës të sistemit.
4. Operatorët e sistemit të shpërndarjes ose të sistemit të mbyllur të shpërndarjes që janë përdorues të sistemit të transmetimit dhe kanë të lidhur në sistemet e tyre module të parkut të energjisë të tipit C do të sigurohen që këto gjenerues respektojnë kërkesat e mësipërme.
5. Moduli i parkut të energjisë do të jetë në gjendje të sigurojë fuqi reaktive automatikisht ose nga modaliteti me kontroll të tensionit, modaliteti me kontroll të fuqisë reaktive, ose nga modaliteti me kontroll të faktorit të fuqisë. Specifikimet se cili prej opsioneve të kontrollit të fuqisë reaktive dhe parametrave të përcaktuara të ndërlidhura duhet të aplikohen si dhe çfarë pajisjesh shtesë kërkohen për të bërë rregullimin e pikës së caktuar përkatëse në operim nga distanca, do të përcaktohet rast pas rasti dhe dokumentohen në marrëveshjen e lidhjes/operimit.

Kapitulli 2 – Kërkesat në lidhje me frekuencën

Neni 52. Diapazonet e frekuencës

1. Frekuenca nominale në sistemin elektroenergjetik në operim sinkron me rrjetin evropian të transmetimit është 50 Hz.
2. Periudhat minimale kohore për të cilat një modul gjenerues i energjisë duhet të jetë në gjendje të operojë pa u shkëputur nga rrjeti në frekuenca të ndryshme nga vlera nominale, janë si vijon:

Intervalet e frekuencës	Koha
47,5 Hz – 48,5 Hz	30 minuta
48,5 Hz – 49,0 Hz	30 minuta
49,0 Hz – 51,0 Hz	Pa limit
51,0 Hz – 51,5 Hz	30 minuta

- Operatoret e sistemit të shpërndarjes ose të sistemit të mbyllur të shpërndarjes që janë përdorues të sistemit të transmetimit dhe kanë të lidhur në sistemet e tyre module gjenerues të energjisë të tipit A, B dhe C do të sigurohen që këta gjenerues respektojnë kërkesat e mësipërme.

Neni 53. Aftësia e qëndrueshmërisë ndaj shkallës së ndryshimit të frekuencës

- Shkalla maksimale e ndryshimit të frekuencës për të cilën moduli gjenerues do të mbetet i lidhur në operim është e barabartë ose më e vogël se vlera $\pm 2\text{Hz} / \text{s}$ për mesataren e lëvizshme të dritares/hapësirës kohore 500 msekonda të matjes së frekuencës, në varësi të llojit të teknologjisë së gjeneruesit dhe fuqisë/rrymës së qarkut të shkurtër në pikën e lidhjes me sistemin.
- Modulet e gjenerimit të energjisë duhet të lejohen të shkëputen nëse ndonjë nga kriteret e përmendura më sipër janë shkelur ose frekuenca kalon diapazonet e përcaktuara në nenin 52 (p.sh. nën 47,5Hz ose mbi 51,5Hz).
- Operatoret e sistemit të shpërndarjes ose të sistemit të mbyllur të shpërndarjes që janë përdorues të sistemit të transmetimit dhe kanë të lidhur në sistemet e tyre module gjenerues të energjisë të tipit A, B dhe C do të sigurohen që këta gjenerues respektojnë kërkesat e mësipërme.

Neni 54. Modaliteti me ndjeshmëri ndaj frekuencës së kufizuar

- Pragu i frekuencës për modalitet me ndjeshmëri për frekuencë të kufizuar–nën frekuenca (LFSM-U) do të jetë 49.8 Hz dhe për modalitet me ndjeshmëri për frekuencë të kufizuar – mbi frekuenca (LFSM-O) 50.2 Hz.
- Parametrizimi i përkulshmërisë (droop), do të jetë i rregullueshëm në intervalin 2% - 12% dhe për LFSM-O/U vlera e parazgjedhur do të jetë 5%.
- Sistemet e kontrollit të moduleve gjenerues duhet të lejojnë rregullimin dhe rizgjedhjen e vlerës së përkulshmërisë (droop), gjatë jetëgjatësisë/operimit të modulit.
- Përkulshmëria për LFSM-U, do të vlerësohet bazuar në të dhënat për gjeneruesit të cilët do të dëshmojnë aftësi teknike për LFSM-U. Në çdo rast parametrizimi duhet të koordinohet dhe përputhet me masat e planeve të tjera të mbrojtjes së sistemit për të adresuar ngjarjet me frekuencë të ulët.

5. P_{ref} do të konsiderohet P_{aktive} disponibel në momentin e arritjes së pragut LFSM-O/U si parametër i parazgjedhur për modulet e parkut të energjisë, ndërkohë për regjime operimi afër kapacitetit maksimal P_{ref} do të konsiderohet $P_{max} = P_n$.
6. Koha e vonesës fillestare (T_{id}) e cila mbulon kohën nga ndryshimi i frekuencës deri në fillimin e përgjigjes në mënyrë të paracaktuar të jetë sa më e shpejtë që është e mundur teknikisht (pa vonesë të qëllimshme).
7. Për LFSM-O, pasi të arrihet niveli minimal rregullues, mënyra e funksionimit do të vazhdojë në të njëjtin nivel (nuk ka ulje të mëtejshme të fuqisë aktive për rritje të mëtejshme të frekuencës).
8. Koha e përgjigjes (T_{resp}) parametrizohet si vijon:

T_{resp}	Rritje e fuqisë aktive (për rënie të frekuencës)	Ulja e fuqisë aktive (për rritje të frekuencës)
Për modulet sinkrone gjeneruese të energjisë	≤ 5 min për një ndryshim të fuqisë aktive prej 20% të fuqisë maksimale (performanca e ngadaltë nuk aplikohet, nëse rritja është e shpejtë (brenda pak sekondash) pas rënies së frekuencës)	≤ 8 s për një ndryshim të fuqisë aktive prej 45% të fuqisë maksimale
Për modulet e parkut të energjisë (jo eolik)	≤ 10 s për një ndryshim të fuqisë aktive prej 50% të fuqisë maksimale	≤ 2 s për një ndryshim të fuqisë aktiv prej 50% të fuqisë maksimale
Modulet e parkut të energjisë (gjeneruesit eolike)	≤ 5 s për një ndryshim të fuqisë aktive prej 20% të fuqisë maksimale, nëse fuqia aktuale aktive është mbi 50% e fuqisë maksimale. Për pikat e punës nën 50% të fuqisë maksimale mund të zbatohen një reagim më i ngadalshëm. Pavarësisht nga kjo, koha e përgjigjes do të jetë aq e shpejtë sa është teknikisht e mundshme dhe të argumentohet teknikisht nëse është > 5 s	≤ 2 s për një ndryshim të fuqisë aktiv prej 50% të fuqisë maksimale

9. Koha e vendosjes (shuarjes) (T_{sett}) parametrizohet si vijon:


T_{sett}	Rritje e fuqisë aktive (për rënie të frekuencës)	Ulja e fuqisë aktive (për rritje të frekuencës)
Për modulet sinkrone gjeneruese	≤ 6 min (performanca e ngadaltë nuk aplikohet, nëse rritja është e shpejtë (brenda pak sekondash) pas rënies së frekuencës)	≤ 30 s

të energjisë		
Për modulet e parkut të energjisë (jo eolik)	≤ 30 s	≤ 20 s
Modulet e parkut të energjisë (gjeneruesit eolike)	≤ 30 s	≤ 20 s

10. Parametrizimi për LFSM-O aplikohet për të gjitha tipet e moduleve ndërsa parametrizimi LFSM-U aplikohet për modulet e tipit C dhe D.
11. Dispozita specifike të përcaktohen në marrëveshjen e lidhjes/operimit me operatorin përkatës dhe përdoruesin.
12. Operoret e sistemit të shpërndarjes ose të sistemit të mbyllur të shpërndarjes që janë përdorues të sistemit të transmetimit dhe kanë të lidhur në sistemet e tyre module gjenerues të energjisë të tipit A, B dhe C do të sigurohen që këta gjenerues respektojnë kërkesat e mësipërme.

Neni 55. Reduktimi i pranueshëm i fuqisë aktive nga output maksimal për frekuencën në rënie

1. Modulet gjeneruese do të përmbushin kërkesat në lidhje me karakteristikën $F(\text{Hz}) - \Delta P/P_{\max}$ për maksimumin e pranueshëm të reduktimit të fuqisë aktive në frekuenca në rënie sipas grafikut me poshtë:
2. Për të gjitha modulet gjenerues, maksimumi i lejuar i reduktimit të fuqisë aktive në frekuenca në rënie të parametrizohet si më poshtë:



	Parametrat	Vlerat
Karakteristika të përkohshme (kalimtare)	Pragu i frekuencës	49 Hz
	Pjerrësia	2%/Hz
	t1	≤ 2s
	t2	30s
Karakteristika të qëndrueshme	Pragu i frekuencës	49.5Hz
	Pjerrësia	10%/Hz
	t3	30 min

3. Modulet gjeneruese gjatë fazës së aplikimit për pikë lidhje me sistemin duhet të sigurojnë informacion për karakteristikat e tyre të pritshme për temperatura [-10°C, 0°C, 15°C, 25°C, 30°C, 40°C].
4. Temperatura e ambientit 25°C, lartësia 400 deri 500 m dhe lagështia 15 deri në 20 g H₂O / 1 kg ajër, do të aplikohen si kushtet e ambientit referencë dhe standard për të gjitha teknologjitë.
5. Operatorët e sistemit të shpërndarjes ose të sistemit të mbyllur të shpërndarjes që janë përdorues të sistemit të transmetimit dhe kanë të lidhur në sistemet e tyre module gjenerues të energjisë të tipit A, B dhe C do të sigurohen që këta gjenerues respektojnë kërkesat e mësipërme.


Neni 56. Kyçja automatikisht në rrjet

1. Kyçja automatike do të lejohet për të gjitha njësitë e tipit A dhe për njësitë e tipit B me kusht që të plotësohen kërkesat e mëposhtme:
 - a. Frekuenca të jetë brenda 49.9 Hz dhe 50.1 Hz; dhe
 - b. Tensioni duhet të jetë brenda $0.9 pu \leq U \leq 1.1 pu$; dhe
 - c. Koha minimale e vëzhgimit kur kushtet e mësipërme përmbushen të jetë mbi 60 sekonda
2. Pas kyçjes aplikohet tarimi sipas kushteve operationale i kufizimit të rregullueshëm të gradientit të rritjes së fuqisë aktive $\leq 20\%$ e P_{max} / \min .

3. Kur kyçja automatike aktivizohet pas një shqetësimi në rrjet, gradienti maksimal i pranueshëm në prodhimin aktiv është 10% e P_{max} / min.
4. Për rastet e tjera, kyçja automatike do të rregullohet me autorizim individual që duhet të përcaktohet si dispozitë në marrëveshjen individuale të lidhjes/operimit.
5. Operatoret e sistemit të shpërndarjes ose të sistemit të mbyllur të shpërndarjes që janë përdorues të sistemit të transmetimit dhe kanë të lidhur në sistemet e tyre module gjenerues të energjisë të tipit A, B dhe C do të sigurohen që këta gjenerues respektojnë kërkesat e mësipërme.

Neni 57. Stabiliteti i frekuencës

1. Modulet gjenerues do të arrijnë pikën referuese të fuqisë aktive brenda një periudha minimale të përcaktuar rast pas rasti në marrëveshjen e lidhjes/operimit sipas aftësive teknike të fleksibilitetit (ramping) në varësi të teknologjisë së modulit.
2. Në mënyrë skematike aftësia e kërkuar jepet në grafikun në vijim:




3. Në rastet kur pajisjet automatike të kontrollit në distancë janë jashtë shërbimit, koha maksimale për arritjen e pikës së caktuar të punës është e barabartë me 15 minuta për një tolerancë prej $\pm 5\%$ kundrejt pikës referuese të fuqisë aktive. Kur kërkesa më strikte aplikohen në akte të tjera ato do të mbizotërojnë.
4. Operatoret e sistemit të shpërndarjes ose të sistemit të mbyllur të shpërndarjes që janë përdorues të sistemit të transmetimit dhe kanë të lidhur në sistemet e tyre module gjenerues të energjisë të tipit C do të sigurohen që këta gjenerues respektojnë kërkesat e mësipërme.

Neni 58. Modaliteti me ndjeshmëri ndaj frekuencës

1. Parametrizimi i modalitetit me ndjeshmëri ndaj frekuencës për modulet gjenerues do të kryhet sipas parametrave në vijim:

Diapazoni i fuqisë aktive $ \Delta P_1 /P_{max}$	Diapazon ndërmjet 1.5% - 10 %
Përkulshmëria (droop)	E rregullueshme 2 - 12%, e parazgjedhur 5%
Pandjeshmëria e përgjigjes ndaj frekuencës $ \Delta f $ $ \Delta f /f_n$	Max 10 mHz Max 0.02%
Deadband i përgjigjes ndaj frekuencës	ndërmjet 0 - 200 mHz, i parazgjedhur 10 mHz
Vonesa maksimale fillestare e aktivizimit modalitetit me ndjeshmëri ndaj frekuencës (t_1)	Modulet gjeneruese sinkron: sa më shpejt të jetë e mundur deri nën 2s (për t'u justifikuar teknikisht nga aplikuesi nëse është > 2s) Modulet e parkut të energjisë: 500 ms
Vonesa maksimale e aktivizimit të plotë të modalitetit me ndjeshmëri ndaj frekuencës (t_2)	Max 30 s
Kohëzgjatja e aktivizimit të plotë	Minimumi 15 minuta

2. Aftësia e reagimit të fuqisë aktive për çdo modul gjenerues përcaktohet sipas grafikut në vijim dhe sipas parametrizimit në tabelën më sipër:



3. Modulet gjenerues duhet të sigurojnë që aftësitë teknike dhe parametrat mbulojnë nevojat operacionale, siç përcaktohen nga kërkesat minimale teknike të rezervës për mbajtjen e frekuencës që përcakton OST.
4. Operoret e sistemit të shpërndarjes ose të sistemit të mbyllur të shpërndarjes që janë përdorues të sistemit të transmetimit dhe kanë të lidhur në sistemet e tyre module gjenerues të energjisë të tipit C do të sigurohen që këta gjenerues respektojnë kërkesat e mësipërme.

Neni 59. Kontrolli i rivendosjes së frekuencës

1. Parametrat e kontrollit të rivendosjes së frekuencës specifikohet në përputhje me dispozitat e Rregulloren e Komisionit të BE 2017/1485, 2 Gusht 2017, për përcaktimin e “Udhëzuesit për Operimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike” dhe ketij kodi. Parametrat do të dakordohen gjatë procesit të lidhjes me operatorin përkatës të sistemit rast pas rasti dhe do të përfshihen si dispozita në marrëveshjen e lidhjes/operimit ose sipas kuadrit në fuqi për tregun balancues.
2. Operoret e sistemit të shpërndarjes ose të sistemit të mbyllur të shpërndarjes që janë përdorues të sistemit të transmetimit dhe kanë të lidhur në sistemet e tyre module gjenerues të energjisë të tipit C do të sigurohen që këta gjenerues respektojnë kërkesat e mësipërme.

Neni 60. Monitorimi i modalitetit me ndjeshmëri ndaj frekuencës në kohë reale

1. Në marrëveshjen e lidhjes/operimit do të përcaktohen sinjale shtesë që duhet të sigurohen nga objekti i gjenerimit të energjisë në lidhje me monitorimin në kohë reale të modalitetit me ndjeshmëri ndaj frekuencës duke monitoruar dhe regjistruar pajisjet në mënyrë që të verifikojë performancën e ofrimit të reagimit ndaj frekuencës të moduleve gjeneruese të energjisë.
2. Standardi referencë që do të përdoret është IEC 60870.
3. Operoret e sistemit të shpërndarjes ose të sistemit të mbyllur të shpërndarjes që janë përdorues të sistemit të transmetimit dhe kanë të lidhur në sistemet e tyre module gjenerues të energjisë të tipit C do të sigurohen që këta gjenerues respektojnë kërkesat e mësipërme.

Neni 61. Shkalla e ndryshimit të fuqisë aktive

1. Limitet minimale dhe maksimale të shkallës së ndryshimit të fuqisë aktive (kufijtë minimalë dhe maksimalë) në të dy drejtimet e ndryshimit, rritës dhe zbritës, duke marrë parasysh karakteristikat specifike të teknologjisë dhe ato të burimit primar, përcaktohen nga operatori përkatës i sistemit gjatë procedurës së lidhjes në rrjet për çdo pikë lidhje të veçantë duke pasqyruar parametrat në marrëveshjen e lidhjes/operimit me rrjetin.
2. Limitet përcaktohen ndërmjet nivelit minimal të rregullimit dhe kapacitetit maksimal. Shkalla e ndryshimit do të variojë nga 1.5% /min – 20% /min në të dyja drejtimet.

3. Operatoret e sistemit të shpërndarjes ose të sistemit të mbyllur të shpërndarjes që janë përdorues të sistemit të transmetimit dhe kanë të lidhur në sistemet e tyre module gjenerues të energjisë të tipit C do të sigurohen që këta gjenerues respektojnë kërkesat e mësipërme.

Kapitulli 3 – Kërkesat në lidhje me rivendosjen e sistemit

Neni 62. Aftësia për rikyçje pas një shkyçje të shkaktuar nga një shqetësim në sistem

1. Kyçja automatike nuk lejohet për modulet gjeneruese tip C dhe D. Lidhja automatike do të rregullohet me autorizim individual që duhet të përcaktohet si dispozitë në marrëveshjen individuale të lidhjes/operimit.
2. Për njësitë e tipit A dhe B lidhja automatike lejohet me kusht që të plotësohen kërkesat e mëposhtme:
 - a. Frekuenca të jetë brenda 49.9 Hz dhe 50.1 Hz;
 - b. Tensioni duhet të jetë brenda $0.9 pu \leq U \leq 1.1 pu$;
 - c. Koha minimale e vëzhgimit kur kushtet e mësipërme përmbushen të jetë mbi 60 sekonda
3. Pas lidhjes aplikohet tarimi sipas kushteve operacionale i kufizimit të rregullueshëm të gradientit të rritjes së fuqisë aktive $\leq 20\%$ e P_{max} / \min . Kur rilidhja automatike aktivizohet pas një shqetësimi në rrjet, gradienti maksimal i pranueshëm në prodhimin aktiv të energjisë është 10% e P_{max} / \min .
4. Operatoret e sistemit të shpërndarjes ose të sistemit të mbyllur të shpërndarjes që janë përdorues të sistemit të transmetimit dhe kanë të lidhur në sistemet e tyre module gjenerues të energjisë të tipit A, B dhe C do të sigurohen që këta gjenerues respektojnë kërkesat e mësipërme.

Neni 63. Operimi pas kalimit në houseload

1. Koha minimale e operimit gjatë së cilës një modul gjenerues duhet të qëndrojë në operim pas kalimit në houseload do të përcaktohet si dispozitë në marrëveshjen individuale të lidhjes/operimit duke marrë parasysh karakteristikat specifike të teknologjisë së burimit primar. Vlerat indikative prej 2 - 4 orë operim në houseload duhet të merren në konsideratë.
2. Operatoret e sistemit të shpërndarjes ose të sistemit të mbyllur të shpërndarjes që janë përdorues të sistemit të transmetimit dhe kanë të lidhur në sistemet e tyre module gjenerues të energjisë të tipit C do të sigurohen që këta gjenerues respektojnë kërkesat e mësipërme.

Neni 64. Rivendosja e fuqisë aktive për modulet gjenerues sinkrone

1. Operatoret e sistemit të shpërndarjes ose të sistemit të mbyllur të shpërndarjes që janë përdorues të sistemit të transmetimit dhe kanë të lidhur në sistemet e tyre module sinkrone gjenerues të energjisë të tipit B dhe C duhet të sigurohen që modulet gjenerues të jenë të aftë të kryejnë rivendosjen dhe rikuperimin e 90% të pikës së caktuar të fuqisë aktive brenda 5 s pas eliminimit të defektit.
2. Operatoret e sistemit të shpërndarjes ose të sistemit të mbyllur të shpërndarjes që janë përdorues të sistemit të transmetimit dhe kanë të lidhur në sistemet e tyre module të parkut të energjisë të tipit B dhe C duhet të sigurohen që modulet gjenerues të jenë të aftë që fuqia aktive e tyre të rikuperohet në 90% të fuqisë para defektit e matur me saktësi +/- 5% në më pak se 3 s dhe tensioni në pikën e kyçjes $U \geq 0.85$ p.u.
3. Për modulet e tipit D këta parametra do të rregullohet dhe të përcaktohet si dispozitë në marrëveshjen individuale të lidhjes/operimit për secilin objekt ne veçanti.

Kapitulli 4 – Kërkesat në lidhje me instrumentalizimin, modelet e simulimit dhe mbrojtjen

Neni 65. Skemat e kontrollit dhe tarimet e pajisjeve të kontrollit

1. Skemat dhe tarimet e pajisjeve të kontrollit do të koordinohen ndërmjet përdoruesit/aplikuesit, operatorit të sistemit ku lidhet moduli dhe OST dhe përcaktohen si dispozitë në marrëveshjen individuale të lidhjes/operimit.
2. Skemat dhe tarimet e kontrollit dhe çdo ndryshim eventual i pajisjeve të ndryshme të modulit gjenerues që janë të nevojshme për qëndrueshmërinë e sistemit dhe për kryerjen e veprimeve të emergjencës do të koordinohen dhe dakordohen ndërmjet OST, operatorit të sistemit përkatës dhe pronarit të modulit gjenerues.
3. Operatoret e sistemit të shpërndarjes ose të sistemit të mbyllur të shpërndarjes që janë përdorues të sistemit të transmetimit dhe kanë të lidhur në sistemet e tyre module gjenerues të energjisë të tipit B dhe C do të sigurohen që këta gjenerues respektojnë kërkesat e mësipërme.

Neni 66. Skemat e mbrojtjes dhe tarimet

1. Skemat dhe tarimet e mbrojtjes do të koordinohen ndërmjet përdoruesit/aplikuesit, operatorit të sistemit ku lidhet moduli dhe OST dhe përcaktohen si dispozitë në marrëveshjen individuale të lidhjes/operimit.
2. Operatoret e sistemit të shpërndarjes ose të sistemit të mbyllur të shpërndarjes që janë përdorues të sistemit të transmetimit dhe kanë të lidhur në sistemet e tyre module gjenerues të energjisë të tipit B dhe C do të sigurohen që këta gjenerues respektojnë kërkesat e mësipërme.

Neni 67. Shkëmbimi i informacionit

1. Modulet gjenerues të lidhur në transmetim do të pajisen në përputhje me standardet IEC 60870 dhe do të sigurojnë informacion në kohë reale të kërkuar nga OST dhe operatori përkatës i rrjetit ku janë të lidhur në përputhje me dispozitat përkatëse të përcaktuara në këtë kod.
2. Përmbajtja informacionit që do të shkëmbehet, përfshirë një listë të të dhënave që do sigurohen nga gjeneruesi, do të detajohet, koordinohet dhe përcaktohet si dispozitë në marrëveshjen individuale të lidhjes/operimit.
3. Operoret e sistemit të shpërndarjes ose të sistemit të mbyllur të shpërndarjes që janë përdorues të sistemit të transmetimit dhe kanë të lidhur në sistemet e tyre module gjenerues të energjisë të tipit B dhe C do të sigurohen që këta gjenerues respektojnë kërkesat e mësipërme.

Neni 68. Masat manuale lokale kur pajisjet e komandimit në distance janë jashtë shërbimit

1. Në rastet kur pajisjet automatike të kontrollit në distancë janë jashtë shërbimit, koha maksimale për arritjen e pikës së caktuar të punës është e barabartë me 15 minuta për një tolerancë prej $-/+5%$ kundrejt pikës referuese të fuqisë aktive. Kur kërkesa me strikte aplikohen në akte të tjera ato do të mbizotërojnë.
2. Parametrizime dhe specifikime të tjera nëse është e nevojshme do të detajohen, koordinohen dhe përcaktohen si dispozitë në marrëveshjen individuale të lidhjes/operimit.
3. Operoret e sistemit të shpërndarjes ose të sistemit të mbyllur të shpërndarjes që janë përdorues të sistemit të transmetimit dhe kanë të lidhur në sistemet e tyre module gjenerues të energjisë të tipit C do të sigurohen që këta gjenerues respektojnë kërkesat e mësipërme.

Neni 69. Humbja e stabilitetit këndor ose humbja e kontrollit

1. Kriteret për zbulimin e humbjes së stabilitetit këndor ose humbjes së kontrollit do të detajohen, koordinohen dhe përcaktohen si dispozitë në marrëveshjen individuale të lidhjes/operimit.
2. Operoret e sistemit të shpërndarjes ose të sistemit të mbyllur të shpërndarjes që janë përdorues të sistemit të transmetimit dhe kanë të lidhur në sistemet e tyre module gjenerues të energjisë të tipit C do të sigurohen që këta gjenerues respektojnë kërkesat e mësipërme.
3. Pika e neutrit e transformatorëve rritës nga ana e rrjetit, parametrizimet e pajisjeve për regjistrimin e defekteve, përfshirë kriteret aktivizuese dhe diapazonet e kampionimit do të detajohen, koordinohen dhe përcaktohen si dispozitë në marrëveshjen individuale të lidhjes/operimit.

4. Monitorimi i sjelljes dinamike të sistemit, oshilatori i ngacmimeve dhe parametrizimet e pajisjeve dhe specifikimet e luhatjes aktivizuese që zbulon lëkundjet e pashuara të fuqisë do të detajohen, koordinohen dhe përcaktohen si dispozitë në marrëveshjen individuale të lidhjes/operimit.
5. Objektet e monitorimit të cilësisë së furnizimit dhe të sjelljes dinamike të sistemit si dhe protokollet e komunikimit për të dhënat e regjistruara do të detajohen, koordinohen dhe përcaktohet si dispozitë në marrëveshjen individuale të lidhjes/operimit.
6. Kufijtë e luhatjeve, procedurat e kontrollit dhe matjes do të bazohen në standardet përkatëse IEC.
7. Operoret e sistemit të shpërndarjes ose të sistemit të mbyllur të shpërndarjes që janë përdorues të sistemit të transmetimit dhe kanë të lidhur në sistemet e tyre module gjenerues të energjisë të tipit C do të sigurohen që këta gjenerues respektojnë kërkesat e mësipërme.

Neni 70. Pika e neutrit nga ana e rrjetit e transformatorëve rritës

1. Statusi i neutrit të transformatorëve ngritës të fuqisë të gjeneruesit në anën e lidhjes me rrjetin e transmetimit dhe vlerat e rezistencës së tokëzimit përcaktohet nga studimet dhe analizat për qëllime të mbtensioneve dhe dimensionimit të pajisjeve të rrjetit të transmetimit, që përcaktojnë faktorin e lidhjes me tokën. Specifikimet përkatëse do të detajohen, koordinohen dhe përcaktohen si dispozitë në marrëveshjen individuale të lidhjes/operimit.
2. Operoret e sistemit të shpërndarjes ose të sistemit të mbyllur të shpërndarjes që janë përdorues të sistemit të transmetimit dhe kanë të lidhur në sistemet e tyre module gjenerues të energjisë të tipit C do të sigurohen që këta gjenerues respektojnë kërkesat e mësipërme.

Neni 71. Sinkronizimi

1. Sinkronizimi i moduleve gjenerues do të kryhet vetëm pas autorizimit nga operatorit i sistemit.
2. Specifikimet përkatëse në lidhje me tensionin, frekuencën, fazimin, sekuencën e fazës dhe devijimin e tensionit dhe frekuencës gjatë sinkronizimit do të detajohen, koordinohen dhe përcaktohen si dispozitë në marrëveshjen individuale të lidhjes/operimit në përputhje me diapazonet e frekuencës, tensionit si dhe kushtet specifike të çdo gjeneruesi në varësi të teknologjisë dhe pikës së lidhjes.

Neni 72. Stabiliteti këndor në kushte defekti

1. Aftësitë teknike në lidhje me stabilitetin këndor në kushte defekti që duhet të përmbushen nga moduli gjenerues do të detajohen, koordinohen dhe përcaktohet si dispozitë në marrëveshjen individuale të lidhjes/operimit

Titulli 2 – Parametrat për përdoruesit ngarkesë

Kapitulli 1 – Kërkesat në lidhje me tensionin

Neni 73. Diapazonet e tensionit

1. Objektet e ngarkesës që lidhen në transmetim, objektet e shpërndarjes që lidhen në transmetim dhe sistemet e mbyllura të shpërndarjes të lidhura në transmetim duhet të jenë në gjendje të mbeten të lidhura me rrjetin dhe operojnë në diapazonet e tensionit dhe kohën e specifikuar si vijon:

Niveli i tensionit 110 - 300 kV	Koha
0.90 pu – 1.118 pu	Pa kufizim
1.118 pu – 1.15 pu	20 minuta

Niveli i tensionit > 300 kV	Koha
0.90 pu – 1.05 pu	Pa kufizim
1.05 pu – 1.10 pu	20 minuta

Neni 74. Shkyçja automatike për shkak të nivelit të tensionit

1. Shkyçja automatike për shkak të nivelit të tensionit konsiderohet specifike për çdo pikë lidhje. Aktivizimi, vlerat dhe parametrizimet e këtij funksionaliteti duhet të dakordohen gjatë procesit të lidhjes nga operatori përkatës i sistemit në koordinim me operatorin/përdoruesin përkatës rast pas rasti dhe të dokumentohen në marrëveshjen e lidhjes/operimit me operatorin përkatës të sistemit.
2. Përdoruesi i rrjetit do të duhet të vërtetojë parametrat e shkyçjes së releve nëpërmjet testimeve me operatorin përkatës.
3. Rilidhja automatike në rrjet pas një shkëputjeje nuk lejohet dhe duhet të koordinohet me operatorin përkatës.

Neni 75. Aftësia e fuqisë reaktive për njësitë e ngarkesës dhe sistemet e shpërndarjes të lidhura në transmetim

1. Objektet e ngarkesës të lidhura në transmetim duhet të kenë faktor fuqie ($\cos\phi$) sa më afër njësisë 1 ($\cos\phi \geq 0.9$);
2. Faktori minimal i lejuar i faktorit të fuqisë për sistemet e shpërndarjes të lidhura në transmetim është 0.9 ($\cos\phi = 0.9$)
3. Matja e faktorit të fuqisë bëhet në mënyre të vazhdueshme së bashku me matjen e tensionit, në kohë reale, nëpërmjet sistemit SCADA/EMS dhe sistemit të telematjes.
4. Objektet e ngarkesës të lidhura në transmetim dhe sistemet e shpërndarjes të lidhura në transmetim me faktor fuqie më të ulët së vlera e lejuar duhet menjëherë të instalojnë pajisje kompensuese të energjisë reaktive për përmirësimin e $\cos\phi$.

5. Aftësia e fuqisë reaktive për sistemet e shpërndarjes të lidhura në transmetim përcaktohet nga analiza e cila duhet të adresojë zgjidhje të mundshme dhe përcaktojë zgjidhje optimale për shkëmbime të fuqive reaktive të sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes duke marrë në konsideratë parimet sipas të cilave:
 - a. Burimet e fuqisë reaktive të disponueshme duhet të jenë të mjaftueshme për të garantuar sigurinë operative dhe të jenë në gjendje për të ruajtur nivelet e duhura të tensionit si dhe të mundësojnë menaxhimin e fuqisë reaktive nëpërmjet aftësisë kontrolluese të fuqisë reaktive.
 - b. Studimi dhe përcaktimi i instalimeve për gjenerimin/absorbimin e fuqisë reaktive bazohet mbi analizën dhe nivelet e tensionit në të gjitha nyjet e sistemit, në të gjithë regjimet e operimit të rrjetit në konfiguracion (n) dhe praninë e kontigjencave sipas kriterit (n-1) duke respektuar nivelet e lejuara të tensionit.
 - c. Studimi dhe analizat për përcaktimin teknik të instalimeve për gjenerimin/absorbimin e fuqisë reaktive do të përcaktojnë masat për optimizimin dhe përmirësimin e performancës teknike dhe ekonomike të operimit të sistemit elektroenergjetik me tensione brenda niveleve të lejuara, duke reduktuar humbjet teknike si dhe duke rritur marxhinën e qëndrueshmërisë dinamike të operimit të sistemit elektroenergjetik.
 - d. Studimi dhe analizat për këtë qëllim do të kryhen për një horizont kohor 2 vjeçar, duke vlerësuar si regjimet me ngarkesa maksimale ashtu dhe ato me ngarkesa minimale të sistemit elektroenergjetik.

Neni 76. Cilësia e furnizimit

1. Sistemi i përdoruesit të duhet të projektohet dhe instalohet në mënyrë të tillë që gjatë operimit të mos ndikojë në cilësinë e energjisë së palëve të treta dhe në deformimin e sinjaleve të të dhënave dhe informacionit.
2. Përdoruesit duhet të marrin masat e nevojshme për kufizimin në maksimum të harmonikave shqetësuese.
3. Instalimet e përdoruesve dhe operimi i tyre do të përmbushë kërkesat e cilësisë së energjisë sipas standardeve IEC / 61000-3-6 (Kufijtë e deformimit harmonik), IEC / 61000-3-7 (Limitet e luhatjes së tensionit) dhe CENELEC EN 50160.

Kapitulli 2 – Kërkesat në lidhje me frekuencën

Neni 77. Diapazonet e frekuencës

1. Periudhat minimale kohore për të cilat objektet e kërkesës të lidhura në transmetim, objektet e shpërndarjes të lidhura në transmetim dhe sistemet e shpërndarjes duhet të jetë në gjendje të operojë pa u shkëputur nga rrjeti në frekuenca të ndryshme nga vlera nominale, janë si vijon:

Intervalet	Kohezgjatja
47,5 Hz – 48,5 Hz	30 minuta
48,5 Hz – 49,0 Hz	30 minuta
49,0 Hz – 51,0 Hz	Pa limit
51,0 Hz – 51,5 Hz	30 minuta

Kapitulli 3 – Kërkesat në lidhje me rivendosjen e sistemit

Neni 78. Kërkesat për lidhjen e shkurtër

1. Zgjedhja dhe përcaktimi i aftësive shkyçëse të pajisjeve komutuese dhe qëndrueshmërisë ndaj rrymave të lidhjeve të shkurtra, duhet të jetë brenda vlerave dhe standardeve në fuqi të përcaktuar për secilën pikë lidhje.
2. Përdoruesit sigurojnë të dhënat e kërkuara për përcaktimin e rrymave të lidhjeve të shkurtra në çdo pikë lidhje të përdoruesit të sistemit të transmetimit, si dhe aftësitë shkyçëse për lidhjet e shkurtra, të pajisjeve komutuese në kufijtë teknik dhe pronësor me sistemin e transmetimit.
3. Rryma maksimale e qarkut të shkurtër në pikën e kyçjes parametrizohet gjatë procesit të lidhjes nga operatori përkatës i sistemit në koordinim me operatorin/përdoruesin përkatës rast pas rasti dhe dokumentohet në marrëveshjen e lidhjes/operimit me operatorin përkatës të sistemit.
4. OST do të specifikojë në marrëveshje me përdoruesin listën e ngjarjeve të mundshme të paplanifikuara dhe pragun e rrymës së qarkut të shkurtër maksimale mbi të cilin OST është e detyruar të informojë përdoruesin në rast të një ndryshimi mbi këtë prag.
5. OST do të specifikojë në marrëveshje me përdoruesin listën e ngjarjeve të mundshme të planifikuara dhe pragun e rrymës së qarkut të shkurtër maksimale mbi të cilin OST është e detyruar të informojë përdoruesin në rast të një ndryshimi mbi këtë prag.
6. Ngjashmërisht, në marrëveshje me përdoruesin do të listohen ngjarjet e mundshme të planifikuara dhe të paplanifikuara si dhe pragun e rrymës së qarkut të shkurtër maksimale mbi të cilin përdoruesi, objektet e ngarkesës që lidhen në transmetim dhe/apo objektet e shpërndarjes që lidhen në transmetim janë të detyruar të informojnë OST në rast të një ndryshimi mbi këtë prag.

Neni 79. Shkyçja e ngarkesës për mbrojtjen e sistemit

1. OST, objektet e ngarkesës që lidhen në transmetim dhe/apo objektet e shpërndarjes që lidhen në transmetim do të bien dakord dhe përcaktojnë si dispozita në marrëveshjen e lidhjes/operimit kërkesat dhe parametrizimin e aftësive të skemës së shkyçjes së kërkesës për frekuencë të ulët.
2. OST, objektet e ngarkesës që lidhen në transmetim dhe/apo objektet e shpërndarjes që lidhen në transmetim do të bien dakord dhe përcaktojnë si dispozita në marrëveshjen e lidhjes/operimit kërkesat dhe parametrizimin e aftësive të skemës së shkyçjes

automatike të kërkesës nga nën tensioni për objektet e kërkesës dhe shpërndarjes që lidhen në transmetim.

3. Objektet e kërkesës të lidhura në transmetim dhe sistemet e shpërndarjes të lidhura në transmetim do të përmbushin kërkesat në lidhje me shkyqjen ose rilidhjen automatike të objekteve të kërkesës të lidhura në transmetim ose sistemeve të shpërndarjes të lidhura në transmetim. Aktivizimi, vlerat dhe parametrizimet e funksionaliteti duhet të dakordohen gjatë procesit të lidhjes nga operatori përkatës i sistemit në koordinim me operatorin/përdoruesin përkatës rast pas rasti dhe të dokumentohen në marrëveshjen e lidhjes/operimit me operatorin përkatës të sistemit.
4. OST, objektet e kërkesës të lidhura në transmetim dhe sistemet e shpërndarjes të lidhura në transmetim do të bien dakord dhe do të përfshijnë si dispozita në marrëveshjen e lidhjes/operimit kërkesat dhe parametrizimin e pajisjeve të sinkronizimit (përfshirë frekuencën, tensionin, këndin e fazës diapazoni dhe devijimi i tensionit dhe frekuencës).

Kapitulli 4 – Kërkesat në lidhje me instrumentalizimin, modelet e simulimit dhe mbrojtjen

Neni 80. Skemat e mbrojtjes rele dhe parametrat

1. OST, objektet e ngarkesës të lidhur në transmetim ose operatori i sistemit të shpërndarjes të lidhur në transmetim do të bien dakord dhe do të përfshijnë si dispozita në marrëveshjen e lidhjes/operimit skemat e mbrojtjes dhe tarimet përkatëse për objektet e kërkesës të lidhur në transmetim ose sistemet e shpërndarjes të lidhura në transmetim.

Neni 81. Skemat dhe parametrat për pajisjet e kontrollit

1. OST, objektet e ngarkesës të lidhur në transmetim ose operatori i sistemit të shpërndarjes të lidhur në transmetim do të bien dakord dhe do të përfshijnë si dispozita në marrëveshjen e lidhjes/operimit skemat e kontrollit dhe tarimet përkatëse për objektet e kërkesës të lidhur në transmetim ose sistemet e shpërndarjes të lidhura në transmetim.

Neni 82. Shkëmbimi i informacionit

1. Objektet e ngarkesës të lidhura në transmetim dhe sistemet e shpërndarjes të lidhur në transmetim do të pajisen në përputhje me standardet IEC 60870 me qëllim që të shkëmbejnë informacion ndërmjet OST dhe objektit të ngarkesës të lidhur në transmetim dhe sistemet e shpërndarjes të lidhur në transmetim sipas specifikimeve në dispozitat e këtij kodi.
2. Lista e të dhënave të kërkuara do të hartohet në përputhje me kërkesat dhe afateve kohore në lidhje me operimin të specifikuara në dispozitat e këtij kodi, do të dakordohet dhe përfshihen si dispozitë në marrëveshjen e lidhjes/operimit.

Titulli 3 - Sistemet me rrymë të vazhduar dhe parqet e moduleve të energjisë të lidhur me rrymë të vazhduar

Neni 83. Parametrat jo-shteruese për sistemet me rrymë të vazhduar dhe parqet e moduleve të lidhur me rrymë të vazhduar

1. Parametrat joshteruese në kuptim të vendimit të ERE nr. 127, dt.04/06/2018 do të aplikohen sipas dokumentit udhëzues për zbatimin e kodeve të ENTSO-E, “HVDC systems default parameters - ENTSO-E guidance document for national implementation for network codes on grid connection - 4. June 2018”

PJESA III – Kërkesave teknike të tjera për mbrojtjen rele dhe tokëzimin

Neni 84. Kërkesat e mbrojtjes rele dhe koordinimi me mbrojtjen rele të përdoruesit të sistemit të transmetimit

1. Përdoruesit e sistemit të transmetimit nuk do të lidhen dhe nuk do të vazhdojnë të mbeten të lidhura me sistemin e transmetimit, nëse ato nuk janë të pajisur me instalimet e mbrojtjes rele të nevojshme që përmbushin parimet përkatëse të sigurisë, selektivitetit, shpejtësisë, diferencimit dhe ndjeshmërisë.
2. Përdoruesit e lidhur me sistemin e transmetimit do të mbrohen nga një sistem mbrojtje rele konform standardeve përkatëse të përcaktuara në VKM nr.482 dhe 483 dt.17/06/2020 dhe vendimet e ERE nr. 127, 128 dhe 129, datë 04.06.2018 në mënyrë që Sistemi i Transmetimit të mos pësojë dëmtime nga ndonjë avari me origjinë nga përdoruesit.
3. Mbrojtja rele e instaluar në instalimet dhe pajisjet e përdoruesit të sistemit të transmetimit duhet të koordinohet, në bashkëveprim me mbrojtjen rele të instaluar në sistemin e transmetimit. Për këtë qëllim OST dhe përdoruesit e sistemit të transmetimit bashkëveprojnë në çdo kohë në tarimin e mbrojtjes rele dhe përmirësimin e teknologjisë së mbrojtjes rele. Mbrojtja rele e sistemeve/objekteve të përdoruesve të sistemit të transmetimit nuk duhet të tarohet dhe të vihet në punë pa miratimin e OST.
4. OST do të jetë përgjegjëse për tarimin e mbrojtjes rele në gjithë sistemin e transmetimit. OST miraton sistemin e mbrojtjes rele dhe vendos tarimet në elementet e sistemit të saj në koordinim me përdoruesit e sistemit të transmetimit.
5. Përdoruesit e sistemit të transmetimit janë përgjegjës për tarimin e mbrojtjes rele në sistemet/objektet e tyre dhe do të koordinojnë tarimet e mbrojtjes rele në këto instalimet dhe pajisje, në kufirin pronësor me sistemin e transmetimit.
6. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të përgatisë studime dhe plane për modifikimin e sistemeve të mbrojtjes dhe të automatikës, për instalimin e releve të frekuencës në bashkëveprim me OST.
7. OST do të këshillojë modifikime dhe përmirësime të mbrojtjes rele në sistemin e shpërndarjes, me qëllim që të ulë ndikimet negative në sistemin e transmetimit.

8. OST do të kryej studime të qëndrueshmërisë statike dhe dinamike të sistemit elektroenergjetik (qëndrueshmërisë përkundrejt kolapsit të tensionit, qëndrueshmërisë këndore, qëndrueshmërisë përkundrejt frekuencës) si dhe analiza të performancës së mbrojtjes rele dhe të pajisjeve primare komutuese të instaluar në sistemin e transmetimit, për të përcaktuar kohët minimale kritike të shkyçjes së avarisë (koha kritike e pastrimit të avarisë në sistemin elektroenergjetik).

Neni 85. Kërkesat e mbrojtjes rele për sistemin e transmetimit

1. Linjat elektrike të tensionit të lartë 400 kV, 220 kV, 150 kV dhe 110 kV do të kenë mbrojtje distancionale dhe mbrojtje rezervë (back-up). Të gjithë linjat 400 kV, 220 kV do të kenë dy skema mbrojtje distancionale kryesore me operim të shpejtë dhe një mbrojtje rezervë.
2. Mbrojtjet kryesore dhe ato rezervë do të ushqehen nga burime të ndryshme tensioni dhe rryme.
3. Bazuar në analiza specifike të performancës së mbrojtjes rele, sistemi i transmetimit mund të sigurojë mbrojtje rezervë shtesë në linjat elektrike të veçanta.
4. Të gjitha pajisjet kompensuese të lidhura me sistemin e transmetimit duhet të jenë të pajisura me mbrojtje rele sipas standardit përkatës.
5. Specifikime të tjera teknike të detyrueshme për linjat elektrike 400 kV, 220 kV, 150 kV dhe 110 kV janë:
 - a. Mbrojtja distancionale në linjat elektrike 400 kV, 220 kV, 150 kV dhe 110 kV mund të jetë statike ose numerike me të paktën 4 zona me veprim të shpejtë;
 - b. Mbrojtjet kryesore 1 dhe 2 në linjat elektrike 400 kV, 220 kV, kanë të njëjtën shpejtësi veprimi dhe principe të ndryshme funksionimi;
 - c. Kohët e tarimit të zonave duhet të përfshijnë dhe kohët e veprimit të shkyçjes së çelësave;
 - d. Koha e veprimit të zonës së parë (bashkë me veprimin e shkyçjes së çelësit) është 80 mili sekonda për linjat 400 kV, 110 mili sekonda për linjat 220 kV dhe 120 mili sekonda për linjat 150 kV dhe 110 kV;
 - e. Kohët e zonave të tjera përcaktohen sipas zonës së mbulimit dhe konfiguracionit të sistemit të transmetimit të përlogaritura për çdo regjim për çdo vit. Mbrojtjet e linjave elektrike 400 kV dhe 220 kV pajisen me automatikën e kyçjes së përsëritur një fazore dhe tre fazore për linjat 150 kV dhe 110 kV, me kontroll të mungesës së tensionit dhe kontroll të sinkronizimit në të dy skajet e linjës elektrike.
 - f. Në varësi të analizave të sigurisë operationale të sistemit elektroenergjetik të kryera nga OST, mbrojtjet rele kryesore 1 dhe kryesore 2 mund të kenë furnizim me rrymë të vazhduar operative nga instalime baterish akumulatore të ndryshme.

- g. Në kërkesat e mbrojtjes rele për auto-transformatorët dhe transformatorët e fuqisë në sistemin elektroenergjetik përfshihet mbrojtja diferenciale dhe mbrojtjet (teknologjike) të tjera nga dëmtimet e brendshme (mbrojtja gazore, mbrojtje nga temperatura e pështjellave, mbrojtje nga temperatura e vajit dhe mbrojtje nga zjarri).

Neni 86. Kërkesat e mbrojtjes rele të zbarave të nënstacioneve elektrike

1. Zbarat e nënstacioneve elektrike të nivelit të tensionit 400 kV, 220 kV, 150 kV, 110 kV, mbrohen me mbrojtje diferenciale gjatësore dhe tërthore. Zbarat pajisen gjithashtu me mbrojtje nga refuzimi i veprimit të çelësit i të gjithë trakteve përkatëse të zbarës.

Neni 87. Mbrojtja nga zjarri e instalimeve dhe pajisjeve elektrike

1. Sistemi i mbrojtjes nga zjarri për instalimet dhe pajisjet elektrike dhe rregullat e zbatimit të tij, duhet të jenë në përputhje me specifikimet, standardet, rregulloret dhe dispozitat ligjore në fuqi të mbrojtjes kundra zjarrit.

Neni 88. Të dhënat për mbrojtjen rele të përdoruesve të sistemit të transmetimit

1. Të dhënat për mbrojtjen rele të kërkuara nga OST, prej përdoruesve të sistemit të transmetimit, janë si më poshtë:
 - a. Tipet, specifikimet dhe tarimet e të gjitha releve dhe sistemeve të mbrojtjes rele të instaluar në njësitë gjeneruese, bllokun gjenerator-transformator, transformatorët e nënstacionit ngritës, transformatorët e nevojave vetjake si dhe pajisjet e nevojave vetjake kryesore.
 - b. Tipet, specifikimet dhe tarimet e të gjitha releve, të instaluara në gjithë transformatorët e fuqisë të nënstacioneve të operatorit të sistemit të shpërndarjes dhe të përdoruesve të ngarkesës të sistemit të transmetimit 220/TM kV dhe 110 kV/TM kV.
 - c. Tipet, specifikimet dhe tarimet e releve të mbrojtjeve të instaluara në të gjithë zbarat 110 kV, 150 kV, 220 kV, 400 kV dhe linjat 35-400 kV në pronësi të përdoruesve të sistemit të transmetimit.
 - d. Të dhënat e kërkuara për përcaktimin e rrymave të lidhjeve të shkurtra në çdo pikë lidhje të re apo ekzistuese të përdoruesit të sistemit të transmetimit në bazë të planifikim-zhvillimit, si dhe aftësitë shkyçëse për lidhjet e shkurtra të pajisjeve komutuese në kufijtë teknik dhe pronësor të tyre me sistemin e transmetimit.

Neni 89. Tokëzimi

1. Tokëzimi i pështjellave të anës primare të transformatorëve të fuqisë me tension 400 / TM kV, 220 /TM kV, 150/TM kV, 110/TM kV dhe sistemi i tokëzimit studiohet, analizohet dhe përcaktohet nga OST.

2. Statusi i tokëzimit dhe madhësia e rezistencës së tokëzimit i përcaktuar nga studimet përkatëse të shoqërisë OST është e detyrueshme të respektohet nga të gjithë përdoruesit e sistemit të transmetimit në sistemet/objektet e tyre.

PJESA IV – Kërkesa sipas rregullit teknik për linjat dhe instalimet mbi 1 kV

Neni 90. Mirëmbajtja, kontrollet periodike dhe inspektimet e instalimeve dhe linjave

1. OST dhe përdoruesi i sistemit të transmetimit janë individualisht përgjegjës për mirëmbajtjen e pajisjeve dhe komponenteve në objektet e tyre, sipas ndarjes së pronësisë.
2. OST, përdoruesit dhe subjektet përkatëse të kontraktuara kur mirëmbajtja kryhet nga të tretë, duhet të përmbushin kërkesat e VKM nr.482 dhe 483 dt.17/06/2020.
3. Komponentët e rëndësishëm për sigurinë e impiantit, siç janë çelësat, bateritë, burimet e ushqimit të sistemeve të emergjencës dhe pajisjet e mbrojtjes duhet të testohen rregullisht sipas një plani të përgatitur nga përdoruesi i sistemit të transmetimit dhe të aprovuar nga OST për çdo vit.
4. Plani duhet të dorëzohet në OST brenda muajit tetor të vitit paraardhës për vitin në vazhdim.
5. Inspektimet e instalimeve dhe linjave kryhen nga subjekte të miratuar, çdo tre vjet dhe dokumentacioni duhet të ruhet për një periudhë 10 vjeçare.
6. Nëse konstatohen rrezik për pronën dhe jetën, rezultatet e inspektimit i dërgohen inspektorati shtetëror

Neni 91. Pajisjet dhe materialet

1. Materialet dhe pajisjet e instalimeve dhe linjave të përdoruesit dhe të OST duhet të jenë konformë standardeve të harmonizuara shqiptare sipas përcaktimeve të VKM 482 dhe 483, dt.17/06/2020.
2. Materialet dhe pajisjet shoqërohen me dokumentacionin teknik të nevojshëm që evidenton konformitetin me standardet e harmonizuara shqiptare.
3. Konformiteti i pajisjeve dhe materialeve do të konsiderohet në pajtueshmëri me standardet nëse dëshmohet me dokumentacion të përshtatshëm të lëshuar nga një organizëm i miratuar i vlerësimit të konformitetit.
4. Pajisjet dhe materialet si dhe instalimi i tyre i nënshtrohen inspektimit nga organet e autorizuara, në lidhje me respektimin e standardeve të harmonizuara dhe konformitetit.

Neni 92. Specifikimet për instalimet dhe linjat e transmetimit

1. Përdoruesit e rrjetit të transmetimit do të përmbushin kërkesat sipas vendimeve të ERE nr. 127, 128, 129, dt.04/06/2018 dhe VKM 482 dhe 483, dt.17/06/2020 si dhe kërkesat specifike të përcaktuara në këtë kod.

2. Kërkesat teknike aplikohen edhe për linjat e transmetimit të përdoruesve, në pronësi të tyre dhe/apo kur synohet transferimi i tyre tek OST.
3. Seti i specifikimeve teknike të cilat duhet të përmbushen nga përdoruesit në zbatim të këtij kodi depozitohen nga OST pranë inspektoratit shtetëror përgjegjës.
4. OST do të verifikojë pajtueshmërinë e përdoruesit me kërkesat e këtij kodi sipas procedurave të përcaktuara në vendimet e ERE nr. 127, 128, 129, dt.04/06/2018 dhe VKM 482 dhe 483, dt.17/06/2020.
5. Verifikimi kryhet nga specialistë të certifikuar nga një trupë certifikuese e akredituar sipas standardit SSH EN ISO/IEC 17024 ose standardeve, dhe/ose specifikimeve teknike të barasvlershme me to.
6. Kopje të dokumentacionit teknik të përdoruesit, certifikata e pajisjes dhe deklarata e pajtueshmërisë i vihen në dispozicion nga OST, inspektoratit shtetëror përgjegjës kur kërkohen.

Neni 93. Dokumentimi dhe operimi i instalimeve dhe linjave të transmetimit

1. Përveç sa kërkohet në këtë kod, përdoruesit dhe OST pajisen me lejet e nevojshme administrative për ndërtimin, zgjerimin, modifikimin dhe operimin e instalimeve elektrike të transmetimit.
2. OST dhe përdoruesit mbajnë dokumentacion të plotë teknik (projekti, raporti i inspektimit të pajtueshmërisë, deklaratë konformitetit etj.) për instalimet, pajisjet dhe linjat në pronësi të tyre apo të lidhur në rrjetin në pronësi të tyre në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Neni 94. Dokumentacioni, vënia në shfrytëzim dhe mirëmbajtja e linjave

1. Përdorimi i linjave elektrike të instaluar nga kompanitë e autorizuara në kuptim të VKM 483, dt.17/06/2020, kryhet duke zbatuar kërkesat si vijon:
 - a. paraqitet një projekt në të cilin jepen karakteristikat e linjës;
 - b. kryhen verifikimet e linjës së instaluar nëse është e pajisur me autorizimet e duhura dhe puna është kryer nën mbikëqyrjen e duhur;
 - c. kryhet inspektimi fillestar nga një organizëm i vlerësimit të konformitetit i miratuar;
 - d. lëshohet certifikata dhe procesverbali i instalimit;
 - e. lëshohet një certifikatë inspektimi, e cila duhet të deklarojë se linja është realizuar në përputhje me dispozitat e kësaj rregulle teknike duke identifikuar dhe justifikuar ndryshimet që mund të kenë ndodhur në zbatimin e projektit;

- f. kryhen verifikime të tjera që konsideron të përshtatshme nga OST, në lidhje me përputhshmërinë e linjës me kërkesat e teknike;
- g. hartohet procesverbal përkatës nëse konstatohen papajtueshmëri për rezultatet e kontrolleve, të cilat duhet të jenë të nënshkruara nga pronari i linjës;
- h. një kopje e procesverbalit dorëzohet në inspektoratin shtetëror përgjegjës, i cili duhet të përcaktojë marrjen e masave të përshtatshme;
- i. një kompani të autorizuar e mirëmbajtjes së linjave kontraktohet dhe bëhet përgjegjëse për mbajtjen në vijimësi të gjendjes teknike dhe të funksionimit të linjës, përveç nëse pronari i linjës ka statusin e kompanisë së autorizuar për mirëmbajtjen e linjës;
- j. linja regjistrohet pranë inspektoratit shtetëror përgjegjës para vënies në shfrytëzim duke paraqitur dokumentacionin siç përcaktohet në VKM 483, dt.17/06/2020.


Neni 95. Inspektimet periodike të instalimeve dhe linjave

1. Pajisjet dhe instalimet, përfshirë dhe linjat u nënshtrohen inspektimeve periodike të paktën çdo tre vjet.
2. Pronari i pajisjeve, instalimeve apo linjës është përgjegjës që inspektimet të kryhen sipas afateve nga organizma të vlerësimit të konformitetit të miratuara në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Në çdo rast hartohet raporti/certifikata e inspektimeve dhe verifikimeve të kryera dhe një kopje duhet t'i dorëzohet pronarit apo personit përgjegjës të pajisjes, instalimit apo linjës, si dhe një kopje depozitohet pranë inspektoratit shtetëror përgjegjës veçanërisht në rastet kur konstatohet rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe pronën.


Aneksi 1 - Aftësitë e operimit në avari në raste të avarive simetrike dhe asimetrike

Uret është tensioni i mbetur në pikën e lidhjes gjatë një defekti, tclear është casti kur një defekt është pastruar. Urec1, Urec2, trec1, trec2 dhe trec3 specifikojnë pikat e caktuara të kufijve me tërësi të tensionit pas pastrimit të defektit.


FRT - SPGM Tipi D			
	t		U
tclear:	0,15	Uret:	0
trec1:	0,3	Uclear:	0,25
trec2:	0,5	Urec1:	0,7
trec3:	1,5	Urec2:	0,85




FRT - PPM Tipi D			
	t		U
tclear:	0,15	Uret:	0
trec1:	0,15	Uclear:	0
trec2:	0,15	Urec1:	0
trec3:	3	Urec2:	0,85



FRT - SPGM Tipi B dhe C			
	t		U
tclear:	0,15	Uret:	0,3
trec1:	0,15	Uclear:	0,7
trec2:	0,7	Urec1:	0,7
trec3:	1,5	Urec2:	0,85




FRT - PPM Tipi B dhe C			
	t		U
tclear:	0,15	Uret:	0,15
trec1:	0,15	Uclear:	0,15
trec2:	0,15	Urec1:	0,15
trec3:	3	Urec2:	0,85




Aneksi 2 - Aftësia per fuqi reaktive

Aftësia e Q per SPGM te tipit C dhe D per Pmax			
limitet min& max			
Q/Pmax	U	Q/Pmax	U
-0,5	1,1	-0,2500	1,0500
0,65	1,1	0,3000	1,0500
0,65	0,875	0,4500	0,9750
-0,5	0,875	0,4500	0,9000
-0,5	1,1	-0,1000	0,9000
		-0,2500	0,9750
		-0,2500	1,0500




Aftësia e Q per PPM te tipit C dhe D per Pmax			
limitet min& max			
Q/Pmax	U	Q/Pmax	U
-0,5	1,1	-0,3	1,05
0,65	1,1	0,35	1,05
0,65	0,875	0,35	0,95
-0,5	0,875	-0,3	0,95
-0,5	1,1	-0,3	1,05



Aftesia e Q per PPM te tipit C dhe D per P nen Pmax

limitet min& max	Q/Pmax	P	Q/Pmax	P
	-0,5	1	-0,3000	1,0000
	0,65	1	0,3500	1,0000
	0,65	0	0,3500	0,0000
	-0,5	0	-0,3000	0,0000
	-0,5	1	-0,3000	1,0000



KODI I OPERIMIT

Pjesa I – Dispozita të përgjithshme

Neni 96. Objekti i kodit

2. Me qëllim ruajtjen e sigurisë së operimit, cilësinë e frekuencës dhe shfrytëzimin efikas të sistemit të interkonektuar dhe burimeve, ky kod përcakton udhëzime të hollësishme mbi:
 - a. kërkesat dhe parimet lidhur me sigurinë e operimit;
 - b. rregullat dhe përgjegjësitë për koordinimin dhe shkëmbimin e të dhënave ndërmjet OST, ndërmjet OST dhe OSSH, dhe ndërmjet OST, ose OSSH dhe SGU, në planifikimin operacional dhe në operimin në kohë reale;
 - c. rregullat për trajnimin dhe certifikimin e punonjësve të operatorit të sistemit;
 - d. kërkesat për koordinimin e ndërprerjeve;
 - e. kërkesat për skedulimin ndërmjet zonave të kontrollit të OST; dhe
 - f. rregullat për krijimin e një kuadri rajonal për kontrollin fuqi-frekuencë dhe rezervat.

Neni 97. Fushëveprimi

1. Rregullat dhe kërkesat e përcaktuara në këtë kod do të zbatohen për SGU e mëposhtme:
 - a. modulet gjeneruese ekzistuese dhe të reja të klasifikuara si tipi B, C dhe D në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 5 të Kodit “Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin të Gjeneruesve” i miratuar me vendimin ERE Nr. 129 Datë 04.06.2018.
 - b. objektet e ngarkesës (konsumit) ekzistuese dhe të reja të lidhura në sistemin e transmetimit;
 - c. sistemet e mbyllura të shpërndarjes, ekzistuese dhe të reja, të lidhura në sistemin e transmetimit;
 - d. objektet e ngarkesës, sistemet e mbyllura të shpërndarjes dhe palë të treta, ekzistuese dhe të reja, nëse ato sigurojnë përgjigje (ndryshim) të ngarkesës direkt në OST, në përputhje me kriteret e nenit 27 të Kodit “Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin të Objekteve të Ngarkesës” i miratuar me Vendimin ERE Nr. 128 Datë 04.06.2018;
 - e. ofruesit e redispecimit të moduleve gjeneruese të energjisë apo objekteve të ngarkesës me anë të bashkimit (agregimit) dhe ofruesve të rezervës aktive të energjisë në përputhje me Titullin 8 të Pjesës IV të këtij kod; dhe
 - f. sistemet HVDC, në përputhje me kriteret në nenin 3(1) të Kodit të Lidhjes (kërkesat për HVDC).

Neni 98. Raporti vjetor mbi treguesit e sigurisë operationale

1. Brenda tremujorit të parë të çdo viti, OST dërgon në ERE një raport vjetor me të dhënat për vitin paraardhës lidhur me sigurinë operationale të sistemit të transmetimit.

2. Raporti vjetor duhet të përmbajë të paktën treguesit e mëposhtëm operative të sigurisë, relevante për sigurinë operative:
 - a. numri i shkyçjeve të elementeve të sistemit të transmetimit;
 - b. numri i shkyçjeve të objekteve të gjenerimit të energjisë;
 - c. energjia e pa-furnizuar në vit për shkak të shkyçjes së paplanifikuar të objekteve të ngarkesës;
 - d. kohëzgjatja dhe numri i rasteve në gjendje alarmi dhe emergjence;
 - e. kohëzgjatja dhe numri i ngjarjeve në të cilat ka pasur një mungesë të rezervave të identifikuara për OST;
 - f. kohëzgjatja dhe numrin e devijimeve të tensionit që tejkalojnë diapazonin (limitet) nga Tabela 1 dhe 2 të Aneksit II, për OST;
 - g. numri i ndarjeve të sistemit ose të gjendjeve të blackout lokale; dhe
 - h. numri i ndërprerjeve blackout që përfshin dy ose më shumë OST të rajonit.
3. Raportet vjetore duhet të përmbajnë shpjegime të arsyeve për incidentet në sigurinë operationale te rangut 2 dhe 3 sipas shkallës së klasifikimit të incidenteve të miratuar nga ENTSO-E.

Pjesa II – Siguria operative

Titulli 1 – Kërkesat e sigurisë operationale

Kapitulli 1 – Gjendjet e sistemit, veprimet përmirësuese dhe kufijtë e sigurisë operationale

Neni 99. Klasifikimi i gjendjeve të sistemit

1. Sistemi i transmetimit do të jetë në gjendje **normale**, kur të gjitha kushtet e mëposhtme janë përmbushur:
 - a. tensioni dhe flukset e energjisë janë brenda kufijve operative të sigurisë të përcaktuara në përputhje me nenin 106;
 - b. frekuenca plotëson kushtet e mëposhtme:
 - i. devijimi i frekuencës në gjendje të qëndrueshme është brenda intervalit të standardit të frekuencës; ose
 - ii. vlera absolute e devijimit të frekuencës në gjendje të qëndrueshme të sistemit nuk është më e madhe se devijimi maksimal në gjendje të qëndrueshme dhe limitet e frekuencës së sistemit të përcaktuara për gjendje alarmi nuk janë plotësuar;
 - c. rezerva aktive dhe reaktive janë të mjaftueshme për të përballuar të papriturat nga lista e kontingjencave të përcaktuar në përputhje me nenin 20 106 pa shkelur kufijtë operative të sigurisë;

- d. operimi i zonës së kontrollit të OST është dhe do të mbetet brenda kufijve operative të sigurisë edhe pas ndodhjes së një kontingjence nga lista e kontingjencave të përcaktuar në përputhje me nenin 106, si edhe pas aktivizimit të veprimeve korrigjuese;
2. Sistemi i transmetimit do të jetë në gjendje **alarmi** kur:
 - a. tensioni dhe flukset e energjisë janë brenda kufijve operative të sigurisë të përcaktuara në përputhje me nenin 106 dhe
 - b. kapaciteti rezervë i OST është reduktuar me më shumë se 20% për më shumë se 30 minuta dhe nuk ka mjete për të kompensuar këtë reduktim në operimin e sistemit në kohë reale; ose
 - c. frekuenca plotëson kriteret e mëposhtme:
 - i. vlera absolute e devijimit të frekuencës në gjendje të qëndrueshme nuk është më e madhe se devijimi maksimal i frekuencës në gjendje të qëndrueshme; dhe
 - ii. vlera absolute e devijimit të frekuencës në gjendje të qëndrueshme ka tejkaluar vazhdimisht 50% të devijimit maksimal të frekuencës në gjendje të qëndrueshme për një periudhë kohore më të gjatë se koha e lëshimit të gjendjes së alarmit, ose intervali i standardit të frekuencës për një periudhë kohore më të gjatë se sa koha për të rivendosur frekuencën;
 - d. të paktën një kontingjencë nga lista e kontingjencave të përcaktuar në përputhje me nenin 106 të çon në shkeljen e kufijve operative të sigurisë të OST, edhe pas aktivizimit të veprimeve përmirësuese;
 3. Sistemi i transmetimit do të jetë në gjendje **emergjence** kur është përmbushur së paku një nga kushtet e mëposhtme:
 - a. ka të paktën një shkelje të kufijve operacionale të sigurisë të OST të përcaktuara në përputhje me nenin 106;
 - b. frekuenca nuk i plotëson kriteret për gjendjen normale dhe për gjendje alarmi të përcaktuar në përputhje me paragrafët 1 dhe 2;
 - c. të paktën një masë e planit të mbrojtjes të sistemit të OST është aktivizuar;
 - d. ka një dështim në funksionimin e mjeteve, mënyrave dhe objekteve të përcaktuara në përputhje me nenin 105 (1), duke rezultuar në mospasjen e këtyre mjeteve dhe objekteve për më shumë se 30 minuta.
 4. Sistemi i transmetimit do të jetë në gjendje **ndërprerje** (blackout), kur të paktën përmbushet një nga kushtet e mëposhtme:
 - a. humbja e më shumë se 50% të ngarkesës në zonën e kontrollit të OST;
 - b. mungesa totale e tensionit për të paktën tre minuta në zonën e kontrollit, duke çuar në aktivizimin e masave të rivendosjes.

5. Sistemi i transmetimit do të jetë në gjendje **rivendosje** kur OST ka qenë në gjendje emergjence ose blackout dhe ka filluar të aktivizojë masat e planit të rivendosjes.

Neni 100. Monitorimi dhe përcaktimi i gjendjeve të sistemit nga OST

1. Në operimin në kohë reale, OST do të përcaktojë gjendjen e sistemit të transmetimit, duke monitoruar parametrat e mëposhtëm, në bazë të telematjeve ose mbi vlerat e llogaritura, duke marrë parasysh të dhënat strukturore dhe në kohë reale në përputhje me nenin 123:
 - a. fluksin e energjisë aktive dhe reaktive;
 - b. tensionet e zbarave;
 - c. frekuencën dhe gabimin e kontrollit të restaurimit të frekuencës (FRCE, ose ACE) për zonën e saj të kontrollit LFC;
 - d. rezervat e fuqisë aktive dhe reaktive; dhe
 - e. prodhimin (gjenerimin) dhe ngarkesën (konsumin).
2. Në mënyrë që të përcaktojë gjendjen e sistemit, OST do të kryejë analiza të kontingjencës të paktën një herë në çdo 15 minuta, monitorimin e parametrave të sistemit të transmetimit të përcaktuara në përputhje me paragrafin 1, përkundrejt limiteve operative të sigurisë të përcaktuara në përputhje me nenin 106 dhe kriteret për gjendjet e sistemit të përcaktuara në përputhje me nenin 99. OST do të monitorojë nivelin e rezervave në dispozicion, përkundrejt kapacitetit rezervë të kërkuar. Analiza e kontingjencave do të marrë parasysh efektin e veprimeve përmirësuese dhe masat e planit të mbrojtjes të sistemit.
3. Në qoftë se sistemi transmetimit nuk është në gjendje normale dhe nëse kjo gjendje është kualifikuar si një situatë në zonë të gjerë, atëherë OST duhet:
 - a. të informojë të gjitha OST-te e rajonit në lidhje me gjendjen e sistemit të tij të transmetimit nëpërmjet platformës EAS të ENTSO-E; dhe
 - b. të sigurojë informata shtesë për elementet e saj të transmetimit të cilat janë pjesë e zonës së observimit të OST-ve të tjera, për ato OST.

Neni 101. Veprimet përmirësuese në operimin e sistemit

1. OST do të përpiqet për të siguruar që sistemi i transmetimit të mbetet në gjendje normale, duke qenë përgjegjës për menaxhimin e cenimeve të sigurisë operative. Për të arritur këtë objektiv, OST do të dizajnojë, përgatisë dhe aktivizojë veprime përmirësuese duke marrë parasysh disponueshmërinë e tyre, kohën dhe burimet e nevojshme për aktivizimin e tyre dhe kushtet (ndikimet) e jashtme me sistemin e transmetimit të cilat janë relevante për secilin veprim përmirësues.
2. Veprimet përmirësuese të përdorura nga OST në operimin e sistemit në përputhje me paragrafin 1, dhe me nenet 102 deri 104 të këtij kodi do të jenë në përputhje me

veprimet përmirësuese të marra parasysh në llogaritjen e kapaciteteve në përputhje me nenin 25 të Rregullores (BE) Nr. 2015 / 1222¹.

Neni 102. Parimet dhe kriteret e aplikueshme të veprimeve përmirësuese

1. OST duhet të zbatojë parimet e mëposhtme, për aktivizimin dhe koordinimin e veprimeve përmirësuese, në përputhje me nenin 104:
 - a. për çënime të sigurisë operative që nuk kanë nevojë të menaxhohen në mënyrë të koordinuar, OST do të projektojë, përgatisë dhe aktivizojë veprime përmirësuese nga kategoritë e përcaktuara në nenin 103, për të rivendosur sistemin në gjendjen normale dhe për të parandaluar përhapjen e gjendjes së alarmit apo emergjencës jashtë zonës së vet të kontrollit;
 - b. për çënime të sigurisë operative që duhet të menaxhohen në mënyrë të koordinuar, OST do të projektojë, përgatisë dhe aktivizojë veprime përmirësuese në koordinim me TSO-të fqinje, duke ndjekur metodologjinë për përgatitjen e veprimeve përmirësuese në një mënyrë të koordinuar dhe duke marrë parasysh rekomandimin e koordinatorit rajonal të sigurisë në përputhje me nenin 157 (4).
2. Kur bën zgjedhjen e veprimeve të duhura përmirësuese, OST do të zbatojë kriteret e mëposhtme:
 - a. të aktivizojë veprimet përmirësuese më efektive dhe ekonomikisht efikase;
 - b. të aktivizojë veprimet përmirësuese sa më pranë të jetë e mundur për kohën reale duke marrë parasysh kohën e pritshme të aktivizimit dhe urgjencën e situatës së operimit të sistemit që duhet zgjidhur;
 - c. të marrë në konsideratë rrezikun e dështimit në zbatimin e veprimeve përmirësuese në dispozicion dhe ndikimin e tyre në sigurinë operationale të tilla si:
 - i. rreziku i dështimit ose i qarkut të shkurtër, lidhur me ndryshimet në topologji;
 - ii. rreziku i shkaktimit të ndërprerjeve të lidhura me ndryshimet e fuqisë aktive ose reaktive në modulet e gjenerimit të energjisë ose objekteve të ngarkesës; dhe
 - iii. rreziku i mosfunksionimit në lidhje me sjelljen e pajisjeve;
 - d. t'i japë përparësi veprimeve përmirësuese të cilat bëjnë disponibël kapacitete ndërzonale më të mëdha për alokimin e kapaciteteve, duke plotësuar të gjitha kufijtë operative të sigurisë.

¹ Commission Regulation (EU) 2015/1222 of 24 July 2015 establishing a guideline on capacity allocation and congestion management

Neni 103. Kategoritë e veprimeve përmirësuese

1. OST do të përdorë kategoritë e mëposhtme të veprimeve përmirësuese:
 - a. të ndryshojë kohëzgjatjen e një ndërprerje të planifikuar ose të kthejë në shërbim elementet e sistemit të transmetimit për të arritur disponueshmëri operative të këtyre elementeve të sistemit të transmetimit;
 - b. në mënyrë aktive të ndikojë në flukset e fuqisë me anë të:
 - i. ndryshime të pozicioneve (ancafkave) të transformatorëve të fuqisë;
 - ii. ndryshime të pozicioneve (ancafkave) të transformatorëve fazorë;
 - iii. modifikimin e topologjisë së rrjetit;
 - c. kontrolli i tensionit dhe menaxhimi i fuqisë reaktive me anë të:
 - i. ndryshime të pozicioneve (ancafkave) të transformatorëve të fuqisë;
 - ii. ndryshimin, kyçjen/shkyçjen e kapacitorëve dhe reaktorëve;
 - iii. ndryshimin e tensionit në rregullatorët me module elektronike (me tiristore), dhe në pajisjet e menaxhimit të energjisë reaktive;
 - iv. udhëzon OSSH dhe përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit për të bllokuar rregullimin automatik të tensionit dhe kontrollin e fuqisë reaktive të transformatorëve ose për të aktivizuar në objektet e tyre veprimet përmirësuese të përcaktuara në pikat (i) deri në (iii) nëse përkeqësimi i tensionit rrezikon sigurinë operative ose kërcënon të çojë në një kolaps të tensionit në sistemin e transmetimit;
 - v. kërkon ndryshimin e prodhimit të energjisë reaktive ose tarimin e vlerës së tensionit të moduleve gjeneruese të lidhur sinkron me sistemin e transmetimit;
 - vi. kërkon ndryshimin e prodhimit të energjisë reaktive prej konvertuesve të moduleve gjeneruese jo-sinkrone të lidhur në sistemin e transmetimit;
 - d. ri-llogarit kapacitetet ndër-zonale për ditën në avancë dhe brenda ditës, në përputhje me Rregulloren (BE) Nr. 2015/12222;
 - e. ri-dispeçon përdoruesit e lidhur në transmetim ose shpërndarje, konform marrëveshjeve të aplikueshme;
 - f. kundër-tregton midis dy ose më shumë kufijve të zonave ofertuese, konform marrëveshjeve të aplikueshme;
 - g. axhuston fluksin e fuqisë aktive nëpërmjet sistemeve HVDC;

² Commission Regulation

(EU) 2015/1222 of 24 July 2015 establishing a guideline on capacity allocation and congestion management

- h. aktivizon procedurat e menaxhimit të devijimit të frekuencës;
 - i. kufizon, në pajtim me nenin 16 (2) të Rregullores Nr. 714/2009³, kapacitetin ndërzonal të alokuar tashmë, në një situatë emergjence, ku duke përdorur këtë kapacitet rrezikon sigurinë operationale, në rakordim me OST-në fqinje, kur ri-dispecimi dhe kundër-tregtimi nuk është i mundur; dhe
 - j. kur është e aplikueshme, duke përfshirë gjendjen normale dhe të alarmit, kontrollohet në mënyrë manuale kufizimi i ngarkesës.
2. Kur është e nevojshme dhe e arsyeshme për të ruajtur sigurinë operationale, OST mund të përgatisë dhe të aktivizojë veprime shtesë përmirësuese, duke raportuar e justifikuar këto raste tek autoriteti rregullator.

Neni 104. Përgatitja, aktivizimi dhe koordinimi i veprimeve përmirësuese

1. OST do të përgatisë dhe aktivizojë masat përmirësuese në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 102 (2) për të parandaluar përkeqësimin e gjendjes së sistemit, në bazë të elementeve të mëposhtme:
 - a. monitorimi dhe përcaktimi i gjendjeve të sistemit në përputhje me nenin 100;
 - b. analizat e kontingjencës në operimin në kohë reale në përputhje me nenin 115; dhe
 - c. analizat e kontingjencës në planifikimin operational në përputhje me nenin 153.
2. Gjatë përgatitjes dhe aktivizimit të një veprimi përmirësues, përfshirë ri-dispecimin ose kundër-tregtimin në bazë të nenit 25 dhe nenit 35 të Rregullores (BE) Nr 2015/1222⁴, ose një procedurë të planit të mbrojtjes së sistemit, e cila ka një efekt mbi OST-te e tjera, atëherë OST, në koordinim me OST-të në fjalë, do të vlerësojë ndikimin e një veprimi të tillë brenda dhe jashtë zonës së saj të kontrollit, në përputhje me nenin 156 (1), neni 157 (1), (2) dhe (4) dhe do t'i japë OST-ve të interesuara informacion në lidhje me këtë ndikim.
3. Gjatë përgatitjes dhe aktivizimit të veprimeve përmirësuese të cilat kanë ndikim në OSSH dhe SGU-te të lidhur në transmetim, OST, nëse është në gjendje normale apo alarmi, do të vlerësojë ndikimin e veprimeve të tilla përmirësuese në koordinim me OSSH dhe SGU-te e prekura dhe do të përzgjedhë veprime përmirësuese që kontribuojnë në ruajtjen e gjendjes normale dhe funksionimin e sigurtë të të gjitha palëve të përfshira. OSSH dhe SGU-te e prekura do t'i sigurojnë OST-se të gjitha informacionet e nevojshme për këtë koordinim.
4. Gjatë përgatitjes dhe aktivizimit të veprimeve përmirësuese, nëse sistemi i transmetimit nuk është në gjendje normale apo alarmi, OST do të koordinojë në masën e mundshme

³ Regulation (Ec) No 714/2009 Of The European Parliament And Of The Council Of 13 July 2009 On Conditions For Access To The Network For Cross-Border Exchanges In Electricity

⁴ Commission Regulation (EU) 2015/1222 of 24 July 2015 establishing a guideline on capacity allocation and congestion management

të tilla veprime përmirësuese, me OSSH dhe SGU-të e prekura, për të ruajtur sigurinë operacionale dhe integritetin e sistemit të transmetimit.

5. Kur OST aktivizon një veprim përmirësues, çdo përdorues i lidhur në sistemin e transmetimit do të ekzekutojë udhëzimet e dhëna nga OST.
6. Kur kongestionet kanë pasoja vetëm lokale brenda zonës së kontrollit të OST-së dhe cënimi i sigurisë operative nuk ka nevojë të menaxhohet në mënyrë të koordinuar, OST është përgjegjëse për menaxhimin e situatës dhe mund të vendosë të mos e aktivizojë veprime përmirësuese me shpenzime, për lehtësimin e kongestionëve.

Neni 105. Disponueshmëria e mjeteve dhe pajisjeve të OST-së

1. OST do të sigurojë disponueshmërinë, besueshmërinë dhe rezervën shtesë të elementeve të mëposhtme:
 - a. Mjete për monitorimin e gjendjes së sistemit të transmetimit, duke përfshirë edhe aplikacione të vlerësimit të gjendjes dhe mjetet për kontrollin fuqi-frekuencë;
 - b. Mjete për të kontrolluar komutimin e çelësave, çelësave zbara-lidhës, ancafkave të transformatorëve dhe pajisje të tjera të cilat shërbejnë për të kontrolluar elementet e sistemit të transmetimit;
 - c. Mjete për të komunikuar me qendrat e kontrollit të OST-ve të tjera dhe me RSC-në;
 - d. Mjetet për analiza operacionale të sigurisë; dhe
 - e. Mjete dhe pajisje të komunikimit të nevojshme për OST-në për të lehtësuar operacionet e tregut ndër-kufitar.
2. Kur mjetet e OST-së të referuara në paragrafin 1 ndikojnë OSSH-ne ose SGU-te të lidhura në transmetim, të përfshirë në furnizimin e shërbimeve balancuese, shërbimeve ndihmëse, mbrojtjen e sistemit, restaurimin ose dorëzimin e të dhënave operative në kohë reale në përputhje me nenet 125, 128, 131, 132 dhe 133, atëherë OST, OSSH dhe SGU-te do të bashkëpunojnë dhe koordinojnë për të specifikuar dhe për të siguruar disponueshmërinë, besueshmërinë dhe rezervën shtesë të këtyre mjeteve dhe objekteve.

Neni 106. Kufijtë e sigurisë së operimit

1. OST do të specifikojë kufijtë e sigurisë së operimit për çdo element të sistemit të transmetimit, duke marrë në konsideratë të paktën karakteristikat fizike të mëposhtme:
 - a. kufijtë e tensionit në përputhje me nenin 108;
 - b. limitet e rrymës të qarkut të shkurtër sipas nenit 111; dhe
 - c. limitet e rrymës në terma të vlerësimit termik duke përfshirë mbingarkesat e lejuara kalimtare.

2. Gjatë përcaktimit të kufijve të sigurisë operationale, OST do të marrë parasysh kapacitetet e SGU-ve për të parandaluar që intervalet e tensionit dhe kufijtë e frekuencës në situatë normale dhe alarmi, të çojnë në shkyçjen e tyre.
3. Në rast të ndryshimeve të një prej elementeve të sistemit të transmetimit, OST duhet të verifikojë dhe kur është e nevojshme të azhurnojë kufijtë e sigurisë operationale.
4. Për çdo interkonektor, OST do të bjerë dakord me OST-ne fqinjë për kufijtë e përbashkët të sigurisë operationale në përputhje me paragrafin 1.

Neni 107. Plani i sigurisë për mbrojtjen e infrastrukturës kritike

1. OST do të specifikojë, një plan konfidencial sigurie që përmban një vlerësim të riskut të aseteve në pronësi ose të operuara nga OST, që mbulon skenarë të kërcënimit fizik ose kibernetike të përcaktuara nga VKM përkatëse.
2. Plani i sigurisë do të konsiderojë ndikimet e mundshme në sistemet e ndërlidhura evropiane të transmetimit, dhe përfshin masat organizative dhe fizike që synojnë zbutjen e rreziqeve të identifikuar.
3. OST do të rishikojë rregullisht planin e sigurisë për të adresuar ndryshimet e skenarëve të kërcënimeve dhe të pasqyrojë ndryshimet në sistemin e transmetimit.

Kapitulli 2 – Kontrolli i tensionit dhe menaxhimi i fuqisë reaktive

Neni 108. Detyrimet e OST në lidhje me kufijtë e tensionit

1. Në pajtim me nenin 99, OST do të përpiqet të sigurojë që gjatë gjendjes normale tensioni në pikat e lidhjes me sistemin e transmetimit, mbetet në gjendje të qëndrueshme, brenda intervaleve të specifikuar në Tabelat 1 dhe 2 të Aneksit II.
2. OST do të përcaktojë tensionin bazë në njësi relative (p.u.), për çdo nivel tensioni.
3. OST do të përpiqet të sigurojë që gjatë gjendjes normale dhe pas ndodhjes së një kontingjence, tensioni mbetet brenda intervaleve më të gjera të tensionit për afate të kufizuara të operimit, në marrëveshje për ato intervale të gjera të tensionit me OSSH dhe SGU-të.
4. OST do të rakordojë me OSSH dhe SGU-të në lidhje me diapazonin e tensionit në pikat e kyçjes nën 110 kV nëse këto diapazone të tensionit janë relevante për ruajtjen e limiteve operationale të sigurisë. OST do të përpiqet të sigurojë që tensioni të mbetet brenda intervalit të rënë dakord gjatë gjendjes normale dhe pas ndodhjes së një kontingjence.

Neni 109. Detyrimet e SGU-ve në lidhje me kontrollin e tensionit dhe menaxhimin e fuqisë reaktive në funksionimin e sistemit

1. Brenda tre muaj pas hyrjes në fuqi të këtij kodi, të gjithë përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit që janë module gjeneruese të lidhur në transmetim dhe nuk janë objekt i Nenit

16 të Vendimit të ERE Nr.129, datë 04.06.2018 “Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin të Gjeneruesve” ose që janë sisteme HVDC dhe që nuk i nënshtrohet kërkesave të Nenit 18 të Vendimit të ERE Nr.127, datë 04.06.2018 “Kërkesat Për Lidhjen Me Rrjetin Të Sistemeve Me Tension Të Lartë Me Rrymë Të Vazhduar Dhe Parqet Me Module Të Energjisë Të Lidhur Me Rrymë Të Vazhduar”, do të informojnë OST lidhur me aftësitë e tyre krahasuar me kërkesat e tensionit në Nenin 16 të Vendimit të ERE Nr. 129 datë 04.06.2018 ose në Nenin 18 të Vendimit të ERE Nr.127, datë 04.06.2018, duke deklaruar aftësitë e tyre për kontrollin e tensionit dhe kohën që mund të përballojnë pa u shkyçur.

2. Përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit, të cilat janë objekte konsumatorë që i nënshtrohen kërkesave të nenit 3 të Vendimi të ERE Nr.128, datë 04.06.2018, nuk do të shkyçen për shkak të një shqetësimi brenda diapazonit të tensionit të përmendur në nenin 108.
5. Brenda 3 muajve pas hyrjes në fuqi të këtij kodi, SGU-të që janë objekte konsumatorë të lidhura në transmetim dhe që nuk janë objekt i nenit 3 të Vendimit të ERE Nr.128, datë 04.06.2018 “Kodi të Rrjetit për Lidhjen e Ngarkesës” duhet të informojnë OST lidhur me aftësitë e tyre në lidhje me kërkesat e tensionit të përcaktuara në Aneksin II të Vendimit të ERE Nr.128, datë 04.06.2018, duke deklaruar aftësitë e tyre për kontrollin e tensionit dhe kohën që mund të përballojnë pa u shkyçur.
3. Çdo përdorues i rëndësishëm i rrjetit i lidhur në transmetim do të ruajë tarimet e fuqisë reaktive, diapazonin e faktorit të fuqisë dhe tarimet të tensionit për kontrollin e tensionit në diapazonin e rënë dakord me OST në përputhje me nenin 108.

Neni 110. Detyrimet e OST në lidhje me kontrollin e tensionit dhe menaxhimin e fuqisë reaktive në funksionimin e sistemit

1. Nëse tensioni në një pikë lidhjeje në sistemin e transmetimit është jashtë diapazonit të përcaktuar në tabelën 1 dhe 2 te Aneksit II të këtij kodi, OST do të zbatojë veprimet përmirësuese për kontrollin e tensionit dhe menaxhimin e fuqisë reaktive në përputhje me nenin 103(1)(c) të këtij kodi në mënyrë që në pikën e lidhjes të rivendoset tensioni brenda diapazonit të përcaktuar në Aneksin II dhe brenda afatit kohor të përcaktuar në nenin 16 të Vendimit të ERE Nr.129, datë 04.06.2018 dhe Nenit 13 të Vendimit të ERE Nr.129, datë 04.06.2018 Kodit “Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin të Gjeneruesve”.
2. OST do të marrë në konsideratë në analizën e sigurisë së operimit vlerat e tensionit në të cilat mund të shkyçen nga rrjeti përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit që lidhen në transmetim dhe që nuk i nënshtrohen kërkesave të Vendimit të ERE Nr.129, datë 04.06.2018 ose Vendimit të ERE Nr.128, datë 04.06.2018 “Kodi të Rrjetit për Lidhjen e Ngarkesës”.
3. OST do të sigurojë rezervat e fuqisë reaktive, në sasinë dhe kohën e duhur, me qëllim që të mbahet tensioni brenda zonës së kontrollit dhe në interkonektorë brenda diapazonit të përcaktuar në Aneksin II.

4. OST në bashkëpunim me OST-të fqinje në interkoneksionin AC do të specifikojë regjimin e përshtatshëm të kontrollit të tensionit me qëllim që të zbatohen kufijtë e përbashkët të sigurisë së operimit të përcaktuar në përputhje me nenin 106 (4).
5. OST do të bjerë dakord me OSSH për tarimet e fuqisë reaktive, diapazonin e faktorit të fuqisë dhe tarimet për kontrollin e tensionit në pikën e lidhjes midis OST dhe OSSH në përputhje me nenin 15 të Vendimit të ERE Nr.128, datë 04.06.2018 “Kodi të Rrjetit për Lidhjen e Ngarkesës”.
6. Për të siguruar që këto parametra ruhen, OSSH duhet të përdorë burimet e saj të fuqisë reaktive dhe të ketë të drejtën të japë instruksione për kontrollin e tensionit tek përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit të lidhur në shpërndarje.
7. OST ka të drejtë të përdorë të gjitha kapacitetet e disponueshme të fuqisë reaktive të lidhur në transmetim brenda zonës së kontrollit për menaxhimin efektiv të fuqisë reaktive dhe mbajtjen e diapazonit të tensionit në vlerat e përcaktuara në Tabelat 1 dhe 2 të Aneksit II të këtij kodi.
8. OST duhet, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në koordinim me OSSH, kur është e aplikueshme, të operojë burime të energjisë reaktive brenda zonës së kontrollit, duke përfshirë bllokimin e kontrollit automatik të tensionit/fuqisë reaktive të transformatorëve, reduktimin e tensionit dhe shkyçjen e konsumatorit me tension të ulët, në mënyrë që të ruajë kufijtë e sigurisë së operimit dhe të parandalojnë kolapsin e tensionit në sistemin e transmetimit.
9. OST do të përcaktojë veprimet e kontrollit të tensionit në koordinim me OSSH, përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit dhe OST-të fqinje.
10. Kur është e rëndësishme për kontrollin e tensionit dhe menaxhimin e fuqisë reaktive të sistemit të transmetimit, OST mund t’i kërkojë, në koordinim me OSSH, një përdoruesi të rëndësishëm të rrjetit të lidhur me shpërndarjen, të ndjeke udhëzimet për kontrollin e tensionit.

Kapitulli 3 – Menaxhimi i rrymave të lidhjes së shkurtër

Neni 111. Rryma e lidhjes së shkurtër

1. OST do të përcaktojë:
 - a. rrymën maksimale të lidhjes së shkurtër në të cilën aftësia nominale e çelësave dhe pajisjeve të tjera komutuese tejkalohet; dhe
 - b. rryma minimale e lidhjes së shkurtër për funksionimin e duhur të pajisjeve mbrojtëse.

Neni 112. Llogaritja e rrymës së lidhjes së shkurtër dhe masat përkatëse

1. OST do të kryejë llogaritjet e rrymës së lidhjes së shkurtër për të vlerësuar ndikimin e OST-ve fqinje, të përdoruesve të rëndësishëm të rrjetit të lidhur në transmetim, OSSH

- përfshirë sistemet e mbyllura të shpërndarjes, mbi nivelin e rrymës së lidhjes së shkurtër në sistemin e transmetimit. Kur OSSH, përfshirë sistemet e mbyllura të shpërndarjes, ka ndikim në nivelet e rrymës së lidhjes së shkurtër, ai duhet të përfshihet në llogaritjet e rrymës të lidhjes së shkurtër.
2. Kur kryen llogaritjet e rrymës së lidhjes së shkurtër, OST duhet:
 - a. të përdorë të dhëna me saktësinë dhe me cilësinë më të lartë të disponueshme;
 - b. të marrë parasysh standardet ndërkombëtare; dhe
 - c. të konsiderojë si bazën e llogaritjes së rrymës maksimale të lidhjes së shkurtër, kushtet e operimit që japin nivelin më të lartë të mundshëm të rrymave të lidhjes së shkurtër, duke përfshirë rrymën e lidhjes së shkurtër nga rrjeti i shpërndarjes përfshirë dhe sistemet e mbyllura të shpërndarjes.
 3. OST do të zbatojë masa operative ose masa të tjera për të parandaluar devijimin nga kufijtë maksimal dhe minimal të rrymës së lidhjes së shkurtër referuar në nenin 111, në të gjitha fragmentet e kohës dhe për të gjitha pajisjet mbrojtëse. Nëse ndodh një devijim i tillë, OST do të aktivizojë veprimet përmirësuese ose do të zbatojë masa të tjera për të siguruar që kufijtë e përmendur në nenin 111 të ri-vendosen. Një devijim nga këto kufij lejohet vetëm gjatë sekuencave të kyçjeve (te komutimit).

Kapitulli 4 – Menaxhimi i fluksit të energjisë

Neni 113. Kufijtë e flukseve të fuqisë

1. OST duhet të mbajë lëvizjen e flukseve brenda kufijve të sigurisë së operimit të përcaktuara kur sistemi është në gjendjen normale dhe pas shfaqjes së një kontingjence nga lista e kontingjencave të referuara në nenin 114 (1).
2. Në situatën (N-1), në gjendje normale OST do të ruajë flukset e fuqisë brenda mbingarkesave kalimtare të lejuara referuar në nenin 106(1)(c), pasi ka përgatitur veprimet përmirësuese që do të zbatohen dhe ekzekutohen brenda afatit kohor të lejuar për mbingarkesat kalimtare të lejuara.

Kapitulli 5 – Analiza dhe trajtimi i kontingjencave

Neni 114. Listat e kontingjencave

1. OST do të krijojë një listë të kontingjencave, duke përfshirë kontingjencat e brendshme dhe të jashtme të zonës së saj të vëzhgimit, duke vlerësuar nëse ndonjë prej këtyre kontingjencave rrezikon sigurinë operationale të zonës së kontrollit të OST-së. Lista e kontingjencave përfshin si kontingjencat e zakonshme ashtu dhe kontingjencat e jashtëzakonshme të identifikuara nga zbatimi i metodologjisë së zhvilluar në pajtim me nenin 156.
2. Për të krijuar listën e kontingjencave, OST do të klasifikojë çdo kontingjence në bazë të faktit nëse ajo është e zakonshme, e jashtëzakonshme ose jashtë diapazonit, duke marrë në konsideratë probabilitetin e ndodhjes dhe parimet e mëposhtme:

- a. OST do të klasifikojë kontingjencat për zonën e saj të kontrollit;
 - b. Kur kushtet operacionale ose kushtet e motit rritin ndjeshëm probabilitetin e një kontingjence të jashtëzakonshme, OST duhet të përfshijë atë kontingjence të jashtëzakonshme në listën e saj të kontingjencave; dhe
 - c. Për të llogaritur kontingjencat e jashtëzakonshme me ndikim të lartë në sistemin e saj të transmetimit ose në atë të fqinjëve, OST do të përfshijë kontingjenca të tilla të jashtëzakonshme në listën e saj të kontingjencave.
3. OSSH dhe përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit të lidhur në rrjetin e transmetimit të cilët janë objekte gjeneruese, duhet të japin të gjitha informacionet e rëndësishme për analizën e kontingjencave siç kërkohet nga OST, duke përfshirë parashikimet dhe të dhënat në kohë reale, mundësisht me të dhëna të përmbledhura, në përputhje me nenin 131 (2).
 4. OST do të koordinojë analizën e kontingjencave në mënyrë koherente me listën e kontingjencave të paktën me OST-të e zonës së saj të vëzhgimit, në përputhje me nenin 156.
 5. OST do të informojë OST-të në zonën e vëzhgimit për kontingjencat e jashtme të përfshira në listën e kontingjencave.
 6. OST do të informojë, mjaftueshëm përpara, OST-të e përfshira në zonën e saj të vëzhgimit, për çdo ndryshim topologjik të synuar në elementet e sistemit të tij të transmetimit të cilat përfshihen si kontingjenca të jashtme në listat e OST-ve në fjalë.
 7. OST do të sigurojë që të dhënat në kohë reale janë mjaftueshëm të sakta për të lejuar konvergencën e llogaritjeve të fluksit të ngarkesës të cilat kryhen në analizën e kontingjencave.

Neni 115. Analiza e kontingjencave

1. OST do të kryejë analiza të kontingjencave në zonën e saj të vëzhgimit me qëllim të identifikimit të rasteve të kontingjencave që rrezikojnë ose mund të rrezikojnë sigurinë operacionale të zonës së saj të kontrollit dhe të identifikojë veprimet korrigjuese që mund të jenë të nevojshme për të adresuar rastet e kontingjencave, duke përfshirë zbutjen e ndikimit të kontingjencave të jashtëzakonshme.
2. OST do të sigurojë që devijimet e mundshme të kufijve operative të sigurisë në zonën e saj të kontrollit të identifikuar nga analiza e kontingjencave, nuk rrezikojnë sigurinë operacionale të sistemit të transmetimit ose të sistemeve të transmetimit të ndërlidhura.
3. OST do të kryejë analiza të kontingjencave bazuar në parashikimin e të dhënave operacionale dhe në të dhënat operative në kohë reale nga zona e saj e vëzhgimit. Pika fillestare për analizën e kontingjencave në situatën -N do të jetë topologjia përkatëse e sistemit të transmetimit, që do të përfshijë ndërprerjet e planifikuara në fazat e planifikimit operativ.

Neni 116. Trajtimi i kontingjencave

1. OST do të vlerësojë rreziqet që lidhen me kontingjencat pas simulimit të secilës kontingjencë nga lista, dhe pas vlerësimit nëse kjo mund të mbajë sistemin e transmetimit brenda kufijve të sigurisë operationale në situatën (N-1).
2. Kur OST vlerëson se rreziqet që lidhen me një kontingjencë janë kaq domethënëse sa që ajo të mos jetë në gjendje të përgatisë dhe të aktivizojë veprimet përmirësuese në kohën e duhur për të parandaluar mosrespektimin e kriterit (N-1), ose që ka një risk të përhapjes së avarisë në sistemin e transmetimit të ndërlidhur, OST do të përgatisë dhe aktivizojë veprime përmirësuese për të arritur pajtueshmërinë me kriterin (N-1) sa më shpejt që të jetë e mundur.
3. Në rastin e një situatë (N-1) të shkaktuar nga një incident, OST do të aktivizojë një veprim përmirësues për të siguruar që sistemi i transmetimit të rivendoset në një gjendje normale sa më shpejt që të jetë e mundur dhe që situata (N-1) të bëhet situata e re (N).
4. Nuk do të kërkohet që OST të jetë në pajtueshmëri me kriterin (N-1) në situatat e mëposhtme:
 - a. gjatë sekuencave të komutimeve (manovrimeve në rrjet);
 - b. gjatë periudhës kohore të nevojshme për të përgatitur dhe aktivizuar veprimet përmirësuese.
5. OST mund të mos jetë në pajtueshmëri me kriterin (N-1) përderisa ka vetëm pasoja lokale brenda zonës së kontrollit të saj.

Kapitulli 6 – Mbrojtja

Neni 117. Kërkesat e përgjithshme për mbrojtjen

1. OST do të operojë sistemin e vet të transmisionit me pajisjet mbrojtëse si dhe pajisjet rezervë të mbrojtjes, me qëllim që të parandalojë përhapjen e incidenteve që mund të rrezikojnë sigurinë operationale të sistemit të vet të transmetimit dhe të sistemit të ndërlidhur.
2. Së paku një herë në 5 vjet, OST do të rishikojë strategjinë dhe konceptet e saj të mbrojtjes dhe do t'i përditësojë aty ku është e nevojshme për të siguruar funksionimin korrekt të pajisjeve mbrojtëse dhe mirëmbajtjen e sigurisë operationale.
3. Pas një veprimi të mbrojtjes që kishte një ndikim jashtë zonës së kontrollit të OST-së duke përfshirë interkonektorët, OST do të vlerësojë nëse pajisjet mbrojtëse në zonën e saj të kontrollit kanë punuar sipas planit, dhe do të ndërmerren veprime korrigjuese nëse është e nevojshme.
4. OST duhet të përcaktojë pikat e punës për pajisjet mbrojtëse të sistemit të saj të transmetimit që sigurojnë pastrim të besueshëm, të shpejtë dhe selektiv të defekteve,

duke përfshirë mbrojtjen rezervë për pastrimin e defekteve në rast mosfunksionimi të sistemit të mbrojtjes primare.

5. Para hyrjes në punë të pajisjeve të mbrojtjes primare dhe rezervë ose pas çdo modifikimi, OST do të koordinojë me OST-të fqinjë për përcaktimin e pikave të punës (tarimeve) për interkonektorët dhe duhet të koordinojë me ato përpara se të ndryshojë tarimet.

Neni 118. Skemat e veçanta të mbrojtjes

1. Në rastet kur përdoren skema speciale të mbrojtjes, OST do të:
 - a. sigurojë që çdo skemë speciale e mbrojtjes vepron në mënyrë selektive, të besueshme dhe efektive;
 - b. vlerësojë, kur dizajnon një skemë speciale të mbrojtjes, pasojat për sistemin e transmetimit në rast të funksionimit të saj të pasaktë, duke marrë parasysh ndikimin në OST-të e prekura;
 - c. verifikojë që skema speciale e mbrojtjes ka një besueshmëri të krahasueshme me sistemet e mbrojtjes të përdorura për mbrojtjen primare të elementeve të sistemit të transmetimit;
 - d. operojë sistemin e transmetimit me skemën speciale të mbrojtjes brenda kufijve të sigurisë operationale të përcaktuara në përputhje me nenin 106; dhe
 - e. koordinojë funksionet e skemës speciale të mbrojtjes, parimet e aktivizimit dhe tarimet me OST-të fqinje të ndikuara dhe OSSH përfshirë sistemet e mbyllura të shpërndarjes dhe SGU-të e lidhura me transmetimin.

Neni 119. Monitorimi dhe vlerësimi i stabilitetit dinamik

1. OST duhet të monitorojë stabilitetin dinamik të sistemit të transmetimit nga studimet e kryera offline dhe do të shkëmbejë të dhënat përkatëse për monitorimin e stabilitetit dinamik të sistemit të transmetimit me OST-të e tjera të zonës së saj sinkrone.
2. OST do të kryejë studime për vlerësimin e qëndrueshmërisë dinamike (VQD) të paktën një herë në vit, në mënyrë që të identifikohen kufijtë e qëndrueshmërisë dhe problemet e mundshme të qëndrueshmërisë në sistemin e transmetimit. Studimet e VQD do të koordinohen ndërmjet OST-ve në zonën sinkrone dhe do të përfshijnë të gjithë zonën sinkrone.

Neni 120. Menaxhimi i stabilitetit dinamik

1. Kur vlerësimi i stabilitetit dinamik tregon se ekziston një shkelje e kufijve të stabilitetit, OST duhet të hartojë, përgatisë dhe aktivizojë veprime përmirësuese për të mbajtur stabilitetin e sistemit të transmetimit. Veprimet përmirësuese mund të përfshijnë edhe SGU-të.

2. OST do të sigurojë që kohët e pastrimit të defekteve për defektet që mund të çojnë në paqëndrueshmëri të sistemit të transmetimit në interkoneksion, janë më të shkurtra se koha kritike për pastrimin e defekteve të llogaritur nga OST në vlerësimin e saj të stabilitetit dinamik të kryer në përputhje me nenin 119.

Titulli 2 – Shkëmbimi i të dhënave

Kapitulli 1 – Kërkesat e përgjithshme për shkëmbimin e të dhënave

Neni 121. Organizimi, rolet, përgjegjësitë dhe cilësia e shkëmbimit të të dhënave

1. Shkëmbimi dhe dhënia e të dhënave dhe informacionit në zbatim të këtij titulli do të pasqyrojnë, sa të jetë e mundur, situatën reale dhe të parashikuar të sistemit të transmetimit.
2. OST do të jetë përgjegjëse për sigurimin dhe përdorimin e të dhënave dhe informacionit të kualitetit të lartë.
3. OST do të mbledhë informacionin e mëposhtëm në lidhje me zonën e saj të vëzhgimit dhe do të shkëmbejë këto të dhëna me të gjitha OST-të e tjera në masën që është e nevojshme për kryerjen e analizës së sigurisë operacionale në përputhje me nenin 153:
 - a. gjenerimi;
 - b. konsumi;
 - c. skedulimet;
 - d. pozicionet e balancimit;
 - e. ndërprerjet e planifikuara dhe topologjitë e nënstacioneve; dhe
 - f. parashikimet.
4. OST do të paraqesë informacionin referuar paragrafit (3) si në injeksione dhe tërheqje në çdo nyje të modelit të rrjetit individual të OST të përmendur në nenin 145.
5. Në koordinim me OSSH-në dhe SGU-të, OST do të përcaktojë zbatueshmërinë dhe fushëveprimin e shkëmbimit të të dhënave bazuar në kategoritë e mëposhtme:
 - a. të dhënat strukturore në përputhje me nenin 129;
 - b. skedulimin dhe parashikimin e të dhënave në përputhje me nenin 130;
 - c. të dhënat në kohë reale në përputhje me nenet 125, 128 dhe 131; dhe
 - d. dispozitat në përputhje me nenet 132, 133 dhe 134.
6. Shkëmbimin e të dhënave në përputhje me këtë pikë të kodit, OST e realizon sipas metodologjisë së përgatitur nga të gjitha OST-të anëtare të ENTSO-E, mbi Kërkesat Organizative, Rolet dhe Përgjegjësitë (KORP). Metodologjia “Kërkesat Organizative, Rolet dhe Përgjegjësitë (KORP) në lidhje me Shkëmbimin e të Dhënave është miratuar nga ERE me Vendimin Nr. 159 datë 09.07.2018, si dhe amendimet e bëra kësaj

metodologjie nga Komuniteti i Energjisë janë të miratuara , me Vendimin Nr. 251 datë 11.12.2018.

7. OST do të rakordojë me OSSH në marrëveshjen operationale ndërmjet tyre, për procese efektive, efikase dhe proporcionale për sigurimin dhe menaxhimin e shkëmbimeve të të dhënave, duke përfshirë, aty ku kërkohet për funksionim efikas të sistemit, dhënien e të dhënave për SGU-të të lidhur me sistemin e shpërndarjes. OST dhe OSSH do të rakordohen për formatin e shkëmbimit të të dhënave.
8. SGU-të e lidhura me transmetimin do të kenë akses në të dhënat që kanë të bëjnë me instalimet e tyre në pikën e kyçjes.

Kapitulli 2 – Shkëmbimi i të dhënave ndërmjet OST-ve

Neni 122. Shkëmbimi i të dhënave strukturore dhe të parashikuara

1. OST do të shkëmbejë me OST-të fqinje së paku informacionet strukturore në vijim lidhur me zonën e vëzhgimit:
 - a. topologjia e rregullt e nënstacioneve dhe të dhëna të tjera relevante, sipas nivelit të tensionit;
 - b. të dhënat teknike mbi linjat e transmetimit;
 - c. të dhënat teknike për transformatorët që lidhin OSSH, SGU-të, të cilat janë objekte ngarkese dhe bllok transformatorët të gjeneratorëve të SGU-ve që janë objekte gjeneruese të energjisë;
 - d. fuqia maksimale dhe minimale aktive dhe reaktive e SGU-ve të cilat janë module të gjenerimit të energjisë;
 - e. të dhëna teknike për transformatorët me zhvendosje të fazës;
 - f. të dhëna teknike për sistemet HVDC;
 - g. të dhëna teknike për reaktorët, kondensatorët dhe kompensuesit statike (VAR); dhe
 - h. limitet e sigurisë operationale të përcaktuara nga OST sipas nenit 106.
2. Për të koordinuar mbrojtjen e sistemeve të tyre të transmetimit, OST-të fqinje do të shkëmbejnë pikat e mbrojtjes (tarimet) të linjave për të cilat kontingjencat janë përfshirë si kontingjenca të jashtme në listat e tyre të kontingjencave.
3. Për të bashkërenduar analizën operationale të sigurisë dhe për të vendosur modelin e rrjetit të përbashkët në përputhje me nenet 148, deri 151, OST do të shkëmbejë me OST-të e tjera të rajonit, të paktën të dhënat e mëposhtme:
 - a. topologjia e sistemeve të transmetimit të tensionit 220 kV dhe më të lartë, brenda zonës së tij të kontrollit;
 - b. një model ose një ekuivalent i sistemit të transmetimit me tension nën 220 kV me ndikim të rëndësishëm në sistemin e vet të transmetimit;

- c. limitet termikë të elementëve të sistemit të transmetimit; dhe
 - d. një sasi realiste dhe të saktë të parashikuar të injektimit dhe tërheqjes, sipas burimit primar të energjisë, në çdo nyje të sistemit të transmetimit, për korniza kohore të ndryshme.
4. Për të bashkërenduar vlerësimet e stabilitetit dinamik sipas nenit 119, dhe për t'i kryer ato, OST do të shkëmbeje me OST-të e tjera të rajonit të dhënat e mëposhtme:
- a. të dhënat në lidhje me SGU-të të cilat janë module gjeneruese të energjisë që lidhen, por pa u kufizuar në:
 - b. parametrat elektrikë të alternatorit të përshtatshëm për vlerësimin e stabilitetit dinamik, duke përfshirë inercinë totale;
 - i. modelet e mbrojtjes;
 - ii. alternator dhe lëvizës primar;
 - iii. përshkrimi i transformatorit ngritës;
 - iv. fuqia minimale dhe maksimale reaktive;
 - v. modelet e tensionit dhe modelet e kontrolluesit të shpejtësisë; dhe
 - vi. modelet e lëvizësit primar dhe modelet e sistemit të eksitimit të përshtatshëm për incidente të mëdha;
 - c. të dhënat për llojin e rregullimit dhe diapazonit të rregullimit të tensionit, përfshirë rregullimin nën ngarkesë, si dhe të dhënat për llojin e rregullimit dhe diapazonin e rregullimit të tensionit në lidhje me transformatorët ngritës të sistemit; dhe
 - d. të dhënat në lidhje me sistemet e HVDC dhe pajisjet FACTS në modelet dinamike të sistemit ose pajisjes dhe rregullorja e tij përkatëse e përshtatshme për incidente të mëdha.

Neni 123. Shkëmbimi i të dhënave në kohë reale

1. Në përputhje me 99 dhe 100, OST do të shkëmbeje me OST-të e tjera të zonës sinkrone të dhënat e mëposhtme mbi gjendjen e sistemit të transmetimit duke përdorur mjetin IT për shkëmbimin e të dhënave në kohë reale në nivel pan-evropian i siguar nga ENTSO-E:
 - a. frekuenca;
 - b. gabimi i kontrollit të restaurimit të frekuencës (ACE);
 - c. shkëmbimet e fuqisë aktive të matur ndërmjet zonave të LFC;
 - d. injektimin e gjenerimit të agreguar;
 - e. gjendjen e sistemit në përputhje me nenin 99;
 - f. pikën e përcaktuar (set-point) të kontrollit fuqi-frekuenca; dhe
 - g. fuqinë e shkëmbyer nëpërmjet linjave virtuale.

2. OST do të shkëmbejë me OST-të e tjera në zonën e saj të vëzhgimit, të dhënat e mëposhtme për sistemin e saj të transmetimit duke përdorur shkëmbimet e të dhënave në kohë reale ndërmjet sistemeve të kontrollit mbikëqyrës dhe marrjes së të dhënave (SCADA) të OST-ve dhe sistemeve të menaxhimit të energjisë:
 - a. topologjinë aktuale të n/st;
 - b. fuqia aktive dhe reaktive në çdo dalje të linjës, përfshirë transmetimin, shpërndarjen dhe linjat që lidhin SGU-të;
 - c. fuqia aktive dhe reaktive e transformatorit, duke përfshirë transmetimin, shpërndarjen dhe transformatorët që lidhin SGU-te;
 - d. fuqia aktive dhe reaktive e objektit gjenerues të energjisë;
 - e. rregullimi i pozicioneve të transformatorëve, duke përfshirë transformatorët me zhvendosjen e fazës;
 - f. tensionin e matur të zbarave;
 - g. fuqia reaktive e reaktorit dhe kondensatorit ose nga një kompensator statik VAR; dhe
 - h. kufizimet në aftësitë e furnizimit me energji aktive dhe reaktive në lidhje me zonën e vëzhgimit.

3. Çdo OST ka të drejtë të kërkojë nga të gjithë OST-të nga zona e saj e vëzhgimit që të sigurojnë snapshot-e në kohë reale të të dhënave të vlerësuara, nga ajo zonë e kontrollit të OST nëse kjo është e rëndësishme për sigurinë operacionale të sistemit të transmetimit të OST-së kërkuese.

Kapitulli 3 – Shkëmbimi i të dhënave ndërmjet OST dhe OSSH

Neni 124. Shkëmbimi i të dhënave strukturore

1. OST do të përcaktojë zonën e vëzhgimit të sistemit të shpërndarjes, e cila është e nevojshme për OST-në për të përcaktuar gjendjen e sistemit në mënyrë të saktë dhe efikase, bazuar në metodologjinë e zhvilluar në përputhje me nenin 156.
2. Nëse OST konsideron që një sistem i shpërndarjes jo i lidhur direkt në transmetim ka një ndikim të rëndësishëm në terma të tensionit, flukseve të fuqisë ose parametrave të tjerë, për përfaqësimin e sjelljes së sistemit të transmetimit, ky sistem i shpërndarjes do të përcaktohet nga OST si pjesë e zonës së vëzhgimit në përputhje me nenin 156.
3. Informacioni strukturor që lidhet me zonën e vëzhgimit të përmendur në paragrafët 1 dhe 2 të siguruara nga OSSH për OST-në duhet të përfshijë së paku:
 - a. nënstacionet sipas tensionit;
 - b. linjat që lidhin nënstacionet e përmendura në pikën (a);
 - c. transformatorët nga nënstacionet e përmendura në pikën (a);
 - d. SGU-të; dhe

- e. reaktorët dhe kondensatorët e lidhur me nënstacionet e përmendura në pikën (a).
4. OSSH duhet t'i sigurojë OST-së një përditësim të informacionit strukturor në përputhje me paragrafin 3 të paktën çdo 6 muaj.
 5. Së paku një herë në vit, OSSH duhet ti sigurojë OST-së, sipas burimeve primare të energjisë, kapacitetin total të gjenerimit të përgjithshëm të moduleve gjeneruese të tipit A që i nënshtrohen kërkesave të Kodit “Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin të Gjeneruesve” i miratuar me vendimin ERE Nr. 129 Datë 04.06.2018 dhe sa më mirë të jetë e mundur vlerësimet e kapacitetit gjenerues të moduleve gjeneruese të tipit A që nuk i nënshtrohen ose janë të përjashtuara nga kërkesat e kodit “Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin të Gjeneruesve” i miratuar me vendimin ERE Nr. 129 Datë 04.06.2018 , te lidhura me sistemin e tij të shpërndarjes dhe informacionet përkatëse në lidhje me sjelljen e tyre të frekuencës.

Neni 125. Shkëmbimi i të dhënave në kohë reale

1. Nëse nuk parashikohet ndryshe nga OST, OSSH duhet t'i sigurojë në kohë reale OST-së informacionin që lidhet me zonën e vëzhgimit të OST-së siç referohet në nenin 124 (1) dhe (2) duke përfshirë:
 - a. topologjia aktuale e nënstacioneve;
 - b. fuqia aktive dhe reaktive në çdo dalje të linjës;
 - c. fuqia aktive dhe reaktive në daljen (lidhjen) e transformatorit;
 - d. injektimi i fuqisë aktive dhe reaktive në daljen (lidhjen) e objektit gjenerues të energjisë;
 - e. pozicionet e ancafkave të transformatorëve të lidhur me sistemin e transmetimit;
 - f. tensionet e zbarave;
 - g. fuqia reaktive në daljen e reaktorit dhe kondensatorit;
 - h. të dhënat më të mira në dispozicion për prodhimin e agreguar sipas burimit primar të energjisë në zonën e OSSH-së; dhe
 - i. të dhënat më të mira në dispozicion për ngarkesën e agreguar në zonën e OSSH-së.

Kapitulli 4 – Shkëmbimi i të dhënave ndërmjet OST, pronarëve të interkonektorëve ose linjave të tjera dhe moduleve gjeneruese të energjisë që lidhen me sistemin e transmetimit

Neni 126. Shkëmbimi i të dhënave strukturore

1. Çdo SGU që zotëron një objekt gjenerues të energjisë të një moduli gjenerues të energjisë të tipit D i lidhur me sistemin e transmetimit duhet t'i sigurojë OST-së së paku të dhënat e mëposhtme:
 - a. të dhënat e përgjithshme të modulit gjenerues të energjisë, duke përfshirë kapacitetin e instaluar dhe burimin primar të energjisë;

- b. të dhënat e turbinës dhe gjeneratorit, duke përfshirë kohën për startimin e ftohtë dhe të ngrohtë;
 - c. të dhënat për llogaritjen rrymës të lidhjes së shkurtër;
 - d. të dhënat e transformatorit ngritës;
 - e. të dhënat e rregullimit primar (FCR) të moduleve gjeneruese të energjisë që sigurojnë ose ofrojnë atë shërbim, në përputhje me nenin 223;
 - f. të dhënat e rregullimit sekondar (FRR) të moduleve gjeneruese të energjisë që sigurojnë ose ofrojnë atë shërbim, në përputhje me nenin 227;
 - g. të dhënat e rezervës terciare RR të moduleve gjeneruese të energjisë që sigurojnë ose ofrojnë atë shërbim në përputhje me nenin 230;
 - h. të dhënat e nevojshme për ringritjen e sistemit të transmetimit;
 - i. të dhënat dhe modelet e nevojshme për kryerjen e simulimit dinamik;
 - j. të dhënat e mbrojtjes rele;
 - k. të dhënat e nevojshme për përcaktimin e kostove të veprimeve përmirësuese në përputhje me nenin 157 (1) (b);
 - l. aftësia e kontrollit të tensionit dhe fuqisë reaktive.
2. Çdo SGU që zotëron një objekt gjenerues të energjisë të tipit B ose C duhet t'i sigurojë OST-së të paktën të dhënat e mëposhtme:
- a. të dhënat e përgjithshme të modulit gjenerues të energjisë, duke përfshirë kapacitetin e instaluar dhe burimin primar të energjisë;
 - b. të dhënat për llogaritjen e rrymës të lidhjes së shkurtër;
 - c. të dhënat e FCR sipas përkufizimit dhe kërkesave për modulet gjeneruese të energjisë që sigurojnë ose ofrojnë atë shërbim;
 - d. të dhënat e FRR për modulet gjeneruese të energjisë që sigurojnë ose ofrojnë atë shërbim;
 - e. Të dhënat e RR për modulet gjeneruese të energjisë që sigurojnë ose ofrojnë atë shërbim;
 - f. të dhënat e mbrojtjes rele;
 - g. aftësia e kontrollit të fuqisë reaktive;
 - h. të dhënat e nevojshme për përcaktimin e kostove të veprimeve përmirësuese në përputhje me nenin 157 (1) (b);
 - i. të dhënat e nevojshme për kryerjen e vlerësimit të stabilitetit dinamik sipas nenit 119.
3. OST mund ti kërkojë pronarit të objektit gjenerues të energjisë të një moduli gjenerues të energjisë të lidhur me sistemin e transmetimit për të siguruar të dhëna të mëtejshme

aty ku është e përshtatshme për analizën operative të sigurisë në përputhje me Titullin 2 të Pjesës III.

4. Çdo pronar i sistemit HVDC ose pronari i interkonjeksionit duhet të sigurojë OST-në me të dhënat e mëposhtme lidhur me sistemin HVDC ose interkonektorin:
 - a. të dhënat e tipit (targetes) të instalimit;
 - b. të dhënat e transformatorëve;
 - c. të dhënat për filtrat dhe bankat filtruese;
 - d. të dhënat e kompensimit të fuqisë reaktive;
 - e. aftësinë e kontrollit të fuqisë aktive;
 - f. aftësinë e kontrollit të fuqisë reaktive dhe të tensionit;
 - g. aftësinë e reagimit nga frekuenca;
 - h. modelet dinamike për simulim dinamik;
 - i. të dhënat e mbrojtjes; dhe
 - j. aftësinë për operim gjatë incidentit (pa u shkëputur nga rrjeti).
5. Çdo pronar i interkonjeksionit AC do të sigurojë OST-në së paku të dhënat e mëposhtme:
 - a. të dhënat e tipit (targetes) të instalimit;
 - b. parametrat elektrikë;
 - c. mbrojtjet shoqëruese.

Neni 127. Shkëmbimi i të dhënave të skeduluara

1. Çdo SGU që është pronar i një njësie gjeneruese të energjisë të një moduli gjenerues të energjisë të tipit B, C ose D i lidhur me sistemin e transmetimit duhet t'i sigurojë OST-së të paktën të dhënat e mëposhtme:
 - a. fuqinë aktive të energjisë, rezervat e fuqisë aktive dhe disponueshmërisë, me bazë orare për ditën përpara dhe brenda ditës;
 - b. pa ndonjë vonesë, çdo padisponueshmëri të planifikuar ose kufizim të fuqisë aktive;
 - c. çdo kufizim të parashikuar në aftësinë e kontrollit të fuqisë reaktive;
2. Çdo operator i sistemit HVDC duhet t'i sigurojë OST-të së paku të dhënat e mëposhtme:
 - a. skedulimin e fuqisë aktive dhe disponueshmërinë me bazë orare për ditën në avancë dhe brenda ditës;
 - b. pa vonesë, padisponueshmërinë e planifikuar ose kufizimin i fuqisë aktive; dhe

- c. çdo parashikim kufizimi në aftësinë e kontrollit të fuqisë reaktive ose të tensionit.
3. Çdo operator i interkoneksionit ose linjës AC duhet të sigurojë të dhënat e tij të planifikimit ose të kufizimit të fuqisë aktive në OST.

Neni 128. Shkëmbimi i të dhënave në kohë reale

1. Nëse nuk parashikohet ndryshe nga OST, çdo SGU që është pronar i objektit gjenerues të energjisë të modulit gjenerues të tipit B, C ose D, duhet të sigurojë OST-në në kohë reale të paktën me të dhënat e mëposhtme:
 - a. pozicioni i çelësave në pikën e kyçjes ose në një pikë tjetër të ndërveprimit të dakorduar me OST-në;
 - b. fuqia aktive dhe reaktive në pikën e kyçjes ose në një pikë tjetër të ndërveprimit të rënë dakord me OST-në; dhe
 - c. në rastin e stabilimentit gjenerues të energjisë, me konsum përveç nevojave vetjake, fuqinë neto aktive dhe reaktive.
2. Nëse nuk parashikohet ndryshe nga OST, çdo sistem HVDC ose pronar i interkoneksionit AC do të ofrojë në OST, në kohë reale të paktën të dhënat e mëposhtme në lidhje me pikën e kyçjes të sistemit HVDC ose interkonektorit AC:
 - a. pozicioni i çelësave;
 - b. statusin operativ; dhe
 - c. fuqia aktive dhe reaktive.

Kapitulli 5 – Shkëmbimi i të dhënave ndërmjet OST, OSSH dhe moduleve gjeneruese të energjisë të lidhura me shpërndarjen

Neni 129. Shkëmbimi i të dhënave strukturore

1. Nëse nuk parashikohet ndryshe nga OST, çdo pronar moduli gjenerues të energjisë që është SGU, në përputhje me nenin 97, të lidhur në sistemin e shpërndarjes duhet të sigurojë të paktën të dhënat e mëposhtme për OST dhe OSSH me të cilën ka një pikë lidhjeje:
 - a. të dhëna të përgjithshme të modulit gjenerues të energjisë, duke përfshirë kapacitetin e instaluar dhe burimin primar të energjisë ose llojin e karburantit;
 - b. të dhënat e FCR sipas përkufizimit dhe kërkesave për pajisjet gjeneruese të energjisë që sigurojnë ose ofrojnë shërbimin FCR;
 - c. të dhënat e FRR për pajisjet gjeneruese të energjisë që sigurojnë ose ofrojnë shërbimin FRR;
 - d. të dhënat e RR për modulet gjeneruese të energjisë që sigurojnë ose ofrojnë shërbimin RR;
 - e. të dhënat e mbrojtjes;

- f. aftësinë e kontrollit të fuqisë reaktive;
 - g. aftësinë e komandimit në largësi të çelësit;
 - h. të dhënat e nevojshme për kryerjen e simulimit dinamik sipas dispozitave të “Kodit mbi Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin të Gjeneruesve” i miratuar me vendimin ERE Nr. 129 Datë 04.06.2018; dhe
 - i. nivelin e tensionit dhe vendndodhjen e secilit modul gjenerues të energjisë.
2. Çdo pronar gjenerues i energjisë i një moduli gjenerues të energjisë që është një SGU, në përputhje me nenin 97, duhet të informojë OST-në dhe OSSH-në me të cilën ai ka një pikë lidhjeje, brenda kohës së caktuar dhe jo më vonë se komisionimi i parë ose ndonjë ndryshim në instalimin ekzistues, për çdo ndryshim në fushëveprimin dhe përmbajtjen e të dhënave të renditura në paragrafin 1.

Neni 130. Shkëmbimi i të dhënave të skeduluara

1. Nëse nuk parashikohet ndryshe nga OST, çdo pronar i gjenerimit të energjisë të një moduli gjenerues të energjisë që është një SGU, në përputhje me nenin 97, i lidhur me sistemin e shpërndarjes do të sigurojë OST-në dhe OSSH-në me të cilën ka pikën e lidhjes, së paku me të dhënat e mëposhtme:
- a. pamundësia e planifikuar e tij, kufizimi i planifikuar i fuqisë aktive dhe prodhimi i parashikuar i energjisë aktive në pikën e lidhjes;
 - b. çdo kufizim të parashikuar në aftësinë e kontrollit të fuqisë reaktive.

Neni 131. Shkëmbimi i të dhënave në kohë reale

1. Nëse nuk parashikohet ndryshe nga OST, çdo pronar i gjenerimit të energjisë të një moduli gjenerues të energjisë që është SGU, në përputhje me nenin 97, i lidhur me sistemin e shpërndarjes do të sigurojë OST-në dhe OSSH-në me të cilin ai ka pikën e lidhjes, në kohë reale, së paku të dhënat e mëposhtme:
- a. statusi i pajisjeve komutuese dhe çelësave në pikën e lidhjes; dhe
 - b. flukset aktive dhe reaktive të fuqisë, rryma dhe tensioni në pikën e lidhjes.
2. OST do të përcaktojë në koordinim me OSSH-në, për SGU-të që mund të përjashtohen nga dhënia e të dhënave në kohë reale të listuara në paragrafin 1, direkt në OST. Në raste të tilla, OST dhe OSSH do të bien dakord mbi të dhënat e agreguara në kohë reale të SGU-ve në fjalë që do të dërgohen në OST.

Neni 132. Shkëmbimi i të dhënave ndërmjet OST dhe OSSH në lidhje me modulet e rëndësishme të gjenerimit të energjisë

1. Nëse nuk parashikohet ndryshe nga OST, OSSH duhet t'i sigurojë OST-së informacionin e specifikuar në nenet 129, 130 dhe 131 me shpeshtësinë dhe nivelin e detajeve të kërkuara nga OST

2. OST do të vendosë në dispozicion të OSSH-së, në sistemin e së cilës SGU-të janë të lidhura, informacionet e specifikuar në nenet 129, 130 dhe 131 siç kërkohet nga OSSH-ja.
3. OST mund të kërkojë të dhëna të mëtejshme nga një prodhues i energjisë pronar i një moduli gjenerues të energjisë që është SGU në përputhje me nenin 97, i lidhur me sistemin e shpërndarjes, nëse është e nevojshme për analizën e sigurisë operative dhe për vlerësimin e modeleve.

Kapitulli 6 – Shkëmbimi i të dhënave ndërmjet OST dhe objekteve të kërkesës

Neni 133. Shkëmbimi i të dhënave ndërmjet OST dhe objekteve të kërkesave të lidhura me transmetimin

1. Në rast se nuk parashikohet ndryshe nga OST, çdo pronar i objektit të ngarkesës të lidhur me transmetimin duhet të sigurojë të dhënat strukturore në OST:
 - a. të dhënat elektrike të transformatorëve të lidhur me sistemin e transmetimit;
 - b. karakteristikat e ngarkesës së objektit të ngarkesës; dhe
 - c. karakteristikat e kontrollit të fuqisë reaktive.
2. Nëse nuk parashikohet ndryshe nga OST, çdo pronar i objektit të ngarkesës të lidhur me transmetimin duhet të sigurojë të dhënat e mëposhtme për OST-në:
 - a. Konsumin e energjisë aktive dhe reaktive të planifikuar në baza ditore dhe brenda ditore, duke përfshirë çdo ndryshim të këtyre skedulimeve ose parashikimeve;
 - b. çdo kufizim të parashikuar në aftësinë e kontrollit të fuqisë reaktive;
 - c. në rast të pjesëmarrjes në përgjigjen e ngarkesës, një skedulim orar i gamës së fuqisë strukturore minimale dhe maksimale që duhet të kufizohet.
3. Nëse nuk parashikohet ndryshe nga OST, çdo pronar i objektit të ngarkesës të lidhur me transmetimin duhet të sigurojë të dhënat në vijim në OST në kohë reale:
 - a. fuqinë aktive dhe reaktive në pikën e lidhjes; dhe
 - b. gamën e fuqisë minimale dhe maksimale që mund të kufizohet.
4. Çdo pronar i objektit të ngarkesës të lidhur me transmetimin duhet t'i përshkruajë OST-së sjelljen e tij në diapazonin e tensionit të referuar në nenin 108.

Neni 134. Shkëmbimi i të dhënave ndërmjet OST-se dhe objekteve të ngarkesave të lidhura me shpërndarjen ose palët e treta që marrin pjesë në përgjigjen e ngarkesës

1. Nëse nuk parashikohet ndryshe nga OST, çdo SGU, e cila është një strukturë ngarkese e lidhur me shpërndarjen dhe e cila merr pjesë në përgjigjen e ngarkesës, përveçse nëpërmjet një pale të tretë, do të sigurojë të dhënat në vijim, të skeduluara dhe në kohë reale, në OST dhe OSSH:

- a. fuqia aktive minimale dhe maksimale e strukturës në dispozicion për përgjigjen e ngarkesës dhe kohëzgjatjen maksimale dhe minimale të çdo përdorimi potencial të kësaj fuqie për përgjigjen e ngarkesës;
 - b. një parashikim të fuqisë aktive të pakushtëzuar në dispozicion për përgjigjen e ngarkesës dhe çdo përgjigje të planifikuar të ngarkesës;
 - c. fuqia aktive dhe reaktive në kohë reale në pikën e lidhjes; dhe
 - d. një konfirmim që vlerësimet e vlerave aktuale të përgjigjes së ngarkesës, janë aplikuar.
2. Nëse nuk parashikohet ndryshe nga OST, çdo SGU, i cili është një palë e tretë që merr pjesë në rregullimin e ngarkesës siç përcaktohet në Nenin 27 të Kodit “Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin të Objekteve të Ngarkesës” i miratuar me Vendimin ERE Nr. 128 Datë 04.06.2018;,, duhet t’i ofrojë OST-se dhe OSSH-se për ditën në avancë dhe afër kohës reale, të dhënat e mëposhtme:
- a. fuqia aktive minimale dhe maksimale strukturore e disponueshme për përgjigjen e ngarkesës dhe kohëzgjatjen maksimale dhe minimale të çdo aktivizimi potencial të përgjigjes së ngarkesës në një vendndodhje specifike gjeografike të zonës të përcaktuar nga OST dhe OSSH;
 - b. një parashikim të fuqisë aktive të pakufizuar në dispozicion për përgjigjen e ngarkesës dhe çdo nivel të planifikuar të përgjigjes së ngarkesës në një zonë gjeografike specifike të përcaktuar nga OST dhe OSSH;
 - c. fuqia aktive dhe reaktive në kohë reale; dhe
 - d. një konfirmim që vlerësimet e vlerave aktuale të përgjigjes së ngarkesës, janë aplikuar.

Titulli 3 – Përshtatja

Kapitulli 1 – Rolet dhe përgjegjësitë

Neni 135. Përgjegjësia e SGU-ve

1. Çdo SGU do të njoftojë OST-në ose OSSH-në ku ai ka një pikë lidhjeje për çdo modifikim të planifikuar të aftësive teknike të tij, të cilat mund të kenë ndikim në përshtatjen e tij me kërkesat e këtij kodi, përpara ekzekutimit të modifikimit.
2. Çdo SGU duhet të njoftojë OST-në ose OSSH-në ku ai ka një pikë lidhjeje për çdo incident operacional në objektin e tij, i cili mund të ketë ndikim në përshtatjen e kërkesave të këtij kodi, sa më shpejt që të jetë e mundur pas ndodhjes së incidentit.
3. Çdo SGU do të njoftojë OST-në ose OSSH-në ku ai ka një pikë lidhjeje, për testimet dhe procedurat e planifikuara që duhet të ndiqen për verifikimin e përputhshmërisë së objektit të tij me kërkesat e këtij kodi, në kohën e duhur dhe para fillimit të tyre. OST ose OSSH duhet të miratojnë paraprakisht dhe në kohën e duhur skedulimet dhe procedurat e planifikuara të testimit dhe miratimi nuk duhet të privohet në mënyrë të paarsyeshme. Kur SGU ka një pikë lidhjeje me OSSH-në dhe ndërvepron, në pajtim

me paragrafin 2, vetëm me OSSH-në, OST do të ketë të drejtë të kërkojë nga OSSH-ja rezultatet e testimin të përputhshmërisë, të cilat janë relevante për sigurinë operationale të sistemit të transmetimit.

4. Sipas kërkesës nga OST ose OSSH, në përputhje me nenin 41 (2) të Kodit “Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin të Gjeneruesve” i miratuar me vendimin ERE Nr. 129 Datë 04.06.2018 dhe nenit 35 (2) të kodit“, SGU do të kryejë teste të pajtueshmërisë dhe simulime në përputhje me këto rregullore në çdo kohë gjatë gjithë jetës së objektit të tij dhe në veçanti pas çdo defekti, modifikimi ose zëvendësimi të ndonjë pajisjeje, të cilat mund të kenë ndikim në përmbushjen e kërkesave të këtij kodi në lidhje me aftësinë e objektit për të arritur vlerat e deklaruara, kërkesat kohore të aplikueshme për ato vlera dhe disponueshmërinë ose ofrimin e shërbimeve të kontraktuara të shërbimeve ndihmëse. Palët e treta që sigurojnë përgjigje të ngarkesës direkt në OST, ofruesit e redispecimit të moduleve gjeneruese të energjisë ose objekteve të ngarkesës me anë të grumbullimit, dhe ofruesve të tjerë të rezervave aktive të energjisë duhet të sigurojnë që objektet në portofolin e tyre të jenë në përputhje me kërkesat e këtij kodi.

Neni 136. Detyrat e OST-së në lidhje me funksionimin e sistemit

1. OST është përgjegjëse për sigurinë operationale të zonës së saj të kontrollit, dhe në veçanti do të:
 - a. zhvillon dhe zbaton mjetet e operimit të sistemit që janë relevante për zonën e saj të kontrollit dhe që lidhen me operimin në kohë reale dhe planifikimin operativ;
 - b. zhvillon dhe vendos mjete dhe zgjidhje për parandalimin dhe korrigjimin e incidenteve;
 - c. përdor shërbimet e ofruara nga palët e treta, nëpërmjet prokurimit kur është e aplikueshme, si redispecimi ose kundër-tregtimi, shërbimet e menaxhimit të kongjestionëve, rezervat e gjenerimit dhe shërbime të tjera ndihmëse;
 - d. përputhet me shkallën e klasifikimit të incidenteve të miratuar nga ENTSO-E në përputhje me nenin 8 (3) (a) të rregullores (KE) Nr 714/2009⁵ dhe të dorëzojë në ENTSO-E informacionin e kërkuar për kryerjen e detyrave për emetimin e shkallës së klasifikimit të incidenteve; dhe
 - e. monitoron në baza vjetore përshtatshmërinë e mjeteve të operimit të sistemit të përcaktuara në përputhje me pikat (a) dhe (b) të kërkuara për të ruajtur sigurinë operationale. OST do të identifikojë çdo përmirësim të përshtatshëm për ato mjete të operimit të sistemit, duke marrë parasysh raportet vjetore të përgatitura nga ENTSO-E bazuar në shkallën e klasifikimit të incidenteve.

⁵ Regulation (Ec) No 714/2009 Of The European Parliament And Of The Council Of 13 July 2009 On Conditions For Access To The Network For Cross-Border Exchanges In Electricity

Kapitulli 2 – Testimi operacional

Neni 137. Qëllimi dhe përgjegjësitë

1. OST, OSSH dhe çdo SGU i lidhur në transmetim mund të kryejnë testimin operacional përkatësisht të elementeve të sistemit të tij të transmetimit dhe të objekteve të tyre në kushte operacionale të simuluar dhe për një periudhë të kufizuar kohore. Kur veprojnë kështu, ata duhet të japin njoftimin në kohën e duhur dhe para fillimit të testimit dhe do të minimizojnë efektin në operimin e sistemit në kohë reale. Testimi operacional synon të sigurojë:
 - a. vërtetimin e përputhshmërisë me të gjitha dispozitat operacionale teknike dhe organizative të këtij kodi për një element të ri të sistemit të transmetimit në hyrjen e tij të parë në operim;
 - b. vërtetimin e përputhjes me të gjitha dispozitat operacionale teknike dhe organizative të këtij kodi për një strukturë të re të SGU-së ose OSSH-së në hyrjen e saj të parë në veprim;
 - c. vërtetimin e përputhshmërisë me të gjitha dispozitat operacionale teknike dhe organizative të këtij kodi pas çdo ndryshimi të një elementi të sistemit të transmetimit ose një strukture të SGU-së ose OSSH-së, e cila është e rëndësishme për funksionimin e sistemit;
 - d. vlerësimin e efekteve të mundshme negative të një dështimi, lidhje të shkurtër ose incidenteve të tjera të paplanifikuara dhe të papritura në funksionimin e sistemit, në elementin e sistemit të transmetimit ose në objektin e SGU-së ose OSSH-së.
2. Rezultatet e testimit operacional të përmendur në paragrafin 1 do të përdoren nga OST, OSSH ose një SGU, në mënyrë që:
 - a. OST të sigurojë funksionimin korrekt të elementeve të sistemit të transmetimit;
 - b. OSSH dhe SGU për të siguruar funksionimin korrekt të sistemeve të shpërndarjes dhe të objekteve të SGU-ve;
 - c. OST, OSSH ose SGU për të mbajtur praktikën ekzistuese dhe për të zhvilluar praktika të reja operacionale;
 - d. OST për të siguruar përmbushjen e shërbimeve ndihmëse;
 - e. OST, OSSH ose SGU për të marrë informacion në lidhje me performancën e elementeve të sistemit të transmetimit dhe objekteve të SGU-ve dhe OSSH nën çdo kusht dhe në përputhje me të gjitha dispozitat përkatëse operative të këtij kodi, në lidhje me:
 - i. kontrollin e frekuencës ose variacionet e tensionit që synojnë grumbullimin e informacionit mbi sistemin e transmetimit dhe sjelljen e elementëve; dhe
 - ii. testet e praktikave operacionale në gjendje emergjence dhe gjendjen e restaurimit.

3. OST do të sigurojë që testimi operacional nuk rrezikon sigurinë operationale të sistemit të tij të transmetimit. Çdo testim operacional mund të shtyhet ose ndërpritet për shkak të kushteve të paplanifikuara të sistemit, ose për shkak të sigurisë së personelit, të publikut të gjerë, të impiantit ose aparatit që testohet, ose të elementeve të sistemit të transmetimit ose të objekteve të OSSH ose SGU.
4. Në rast të degradimit të gjendjes së sistemit të transmetimit në të cilin kryhet testimi operacional, OST ka të drejtë të ndërpresë testimin operacional. Nëse kryerja e një prove prek një tjetër OST dhe gjendja e sistemit të tij është gjithashtu e degraduar, OST ose SGU ose OSSH që kryen testin, pasi të jetë informuar nga OST në fjalë, ndërpresin menjëherë testin operativ.
5. OST do të sigurojë që rezultatet e testeve përkatëse operationale të kryera së bashku me të gjitha analizat përkatëse janë:
 - a. përfshire në procesin e trajnimit dhe certifikimit të punonjësve përgjegjës për operimin në kohë reale;
 - b. përdorur si input për procesin e kërkimit dhe zhvillimit të ENTSO-E; dhe
 - c. përdorur për të përmirësuar praktikat operationale duke përfshirë edhe ato në gjendjen e emergjencës dhe të restaurimit.

Neni 138. Kryerja e testeve dhe analizave operationale

1. OST ose OSSH, në të cilin SGU ka një pikë lidhjeje, kanë të drejtën për të testuar përputhjen e SGU-se me kërkesat e këtij kodi, inputin ose outputin e pritshëm të SGU-së, ofrimin e shërbimeve ndihmëse të kontraktuara të SGU-së, në çdo kohë gjatë gjithë jetës së objektit. Procedura për ato teste operationale duhet t'i njoftohet SGU-së nga OST ose OSSH në kohën e duhur përpara fillimit të testit operativ.
2. OST ose OSSH në të cilin SGU ka një pikë lidhjeje, do të publikojë listën e informacionit dhe dokumenteve që duhet të ofrohen, si dhe kërkesat që duhet të përmbushen nga SGU për testimin operacional të pajtueshmërisë. Lista e tillë duhet të mbulojë së paku informacionin e mëposhtëm:
 - a. të gjithë dokumentacionin dhe certifikatat e pajisjeve që do të sigurohen nga SGU;
 - b. detajet e të dhënave teknike të objektit të SGU-se me rëndësi për funksionimin e sistemit;
 - c. kërkesat për modelet për vlerësimin e stabilitetit dinamik; dhe
 - d. studimet nga SGU që tregojnë rezultatin e pritshëm të vlerësimit të stabilitetit dinamik, aty ku është e aplikueshme.
3. Kur është e zbatueshme, OST ose OSSH do të publikojë alokimin e përgjegjësive të SGU-së dhe OST-së ose OSSH-së për testimin operacional të pajtueshmërisë.

Titulli 4 – Trajnimi

Neni 139. Programi i trajnimit

1. OST do të zhvillojë dhe miratojë:
 - a. një program trajnimi fillestar për certifikimin dhe një program periodik për trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve të saj përgjegjës për operimin në kohë reale të sistemit të transmetimit;
 - b. një program trajnimi për punonjësit e saj përgjegjës për planifikimin operativ. OST do të kontribuojë në zhvillimin dhe miratimin e programeve të trajnimit për punonjësit e koordinatorëve përkatës të sigurisë rajonale;
 - c. një program trajnimi për punonjësit e saj përgjegjës për balancimin.
2. Programet e trajnimit të OST-se përfshijnë njohjen e elementeve të sistemit të transmetimit, funksionimin e sistemit të transmetimit, përdorimin e sistemeve dhe proceseve në vendin e punës, operacionet ndër-sistimore, rregullimet (kontratat) e tregut, njohjen dhe reagimin ndaj situatave të jashtëzakonshme në funksionimin e sistemit, aktivitetet dhe mjetet e planifikimit operativ.
3. Punonjësit e OST-së, të ngarkuar me operimin në kohë reale të sistemit të transmetimit, si pjesë e trajnimit fillestar, i nënshtrohen trajnimit për çështjet e ndërveprimit midis sistemeve të transmetimit të bazuara në përvojat operacionale dhe reagimet nga trajnimi i përbashkët i kryer me OST-të fqinjë në përputhje me neni 144. Trajnimi për çështjet e ndërveprimit përfshin përgatitjen dhe aktivizimin e veprimeve të koordinuara përmirësuese të kërkuara në të gjitha situatat e sistemit.
4. OST do të përfshijë në programin e saj të trajnimit për punonjësit përgjegjës për operimin në kohë reale të sistemit të transmetimit, frekuencën e trajnimeve dhe komponentët e mëposhtëm:
 - a. një përshkrim të elementeve të sistemit të transmetimit;
 - b. funksionimin e sistemit të transmetimit në të gjitha situatat e sistemit përfshirë restaurimin;
 - c. përdorimin e sistemeve dhe proceseve në vendin e punës;
 - d. koordinimin e operacioneve ndër sistimore dhe marrëveshjeve të tregut;
 - e. njohja dhe reagimi ndaj situatave të jashtëzakonshme operacionale;
 - f. fushat përkatëse të inxhinierisë së energjisë elektrike;
 - g. aspektet relevante të tregut të brendshëm të energjisë elektrike të rajonit;

- h. aspektet relevante të kodeve të rrjetit ose udhëzimeve të miratuara në përputhje me nenet 6 dhe 18 të Rregullores (KE) Nr. 714/2009⁶;
 - i. ruajtja dhe siguria e personave dhe pajisjeve në operimin e sistemit të transmetimit;
 - j. bashkëpunimi dhe bashkërendimi ndërmjet OST-ve në operimin në kohë reale dhe në planifikimin operacional në nivel të qendrave kryesore të kontrollit, që duhet të jepen në gjuhën angleze, nëse nuk specifikohet ndryshe;
 - k. trajnim të përbashkët, sipas rastit, me OSSH-në dhe SGU-të e lidhura me transmetimin;
 - l. shkathtësia e sjelljes me fokus të veçantë në menaxhimin e stresit, veprimin njerëzor në situata kritike, përgjegjësinë dhe aftësitë e motivimit; dhe
 - m. praktikat dhe mjetet e planifikimit operativ, përfshirë ato që përdoren me koordinatoret përkatës të sigurisë rajonale në planifikimin operativ.
5. Programi i trajnimit për punonjësit përgjegjës për planifikimin operativ duhet të përfshijë të paktën aspektet në pikat (c), (f), (g), (h), (j) dhe (m) të paragrafit 4.
 6. Programi i trajnimit për punonjësit përgjegjës për balancimin duhet të përfshijë të paktën aspektet në pikat (c), (g) dhe (h) të paragrafit 4.
 7. OST do të mbajë shënime mbi programet e trajnimit të punonjësve për periudhën e tyre të punësimit. Me kërkesë të autoritetit rregullator përkatës, OST do të ofrojë fushëveprimin dhe detajet e programeve të saj të trajnimit.
 8. OST do të rishikojë programet e saj të trajnimit të paktën një herë në vit ose pas ndryshimeve të rëndësishme të sistemit. OST duhet të azhurnojë programet e saj të trajnimit për të reflektuar ndryshimin e rrethanave operationale, rregullat e tregut, konfigurimin e rrjetit dhe karakteristikat e sistemit, me fokus të veçantë në teknologjitë e reja, ndryshimin e modeleve të gjenerimit dhe kërkesave dhe evoluimin e tregut.

Neni 140. Kushtet e trajnimit

1. Çdo program trajnimi i OST-së për punonjësit përgjegjës për punën në kohë reale duhet të përfshijë trajnimin në vendin e punës dhe atë offline. Trajnimi në vendin e punës do të kryhet nën mbikëqyrjen e një punonjësi me përvojë të ngarkuar me operimin në kohë reale. Trajnimi në simulator (offline) do të kryhet në një mjedis që simulon dhomën e kontrollit dhe me detajet e modelimit të rrjetit në një nivel të përshtatshëm për detyrat për të cilat kryhet trajnimi.
2. OST do të zbatojë trajnime për punonjësit përgjegjës për operimin në kohë reale bazuar në një model gjithëpërfshirës të bazës së të dhënave të rrjetit të saj me të dhënat përkatëse nga rrjetet e tjera, së paku ato të zonës së vëzhgimit, në një nivel të detajuar që është i mjaftueshëm për të përsëritur (imituar) çështje operationale ndër-sistimore.

⁶ Regulation (Ec) No 714/2009 Of The European Parliament And Of The Council Of 13 July 2009 On Conditions For Access To The Network For Cross-Border Exchanges In Electricity

Skenarët e trajnimit duhet të bazohen në kushte reale dhe të simuluar të sistemit. Aty ku është e rëndësishme, roli i OST-ve të tjera, OSSH-së dhe SGU-të gjithashtu duhet të simulohen nëse ato nuk mund të përfaqësohen drejtpërdrejtë në trajnime të përbashkëta.

3. OST do të koordinojë trajnimin offline të punonjësve përgjegjës për operimin në kohë reale me OSSH-në dhe SGU-të e lidhura me transmetimin në lidhje me ndikimin e objekteve të tyre në operimin në kohë reale të sistemit të transmetimit, në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe proporcionale, duke pasqyruar topologjinë e fundit të rrjetit dhe karakteristikat e pajisjeve sekondare. Kur është e rëndësishme, OST, OSSH dhe SGU-të do të bëjnë simulime të përbashkëta trajnimi offline ose workshop-e trajnimi.

Neni 141. Koordinatorët e trajnimit dhe trajnerët

1. Përgjegjësitë e koordinatorit të trajnimit përfshijnë hartimin, monitorimin dhe azhurnimin e programeve të trajnimit, si dhe përcaktimin e:
 - a. kualifikimeve dhe procesit të përzgjedhjes për punonjësit e OST-së që trajnohen;
 - b. trajnimet e nevojshme për certifikimin e punonjësve të sistemit operativ përgjegjës për operimin në kohë reale;
 - c. proceset, duke përfshirë dokumentacionin përkatës, për programet fillestare dhe programet e trajnimit ciklike;
 - d. procesi i certifikimit të punonjësve të sistemit operativ përgjegjës për operimin në kohë reale; dhe
 - e. procesi për zgjatjen e periudhës së trajnimit dhe periudhës së certifikimit për punonjësit e sistemit operativ që janë përgjegjës për operimin në kohë reale.
2. OST do të përcaktojë aftësitë dhe nivelin e kompetencës së trajnerëve në vendin e punës. Trajnerët në vendin e punës duhet të kenë një nivel të përshtatshëm të përvojës operationale pas certifikimit të tyre.
3. OST duhet të ketë një regjistër të punonjësve të sistemit operativ që janë përgjegjës për operimin në kohë reale që kryejnë funksionet e trajnerëve në vendin e punës dhe rishikojnë aftësinë e tyre për të ofruar trajnime praktike kur vendosin për zgjatjen e certifikimit të tyre.

Neni 142. Certifikimi i punonjësve të operimit të sistemit të ngarkuar me operimin në kohë reale

1. Një individ mund të bëhet punonjës i sistemit operativ i ngarkuar me operimin në kohë reale, me kusht që ai ose ajo të jetë i trajnuar dhe më pas të jetë i certifikuar nga një përfaqësues i emëruar nga OST-ja, për detyrat përkatëse brenda afatit kohor të përcaktuar në programin e trajnimit. Punonjësi i sistemit operativ i ngarkuar me operimin në kohë reale nuk duhet të punojë pa mbikëqyrje në dhomën e kontrollit përveç nëse ai ose ajo është i certifikuar.

2. OST do të përcaktojë dhe zbatojë një proces, duke përfshirë nivelin e kompetencës, për certifikimin e punonjësve të sistemit operativ përgjegjës për operimin në kohë reale.
3. Punonjësit e OST-së të ngarkuar me operimin në kohë reale do të certifikohen pas një vlerësimi formal të suksesshëm, i cili duhet të përfshijë një provim me gojë dhe/ose me shkrim dhe/ose një vlerësim praktik me kriteret e paracaktuara të suksesit.
4. OST do të mbajë një kopje të certifikatës së lëshuar dhe rezultatet e vlerësimit formal. Në bazë të kërkesës nga autoriteti rregullator, OST do të sigurojë një kopje të shënimeve të provimit të certifikimit.
5. OST do të regjistrojë periudhën e vlefshmërisë së certifikimit të lëshuar për çdo punonjës përgjegjës për operimin në kohë reale.
6. OST do të përcaktojë afatin maksimal të certifikimit, i cili nuk duhet të kalojë 5 vjet, por që mund të zgjatet në bazë të kriterëve të përcaktuara nga OST dhe mund të marrë në konsideratë pjesëmarrjen e punonjësve përgjegjës për operimin në kohë reale në një program trajnimi të vazhdueshëm me përvojë të mjaftueshme praktike.

Neni 143. Gjuha e përbashkët për komunikim ndërmjet punonjësve të sistemit operativ përgjegjës për operimin në kohë reale

1. Nëse nuk është rënë dakord ndryshe, gjuha e përbashkët e kontaktit midis punonjësve të OST-së dhe atyre të OST-ve fqinjë, është Anglisht.
2. OST do të trajnojë punonjësit e saj të sistemit operativ për të arritur aftësi të mjaftueshme në gjuhët e përbashkëta të kontaktit të dakorduara me OST-të fqinje.

Neni 144. Bashkëpunimi ndërmjet OST-ve për trajnimin

1. OST do të organizojë sesione trajnimi të rregullta me OST-të fqinje për të përmirësuar njohjen e karakteristikave të sistemeve transmetuese fqinje, si dhe komunikimin dhe koordinimin ndërmjet punonjësve të OST-ve fqinjë të ngarkuar me operimin në kohë reale. Trajnimi ndërmjet OST-ve do të përfshijë njohuri të detajuara të veprimeve të koordinuara që kërkohen në çdo situatë të sistemit.
2. OST do të përcaktojë, në bashkëpunim me së paku OST-në fqinje, nevojën dhe frekuencën për seancat e përbashkëta të trajnimit, duke përfshirë përmbajtjen dhe fushëveprimin minimal të këtyre sesioneve, duke marrë parasysh nivelin e ndikimit reciprok dhe bashkëpunimin operacional të nevojshëm. Ky trajnim ndër-OST mund të përfshijë, por nuk duhet të kufizohet në seminare të përbashkëta trajnuese dhe seanca simuluese të trajnimeve të përbashkëta.
3. OST do të marrë pjesë në OST-të e tjera, të paktën një herë në vit, në sesione trajnimi për menaxhimin e çështjeve ndër-OST në operimin në kohë reale. Frekuenca duhet të përcaktohet duke marrë parasysh nivelin e ndikimit të ndërsjellë të sistemeve të transmetimit dhe llojin e lidhjeve interkonektive - DC / AC.

4. OST do të shkëmbeje përvojat nga operimet në kohë reale, duke përfshirë vizitat dhe shkëmbimin e përvojave ndërmjet punonjësve të sistemit operativ që janë përgjegjës për operimin në kohë reale, me OST-të fqinjë, dhe me koordinatorët përkatës të sigurisë rajonale.

Pjesa III – Planifikimi operativ

Titulli 1 – Të dhëna mbi analizën e sigurisë së operimit në planifikimin operacional

Neni 145. Dispozita të përgjithshme në lidhje me modelet individuale dhe të përbashkëta të rrjetit

1. Për të kryer analiza operacionale të sigurisë në përputhje me Titullin 2 të kësaj Pjese, OST do të përgatisë modele të rrjetit individual në përputhje me metodologjitë e përcaktuara në zbatim të Nenit 17 të Rregullores (EU) 2015/1222⁷ dhe Nenit 18 të Rregullores (BE) 2016/1719⁸ për secilën nga afatet e mëposhtme, duke aplikuar formatin e të dhënave të përcaktuara:
 - a. për vitin përpara, në përputhje me nenet 147, 148 dhe 149;
 - b. sipas rastit, për javën përpara, në përputhje me nenin 150;
 - c. për ditën përpara, në përputhje me nenin 151; dhe
 - d. brenda ditës, në përputhje me nenin 151.
2. Modelet e rrjetit individual përfshijnë informacion strukturor dhe të dhëna të përcaktuara në nenin 122.
3. OST do të ndërtojë modelet individuale të rrjetit dhe koordinatori rajonal i sigurisë do të kontribuojë në ndërtimin e modeleve të përbashkëta të rrjetit që aplikojnë formatin e të dhënave të dakordesuara.

Neni 146. Skenarët e vitit përpara

1. Të gjitha OST-të së bashku do të zhvillojnë një listë të përbashkët të skenarëve të vitit përpara përkundrejt së cilës ata vlerësojnë funksionimin e sistemit të transmetimit të ndërlidhur për vitin e ardhshëm. Këto skenarë do të lejojnë identifikimin dhe vlerësimin e ndikimit të sistemit të transmetimit të ndërlidhur në sigurinë operacionale. Skenarët duhet të përfshijnë variablat e mëposhtëm:
 - a. kërkesën për energji elektrike;
 - b. kushtet lidhur me kontributin e burimeve të rinovueshme të energjisë;

⁷ Commission Regulation (Eu) 2015/1222 Of 24 July 2015 Establishing A Guideline On Capacity Allocation And Congestion Management

⁸ Commission Regulation (Eu) 2016/1719 Of 26 September 2016 Establishing A Guideline On Forward Capacity Allocation

- c. pozicionet e përcaktuara të import/eksportit, duke përfshirë vlerat e rakorduara të referencës që lejojnë detyrën e bashkimit (të modelit);
 - d. modelin e gjenerimit, me një park të prodhimit plotësisht të disponueshëm;
 - e. zhvillimin e rrjetit të vitit përpara.
2. Gjatë zhvillimit të listës së përbashkët të skenarëve, OST-të do të marrin parasysh elementët e mëposhtëm:
- a. modelet tipike të shkëmbimit ndërkufitar për nivele të ndryshme të konsumit dhe të burimeve të rinovueshme të energjisë dhe gjenerimit konvencional;
 - b. probabiliteti i shfaqjes së skenarëve;
 - c. devijimet e mundshme nga kufijtë e sigurisë operationale për secilin skenar;
 - d. sasinë e energjisë së gjeneruar dhe konsumuar nga objektet gjeneruese të energjisë dhe objektet e ngarkesës të lidhura me sistemet e shpërndarjes.
3. ENTSO-E do të publikojë çdo vit, deri më 15 korrik, listën e përbashkët të skenarëve të përcaktuar për vitin e ardhshëm, duke përfshirë përshkrimin e atyre skenarëve dhe periudhën gjatë së cilës do të përdoren këto skenarë.

Neni 147. Modelet e rrjetit individual të vitit përpara

1. OST do të përcaktojë një model të rrjetit individual për vitin përpara për secilin nga skenarët e zhvilluar në përputhje me nenin 146, duke përdorur vlerësimet më të mira të variablave të përcaktuar në nenin 146 (1). OST do të publikojë modelet e veta të rrjetit individual për vitin e ardhshëm në mjedisin e të dhënave të planifikimit operational të ENTSO-E.
2. Kur përcaktohet modeli i rrjetit individual të vitit të ardhshëm, OST duhet:
- a. të pajtohet me OST-të fqinjë mbi rrjedhën e vlerësuar të energjisë në sistemet HVDC që lidhin zonat e tyre të kontrollit;
 - b. të balancojë për secilin skenar shumën e:
 - c. shkëmbimeve neto në linjat AC;
 - i. flukset e vlerësuara të fuqisë në sistemet HVDC;
 - ii. ngarkesën, duke përfshirë një vlerësim të humbjeve; dhe
 - iii. gjenerimin.
3. OST duhet të përfshijë në modelet e veta të rrjetit të vitit përpara, prodhimin e agreguar të energjisë për pajisjet gjeneruese të energjisë që lidhen me sistemin e shpërndarjes. Këto prodhime të agreguara të energjisë duhet:
- a. të jenë në pajtim me të dhënat strukturore të dhëna në përputhje me kërkesat e neneve 122, 124, 126 dhe 129;

- b. të jetë në pajtim me skenarët e zhvilluar në përputhje me nenin 146; dhe
- c. të dallojë llojin e burimit të energjisë primare.

Neni 148. Modelet e rrjetit të përbashkët të vitit përpara

1. Të gjitha OST-të e ENTSO-E së bashku, kanë zhvilluar metodologjinë për ndërtimin e modeleve të rrjetit të vitit të ardhshëm nga modelet individuale të rrjetit të vendosura në përputhje me nenin 147 (1) dhe për ruajtjen e tyre. Kjo metodologji është aprovuar nga ERE, Vendimi ERE Nr.250 Datë 11.12.2018.
2. Çdo OST ka të drejtë të kërkojë nga një OST tjetër informacion mbi modifikimet në topologjinë e rrjetit ose në aranzhimet operationale, si pikat e përcaktuara (tarimet) të mbrojtjes ose skemat e mbrojtjes së sistemit, diagramet një-fazore dhe konfigurimi i nënstacioneve ose modelet shtesë të rrjetit që janë relevante për sigurimin e një përfaqësimi të saktë të sistemit të transmetimit për të ndërmarrë analiza operationale të sigurisë.

Neni 149. Përditësimi i modeleve të rrjetit individual dhe të përbashkët të vitit përpara

1. Kur një OST modifikon ose njofton një modifikim të vlerësimeve më të mira për variablet e përdorura për përcaktimin e modelit të rrjetit individual të vitit të ardhshëm, të përcaktuar në përputhje me nenin 147 (1), i cili është domethënës për sigurinë operationale, ajo do të azhurnojë modelin e vet të rrjetit për vitin e ardhshëm dhe do ta publikojë atë në mjedisin e të dhënave të planifikimit operational të ENTSO-E.
2. Kurdoherë që një model i rrjetit individual përditësohet, modeli i rrjetit të vitit të ardhshëm do të përditësohet në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në përputhje me nenin 149 (1).

Neni 150. Modelet e rrjetit individual dhe të përbashkët të javës së ardhshme

1. Kur dy ose më shumë OST e konsiderojnë të nevojshme, ato do të përcaktojnë skenarët më përfaqësues për koordinimin e analizës operationale të sigurisë të sistemit të tyre të transmetimit për periudhën e javës së ardhshme dhe do të zhvillojnë metodologjinë për bashkimin e modeleve të rrjetit individual në përputhje me metodologjinë për ndërtimin e modelit të rrjetit të vitit të ardhshëm nga modelet e rrjetit individual të vitit në vijim, në përputhje me nenin 148 (1).
2. OST do të krijojë ose përditësojë modele individuale të rrjetit të tij për një javë në përputhje me skenarët e përcaktuar sipas paragrafit 1.
3. OST-të e përmendura në paragrafin 1 ose palët e treta, të cilave i është deleguar detyra e referuar në paragrafin 1, do të ndërtojë modelet e përbashkëta të rrjetit të javës së ardhshme duke ndjekur metodologjinë e zhvilluar në përputhje me paragrafin 1 dhe duke përdorur modelet individuale të rrjetit të vendosura në përputhje me paragrafin 2.

Neni 151. Metodologjia për ndërtimin e modeleve të rrjetit të përbashkët të ditës përpara dhe brenda ditës

1. Të gjitha OST-të e ENTSO-E së bashku, kanë zhvilluar metodologjinë për ndërtimin e modeleve të rrjetit të ditës përpara dhe brenda ditës, prej modeleve individuale, dhe për ruajtjen e tyre. Kjo metodologji është aprovuar nga ERE, Vendimi ERE nr. 250 Datë 11.12.2018
2. OST do të krijojë modele të rrjetit individual të ditës përpara dhe brenda ditës në përputhje me paragrafin 1 dhe ja transmeton qendrës rajonale të sigurisë RSC.

Neni 152. Kontrolli i cilësisë për modelet e rrjetit

1. Kur bëhet kontrolli i cilësisë, OST në bashkëpunim me RSC do të kontrollojë të paktën:
 - a. koherencën e statusit të lidhjes së interkonektorëve;
 - b. vlerat e tensionit janë brenda vlerave operative të zakonshme për ato elementë të sistemit që kanë ndikim në zonat e tjera të kontrollit;
 - c. koherencën e mbingarkimeve tranzitore të pranueshme të interkonektorëve; dhe
 - d. fuqia aktive dhe reaktive e injektimeve ose tërheqjeve janë në përputhje me vlerat e zakonshme operationale.

Titulli 2 – Analiza e sigurisë operationale

Neni 153. Analiza e sigurisë operationale në planifikimin operational

1. OST do të kryejë analiza të koordinuara operative të sigurisë për të paktën afatet e mëposhtme:
 - a. një vit përpara;
 - b. javën përpara, kur zbatohet në përputhje me nenin 150;
 - c. ditën përpara; dhe
 - d. brenda ditës.
2. Gjatë kryerjes së një analize të koordinuar të sigurisë operationale, OST do të zbatojë metodologjinë e miratuar në përputhje me nenin 156.
3. Për të kryer analiza operationale të sigurisë, në situatën N, OST do të simulojë çdo kontingjence nga lista e saj e kontingjencave e përcaktuar në përputhje me nenin 114 dhe verifikon që në situatën (N-1) kufijtë e sigurisë operationale të përcaktuara në përputhje me nenin 106 nuk janë tejkaluar në zonën e saj të kontrollit.
4. OST në bashkëpunim me RSC do të kryejë analizat operationale të sigurisë duke përdorur modelet e rrjetit të përbashkët dhe do të marrë parasysh ndërprerjet e planifikuara gjatë kryerjes së këtyre analizave.

5. OST do të ndajë rezultatet e analizës operationale të sigurisë me të paktën OST-të, elementet e të cilëve janë përfshirë në zonën e vëzhgimit të OST-së dhe ndikohen në atë analizë të sigurisë operative, në mënyrë që këto OST të verifikojnë se kufijtë e sigurisë operationale janë respektuar brenda zonave të tyre të kontrollit.

Neni 154. Analizat operationale të sigurisë për vitin përpara, dhe duke përfshirë javën përpara

1. OST do të kryejë analiza operationale të sigurisë për një vit përpara dhe, kur është e zbatueshme për javën përpara, për të zbuluar të paktën kufizimet e mëposhtme:
 - a. Flukset e fuqisë dhe tensionet që tejkalojnë kufijtë e sigurisë operationale;
 - b. shkeljet e kufijve të stabilitetit të sistemit të transmetimit të identifikuar në përputhje me nenin 119; dhe
 - c. shkeljet e pragjeve të lidhjes së shkurtër të sistemit të transmetimit.
2. Kur OST zbulon një kufizim të mundshëm, ajo do të dizajnojë veprime përmirësuese në përputhje me nenet 101 deri 104. Nëse veprimet përmirësuese pa kosto nuk janë të disponueshme dhe kufizimi lidhet me mos disponueshmërinë e planifikuar të disa aseteve përkatëse, atëherë kufizimi përbën një pa-pajtueshmëri të planifikimit të ndërprerjeve, dhe OST do të iniciojë koordinimin e ndërprerjeve në përputhje me nenin 173 ose 178 në varësi të kohës së vitit kur ky veprim është iniciuar.

Neni 155. Analiza e sigurisë operationale për ditën përpara, brenda ditës dhe në afërsi të kohës reale

1. OST do të kryejë analiza të sigurisë operationale për ditën përpara, brenda ditës dhe në afërsi të kohës reale për të zbuluar kufizimet e mundshme dhe për të përgatitur dhe aktivizuar veprimet përmirësuese me çdo OST tjetër përkatëse dhe, nëse është rasti, me OSSH-në ose SGU-të e ndikuara.
2. OST do të monitorojë parashikimet e ngarkesës dhe gjenerimit. Kur këto parashikime tregojnë një devijim të rëndësishëm në ngarkesë ose gjenerim, OST duhet të përditësojë analizën operationale të sigurisë.
3. Gjatë kryerjes së analizës së sigurisë operationale në kohë reale në zonën e saj të vëzhgimit, OST do të përdorë funksionin e vlerësimit të situatës, pjese e EMS/SCADA.

Neni 156. Metodologjia për koordinimin e analizës operationale të sigurisë

1. Të gjitha OST-të e ENTSO-E së bashku, kanë zhvilluar metodologjinë për koordinimin e analizës së sigurisë operationale.
2. Kjo metodologji është aprovuar nga ERE, Vendimi ERE Nr. 32 Datë 28.02.2019.

Neni 157. Koordinimi rajonal i sigurisë operationale

3. OST do t'i sigurojë koordinatorit rajonal të sigurisë të gjitha informacionet dhe të dhënat e nevojshme për të kryer vlerësimin e koordinuar rajonal të sigurisë operative, duke përfshirë së paku:
 - a. listën e përditësuar të kontingjencave, të krijuar sipas kriterëve të përcaktuara në metodologjinë për koordinimin e analizave operationale të sigurisë të miratuara në përputhje me nenin 156;
 - b. listën e azhurnuar të veprimeve të mundshme përmirësuese, midis kategorive të renditura në nenin 103 dhe kostove të pritura të tyre të parashikuara në përputhje me nenin 35 të Rregullores (EU) 2015/1222⁹ nëse një veprim përmirësues përfshin redispecim ose kunder-tregim, që synon të kontribuojë në lehtësimin e çdo pengese të identifikuar në rajon; dhe
 - c. kufijtë e sigurisë operationale të përcaktuara në përputhje me nenin 106.
4. Kur OST pranon nga koordinatori përkatës i sigurisë rajonale rezultatet e vlerësimit të koordinuar rajonal të sigurisë operative me një propozim për një veprim përmirësues, OST do të vlerësojë veprimin e rekomanduar për elementet e përfshirë në atë veprim të vendosur në zonën e tij të kontrollit. OST do të vendosë nëse do të zbatojë veprimin e rekomanduar përmirësues. Kur vendos të mos zbatojë veprimin e rekomanduar përmirësues, OST duhet të japë një shpjegim për këtë vendim në RSC. Kur OST vendos të zbatojë veprimin e rekomanduar, do të zbatojë këtë veprim për elementet e vendosura në zonën e tij të kontrollit, duke siguruar që të jetë në përputhje me konditat në kohë reale.

Neni 158. Koordinimi rajonal i ndërprerjeve

1. OST do t'i sigurojë koordinatorit rajonal të sigurisë informacionin e nevojshëm për zbulimin dhe zgjidhjen e papajtueshmërive të planifikimit të ndërprerjeve rajonale, duke përfshirë së paku:
 - a. planet e disponueshmërisë të aseteve të saj të brendshme relevante, të ruajtura në mjedisin e të dhënave të planifikimit operativ të ENTSO-E;
 - b. planet më të fundit të disponueshmërisë për të gjitha asetet jo relevante të zonës së saj të kontrollit të cilat janë:
 - i. të afta të ndikojnë në rezultatet e analizës së papajtueshmërisë së planifikimit të ndërprerjeve;
 - ii. modeluar në modelet e rrjetit individual të cilat përdoren për vlerësimin e papërshtatshmërisë së ndërprerjeve;

⁹ Commission Regulation (Eu) 2015/1222 Of 24 July 2015 Establishing A Guideline On Capacity Allocation And Congestion Management

- c. skenarët mbi të cilat papajtueshmëritë e planifikimit të ndërprerjeve duhet të hetohen dhe përdoren për të ndërtuar modelet përkatëse të rrjetit të përbashkët që rrjedhin nga modelet e rrjetit të përbashkët për korniza kohore të ndryshme të përcaktuara në përputhje me nenin 148.
2. RSC do të kryejë analiza rajonale të sigurisë operationale në bazë të informacionit të dhënë nga OST-të përkatëse me qëllim që të zbulojë ndonjë papajtueshmëri të planifikimit të ndërprerjeve. Ai do të sigurojë të gjitha OST-të e rajonit të koordinimit të ndërprerjeve me një listë të papajtueshmërive të planifikuara të ndërprerjeve të zbuluara dhe zgjidhjet që propozon për të zgjidhur ato mosplotësime të planifikimit të ndërprerjeve.

Neni 159. Vlerësimi i përshtatshmërisë rajonale

1. RSC do të kryejë vlerësime rajonale të mjaftueshmërisë për të paktën afatin kohor të javës përpara.
2. OST do t'i sigurojë koordinitorit rajonal të sigurisë informacionin e nevojshëm për të kryer vlerësimet rajonale të mjaftueshmërisë të referuara në paragrafin 1, duke përfshirë:
 - a. ngarkesën totale të pritshme dhe burimet në dispozicion të menaxhimit të ngarkesës;
 - b. disponueshmëria e moduleve të prodhimit të energjisë; dhe
 - c. kufijtë e sigurisë operationale.

Titulli 3 – Koordinimi i ndërprerjeve

Kapitulli 1 – Rajonet e koordinimit të ndërprerjeve, asetet relevante

Neni 160. Objektivi i koordinimit të ndërprerjeve

1. OST me mbështetjen e koordinitorit rajonal të sigurisë për rastet e specifikuar në këtë kod, kryen koordinimin e ndërprerjeve në përputhje me parimet e këtij Titulli me qëllim të monitorimit të statusit të disponueshmërisë së aseteve përkatëse dhe koordinimin e planeve të disponueshmërisë për të ruajtur sigurinë operationale të sistemit të transmetimit.

Neni 161. Koordinimi rajonal

1. OST është pjesë e rajonit të koordinimit të ndërprerjeve të Evropës Juglindore, dhe zbaton procedurat operationale të koordinimit rajonal të aprovuara nga ENTSO-E;
2. Procedura e koordinimit rajonal synon vendosjen e aspekteve operationale për zbatimin e ndërprerjeve të koordinuara në çdo rajon, e cila përfshin:
 - a. periodicitetin, fushë-veprimin dhe tipin e koordinimit, i cili do të zhvillohet të paktën për periudhën kohore të vitit në avancë dhe javës në avancë;

- b. dispozitat në lidhje me përdorimin e vlerësimeve të kryera nga koordinatori i sigurisë rajonale në përputhje me nenin 158;
 - c. rregullime praktike për vlefshmërinë e planeve të disponueshmërisë së elementeve të rrjetit për vitin në avancë, siç kërkohet në nenin 176.
3. OST do t'u sigurojë OST-ve të tjera nga i njëjti rajon i koordinimit të ndërprerjeve, të gjitha informacionet e rëndësishme në dispozicion të tij për projektet e infrastrukturës, të lidhura me sistemin e transmetimit, sistemin e shpërndarjes, modulet e gjenerimit të energjisë, ose objektet e ngarkesës që mund të kenë ndikim në funksionimin e zonës së kontrollit të një OST tjetër brenda rajonit të koordinimit të ndërprerjeve.

Neni 162. Metodologjia për vlerësimin e rëndësisë së aseteve për koordinimin e ndërprerjeve

1. OST do të aplikojë metodologjinë e standardizuar të ENTSO-E për zonën sinkrone për vlerësimin e njësive gjeneruese kryesore, objektet e ngarkesës dhe elementet e rrjetit që gjenden në sistemin e transmetimit ose të shpërndarjes, për procesin e koordinuar të ndërprerjeve;
2. Metodologjia referuar në pikën e mësipërme përfshin procedurën e përcaktimit të masës së ndikimit në statusin e disponueshmërisë të njësisë gjeneruese, objekteve të ngarkesës dhe elementëve të rrjetit në zonën e përgjegjësisë të OST-ve pjesëmarrëse në procesin e koordinimit të ndërprerjeve. Kjo procedurë do të bazohet në:
 - a. Analizat e sigurisë operative që përdorin modele rrjeti të përbashkëta të përcaktuara;
 - b. Analiza e ndjeshmërisë së flukseve nëpërmjet rrjetit të interkonektuar; dhe
 - c. Një prag për analizën e ndjeshmërisë së flukseve, të standardizuara për zonën sinkrone evropiane.

Neni 163. Lista e moduleve gjeneruese dhe objekteve konsumatorë të rëndësishëm

1. Bazuar në metodologjinë referuar në nenin e mësipërm, të gjitha OST-të e rajonit të koordinimit të ndërprerjeve, vlerësojnë së bashku rëndësinë e moduleve gjeneruese dhe objekteve konsumatore për koordinimin e ndërprerjeve dhe përcaktojnë për rajonin e koordinimit të ndërprerjeve një listë të vetme të këtyre moduleve gjeneruese dhe objekteve konsumatore të rëndësishme.
2. Të gjitha OST-të e rajonit të koordinimit të ndërprerjeve, së bashku, do të vënë në dispozicion të platformës së të dhënave të planifikimit operativ të ENTSO-E, listën e moduleve gjeneruese dhe objekteve konsumatore të rëndësishme të rajonit të koordinimit të ndërprerjeve.
3. OST duhet të njoftojë ERE për listën e moduleve gjeneruese dhe objekteve konsumatore të rëndësishme për rajonin e koordinimit të ndërprerjeve ku merr pjesë.
4. Për çdo aset të brendshëm të rëndësishëm, i cili është modul gjenerues ose objekt konsumator, OST duhet të:

- a. informojë pronarin e modulit gjenerues ose objektit konsumator të rëndësishëm për përfshirjen e tyre në listë;
- b. informojë OSSH mbi modulet gjeneruese dhe objektet konsumatore të rëndësishme të lidhur në rrjetin e shpërndarjes;
- c. informojë OSMSH për modulet gjeneruese dhe objektet konsumatore të rëndësishme të lidhur në sistemin e mbyllur të shpërndarjes.

Neni 164. Përditësimi i listave të moduleve gjeneruese dhe objekteve konsumatorë të rëndësishme.

1. Para 1 korrikut të çdo viti kalendarik, të gjitha OST-të e rajonit të koordinimit të ndërprerjeve do të ri-vlerësojnë së bashku rëndësinë e moduleve gjeneruese dhe objekteve konsumatore për koordinimin e ndërprerjeve bazuar në metodologjinë e hartuar në përputhje me nenin 162 (1).
2. Kur është e nevojshme, përpara datës 1 gusht të çdo viti kalendarik, të gjitha OST-të e rajonit të koordinimit të ndërprerjeve, së bashku do të vendosin të përditësojnë listën e moduleve gjeneruese të rëndësishme dhe objekteve konsumatore të rëndësishme, të rajonit të koordinimit të ndërprerjeve.
3. Të gjitha OST-të e rajonit të koordinimit të ndërprerjeve do të vënë në dispozicion të platformës së të dhënave të planifikimit operativ të ENTSO-E, listën e përditësuar të moduleve gjeneruese dhe objekteve konsumatore të rëndësishme të rajonit të koordinimit të ndërprerjeve.
4. OST duhet të informojë palët e përmendura në nenin 163 (4) për përmbajtjen e listës së përditësuar.

Neni 165. Lista e elementeve të rëndësishëm të rrjetit

1. Bazuar në metodologjinë referuar në nenin 162 (1), të gjitha OST-të e rajonit të koordinimit të ndërprerjeve, vlerësojnë së bashku rëndësinë e elementëve të rrjetit në sistemin e transmetimit ose në sistemin e shpërndarjes, përfshirë sistemin e mbyllur të shpërndarjes dhe hartojnë një listë të vetme të elementeve të rëndësishëm të rrjetit për rajonin e koordinimit të ndërprerjeve.
2. Lista e elementeve të rëndësishëm të rrjetit të rajonit të koordinimit të ndërprerjeve duhet të përmbajë të gjithë elementët e rrjetit të sistemit të transmetimit ose sistemit të shpërndarjes, duke përfshirë sistemin e mbyllur të shpërndarjes në rajonin e koordinimit të ndërprerjeve, të cilët identifikohen si të rëndësishëm nga zbatimi i metodologjisë së hartuar në përputhje me nenin 162 (1).
3. Të gjitha OST-të e rajonit të koordinimit të ndërprerjeve do të vënë në dispozicion të platformës së të dhënave të planifikimit operativ të ENTSO-E, listën e përditësuar të elementëve të rëndësishëm të rrjetit të rajonit të koordinimit të ndërprerjeve.
4. OST duhet të informojë ERE për listën e elementeve të rëndësishëm të rrjetit.

5. Për çdo aset të rëndësishëm, i cili është element i rrjetit, OST duhet të:
 - a. informoje pronarin e elementit të rëndësishëm të rrjetit për përfshirjen e tij në liste;
 - b. informojë OSSH mbi elementet e rëndësishëm të rrjetit të lidhur në rrjetin e shpërndarjes;
 - c. informojë OSMSH për elementet e rëndësishëm të rrjetit të lidhur në sistemin e mbyllur të shpërndarjes.

Neni 166. Përditësimi i listës së elementëve të rëndësishëm të rrjetit

1. Para 1 korrikut të çdo viti kalendarik, të gjitha OST-të e rajonit të koordinimit të ndërprerjeve, do të rivlerësojnë së bashku, bazuar në metodologjinë e hartuar në përputhje me nenin 162 (1), rëndësinë për koordinimin e ndërprerjeve të elementëve të sistemit të transmetimit ose në sistemin e shpërndarjes, duke përfshirë edhe sistemin e mbyllur të shpërndarjes.
2. Kur është e nevojshme, përpara 1 gushtit të çdo viti kalendarik, të gjitha OST-të e rajonit të koordinimit të ndërprerjeve, do të vendosin së bashku të përditësojnë listën e elementëve të rëndësishëm të rrjetit të rajonit të koordinimit të ndërprerjeve.
3. Të gjitha OST-të e rajonit të koordinimit të ndërprerjeve do të vënë në dispozicion të platformës së të dhënave të planifikimit operativ të ENTSO-E, listën e përditësuar.
4. OST duhet të informojë palët e përmendura në nenin 163 (4) për përmbajtjen e listës së përditësuar.

Neni 167. Caktimi i agjenteve të ndërprerjeve

1. OST vepron si agjent i planifikimit të ndërprerjeve për çdo element të rëndësishëm të sistemit që ai operon.
2. Për çdo aset tjetër të rëndësishëm, pronari do të caktojë, ose do të veprojë si agjent i planifikimit të ndërprerjeve për asetet e rëndësishme përkatëse si dhe do të informojë OST-në për këtë emërim.

Neni 168. Trajtimi i aseteve të rëndësishme të sistemit të shpërndarjes ose sistemit të mbyllur të shpërndarjes

1. OST do të koordinojë me OSSH planifikimin e ndërprerjeve të aseteve të brendshme të rëndësishme të lidhura në sistemin e shpërndarjes.
2. OST do të koordinojë me OSMSH planifikimin e ndërprerjeve të aseteve të brendshme të rëndësishme të lidhura në sistemin e mbyllur të shpërndarjes.

Kapitulli 2 – Hartimi dhe përditësimi i planeve të disponueshmërisë së asetëve të rëndësishme Neni 169. Ndryshimet në afatet për koordinimin vjetor të ndërprerjeve

1. Të gjitha OST-të brenda një zone sinkrone mund të bien dakord bashkërisht për të miratuar dhe zbatuar një kornizë kohore për koordinimin e ndërprerjeve të vitit në avancë që ndryshon nga afati kohor i përcaktuar në nenet 172, 175 dhe 177, me kusht që te mos ndikohet në koordinimin e ndërprerjeve të zonave të tjera sinkrone.

Neni 170. Dispozita të përgjithshme mbi planet e disponueshmërisë

1. Statusi i disponueshmërisë së një elementi të rëndësishëm të rrjetit do të jetë një nga gjendjet e mëposhtme:
 - a. I disponueshëm: aseti relevant është i aftë dhe i gatshëm për ofrimin e shërbimit edhe nëse është ose jo në operim;
 - b. I pa-disponueshëm: aseti relevant nuk është i aftë dhe i gatshëm për ofrimin e shërbimit;
 - c. Në testim: aftësia e asetit relevant po testohet për ofrimin e shërbimit.
2. Statusi i disponueshmërisë “testim” do të përdoret vetëm nëse ka ndikim të rëndësishëm në sistemin e transmetimit dhe do të kufizohet në kohë:
 - a. ndërmjet lidhjes fillestare dhe komisionimit final të asetit relevant; dhe
 - b. menjëherë pas periudhës së mirëmbajtjes së asetit relevant.
3. Planet e disponueshmërisë do të përmbajnë së paku informacionin e mëposhtëm:
 - a. Shkakun për statusin “i padisponueshëm” të asetit të rëndësishëm;
 - b. aty ku identifikohen këto kushte, kushtet që duhet të plotësohen para se të zbatohet statusi 'i padisponueshëm' i një aseti të rëndësishëm në kohë reale;
 - c. Koha e nevojshme për rikthimin e asetit të rëndësishëm në operim kur është e nevojshme me qellim ruajtjen e sigurisë operationale.
4. Statusi i disponueshmërisë për çdo aset të rëndësishëm në horizontin kohor për vitin në avancë do të sigurohet me baze ditore.
5. Për periudhat e kohës kur skedulimi i gjenerimit dhe i konsumit i janë paraqitur OST-së në përputhje me nenin 189, planet e disponueshmërisë do të jenë të detajuara në kohë në përputhje me skedulet e gjenerimit dhe ato të konsumit.

Neni 171. Plani tregues i disponueshmërisë në terma afatgjatë

1. Dy vite para së të fillojë procesi i koordinimit të vitit në avancë, çdo OST do të vlerësojë planin tregues të disponueshmërisë për asetet relevante të brendshme, të siguruara nga agjentët e planifikimit të ndërprerjeve në përputhje me nenet 4, 7 dhe 15 të Rregullores

se BE Nr. 543/2013¹⁰. Nga OST-te do të jepen komentet paraprake duke përfshirë pa-pajtueshmëritë e ndërprerjeve të diktuar, për të gjithë agjentët e planifikimit të ndërprerjeve të ndikuar nga këto pa-pajtueshmëri.

2. OST do të kryejë vlerësimin e planit tregues të disponueshmërisë për asetet e brendshme të përmendura në paragrafin 1, çdo vit, deri në fillimin e procesit të koordinimit të ndërprerjeve të vitit në avancë.

Neni 172. Dhënia e propozimeve të planeve të disponueshmërisë për vitin në avancë.

1. Para 1 gushtit të çdo viti kalendarik, për çdo aset relevant, agjenti përkatës, do të propozojë në OST ose në OSSH një plan disponueshmërie për asetet e tij relevante, për vitin kalendarik pasues.
2. Ndërmjet 1 Gushtit dhe 1 Dhjetorit, të gjithë agjentët e planifikimit të ndërprerjeve, referuar pikës së mësipërme, do të kenë të drejtën të iniciojnë ndryshime në planet e disponueshmërisë të propozuar, duke dërguar kërkesën për ndryshime në OST.
3. OST do të trajtojë kërkesat për ndryshime, pasi të jetë finalizuar procesi i koordinimit të vitit në avancë, në këtë mënyrë:
 - a. duke respektuar radhën me të cilën është bërë kërkesa për ndryshim; dhe
 - b. duke ndjekur një procedurë në pajtim me nenin 178.

Neni 173. Koordinimi i statusit të disponueshmërisë të aseteve relevante për vitin në avancë për të cilin agjenti i koordinimit të ndërprerjeve nuk është OSSH ose OSMSH që merr pjesë në rajonin e koordinimit të ndërprerjeve

1. OST do të vlerësojë, nëse për vitin në avancë, shfaqen pa-pajtueshmëri nga planet e disponueshmërisë në përputhje me nenin 172.
2. Në rastet kur janë zbuluar pa-pajtueshmëri të ndërprerjeve, OST, do të zbatojë procesin e mëposhtëm:
 - a. Do të informojë çdo agjent të ndërprerjeve të planifikuara, për kushtet që duhet të përmbushen për të lehtësuar pa-pajtueshmëritë e ndërprerjeve të zbuluara;
 - b. OST mund të kërkojë që një ose më shumë agjentë të planifikimit të ndërprerjeve të paraqesin një alternativë të planit të disponueshmërisë, që përmbush kushtet e përmendura në pikën (a); dhe
 - c. OST do të përsërisë vlerësimin në pajtim me pikën (1) për të përcaktuar nëse mbeten ende pa-pajtueshmëri të ndërprerjeve.

¹⁰ Commission Regulation (Eu) No 543/2013 Of 14 June 2013 On Submission And Publication Of Data In Electricity Markets And Amending Annex I To Regulation (Ec) No 714/2009 Of The European Parliament And Of The Council

3. Në rastin kur, pas kërkesës së OST-së në përputhje me pikën (b) të paragrafit 2, nuk paraqitet ndonjë plan alternativ disponueshmërie që çliron të gjitha pa-pajtueshmëritë e ndërprerjeve, atëherë OST do të përcaktojë një plan alternativ të disponueshmërisë i cili:
 - a. Do të marrë parasysh ndikimin e raportuar nga agjentët e ndërprerjeve të planifikuara, si dhe OSSH ose OSMSH kur është e rëndësishme;
 - b. Do të kufizojë ndryshimet në planet alternative të disponueshmërisë në atë çfarë është e domosdoshme për të lehtësuar pa-pajtueshmëritë e ndërprerjeve; dhe
 - c. Do të informojë ERE, OSSH dhe OSMSH-të dhe agjentët e prekur të ndërprerjeve, për planin alternativ të disponueshmërisë, përfshirë arsyet që motivuan hartimin e këtij plani, po aq sa dhe impaktin e raportuar nga agjentët e planifikimit të ndërprerjeve.

Neni 174. Koordinimi i statusit të disponueshmërisë të asetëve relevante për vitin në avancë, për të cilin agjenti i planifikimit të ndërprerjeve është OSSH ose OSMSH që merr pjesë në rajonin e koordinimit të ndërprerjeve

1. OST do të koordinojë statusin e disponueshmërisë së elementeve të rëndësishëm të rrjetit që lidhin zonat të ndryshme të kontrollit, për të cilat OST vepron si agjent i koordinimit të ndërprerjeve me OST-të e tjera të të njëjtit rajon të koordinimit të ndërprerjeve.
2. OST, OSSH dhe OSMSH duhet të planifikojnë statusin e disponueshmërisë së elementeve të rëndësishme të rrjetit për të cilët ata kryejnë detyrat e agjentëve të planifikimit të ndërprerjeve dhe që nuk ndërlidhin zona të ndryshme kontrolli, duke përdorur si bazë planet e disponueshmërisë të hartuara në përputhje me paragrafin 1.
3. Kur përcakton statusin e disponueshmërisë së elementeve të rëndësishëm të rrjetit në përputhje me paragrafin 1 dhe 2, OST, OSSH dhe OSMSH do të kryej:
 - a. minimizimin e ndikimit në treg, ndërkohë që ruan sigurinë operative; dhe
 - b. përdor si bazë planet e disponueshmërisë të propozuara për asetet relevante të përcaktuara në pajtim me nenin 172.
4. Kur OST zbulon një papajtueshmëri në planifikimin e ndërprerjeve, ka të drejtën të propozojë një ndryshim në planet e disponueshmërisë të asetëve të brendshme të rëndësishme për të cilat agjenti i planifikimit të ndërprerjeve nuk është OSSH ose OSMSH që merr pjesë në një rajon koordinimi të ndërprerjeve, si dhe do të gjejë një zgjidhje në koordinim me agjentët e planifikimit të ndërprerjeve, OSSH dhe OSMSH, duke përdorur mjetet në dispozicion të tij.
5. Kur pa-disponueshmëria e statusit të disponueshmërisë të elementit relevant të rrjetit, nuk është planifikuar pas marrjes së masave në paragrafin 4, dhe nëse mosplanifikimi i pa-disponueshmërisë së këtij statusi disponibiliteti do të cënonte sigurinë operative, atëherë OST do të:

- a. ndërmarrë veprime të tilla siç ajo e konsideron të nevojshme për të planifikuar këtë pa-disponueshmeri të statusit të disponueshmërisë, duke marrë parasysh ndikimin e raportuar nga agjentet e ndikuar të planifikimit të ndërprerjeve;
 - b. njoftojë për këto veprime të gjitha palët e ndikuara; dhe
 - c. informojë autoritetin rregullator, OSSH ose OSMSH dhe agjentët e planifikimit të ndërprerjeve të prekur nga veprimet e marra, situatën që diktoi ndërmarrjen e këtyre veprimeve dhe arsyetimin për përdorimin e veprimeve të përzgjedhura.
6. OST do të bëjë të disponueshem në portalin e të dhënave të planifikimit operacional të ENTSO-E, të gjithë informacionin në dispozicion për kushte të rrjetit që duhet të përmbushen dhe veprimet përmirësuese që duhet të ndërmerren dhe aktivizohen, para ekzekutimit të statusit” i padisponueshem” ose “testim” i elementit të rëndësishëm të rrjetit.

Neni 175. Dispozita të planit paraprak të disponueshmërisë për vitin në avancë

1. Para 1 Nëntorit të çdo viti kalendarik, OST do të sigurojë planet paraprake të disponueshmërisë për të gjithë asetet relevante të rrjetit për vitin pasues kalendarik, për të gjitha OST-të koordinatorë të ndërprerjeve, nëpërmjet të dhënave të publikuara në portalin e ENTSO-E për të dhënat e planifikimit operativ.
2. Para 1 Nëntorit të çdo viti kalendarik, për çdo aset relevant të lokalizuar në rrjetin e shpërndarjes, OST do t’i sigurojë OSSH-së planin paraprak të disponueshmërisë për vitin në avancë, për çdo aset relevant të lidhur në këtë rrjet.
3. Para 1 Nëntorit të çdo viti kalendarik, për çdo aset relevant të brendshëm të lokalizuar në një rrjet të mbyllur shpërndarje, OST do të sigurojë OSSH-së së mbyllur planin paraprak të disponueshmërisë për vitin në avancë.

Neni 176. Vlefshmëria e planeve të disponueshmërisë për vitin në avancë brenda rajonit të koordinimit të ndërprerjeve

1. OST do të analizojë nëse shfaqen papajtueshmëri në planifikimin e ndërprerjeve duke marrë parasysh të gjitha planet paraprake të disponueshmërisë për vitin në avancë.
2. Në mungesë të papajtueshmërive në planifikimin e ndërprerjeve, të gjithë OST-të e rajonit të koordinimit të ndërprerjeve së bashku do të miratojnë planet e disponueshmërisë për vitin në avancë për të gjithë asetet e rajonit të koordinimit të ndërprerjeve.
3. Nëse OST zbulon një papajtueshmëri në planifikimin e ndërprerjeve, OST-të e përfshira në rajonin e koordinimit të ndërprerjeve së bashku do të gjejnë një zgjidhje në koordinim me agjentët përkatës të planifikimit të ndërprerjeve, OSSH-të dhe OSMSH-të duke përdorur mjetet në dispozicion të tyre, si dhe duke respektuar sa të jetë e mundur planet e disponueshmërisë të paraqitura nga agjentët e planifikimit të ndërprerjeve, të cilët nuk janë as OST, as OSSH ose OSMSH dhe janë hartuar në

- përputhje me nenet 173 dhe 174. Kur gjendet një zgjidhje, të gjitha OST-të në rajonin e koordinimit të ndërprerjeve do të përditësojnë dhe miratojnë planet e disponueshmërisë për vitin në avancë për të gjithë asetet e rëndësishme.
4. Kur nuk gjendet zgjidhje për një papajtueshmëri në planifikimin e ndërprerjeve, nëse parashikohet miratimi nga ERE, OST duhet të:
 - a. imponojë statusin “i disponueshëm” për të gjitha statuset “i padisponueshëm” ose “në testim” për asetet e rëndësishme të përfshira në një papajtueshmëri në planifikimin ndërprerjeve gjatë periudhës në fjalë; dhe
 - b. njoftojë ERE, OSSH ose OSMSH nëse ka, si dhe agjentët e planifikimit të ndërprerjeve për veprimet e ndërmarra, duke përfshirë arsyetimin për veprimet e tilla dhe nëse është e rëndësishme, ndikimin e raportuar nga agjentët e planifikimit të ndërprerjeve, OSSH ose OSMSH.
 5. Të gjithë OST-të e rajoni të koordinimit të ndërprerjeve do të përditësojnë dhe miratojnë planin e disponueshmërisë për vitin në avancë për të gjithë asetet e rëndësishme.

Neni 177. Planet finale të disponueshmërisë së vitit në avancë

1. Përpara 1 dhjetorit të çdo viti kalendarik, OST do të:
 - a. finalizojë planet e disponueshmërisë për vitin në avancë për asetet e brendshme relevante dhe do ta transmetojë atë në portalin e të dhënave të planifikimit operacional të ENTSO-E;
 - b. përditësojë planin paraprak të disponueshmërisë për vitin në avancë, të aseteve relevante, në portalin e të dhënave të planifikimit operacional të ENTSO-E.
2. Para 1 Dhjetorit të çdo viti kalendarik, OST do t’i konfirmojë agjentit të planifikimit të ndërprerjeve (RSC), planin e disponueshmërisë për vitin në avancë, për çdo aset të brendshëm relevant.
3. Para 1 Dhjetorit të çdo viti kalendarik, për çdo aset relevant që gjendet në rrjetin e shpërndarjes, OST do t’i sigurojë OSSH-së planin e përditësuar të disponueshmërisë për vitin në avancë.
4. Para 1 dhjetorit të çdo viti kalendarik, për çdo aset relevant që gjendet në rrjetin e mbyllur të shpërndarjes, OST do t’i sigurojë OSMSH-së, planin e përditësuar të disponueshmërisë për vitin në avancë.

Neni 178. Përditësimet e planeve finale të disponueshmërisë për vitin në avancë

1. Pas përfundimit të procesit të koordinimit dhe para ekzekutimit në kohë reale, agjentet e planifikimit të ndërprerjeve do të kenë të drejtë të iniciojnë një përshtatje të planit të disponueshmërisë të koordinuar për vitin në avancë.

2. Agjenti i planifikimit të ndërprerjeve, i cili nuk merr pjesë në një rajon të koordinimit të ndërprerjeve, mund t'i paraqesë OST-së një kërkesë për ndryshimin e planit të disponueshmërisë për vitin në avancë të aseteve relevante, nën përgjegjësinë e tij.
3. Në rast të një kërkesë për ndryshim në përputhje me paragrafin 2, do të zbatohet procedura e mëposhtme:
 - a. OST pranon kërkesën dhe vlerëson sa më shpejt që është e mundur nëse ndryshimi çon në papajtueshmëri në planifikimin e ndërprerjeve;
 - b. në rastin e zbulimit të pa-pajtueshmërive të ndërprerjeve, OST në bashkëpunim me RSC do të gjejnë një zgjidhje në koordinim me agjentët e planifikimit të ndërprerjeve në fjalë dhe nëse është e rëndësishme përfshijnë OSSH-në dhe OSMSH-te duke përdorur mjetet në dispozicion të tyre.
 - c. në rastin kur nuk është konstatuar ndonjë papajtueshmëri në planifikimin e ndërprerjeve, OST do të pranojë ndryshimin e kërkuar dhe do të përditësojë planin e disponueshmërisë së vitit në avancë në portalin e të dhënave të planifikimit operativ të ENTSO-E; dhe
 - d. nëse nuk gjendet asnjë zgjidhje për papajtueshmërinë e planit të ndërprerjeve, OST refuzon kërkesën për ndryshim.
4. Kur ndryshimi kërkohet nga një agjent që merr pjesë në rajonin e koordinimit të ndërprerjeve, OST do të iniciojë procedurën e mëposhtme:
 - a. do të përgatisë një propozim për ndryshimin e planit të disponueshmërisë të vitit në avancë, duke përfshirë vlerësimin nëse ai mund të çojë në papajtueshmëri në planifikimin e ndërprerjeve dhe duhet të paraqesë propozimin e tij RSC dhe të gjitha OST-të e tjera të rajonit të koordinimit të ndërprerjeve;
 - b. në rastin e zbulimit të pa-pajtueshmërive të ndërprerjeve, OST-te e përfshira të rajonit të koordinimit të ndërprerjeve, së bashku me RSC do të gjejnë një zgjidhje në koordinim me agjentët e planifikimit të ndërprerjeve në fjalë duke përdorur mjetet në dispozicion të tyre;
 - c. në rastin kur nuk është konstatuar ndonjë papajtueshmëri në planifikimin e ndërprerjeve, OST-te respektive do të pranojnë ndryshimin e kërkuar dhe për rrjedhojë do të njoftojnë të gjitha palët e prekura dhe do të përditësojnë planin final të disponueshmërisë së vitit në avancë në portalin e të dhënave të planifikimit operativ të ENTSO-E; dhe
 - d. në rastet kur nuk gjendet zgjidhje për papajtueshmërinë në planifikimin e ndërprerjeve, OST-ja kërkuese do të tërheqë procedurën për ndryshim.

Kapitulli 3 – Ekzekutimi i planeve të disponueshmërisë

Neni 179. Menaxhimi i statusit “testim” të aseteve të rëndësishme

1. Agjenti i planifikimit të ndërprerjeve të asetit relevant për të cilin është deklaruar statusi i disponueshmërisë ‘testim’, do t’i sigurojë OST-së dhe OSSH-së përfshirë OSSH-të e

mbyllura, nëse aseti relevant është i lidhur me rrjetin e shpërndarjes, sa më shpejt të jetë e mundur, dhe jo më vonë së një muaj para fillimit të testit, informacionin me:

- a. një plan testimi të detajuar;
 - b. një skedulim të gjenerimit ose konsumit në varësi të asetit relevant; dhe
 - c. ndryshimet në topologjinë e sistemit të transmetimit ose të rrjetit të shpërndarjes nëse aseti relevant në fjalë është element relevant i rrjetit.
2. Agjentet e planifikimit të ndërprerjeve duhet të përditësojnë informacionin e përmendur në paragrafin 1 menjëherë pasi të jenë subjekt i ndonjë ndryshimi.
 3. OST e një aseti relevant për të cilin është deklaruar statusi i disponueshmërisë ‘testim’, do t’i sigurojë të gjitha OST-ve te rajonit te koordinimit te ndërprerjeve, me kërkesën e tyre, te dhënat dhe informacionin e kërkuar në pikën (1).
 4. Në rast se aseti relevant referuar paragrafit (1) është element relevant i rrjetit që lidh dy zona përgjegjësie, OST-të përkatëse të dy zonave të përgjegjësisë do të koordinojnë me qëllim sigurimin e informacionit në përputhje me paragrafin (1).

Neni 180. Procedura për trajtimin e ndërprerjeve të detyruara

1. OST do të hartojë një procedurë për të adresuar rastet kur një ndërprerje e detyruar rrezikon sigurinë e saj operacionale. Procedura do të lejojë OST të sigurojë që statusi i disponueshmërisë ‘në dispozicion ose jo’ për asetet relevante ose asetet e tjera të saj në zonën e saj të përgjegjësisë, mund të ndryshohet respektivisht në “i padisponueshem” ose “i disponueshëm”.
2. OST do të ndjekë procedurën e përmendur në paragrafin 1 vetëm kur nuk arrihet marrëveshje me agjentët e planifikimit të ndërprerjeve në lidhje me zgjidhjet për ndërprerjet e detyrueshme. OST do të njoftojë autoritetin rregullator në përputhje me rrethanat.
3. Kur ndërmerret një procedurë, OST duhet të respektojë, deri në masën e mundshme, kufijtë teknike të aseteve përkatëse.
4. Agjenti i planifikimit të ndërprerjeve duhet të njoftojë OST-në për ndërprerjen e detyrueshme të një ose më shumë aseteve relevante të saj dhe OSSH ose OSMSH nëse asetet janë të lidhur me sistemin e shpërndarjes ose me një sistem të mbyllur të shpërndarjes sa më shpejt që të jetë e mundur, menjëherë pas ndërprerjes së detyruar.
5. Kur njofton ndërprerjen e detyruar, agjenti i planifikimit të ndërprerjeve duhet të japë informacionin e mëposhtëm:
 - a. shkakun e ndërprerjes së detyruar;
 - b. kohëzgjatjen e pritshme të ndërprerjes së detyruar; dhe

- c. nëse mundet, ndikimin e ndërprerjes së detyruar në statusin e disponueshmërisë të aseteve relevante nën përgjegjësinë e tij.
6. Kurdo që OST dikton që një ose disa ndërprerje të detyruara të përmendura në paragrafin 1, kanë potencial të çojnë sistemin e transmetimit jashtë gjendjes normale, OST do të informojë agjentin përkatës për kohën maksimale të mundshme, në të cilën siguria operative mund të mbahet pa asetin e shkyçur dhe rikthimit të tij në statusin ‘i disponueshëm’. Agjenti i asetit përkatës do të informojë OST-në për mundësinë e respektimit të kohës së dhënë, ose pa-mundësinë dhe justifikimin për devijimin nga kjo kohë.
7. Pas të gjitha përditësimeve në planin e disponueshmërisë për shkak të ndërprerjeve të detyruara, dhe në përputhje me kohën e përcaktuar në neni 7, 10 dhe 15 të Rregullores së BE Nr. 543/2013, OST do të përditësojë me informacionet më të fundit portalin e të dhënave të planifikimit operativ të ENTSO-E.

Neni 181. Ekzekutimi i planeve të disponueshmërisë në kohë reale

1. Çdo pronar i njësive gjeneruese do të sigurojë që njësitë gjeneruese relevante nën përgjegjësinë e tij, të cilat janë deklaruar ‘të disponueshme’ janë gati të prodhojnë energji në përputhje me kapacitet teknike të tyre kur nevojiten për mbajtjen e sigurisë operative, përveç rasteve të ndërprerjeve të detyruara.
2. Çdo pronar i njësive gjeneruese do të sigurojë që njësitë gjeneruese relevante nën përgjegjësinë e tij, të cilat janë deklaruar ‘të pa-disponueshme’, nuk prodhojnë energji.
3. Çdo pronar objekti ngarkese do të sigurojë që të gjitha objektet e ngarkesës nën përgjegjësinë e tij, të cilat janë deklaruar ‘të pa-disponueshme’ nuk konsumojnë energji elektrike.
4. Çdo pronar i elementeve relevante të rrjetit, do të sigurojë që të gjithë elementet e rrjetit nën përgjegjësinë e tij, që janë të deklaruar ‘të disponueshme’, janë të gatshëm të transmetojnë energji në përputhje me kapacitetet teknike të deklaruara, kur nevojiten për të mbajtur sigurinë operative, përveç rasteve të ndërprerjeve të detyruara.
5. Çdo pronar i elementeve relevante të rrjetit, do të sigurojë që të gjithë elementet e rrjetit nën përgjegjësinë e tij, që janë të deklaruar ‘të pa-disponueshëm’, nuk transmetojnë energji.
6. Nëse aplikohen kushte të veçanta të rrjetit, për ekzekutim të një statusi ‘pa-disponueshmërie’ ose ‘testim’ të elementit relevant të rrjetit, në pajtim me nenin 174 (6), OST, OSSH ose OSMSH, në varësi të pikës së lidhjes, do të vlerësojnë nëse këto kushte janë përmbushur para ekzekutimit në kohë-reale të stakimit të elementit. Nëse jo, dalja nga puna e elementit nuk ekzekutohet.
7. Kur OST identifikon që ekzekutimi i statusit ‘i padisponueshem’ ose ‘testimi’ i një aseti përkatës çon ose mund të çojë sistemin e transmetimit jashtë gjendjes normale, ai duhet

të udhëzojë pronarin e asetit përkatës kur ai është i lidhur me sistemin e transmetimit, OSSH ose OSMSH të shtyjë ekzekutimin e statusit "i pa-disponueshëm" ose "testim" të atij asetit përkatës sipas udhëzimeve të tij dhe në masën e mundshme, duke respektuar rregullat teknike dhe kufijtë e sigurisë.

Titulli 4 – Mjaftueshmëria

Neni 182. Parashikimi për analizat e mjaftueshmërisë të zonës së kontrollit

1. OST do të vendosë në dispozicion të të gjithë OST-ve të tjera përmes portalit të të dhënave të ENTSO-E mbi planifikimin operacional, çdo parashikim të përdorur për analizat e mjaftueshmërisë të zonës së saj të kontrollit, në përputhje me nenet 183 dhe 185.

Neni 183. Analizat e mjaftueshmërisë të zonës së kontrollit

1. OST do të kryejë analizën e mjaftueshmërisë së zonës së kontrollit duke vlerësuar mundësinë e shumës së gjenerimit brenda zonës së tij të kontrollit dhe aftësive të importit ndërkufitar për të përmbushur ngarkesën totale brenda zonës së saj të kontrollit nën skenarë të ndryshëm operacionalë, duke marrë parasysh nivelin e kërkuar të fuqisë aktive rezervë të përcaktuara në nenet 192 dhe 193.
2. Kur kryen analiza të mjaftueshmërisë së zonës së kontrollit në përputhje me paragrafin 1, OST do të:
 - a. përdorë planet më të fundit të disponueshmërisë dhe të dhënat më të fundit të disponueshme për:
 - i. aftësinë e njësive gjeneruese në përputhje me nenin 124 (5), nenin 126 dhe nenin 132;
 - ii. kapacitetet ndër-kufitare;
 - iii. objektet konsumatore që mund të marrin pjesë në rregullimin e ngarkesës sipas nenit 133 dhe 134;
 - b. marrë në konsideratë kontributin e gjenerimit nga burimet e rinovueshme të energjisë; dhe kërkesën për energji elektrike;
 - c. vlerësoje probabilitetin dhe kohëzgjatjen e mundshme të mungesës së mjaftueshmërisë dhe energjinë e pafurnizuar si rezultat i kësaj mjaftueshmërie.
3. Sa më shpejt të jetë praktikisht e mundur, pas vlerësimit të mungesës së mjaftueshmërisë brenda zonës së saj të kontrollit, OST do të njoftojë autoritetin rregullator, autoritet e varësisë dhe kur është e zbatueshme, çdo palë të prekur.
4. Sa më shpejt që të jetë e mundur, pas analizës së mungesës së mjaftueshmërisë brenda zonës së kontrollit, OST do të informojë të gjitha OST-të nëpërmjet platformës të të dhënave të planifikimit operativ të ENTSO-E.

Neni 184. Mjaftueshmeria e zonës se kontrollit me bazë stinore dhe përfshirë javën në avancë

1. OST do të kontribuojë në vlerësimet vjetore të mjaftueshmërisë së gjenerimit vere dhe dimër në nivel pan-Evropian duke zbatuar metodologjinë e miratuar nga ENTSO-E të përmendur në nenin 8 (3) (f) të Rregullores (KE) Nr. 714/2009.
2. Dy herë në vit, OST do të kryejë një analizë të mjaftueshmërisë së zonës së përgjegjësisë respektivisht për verën dhe dimrin në vijim, duke marrë parasysh skenarët pan-Evropiane në përputhje me parashikimet e mjaftueshmërisë së gjenerimit për verën dhe dimrin e ardhshëm.
3. OST do të përditësojë analizat e mjaftueshmërisë së zonës së përgjegjësisë nëse zbulon ndonjë ndryshim të mundshëm në statusin e disponueshmërisë së moduleve gjeneruese të energjisë, vlerësimet e ngarkesës, vlerësimet e burimeve të energjisë së rinovueshme ose kapacitetet nderzonale që mund të ndikojnë ndjeshëm në mjaftueshmerine e pritshme.

Neni 185. Mjaftueshmëria e zonës së përgjegjësisë në D-1 dhe brenda ditës

1. OST do të kryejë analiza të mjaftueshmërisë në zonën e saj për ditën në avancë dhe brenda ditës, bazuar në:
 - a. Skedulimet e sipas nenit 189;
 - b. Parashikimin e ngarkesës;
 - c. Parashikimin e gjenerimit nga burimet e energjisë së rinovueshme;
 - d. Rezervat e fuqisë aktive në pajtim me të dhënat e siguruar në përputhje me nenin 127(1)(a);
 - e. Kapacitetet e import-eksportit në përputhje me kapacitetet ndërkufitare;
 - f. Aftësitë e njësive gjeneruese në përputhje me të dhënat e siguruar në pajtim me nenet 124 (4), 126, 132 dhe statuseve të tyre të disponueshmërisë; dhe
 - g. Aftësitë e njësive të ngarkesës të menaxhueshme në përputhje me të dhënat e siguruar sipas nenit 133 dhe 134 dhe statuseve të disponueshmërisë të tyre.
2. OST do të vlerësojë:
 - a. nivelin minimal të kapacitetit importues dhe nivelin maksimal të kapacitetit eksportues në përputhje me mjaftueshmërinë e zonës së përgjegjësisë;
 - b. kohëzgjatjen e pritshme të mungesës potenciale të mjaftueshmërisë; dhe
 - c. energjinë e pritshme të pafurnizuar në mungesë të mjaftueshmërisë.
3. Nëse mjaftueshmëria nuk përmbushet në përputhje me analizat referuar pikës (1) të këtij neni, OST do të informojë ERE dhe autoritetet përkatëse duke paraqitur një analizë të shkaqeve të mungesës së mjaftueshmërisë si dhe masat zbutëse të propozuara.

Titulli 5 – Shërbimet ndihmëse

Neni 186. Shërbimet ndihmëse

1. OST do të monitorojë disponueshmërinë e shërbimeve ndihmëse.
2. Në lidhje me shërbimet e energjisë aktive dhe reaktive, dhe në koordinim me OST të tjera, kur është e përshtatshme, OST duhet të:
 - a. dizajnojë dhe menaxhojë prokurimin e shërbimeve ndihmëse;
 - b. monitorojë, në bazë të të dhënave në pajtim me Titullin 2 të Pjesës II, nëse niveli dhe vendndodhja e shërbimeve ndihmëse në dispozicion lejon përmbushjen e sigurisë operationale; dhe
 - c. përdorë të gjitha mjetet e disponueshme ekonomikisht të efektshme dhe të mundshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të shërbimeve ndihmëse.
3. OST do të publikojë nivelet e kapacitetit rezervë të nevojshme për të ruajtur sigurinë operationale.
4. OST do t'i komunikojë nivelin e disponueshëm të rezervave të energjisë aktive, OST-ve të tjera sipas kërkesës.

Neni 187. Shërbimet ndihmëse të fuqisë reaktive

1. OST do të vlerësojë në të gjitha stadet e planifikimit operativ, përkundrejt parashikimeve të veta, nëse burimet e fuqisë reaktive të disponueshme janë të mjaftueshme për të garantuar sigurinë operative të sistemit të transmetimit.
2. Me qëllim rritjen e efikasitetit në operimin e elementëve të sistemit të transmetimit, OST do të monitorojë:
 - a. kapacitetet e disponueshme të fuqisë reaktive të objekteve gjeneruese;
 - b. kapacitetet e disponueshme të fuqisë reaktive të objekteve të ngarkesës të lidhur në sistemin e transmetimit;
 - c. kapacitetet e disponueshme të fuqisë reaktive të OSSH-së;
 - d. pajisjet e disponueshme të lidhura në transmetim të dedikuara për të ofruar fuqi reaktive; dhe
 - e. raportin fuqisë aktive dhe reaktive në ndërfaqen midis sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes.
3. Kur niveli i shërbimeve ndihmëse të fuqisë reaktive nuk është i mjaftueshëm për mbajtjen e sigurisë operative, OST do të:
 - a. informojë OST-të fqinje;
 - b. përgatit dhe aktivizon veprime përmirësuese në përputhje me nenin 104

Titulli 6 – Skedulimi

Neni 188. Krijimi i proceseve të skedulimit

1. Kur krijon një proces skedulimi, OST duhet të marrë parasysh dhe plotësojë aty ku është e nevojshme kushtet operative të metodologjisë së të dhënave të gjenerimit dhe të ngarkesës të hartuar në përputhje me nenin 16 të Rregullores BE 2015/1222.
2. Kur një zonë ofertuese mbulon vetëm një zonë kontrolli, fushëveprimi gjeografik i zonës së skedulimit është i njëjtë me zonën e ofertimit. Kur një zonë kontrolli mbulon disa zona ofertimi, fushëveprimi gjeografik i zonës së skedulimit është i njëjtë me çdo zonë të ofertimit. Kur një zonë ofertuese mbulon disa zona kontrolli, OST-të brenda asaj zone ofertuese mund të vendosin së bashku për të operuar një proces të përbashkët skedulimi, përndryshe, çdo zonë kontrolli brenda asaj zone ofertuese konsiderohet një zonë e veçantë skedulimi.
3. Për çdo objekt gjenerues dhe kërkesë për të cilët zbatohen kërkesat për skedulim në pajtim me kornizën e aplikueshme ligjore rregullatore, pronari/operatori përkatës do të caktojë ose veproje si një agjent skedulimi.
4. Çdo pjesëmarrës tregu dhe agjent tregtar, për të cilët zbatohen kërkesat për skedulim në pajtim me kornizën e aplikueshme ligjore rregullatore, do të veprojnë si (ose caktojë një) agjent skedulimi.
5. OST do të bëjë rregullimet e nevojshme për të përpunuar skedulet e ofruara nga agjentët e skedulimit.
6. Kur një zone skedulimi mbulon më shumë se një zone kontrolli, OST-te përgjegjëse për zonat e kontrollit do të bien dakord se cila OST do të operojë zonën e skedulimit.

Neni 189. Njoftimi i skeduleve brenda zonës së skedulimit

1. Çdo agjent skedulimi brenda zonës së skedulimit, përveç agjentëve të skedulimit të operatorit të bashkimit të tregut, do t'i paraqesin OST-së dhe nëse është e zbatueshme edhe palëve të treta, skedulet e mëposhtme:
 - a. Skedulet e gjenerimit;
 - b. Skedulet e konsumit;
 - c. Skedulet e transaksioneve të brendshme tregtare; dhe
 - d. Skedulet e transaksioneve të jashtme tregtare.
2. Çdo agjent skedulimi i operatorit të bashkimit të tregut ose aty ku zbatohet një palë respektive qëndrore, do t'i paraqesë OST-se që operon zonën e skedulimit të mbuluar nga çiftimi tregut, dhe aty ku zbatohet edhe palëve të treta, skedulimet për:
 - a. Skedulet e transaksioneve të jashtme tregtare, si:

- i. shkëmbime shumëpalëshe ndërmjet zonës së skedulimit dhe një grupi tjetër të zonave të skedulimit; ose
 - ii. shkëmbime dypalëshe ndërmjet zonës së skedulimit dhe një zone tjetër skedulimi;
- b. Skedulet tregtare të brendshme ndërmjet agjentëve të bashkimit të tregut dhe palës qendrore respektive;
 - c. Skedulet tregtare të brendshme ndërmjet agjentëve të bashkimit të tregut dhe agjenteve të tjerë të bashkimit të tregut.

Neni 190. Koherenca e skeduleve

1. OST duhet të kontrollojë nëse gjenerimi, konsumi, skedulet e tregtisë së jashtme dhe skedulet e jashtme të vetë OST-së në zonën e saj, janë shuma të balancuara.
2. Për skedulimet e jashtme të vetat, OST do të dakordojë mbi vlerat e skedulit me OST-të përkatëse (fqinje). Në mungesë të marrëveshjes (rakordimit), do të zbatohet vlera më e ulët.
3. Për shkëmbime bilaterale midis dy zonave të skedulimit, secila OST do të bjerë dakord mbi skedulet e tregtimit komercial të jashtëm me OST-në përkatëse. Në mungesë të një marrëveshjeje për vlerat e skedulit komercial të tregtimit, do të zbatohet vlera më e ulët.
4. Të gjitha OST-të që operojnë zonat e skedulimit do të verifikojnë nëse të gjitha skedulet e jashtme neto të agreguara ndërmjet të gjitha zonave të skedulimit brenda zonës sinkrone janë të balancuara. Nëse ndodh një mospërputhje dhe OST-të nuk pajtohen mbi vlerat e skedulit të jashtëm neto të agreguar, do të zbatohen vlerat më të ulëta.
5. Çdo agjent skedulimi i operatorit të bashkimit të tregut do të ndjekë procesin e përshkruar më lart, dhe do t'i sigurojë OST-ve të inkluduara vlerat e skedulimit të jashtëm komercial tregtar për çdo zonë skedulimi të përfshirë në bashkimin e tregut në formën e skeduleve të jashtme neto, të agreguara.
6. Secili llogaritës i programit të shkëmbimit do t'i ofrojë OST-ve, sipas kërkesës së tyre, vlerat e shkëmbimeve të skeduluara në lidhje me zonat e skedulimit të përfshira në bashkimin e tregut në formën e skedulit të jashtëm neto të agreguar, duke përfshirë shkëmbimet dypalëshe mes dy zonave të skedulimit.

Neni 191. Sigurimi i informacionit për OST-të e tjera

1. Me kërkesë të një OST-je tjetër, OST-së të cilës i kërkohet do të llogarisë dhe japë:
 - a. Skedulet e jashtme neto të agreguara; dhe
 - b. Pozicionin neto të zonës AC, kur zona e skedulimit është e ndërlidhur me zonat e tjera të skedulimit nëpërmjet linjave të transmetimit AC.

2. Kur kërkohen për krijimin e modeleve të përbashkëta, në përputhje me nenin 245_(1), çdo OST që operon në një zonë skedulimi do ti japë informacionin OST-së që e kërkon lidhur me:
 - a. skedulet e gjenerimit; dhe
 - b. skedulet e konsumit.

Pjesa IV – Kontrolli ngarkesë - frekuencë dhe rezervat

Titulli I – Marrëveshjet operationale

Neni 192. Marrëveshjet operationale të zonës sinkrone

1. OST është pjesë e propozimit të përbashkët të OST-ve të zonës sinkrone Evropiane për:
 - a. rregullat e dimensionimit për FCR në përputhje me nenin 222;
 - b. cilësi shtesë të FCR në përputhje me nenin 223 (2);
 - c. parametrat përcaktues të cilësisë së frekuencës dhe parametrat e synuar të cilësisë së frekuencës në përputhje me nenin 199;
 - d. parametrat e synuara të gabimit të kontrollit të rivendosjes të frekuencës për secilin bllok LFC në përputhje me nenin 200;
 - e. metodologjinë për të vlerësuar rrezikun dhe evoluimin e rrezikut të shterimit të FCR të zonës sinkrone në përputhje me nenin 203 (2);
 - f. monitorimin e zonës sinkrone;
 - g. llogaritja e programit të kontrollit nga pozicioni neto i rrjetit AC me një periudhë të përbashkët rampimi për llogaritjen e ACE në përputhje me nenin 206;
 - h. nëse është e aplikueshme, kufizime për produktin e fuqisë aktive të interkonektorëve HVDC ndërmjet zonave sinkrone;
 - i. struktura e LFC-së në përputhje me nenin 208;
 - j. nëse është e aplikueshme, metodologjia për të zvogëluar devijimin e kohës elektrike në përputhje me nenin 241;
 - k. ndarja specifike e përgjegjësiive ndërmjet OST-ve në përputhje me nenin 210;
 - l. procedurat operationale në rast të shterimit të FCR në pajtim me nenin 221 (7);
 - m. procedurat operationale për të reduktuar devijimin e frekuencës së sistemit për të rikthyer gjendjen e sistemit në gjendje normale dhe për të kufizuar rrezikun e hyrjes në gjendje emergjente në përputhje me nenin 221 (10);
 - n. rolet dhe përgjegjësitë e OST-ve për implementimin e një procesi netimi të disbalancave, një proces aktivizimi FRR ndërkufitar ose procesi i aktivizimit të RR-ve ndërkufitare në përputhje me nenin 218 (2);
 - o. kërkesat lidhur me disponueshmërinë, besueshmërinë dhe rezervën shtese të infrastrukturës teknike në përputhje me nenin 220 (2);

- p. rregullat e përbashkëta për operimin në gjendjen normale dhe gjendjen jo normale në përputhje me nenin 221 (6) dhe veprimet e përmendura në nenin 221 (15);
 - q. periudha e aktivizimit minimal që sigurohet nga ofruesit e FCR në përputhje me nenin 225 (10);
 - r. supozimet dhe metodologjitë për një analizë kosto-përfitim në përputhje me nenin 225 (11);
 - s. rolet dhe përgjegjësitë e OST të lidhur me rezervën, OST që merr rezervën dhe OST të ndikuar, sa i përket shkëmbimit të FRR dhe RR të përcaktuar në përputhje me nenin 234 (1);
 - t. rolet dhe përgjegjësitë e OST që ofron aftësinë kontrolluese, OST që merr aftësinë kontrolluese dhe OST e ndikuar, për ndarjen e FRR dhe RR të përcaktuar në përputhje me nenin 235 (1);
 - u. rolet dhe përgjegjësitë e OST të lidhur me rezervën, OST që merr rezervën dhe OST e ndikuar, për shkëmbimin e rezervave ndërmjet zonave sinkrone, dhe OST që ofron aftësinë kontrolluese, OST që merr aftësinë kontrolluese dhe OST e ndikuar, për ndarjen e rezervave midis zonave sinkrone;
2. Për sa më sipër, OST është palë nënshkruese e marrëveshjes operacionale të zonës sinkrone SAFA.

Neni 193. Marrëveshjet operacionale të bllokut LFC

1. Të gjitha OST-të e bllokut LFC do të zhvillojnë propozime të përbashkëta për:
 - a. kur blloku LFC përbëhet nga më shumë se një zonë LFC, parametrat e synuar të FRCE për secilën zonë LFC të përcaktuar në përputhje me nenin 200 (4);
 - b. Monitorimi i bllokut të LFC në përputhje me nenin 204 (1);
 - c. kufizimet në lidhje me rampimin në prodhimin e energjisë aktive;
 - d. alokimi specifik i përgjegjësive ndërmjet OST-ve brenda bllokut të LFC-së në përputhje me nenin 210 (9);
 - e. nëse është e aplikueshme, përcaktimi i OST-së përgjegjës për detyrat në nenin 214 (6);
 - f. kërkesat shtesë për disponueshmërinë, besueshmërinë dhe rezervën shtesë të infrastrukturës teknike të përcaktuar në përputhje me nenin 220 (3);
 - g. procedurat operacionale në rast të shterimit të FRR ose RR në përputhje me nenin 221 (8);
 - h. rregullat e dimensionimit të FRR të përcaktuara në përputhje me nenin 226 (1);
 - i. rregullat e dimensionimit RR të përcaktuara në përputhje me nenin 229 (2);
 - j. ndarja specifike e përgjegjësive të përcaktuara në përputhje me nenin 226 (3) dhe, nëse është e zbatueshme, ndarja specifike e përgjegjësive të përcaktuara në përputhje me nenin 229 (6);

- k. procedurën e përshkallëzimit të përcaktuar në përputhje me nenin 226 (4) dhe, nëse është e zbatueshme, procedurën e përshkallëzimit të përcaktuar në përputhje me nenin 229 (7);
 - l. kërkesat e disponueshmërisë së FRR, kërkesat për cilësinë e kontrollit të përcaktuar në përputhje me nenin 227 (2) dhe nëse është e zbatueshme, kërkesat e disponueshmërisë së RR-së dhe kërkesat për cilësinë e kontrollit të përcaktuar në përputhje me nenin 230 (2);
 - m. nëse është e aplikueshme, çdo kufizim në shkëmbimin e FCR midis zonave LFC të blloqeve LFC të ndryshme brenda zonës sinkrone Evropiane dhe shkëmbimin e FRR ose RR midis zonave LFC të një blloku LFC të një zone sinkrone që përbëhet nga më shumë se një bllok LFC të përcaktuara në përputhje me nenin 232 (2), nenin 236 dhe nenin 238 (2);
 - n. rolet dhe përgjegjësitë e OST të lidhur me rezervën, OST që merr rezervën dhe OST e ndikuar, për shkëmbimin e FRR dhe/ose RR me OST të blloqeve të tjera të LFC të përcaktuara në përputhje me nenin 234 (6);
 - o. rolet dhe përgjegjësitë e OST që ofron aftësinë kontrolluese, OST që merr aftësinë kontrolluese dhe OST e ndikuar, për ndarjen e FRR dhe RR të përcaktuar në përputhje me nenin 235 (7);
 - p. veprimet e koordinuara që synojnë reduktimin e FRCE siç përcaktohet në nenin 221 (14); dhe
 - q. masat për të reduktuar FRCE duke kërkuar ndryshime në prodhimin ose konsumin e energjisë aktive të moduleve gjeneruese të energjisë dhe njësisive konsumatore në përputhje me nenin 221 (16).
2. OST ka nënshkruar marrëveshjen operacionale të bllokut LFC (AK) ndërmjet OST dhe KOSTT (Kosovë).

Neni 194. Marrëveshja e netimit të disbalancave

- 1. Të gjithë OST-të që marrin pjesë në të njëjtin proces të netimit të disbalancave do të krijojnë një marrëveshje për netimin e disbalancave që së paku do të përfshijë rolet dhe përgjegjësitë e OST-ve në përputhje me nenin 218 (3).

Neni 195. Marrëveshja për aktivizimin e FRR ndërkufitare

- 1. Të gjithë OST-të që marrin pjesë në të njëjtin proces të aktivizimit të FRR ndërkufitare do të krijojnë një marrëveshje ndërkufitare të aktivizimit të FRR që duhet të përfshijë të paktën rolet dhe përgjegjësitë e OST-ve në përputhje me nenin 218 (3).

Neni 196. Marrëveshja e aktivizimit të RR ndërkufitare

- 1. Të gjithë OST-të që marrin pjesë në të njëjtin proces të aktivizimit të RR-së ndërkufitare do të krijojnë një marrëveshje të aktivizimit të RR-së ndërkufitare që do të përfshijë të paktën rolet dhe përgjegjësitë e OST-ve në pajtim me nenin 218 (3).

Neni 197. Marrëveshja e ndarjes së rezervës

1. Të gjithë OST-të që marrin pjesë në të njëjtin proces të ndarjes së FCR, FRR ose RR do të krijojnë një marrëveshje ndarjeje që duhet të përfshijë të paktën, në rast të ndarjes së FRR ose RR brenda një zone sinkrone, rolet dhe përgjegjësitë e OST që merr aftësinë e kontrollit, OST që ofron aftësinë e kontrollit dhe OST-ve të prekura në përputhje me nenin 234 (3).

Neni 198. Marrëveshja e shkëmbimit të rezervës

1. Të gjithë OST-të që marrin pjesë në të njëjtin proces të shkëmbimit të FCR, FRR ose RR do të krijojnë një marrëveshje shkëmbimi që përfshin të paktën, në rast të shkëmbimit të FRR ose RR brenda një zone sinkrone, rolet dhe përgjegjësitë e OST ku lidhet rezerva dhe OST që merr rezervën në përputhje me nenin 234 (3).

Titulli 2 – Cilësia e frekuencës

Neni 199. Parametrat përcaktues dhe të synuar të cilësisë së frekuencës

1. Parametrat përcaktues të cilësisë së frekuencës për të gjitha zonat sinkrone do të jenë:
 - a. frekuenca nominale;
 - b. diapazoni i frekuencës standarde;
 - c. devijimi maksimal i menjëhershëm i frekuencës;
 - d. devijimi maksimal i frekuencës në gjendje të qëndrueshme;
 - e. koha për rivendosjen e frekuencës;
 - f. koha e aktivizimit të gjendjes së alarmit.
2. Frekuenca nominale është 50 Hz për të gjitha zonat sinkrone.
3. Vlerat e paracaktuara të parametrave të cilësisë së frekuencës të renditura në paragrafin 1 janë paraqitur në Tabelën 1 të Aneksit III.
4. Parametri i synuar i cilësisë së frekuencës do të jetë numri maksimal i minutave jashtë diapazonit të frekuencës standarde për çdo vit për çdo zonë sinkrone dhe vlerat e tij të paracaktuar për çdo zonë sinkrone janë paraqitur në Tabelën 2 të Aneksit III.
5. Të gjithë OST-të do të përpiqen të jenë pajtueshëm me vlerat për parametrat përcaktues të cilësisë së frekuencës ose për parametrin e synuar të cilësisë së frekuencës. Të gjithë OST-të duhet të verifikojnë përmbushjen e parametrin të synuar të cilësisë së frekuencës të paktën një herë në vit.

Neni 200. Parametrat e synuar të FRCE

1. Të gjitha OST-të e zonës sinkrone duhet të specifikojnë në marrëveshjen e operimit të zonës sinkrone, diapazonin e vlerave të nivelit 1 të FRCE dhe të nivelit 2 të FRCE për çdo bllok LFC, të paktën një herë në vit.
2. Të gjitha OST-të e zonës sinkrone duhet të sigurojnë që diapazoni i vlerave të nivelit 1 dhe nivelit 2 të FRCE të blloqeve LFC të janë proporcionale me rrënjën katrore të shumës të detyrimeve fillestare të FCR të OST-ve që përbëjnë blloqet LFC në përputhje me nenin 222.
3. Të gjithë OST-të e zonës sinkrone do të përpiqen të përmbushin parametrat e mëposhtëm të synuar të FRCE për secilin bllok LFC të zonës sinkrone:
 - a. numri i intervaleve kohore për çdo vit jashtë nivelit 1 të FRCE brenda intervalit kohor të barabartë me kohën për rivendosjen e frekuencës, duhet të jetë më pak së 30% e intervaleve kohore të vitit; dhe
 - b. numri i intervaleve kohore për çdo vit jashtë nivelit 2 të FRCE brenda intervalit kohor të barabartë me kohën për rivendosjen e frekuencës duhet të jetë më pak së 5% e intervaleve kohore të vitit.
4. Të gjithë OST-të e bllokut LFC duhet të specifikojnë në marrëveshjen e operimit të bllokut LFC vlerat e parametrave të synuar të FRCE për secilën zonë LFC.
5. Të gjithë OST-të duhet të verifikojnë, të paktën një herë në vit, se parametrat e synuar të FRCE janë përmbushur.

Neni 201. Procesi i aplikimit të kritereve

1. Procesi i aplikimit të kritereve do të përfshijë:
 - a. mbledhjen e të dhënave të vlerësimit të cilësisë së frekuencës; dhe
 - b. llogaritjen e kritereve të vlerësimit të cilësisë së frekuencës.

Neni 202. Të dhënat e vlerësimit të cilësisë së frekuencës

1. Të dhënat e vlerësimit të cilësisë së frekuencës do të jenë:
 - a. për zonën sinkrone:
 - i. të dhënat e frekuencës të çastit; dhe
 - ii. të dhënat e devijimit të frekuencës të çastit;
 - b. për çdo bllok LFC të zonës sinkrone, të dhënat e çastit të FRCE.
2. Saktësia e matjes së të dhënave të frekuencës së çastit dhe të dhënave të FRCE së çastit, kur matet në Hz, duhet të jetë 1 mHz ose më e saktë.

Neni 203. Kriteret e vlerësimit të cilësisë së frekuencës

1. Kriteret e vlerësimit të cilësisë së frekuencës do të përfshijnë:
 - a. për çdo bllok LFC të zonës sinkrone, gjatë operimit në gjendjen normale ose gjendjen e alarmit në përputhje me nenin 99 (1) dhe (2), në baza mujore:
 - i. për një grup të dhënash që përmban vlerat mesatare të FRCE të bllokut LFC përgjatë intervaleve kohore të barabarta me kohën e rivendosjes së frekuencës:
 - vlerën mesatare,
 - devijimin standard,
 - nivelin në përqindje 1, 5, 10, 90, 95 dhe 99,
 - numrin e intervaleve kohore në të cilat vlera mesatare e FRCE ishte jashtë diapazonit të nivelit 1 të FRCE, duke dalluar FRCE negative dhe pozitive; dhe
 - numrin e intervaleve kohore në të cilat vlera mesatare e FRCE ishte jashtë diapazonit të nivelit 2 të FRCE, duke dalluar FRCE negative dhe pozitive;
 - ii. për një grup të dhënash që përmban vlerat mesatare të FRCE të bllokut LFC përgjatë intervaleve kohore me një gjatësi prej 1 minute: numrin e ngjarjeve në baza mujore për të cilat FRCE ka tejkaluar 60% të kapacitetit rezervë në FRR dhe nuk është rikthyer në 15% të kapacitetit rezervë në FRR brenda kohës së rivendosjes së frekuencës, duke dalluar FRCE negative dhe pozitive;
2. OST është pjesë e metodologjisë të përbashkët për të vlerësuar riskun dhe evoluimin e riskut të shterimit të FCR në zonën sinkrone. Ky vlerësim duhet të kryhet të paktën një herë në vit dhe duhet të bazohet të paktën në të dhënat historike të frekuencës së çast të sistemit për jo më pak së 1 vit. Të gjithë OST-të e zonës sinkrone do të sigurojnë të dhënat e kërkuara për këtë vlerësim.

Neni 204. Monitorimi i bllokut LFC

1. Të gjithë OST-të e një blloku LFC do të caktojnë një OST të atij blloku LFC në marrëveshjen e operimit të bllokut LFC si monitorues i bllokut LFC.
2. Monitoruesi i bllokut LFC duhet të mbledhë të dhënat e vlerësimit të cilësisë së frekuencës për bllokun LFC në përputhje me procesin e aplikimit të kriterëve të përmendura në nenin 201.

3. Çdo OST do t'i ofrojë monitoruesit të bllokut LFC matjet e zonës LFC të nevojshme për mbledhjen e të dhënave të vlerësimit të cilësisë së frekuencës për bllokun LFC.
4. Monitoruesi i bllokut LFC duhet të dorëzojë tek monitoruesi i zonës sinkrone, të dhënat e vlerësimit të cilësisë së frekuencës të bllokut LFC dhe zonave e tij LFC çdo 3 muaj dhe brenda 2 muajve pas përfundimit të periudhës së analizuar.

Neni 205. Informacioni mbi sjelljen e ngarkesës dhe gjenerimit

1. Në përputhje me nenin 121, OST do të ketë të drejtën të kërkojë informacionin e nevojshëm nga përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit për të monitoruar sjelljen e ngarkesës (konsumit) dhe gjenerimit që lidhet me disbalancat. Ky informacion mund të përfshijë:
 - a. tarimin (piken e punës) me kohë të stampuar të fuqisë aktive për operim në kohë reale dhe atë të ardhshëm; dhe
 - b. prodhimin total të fuqisë aktive me kohë të stampuar.

Neni 206. Periudha e rampimit brenda zonës sinkrone

1. Të gjitha OST-të e zonës sinkrone kanë specifikuar në marrëveshjen e operimit të zonës sinkrone një periudhë të përbashkët rampimi të shumatores së skeduleve midis zonave LFC në zonën sinkrone. Llogaritja e programit të kontrollit nga pozicioni neto i zonës AC për llogaritjen e ACE duhet të kryhet me periudhën e përbashkët të rampimit, që është 5 min para dhe pas orës së ndryshimit të programit të shkëmbimit. Periudha e rampimit është 10 min dhe është funksion linear.
2. OST-të e bllokut LFC kanë të drejtë të përcaktojnë në marrëveshjen e operimit të bllokut LFC masat e mëposhtme për të mbështetur përmbushjen e parametrit të synuar të FRCE të bllokut LFC dhe për të lehtësuar devijimet përcaktuese të frekuencës, duke marrë parasysh kufizimet teknologjike të moduleve gjeneruese dhe njërive konsumatore:
 - a. detyrimet për periudhat e rampimit dhe/ose shkallët maksimale të rampimit për modulet gjeneruese dhe/ose njësitë konsumatore;
 - b. detyrimet mbi kohët e fillimit individual të rampimit për modulet gjeneruese dhe/ose njësitë konsumatore brenda bllokut të LFC; dhe
 - c. koordinimi i rampimit midis moduleve gjeneruese, njërive konsumatore dhe konsumit të energjisë aktive brenda bllokut LFC.

Neni 207. Masat lehtësuese

1. Kur vlerat e llogaritura për periudhën e një viti kalendarik në lidhje me parametrat e synuar të cilësisë së frekuencës ose parametrat e synuar të FRCE janë jashtë objektivave të përcaktuar për bllokun LFC, OST-të e bllokut përkatës LFC duhet:

- a. të analizojnë nëse parametrat e synuar të FRCE do të mbeten jashtë objektivave të përcaktuara për bllokun e LFC dhe në rast të një rreziku të justifikuar, të analizojnë shkaqet dhe të zhvillojnë rekomandime; dhe
- b. të zhvillojnë masa lehtësuese për të siguruar që objektivat për bllokun LFC mund të plotësohen në të ardhmen.

Titulli 3 – Struktura e kontrollit ngarkesë – frekuencë

Neni 208. Struktura bazë

1. Të gjithë OST-të e zonës sinkrone Evropiane kanë specifikuar strukturën e kontrollit ngarkesë-frekuencë në marrëveshjen e operimit të zonës sinkrone. OST është përgjegjëse për zbatimin e strukturës së kontrollit ngarkesë-frekuencë në zonën e saj dhe operon në përputhje me të.
2. Struktura e kontrollit ngarkesë-frekuencë në zonën sinkrone do të përfshijë:
 - a. një strukturë të aktivizimit të procesit në përputhje me nenin 209; dhe
 - b. një strukturë të përgjegjësisë së procesit në përputhje me nenin 210.

Neni 209. Struktura e aktivizimit të procesit

1. Struktura e aktivizimit të procesit do të përfshijë:
 - a. një FCP në përputhje me nenin 211;
 - b. një FRP në përputhje me nenin 212; dhe
 - c. një proces kontrolli kohor në përputhje me nenin 241.
2. Struktura e aktivizimit të procesit mund të përfshijë:
 - a. një RRP në përputhje me nenin 213;
 - b. një proces të netimit të disbalancave në përputhje me nenin 215;
 - c. një proces aktivizimit ndërkuftar të FRR në përputhje me nenin 216;
 - d. një proces të aktivizimit ndërkuftar të RR në përputhje me nenin 217.

Neni 210. Struktura e përgjegjësisë së procesit

1. Në specifikimin e strukturës së përgjegjësisë të procesit, OST-të e zonës sinkrone marrin parasysh të paktën kriteret e mëposhtme:
 - a. madhësinë dhe inercinë totale duke përfshirë inercinë sintetike të zonës sinkrone;
 - b. strukturën e rrjetit dhe/ose topologjinë e rrjetit; dhe
 - c. ngarkesën, gjenerimin dhe sjelljen e HVDC.

2. OST-të e zonës sinkrone kanë zhvilluar një propozim të përbashkët lidhur me përcaktimin e blloqeve LFC, të cilat duhet të jenë në përputhje me kërkesat e mëposhtme:
 - a. një zonë monitorimi i korrespondon ose është pjesë e vetëm një zone LFC;
 - b. një zonë LFC i korrespondon ose është pjesë e vetëm një blloku LFC;
 - c. një bllok LFC i korrespondon ose është pjesë e vetëm një zone sinkrone; dhe
 - d. secili element i rrjetit është pjesë e vetëm një zone monitorimi, vetëm një zone LFC dhe vetëm një blloku LFC.
3. OST-të e çdo zone monitorimi duhet të llogarisin dhe monitorojnë në kohë reale shkëmbimin e fuqisë aktive në zonën e monitorimit.
4. OST-të e secilës zonë LFC duhet:
 - a. të monitorojnë vazhdimisht FRCE e zonës LFC;
 - b. të implementojnë dhe të operojnë një FRP për zonën LFC;
 - c. të përpiqen të përmbushin parametrat e synuar të FRCE të zonës LFC siç përcaktohet në nenin 200; dhe
 - d. të kenë të drejtë të implementojnë një ose disa nga proceset e përmendura në nenin 209 (2).
5. OST-të e secilit bllok LFC duhet:
 - a. të përpiqen të përmbushin parametrat e synuar të FRCE të bllokut LFC siç përcaktohet në nenin 206; dhe
 - b. të jenë pajtueshëm me rregullat e dimensionimit të FRR në përputhje me nenin 226 dhe rregullat e dimensionimit RR në përputhje me nenin 229.
6. OST-të e secilit bllok LFC do të specifikojnë në marrëveshjen e operimit të bllokut LFC ndarjen e përgjegjësisë midis OST-ve në bllokun LFC për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në paragrafin 5.
7. Te gjitha OST-te e dy ose më shumë zonave LFC të lidhura nga interkoneksionet do të kenë të drejtë të formojnë një bllok LFC nëse plotësohen kërkesat për bllokun LFC të paraqitur në paragrafin 5.

Neni 211. Procesi i mbajtjes së frekuencës

1. Qëllimi i kontrollit të FCP është stabilizimi i frekuencës së sistemit me anë të aktivizimit të FCR.
2. Karakteristika e përgjithshme për aktivizimin e FCR në zonën sinkrone pasqyron një rënie monotone të aktivizimit FCR si funksion i devijimit të frekuencës.

Neni 212. Procesi i rivendosjes së frekuencës

1. Për zonën sinkrone Evropiane qëllimi i kontrollit të FRP është:
 - a. të rregullojë FRCE drejt zeros brenda kohës së rivendosjes së frekuencës;
 - b. zëvendësimi në mënyrë progresive i FCR së aktivizuar duke aktivizuar FRR në përputhje me nenin 214.
2. FRCE është:
 - a. ACE e një zone LFC, kur ka më shumë se një zonë LFC në zonën sinkrone; ose
 - b. devijimi i frekuencës, kur një zonë LFC korrespondon me bllokun LFC dhe zonën sinkrone.
3. ACE e një zone LFC llogaritet si shuma e produktit të faktorit K të zonës LFC me devijimin e frekuencës Δf , plus diferencën e:
 - a. fluksit total të fuqisë aktive të interkonektorit dhe linjës virtuale; dhe
 - b. programin e kontrollit në përputhje me nenin 206.
4. Kur një zonë LFC përbëhet nga më shumë se një zonë monitorimi, të gjitha OST-të e zonës LFC do të emërojnë një OST në marrëveshjen e operimit të LFC-së përgjegjëse për implementimin dhe operimin e procesit të rivendosjes së frekuencës.

Neni 213. Procesi i zëvendësimit të rezervës

1. Qëllimi i kontrollit të RRP do të jetë të përmbushë të paktën një nga qëllimet e mëposhtme duke aktivizuar RR:
 - a. në mënyrë progresive rivendos FRR e aktivizuar;
 - b. mbështet aktivizimin e FRR;
2. RRP do të operohet nëpërmjet udhëzimeve për aktivizimin manual të RR në mënyrë që të përmbushë objektivin e kontrollit në përputhje me paragrafin 1.

Neni 214. Procesi i rivendosjes automatike dhe manuale të frekuencës

1. Çdo OST e zonës LFC duhet të implementojë një proces të rivendosjes automatike të frekuencës (aFRP) dhe një proces të rivendosjes manuale të frekuencës (mFRP).
2. Nëse një zonë LFC përbëhet nga më shumë se një zonë monitorimi, të gjitha OST-të e zonës LFC do të përcaktojnë një proces për implementimin e një aFRP dhe një mFRP në marrëveshjen e operimit të zonës LFC. Kur një bllok LFC përbëhet nga më shumë se një zonë LFC, të gjitha OST-të e zonave LFC duhet të përcaktojnë një proces për implementimin e një mFRP në marrëveshjen e operimit të bllokut LFC.

3. aFRP do të operohet në një qark të mbyllur ku FRCE është input dhe pika e punës për aktivizimin automatik të FRR është output. Pika e punës për aktivizimin automatik të FRR duhet të llogaritet nga një kontrollues i vetëm i rivendosjes së frekuencës i operuar nga një OST brenda zonës së saj LFC. Kontrolluesi i rivendosjes së frekuencës duhet:
 - a. të jetë një pajisje automatike e kontrollit e projektuar për të zvogëluar FRCE në zero;
 - b. të ketë sjellje proporcionale-integrale;
 - c. të ketë një algoritëm kontrolli, i cili parandalon termin integral të kontrolluesit proporcional-integral nga akumulimi i gabimit të kontrollit dhe mbivendosjen; dhe
 - d. të ketë funksionalitete për mënyra operimi të jashtëzakonshme për gjendjen e alarmit dhe të emergjencës.
4. mFRP do të operohet nëpërmjet udhëzimeve për aktivizimin manual të FRR me qëllim përmbushjen e objektivit të kontrollit në përputhje me nenin 212 (1).
5. Përveç implementimit të aFRP në zonat LFC, të gjithë OST-të e një blloku LFC që përbëhet nga më shumë se një zonë LFC do të kenë të drejtë të caktojnë në marrëveshjen e operimit të bllokut LFC një OST të bllokut LFC për:
 - a. llogaritjen dhe monitorimin e FRCE së gjithë bllokut LFC; dhe
 - b. të marrë parasysh FRCE e të gjithë bllokut LFC për llogaritjen e vlerës së përcaktuar për aktivizimin aFRR në përputhje me nenin 212 (3) përveç FRCE të zonës së tij LFC.

Neni 215. Procesi i netimit të disbalancave

1. Qëllimi i kontrollit të procesit të netimit të disbalancave do të synojë të zvogëlojë veprimet e njëkohshme kundërvepruese të aktivizimit të FRR të zonave të ndryshme pjesëmarrëse LFC me anë të shkëmbimit të fuqisë për netimin e disbalancave.
2. Çdo OST do të ketë të drejtën të implementojë procesin e netimit të disbalancave për zonat LFC në të njëjtin bllok LFC, midis blloqeve të ndryshme LFC ose midis zonave të ndryshme sinkrone, duke lidhur një marrëveshje të netimit të disbalancave.
3. OST-të do të zbatojnë procesin e netimit të disbalancave në mënyrë që mos ndikojë në:
 - a. qëndrueshmërinë e FCP të zonës sinkrone ose zonave sinkrone të përfshira në procesin e netimit të disbalancave;
 - b. qëndrueshmërinë e FRP dhe RRP të secilës zonë LFC të operuar nga OST-të pjesëmarrëse ose të prekura; dhe
 - c. sigurinë e operimit.
4. OST-të duhet të implementojnë shkëmbimin e fuqisë për netimin e disbalancave midis zonave LFC të një zone sinkrone në të paktën një nga mënyrat e mëposhtme:

- a. duke përcaktuar fluksin e fuqisë aktive në një linjë virtuale e cila do të jetë pjesë e llogaritjes së FRCE;
 - b. duke rregulluar flukset e fuqisë aktive në interkonektorët HVDC.
5. OST-të duhet të implementojnë shkëmbimin e fuqisë për netimin e disbalancave të një zone LFC në mënyrë të tillë që të mos tejkalojë sasinë aktuale të aktivizimit të FRR të nevojshme për rregullimin e FRCE së asaj zone LFC në zero pa shkëmbimin e fuqisë për netimin e disbalancave.
 6. Të gjithë OST-të që marrin pjesë në të njëjtin proces të netimit të disbalancave do të sigurojnë që shumatorja e të gjithë shkëmbimeve të fuqisë për netimin e disbalancave të jetë zero.
 7. Procesi i netimit të disbalancave do të përfshijë një mekanizëm rezervë, i cili do të sigurojë që shkëmbimi i fuqisë për netimin e disbalancave të secilës zonë LFC të jetë zero ose të kufizohet në një vlerë për të cilën mund të garantohet siguria e operimit.
 8. Kur një bllok LFC përbëhet nga më shumë se një zonë LFC dhe kapaciteti rezervë në FRR, si dhe kapaciteti rezervë në RR llogaritet në bazë të disbalancave të bllokut LFC, të gjithë OST-të e të njëjtit bllok LFC duhet të implementojnë dhe shkëmbejnë sasinë maksimale të fuqisë për netimin e disbalancave të përcaktuar në paragrafin 6 me zonat e tjera LFC të të njëjtit bllok LFC.
 9. Kur një proces i netimit të disbalancave zbatohet për zonat LFC të cilat nuk janë pjesë e të njëjtit bllok LFC, të gjitha OST-të e blloqeve LFC të përfshira duhet të përmbushin detyrimet në nenin 210 (5) pavarësisht shkëmbimit të fuqisë për netimin e disbalancave.

Neni 216. Procesi i aktivizimit ndërkufitar të FRR

1. Qëllimi i kontrollit të procesit të aktivizimit ndërkufitar të FRR është që t'u mundësojë OST-ve të kryejnë FRP me anë të shkëmbimit të fuqisë për procesin e rivendosjes së frekuencës ndërmjet zonave LFC.
2. Çdo OST ka të drejtë të zbatojë procesin e aktivizimit ndërkufitar të FRR për zonat LFC brenda të njëjtit bllok LFC, midis blloqeve të ndryshme të LFC ose midis zonave të ndryshme sinkrone, duke përmbyllur një marrëveshje të aktivizimit ndërkufitar FRR.
3. OST-të do të zbatojnë procesin e aktivizimit ndërkufitar të FRR në një mënyrë që nuk ndikon:
 - a. qëndrueshmërinë e FCP të zonës sinkrone ose zonave sinkrone të përfshira në procesin e aktivizimit ndërkufitar të FRR;
 - b. qëndrueshmërinë e FRP dhe të RRP së secilës zonë LFC të operuar nga OST-të pjesëmarrëse ose të prekura; dhe
 - c. sigurinë e operimit.

4. OST-të duhet të implementojnë shkëmbimin e energjisë për rivendosjen e frekuencës ndërmjet zonave LFC të të njëjtës zonë sinkrone përmes veprimeve të mëposhtme:
 - a. duke përcaktuar fluksin e fuqisë aktive në një linjë virtuale e cila do të jetë pjesë e llogaritjes së FRCE ku aktivizimi i FRR është i automatizuar;
 - b. rregullimin e programit të kontrollit ose përcaktimi i fluksit të fuqisë aktive në një linjë virtuale midis zonave LFC ku aktivizimi i FRR është manual; ose
 - c. rregullimin e flukseve të fuqisë aktive në interkonektorët HVDC.
5. OST-të duhet të implementojnë shkëmbimin e energjisë për rivendosjen e frekuencës midis zonave LFC të zonave të ndryshme sinkrone duke rregulluar flukset e fuqisë aktive në interkonektorët HVDC.
6. Të gjithë OST-të që marrin pjesë në të njëjtin proces të aktivizimit ndërkufitar të FRR do të sigurojnë që shumatorja e të gjitha shkëmbimeve të fuqisë për rivendosjen e frekuencës është e barabartë me zero.
7. Procesi i aktivizimit ndërkufitar të FRR do të përfshijë një mekanizëm rezervë i cili do të sigurojë që shkëmbimi i fuqisë për rivendosjen e frekuencës së secilës zonë LFC të jetë zero ose do të kufizohet në një vlerë për të cilën mund të garantohet siguria e operimit.

Neni 217. Procesi i aktivizimit ndërkufitar të RR

1. Qëllimi i kontrollit të procesit të aktivizimit ndërkufitar të RR do të synojë që një OST të mundësojë kryerjen e RRP përmes programit të kontrollit midis zonave LFC.
2. Çdo OST ka të drejtë të zbatojë procesin e aktivizimit ndërkufitar të RR për zonat LFC brenda të njëjtit bllok LFC, midis blloqeve të ndryshme LFC ose midis zonave të ndryshme sinkrone, duke përmbyllur një marrëveshje të aktivizimit ndërkufitar të RR.
3. OST-të do të zbatojnë procesin e aktivizimit ndërkufitar të RR në një mënyrë që nuk ndikon në:
 - a. qëndrueshmërinë e FCP të zonës sinkrone ose zonave sinkrone që përfshihen në procesin e aktivizimit ndërkufitar të RR;
 - b. në qëndrueshmërinë e FRP dhe RRP të secilës zonë LFC të operuar nga OST-të pjesëmarrëse ose të prekura; dhe
 - c. sigurinë e operimit.
4. OST-të duhet të zbatojnë programin e kontrollit midis zonave LFC të të njëjtës zonë sinkrone duke kryer të paktën një nga veprimet e mëposhtme:
 - a. përcaktimi i fluksit të fuqisë aktive në një linjë virtuale e cila do të jetë pjesë e llogaritjes së FRCE;

- b. rregullimi i një programi kontrolli; ose
 - c. rregullimi i flukseve të fuqisë aktive në interkonektorët HVDC.
5. OST-të duhet të implementojnë programin e kontrollit midis zonave LFC të zonave të ndryshme sinkrone duke rregulluar flukset e fuqisë aktive në interkonektorët HVDC.
 6. Të gjithë OST-të që marrin pjesë në të njëjtin proces të aktivizimit ndërkuftar të RR do të sigurojnë që shumatorja e të gjitha programeve të kontrollit është e barabartë me zero.
 7. Procesi i aktivizimit ndërkuftar të RR do të përfshijë një mekanizëm rezervë, i cili do të sigurojë që programi i kontrollit të secilës zonë LFC të jetë zero ose të kufizohet në një vlerë për të cilën mund të garantohet siguria e operimit.

Neni 218. Kërkesat e përgjithshme për proceset e kontrollit ndërkuftar

1. Të gjithë OST-të pjesëmarrëse në një shkëmbim ose ndarje të FRR ose RR do të implementojnë një proces të aktivizimit ndërkuftar të FRR ose RR, sipas rastit, në mënyrë të përshtatshme.
2. Të gjitha OST-të e një zone sinkrone do të specifikojnë në marrëveshjen e operimit të zonës sinkrone rolin dhe përgjegjësitë e OST-ve duke implementuar një proces të netimit të disbalancave, një proces të aktivizimit ndërkuftar të FRR ose një proces të aktivizimit ndërkuftar të RR midis zonave LFC të blloqeve të ndryshme LFC ose të zonave të ndryshme sinkrone.
3. Të gjithë OST-të që marrin pjesë në të njëjtin proces të netimit të disbalancave, në të njëjtin proces të aktivizimit ndërkuftar të FRR ose në të njëjtin proces të aktivizimit ndërkuftar në RR, duhet të specifikojnë në marrëveshjet përkatëse, rolet dhe përgjegjësitë e të gjithë OST-ve duke përfshirë:
 - a. sigurimin e të gjitha të dhënave hyrëse të nevojshme për:
 - i. llogaritjen e shkëmbimit të energjisë duke respektuar kufijtë e sigurisë së operimit; dhe
 - ii. kryerjen e analizave të sigurisë së operimit në kohë reale nga OST-të pjesëmarrëse dhe ato të prekura;
 - b. përgjegjësinë e llogaritjes së shkëmbimit të energjisë; dhe
 - c. implementimin e procedurave operative për të siguruar sigurinë e operimit.
4. Pa paragjykuar nenin 215 dhe si pjesë e marrëveshjeve të përmendura në nenet 194, 195 dhe 196, të gjithë OST-të që marrin pjesë në të njëjtin proces të netimit të disbalancave, të aktivizimit ndërkuftar të FRR dhe të aktivizimit ndërkuftar të RR do të kenë të drejtën të specifikojnë një metodë për llogaritjen e shkëmbimit të energjisë. Llogaritja e shkëmbimit të energjisë duhet të lejojë çdo grup të OST-ve që operojnë në zonat LFC ose blloqet LFC të lidhura nga interkoneksionet për të shkëmbyer fuqinë

për netimin e disbalancave, rivendosjen e frekuencës ose rezervës zëvendësuese midis tyre, përpara llogaritjes së një shkëmbimi me OST-të e tjera.

Neni 219. Njoftimi i OST

1. OST-të që synojnë të ushtrojnë të drejtën për të implementuar një proces të netimit të disbalancave, të aktivizimit ndërkufitar të FRR, të aktivizimit ndërkufitar të RR, një shkëmbim rezervash ose një ndarje rezervash, 3 muaj përpara së të ushtrojnë këtë të drejtë, njoftojnë OST-të e tjera të së njëjtës zonës sinkrone për:
 - a. OST-të e përfshira;
 - b. sasinë e pritshme të shkëmbimit të energjisë për shkak të procesit të netimit të disbalancave, procesit të aktivizimit ndërkufitar të FRR ose procesit të aktivizimit ndërkufitar të RR;
 - c. llojin e rezervës dhe sasinë maksimale të shkëmbimit ose ndarjes së rezervave; dhe
 - d. afatin kohor të shkëmbimit ose ndarjes së rezervave.
2. Kur një proces i netimit të disbalancave, një proces i aktivizimit ndërkufitar të FRR ose një proces i aktivizimit ndërkufitar të RR implementohet për zonat LFC që nuk janë pjesë e të njëjtit bllok LFC, secili OST i zonave sinkrone përkatëse ka të drejtë të deklarojë veten si një OST i prekur për të gjithë OST-të e zonës sinkrone bazuar në një analizë të sigurisë së operimit dhe brenda një muaji pas marrjes së njoftimit në përputhje me paragrafin 1.
3. OST e prekur ka të drejtën të:
 - a. kërkojnë sigurimin e vlerave në kohë reale të shkëmbimit të fuqisë për netimin e disbalancave, të shkëmbimit të fuqisë për rivendosjen e frekuencës dhe programit të kontrollit të nevojshëm për analizën e sigurisë së operimit në kohë reale; dhe
 - b. kërkojnë implementimin e një procedure operative që i mundëson OST-së së prekur të caktojë kufizime për shkëmbimin e fuqisë për netimin e disbalancave, për shkëmbimin e fuqisë për rivendosjen e frekuencës si dhe për programin e kontrollit midis zonave LFC bazuar në një analizë të sigurisë së operimit në kohë reale.

Neni 220. Infrastruktura

1. Të gjithë OST-të do të vlerësojnë së çfarë infrastrukture teknike është e nevojshme për implementimin dhe operimin e proceseve të përmendura në nenin 209 dhe konsiderohen kritike në përputhje me planin e sigurisë të përmendur në nenin 107.
2. Të gjithë OST-të e një zone sinkrone do të specifikojnë, në marrëveshjen e operimit të zonës sinkrone, kërkesat minimale për disponueshmërinë, besueshmërinë dhe rezervën shtesë të infrastrukturës teknike të përmendur në paragrafin 1 duke përfshirë:
 - a. saktësinë, rezolucionin, disponueshmërinë dhe rezervën shtesë të matjeve të flukseve të fuqisë aktive dhe linjave virtuale;

- b. disponueshmërinë dhe rezervën shtesë të sistemeve dixhitale të kontrollit;
 - c. disponueshmërinë dhe tejkalimin e infrastrukturës së komunikimit; dhe
 - d. protokollet e komunikimit.
3. Të gjithë OST-të e një blloku LFC mund të përcaktojnë kërkesa shtesë për disponueshmërinë, besueshmërinë dhe rezervën shtesë të infrastrukturës teknike në marrëveshjen e operimit të bllokut LFC.
4. Çdo OST i një zone LFC duhet:
- a. të sigurojë një cilësi dhe disponueshmëri të mjaftueshme të llogaritjes së FRCE;
 - b. të kryejë monitorim cilësor në kohë reale të llogaritjes së FRCE;
 - c. të ndërmarrë veprime në rastin e keq llogaritjes së FRCE; dhe
 - d. të kryejë një monitorim cilësor ex-post të llogaritjes së FRCE duke e krahasuar FRCE me vlerat e referencës të paktën një herë në vit, kur FRCE përcaktohet nga ACE.

Titulli 4 – Operimi i kontrollit ngarkesë-frekuencë

Neni 221. Gjendja e sistemit lidhur me frekuencën e sistemit

1. OST do të operojë zonën e tij të kontrollit me rezerva të mjaftueshme të fuqisë aktive për rritje dhe ulje, që mund të përfshijnë rezervat e ndara ose të shkëmbyera, për të përballuar disbalancat midis kërkesës dhe furnizimit brenda zonës së tij të kontrollit. OST do të kontrollojë FRCE siç përcaktohet në nenin 118 në mënyrë që të arrihet cilësia e kërkuar e frekuencës brenda zonës sinkrone në bashkëpunim me të gjithë OST-të e zonës sinkrone.
2. OST do të monitorojë në kohë reale skedulimet e gjenerimit dhe shkëmbimit, flukset e fuqisë, injektimet dhe tërheqjet në nyje si dhe parametrat e tjerë brenda zonës së tij të kontrollit, të rëndësishme për parashikimin e riskut të devijimit të frekuencës dhe në koordinim me OST-të e tjera të zonës sinkrone duhet të marrë masa për të kufizuar efektet e tyre negative në balancën midis gjenerimit dhe konsumit.
3. Të gjithë OST-të e zonës sinkrone do të specifikojnë një shkëmbim të të dhënave në kohë reale në përputhje me nenin 123 të cilat përfshijnë:
 - a. gjendjen e sistemit të transmetimit në përputhje me nenin 99; dhe
 - b. të dhënat e matjes në kohë reale të FRCE së blloqeve LFC dhe zonave LFC të zonës sinkrone.
4. Monitoruesi i zonës sinkrone do të sigurojë që të gjithë OST-të të informohen në rast se devijimi i frekuencës së sistemit përmbush një nga kriteret për gjendjen e alarmit të përmendur në nenin 99.

5. Të gjithë OST-të e zonës sinkrone do të përcaktojnë në marrëveshjen e operimit të zonës sinkrone rregullat e përbashkëta për operimin e kontrollit ngarkesë-frekuencë në gjendjen normale dhe gjendjen e alarmit.
6. Të gjithë OST-të e një blloku LFC duhet të specifikojnë procedurat operative për rastet e shterimit të FRR ose RR në marrëveshjen e operimit të bllokut LFC. Në këto procedura operative, OST-të e një blloku LFC do të kenë të drejtë të kërkojnë ndryshime në prodhimin ose konsumin e energjisë aktive të moduleve gjeneruese dhe njësive konsumatore.
7. OST-të e një blloku LFC do të përpiqen të shmangin FRCE që zgjasin më shumë se koha për rivendosjen e frekuencës.
8. Nëse gjendja e sistemit është në gjendje alarmi për shkak të rezervave të pamjaftueshme të fuqisë aktive në përputhje me nenin 99, OST-të e blloqeve përkatëse LFC, në bashkëpunim të ngushtë me OST-të e tjerë të zonës sinkrone, veprojnë për të rivendosur dhe zëvendësuar nivelet e nevojshme të rezervave të fuqisë aktive. Për këtë qëllim, OST-të e një blloku LFC kanë të drejtë të kërkojnë ndryshime në prodhimin ose konsumin e fuqisë aktive të moduleve gjeneruese ose njësive konsumatore brenda zonës së tij të kontrollit për të reduktuar ose për të hequr cënimet (mosplotësimin) e kërkesave lidhur me rezervën e fuqisë aktive.
9. Monitoruesi i bllokut LFC është përgjegjës për identifikimin e çdo cënimi të kufijve të FRCE, dhe:
 - a. do të informojë OST-të e tjera të bllokut LFC; dhe
 - b. do të implementojë, bashkë me OST-të e bllokut LFC, veprime të koordinuara për të reduktuar FRCE, të cilat do të specifikohen në marrëveshjen e operimit të bllokut LFC.

Titulli 5 – Rezervat e ruajtjes së frekuencës

Neni 222. Dimensionimi i FCR

1. Të gjitha OST-të e zonës sinkrone do të përcaktojnë, të paktën një herë në vit, kapacitetin rezervë për FCR të kërkuar për zonën sinkrone dhe detyrimin fillestar të FCR të secilit OST në përputhje me paragrafin 2.
2. Të gjitha OST-të e zonës sinkrone do të specifikojnë rregullat e dimensionimit në marrëveshjen e operimit të zonës sinkrone në përputhje me kriteret e mëposhtme:
 - a. kapaciteti rezervë për FCR që kërkohet për zonën sinkrone duhet të mbulojë të paktën incidentin e referencës dhe për zonën sinkrone Evropiane, rezultatet e qasjes së dimensionimit probabilistik për FCR të kryera në përputhje me pikën (c);
 - b. për zonën sinkrone Evropiane, incidenti referues do të jetë 3 000 MW në drejtim pozitiv dhe 3 000 MW në drejtim negativ;

- c. të gjitha OST-të e zonës sinkrone do të kenë të drejtën të përcaktojnë një qasje probabilistike të dimensionimit për FCR duke marrë parasysh modelin e ngarkesës, gjenerimit dhe incercisë, duke përfshirë incercinë sintetike, si dhe mjetet e disponueshme për vendosjen e incercisë minimale në kohë reale në përputhje me metodologjinë e përmendur në nenin 120, me qëllim reduktimin e probabilitetit të pamjaftueshmërisë së FCR në një ose më pak se një herë në 20 vjet; dhe
- d. ndarjet e kapacitetit rezervë të FCR të kërkuara për secilin OST si detyrim fillestar i FCR do të bazohen në shumatoren e gjenerimit dhe konsumit neto të zonës së tij të kontrollit pjesëtuar me shumatoren e gjenerimit dhe konsumit neto të zonës sinkrone gjatë një periudhe 1 vjeçare.

Neni 223. Kërkesat teknike minimale të FCR

1. Çdo OST ku lidhet rezerva do të sigurojë që FCR përmbush veçoritë e listuara për zonën sinkrone në tabelën e Shtojcës V.
2. Të gjithë OST-të e zonës sinkrone kanë të drejtën të specifikojnë, në marrëveshjen e operimit të zonës sinkrone, veçoritë e përbashkëta shtesë të FCR që kërkohen për të garantuar sigurinë e operimit në zonën sinkrone, me anë të një sërë parametrash teknike dhe brenda diapazoneve në nenin 15(2)(d) të Kodit “Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin të Gjeneruesve” i miratuar me vendimin ERE Nr. 129 Datë 04.06.2018 dhe nenet 27 dhe 28 të “Kodit të Rrjetit për Lidhjen e Ngarkesës” i miratuar me Vendimin ERE Nr.128, datë 04.06.2018.
3. OST ku lidhet rezerva ka të drejtë të përcaktojë kërkesa shtesë për grupet ofruese të FCR brenda diapazoneve në nenin 15(2)(d) të Rregullores BE 2016/631 dhe nenet 27 dhe 28 të “Kodit të Rrjetit për Lidhjen e Ngarkesës” i miratuar me Vendimin ERE Nr.128, datë 04.06.2018 në mënyrë që të sigurohet siguria e operimit. Këto kërkesa shtesë duhet të bazohen në arsye teknike si shpërndarja gjeografike e moduleve gjeneruese ose njësisive konsumatore që i përkasin një grupi ofrues të FCR. Ofruesi i FCR duhet të sigurojë që është i mundur monitorimi i aktivizimit të FCR të njësisive ofruese të FCR brenda një grupi ofrues të rezervës.
4. OST ku lidhet rezerva do të ketë të drejtën të përjashtojë grupet ofruese të FCR nga ofrimi i FCR në mënyrë që të sigurojë sigurinë e operimit. Ky përjashtim do të bazohet në arsye teknike të tilla si shpërndarja gjeografike e moduleve gjeneruese ose njësisive konsumatore që i përkasin një grupi ofrues të FCR.
5. Çdo njësi ofruese e FCR dhe çdo grup ofrues i FCR duhet të ketë vetëm OST-në ku lidhet rezerva.
6. Çdo njësi ofruese e FCR dhe çdo grup ofrues FCR duhet të jetë pajtueshëm me veçoritë e kërkuara për FCR në tabelën e aneksit V dhe me çdo veçori ose kërkesë shtesë të specifikuar në përputhje me paragrafët 2 dhe 3 si dhe duhet të aktivizojë FCR e rënë dakord me anë të një rregullatori proporcional që reagon në devijimet e frekuencave ose në mënyrë alternative bazuar në një karakteristikë lineare monotone të karakteristikës fuqi-frekuencë në rast të aktivizimit të FCR. Ato duhet të jenë në gjendje

- të aktivizojnë FCR brenda diapazonit të frekuencës të përcaktuar në nenin 13 (1) të Kodit “Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin të Gjeneruesve” i miratuar me Vendimin ERE Nr. 129 Datë 04.06.2018.
7. Çdo OST e zonës sinkrone do të sigurojë që reagimi i kombinuar i FCR i një zone LFC të jetë në përputhje me kërkesat e mëposhtme:
 - a. aktivizimi i FCR nuk duhet të vonohet artificialisht dhe duhet të fillojë sa më shpejt të jetë e mundur pas një devijimi të frekuencës;
 - b. në rast të një devijimi të frekuencës të barabartë ose më të madh se 200 mHz, të paktën 50% të kapacitetit të plotë të FCR duhet të aktivizohet jo më vonë se 15 sekonda;
 - c. në rast të një devijimi të frekuencës të barabartë ose më të madh se 200 mHz, 100% e kapacitetit të plotë të FCR duhet të aktivizohet jo më vonë se 30 sekonda;
 - d. në rast të devijimit të frekuencës të barabartë ose më të madh se 200 mHz, aktivizimi i kapacitetit të plotë FCR do të rritet të paktën linearisht nga 15 në 30 sekonda; dhe
 - e. në rast të një devijimi të frekuencës më të vogël se 200 mHz, kapaciteti përkatës i FCR së aktivizuar duhet të jetë të paktën proporcional me të njëjtën sjellje kohore të përmendur në pikat (a) deri (d).
 8. Çdo OST ku lidhet rezerva do të monitorojë kontributin e tij në FCP dhe aktivizimin e FCR duke respektuar detyrimin e tij për FCR, duke përfshirë njësitë ofruese të FCR dhe grupet ofruese të FCR. Çdo ofrues i FCR do të vendosë në dispozicion OST ku lidhet rezerva, për çdo njësi të tij ofruese të FCR dhe grupet ofruese të FCR, të paktën informacionin e mëposhtëm:
 - a. statusin me stampimin e kohës duke treguar nëse FCR është aktive ose jo;
 - b. të dhënat e fuqisë aktive të stampuar në kohë, të nevojshme për të verifikuar aktivizimin e FCR;
 - c. rënia (droop) e rregullatorit për modulet gjeneruese të tipit C dhe D siç përcaktohet në nenin 5 të kodit “Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin të Gjeneruesve” i miratuar me vendimin ERE Nr. 129 Datë 04.06.2018 që vepron si njësi ofruese e FCR, ose parametri i tij ekuivalent për grupet ofruese të FCR që përbëhen nga modulet gjeneruese të tipit A dhe /ose tipit B siç përcaktohen në nenin 5 të kodit “Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin të Gjeneruesve” i miratuar me vendimin ERE Nr. 129 Datë 04.06.2018 dhe/ose njësitë konsumatore me kontrollin e fuqisë aktive për përgjigjen ndaj ngarkesës siç përcaktohet në nenin 28 të “Kodit të Rrjetit për Lidhjen e Ngarkesës” i miratuar me vendimin ERE Nr.128, datë 04.06.2018.
 9. Çdo ofrues i FRC do të ketë të drejtën të mbledhë të dhënat përkatëse për më shumë se një njësi ofruese të FCR nëse fuqia maksimale e njërive të agreguara është nën 1,5 MW dhe është e mundur një verifikim i qartë i aktivizimit të FCR.

10. Me kërkesë të OST ku lidhet rezerva, ofruesi i FCR do të vendosë në dispozicion informacionin e listuar në paragrafin 9 në kohë reale, me një zgjidhje kohore prej të paktën 10 sekondash.
11. Me kërkesë OST ku lidhet rezerva dhe aty ku është e nevojshme për verifikimin e aktivizimit të FCR, një ofrues i FCR duhet të vendosë në dispozicion të dhënat e listuara në paragrafin 9 lidhur me instalimet teknike që janë pjesë e të njëjtës njësi të FCR.

Neni 224. Procesi i parakualifikimit të FCR

1. OST do të zhvillojë një proces parakualifikues të FCR dhe do të bëjë publike detajet e procesit të parakualifikimit të FCR.
2. Një ofrues i mundshëm i FCR do t'i demonstrojë OST ku lidhet rezerva nëse është në përputhje me kërkesat teknike dhe shtesë të përcaktuara në nenin 223 duke plotësuar me sukses procesin e parakualifikimit të njërive ofruese të FCR ose grupeve ofruese të FCR, të përshkruara në paragrafët 3 deri 6 të këtij neni.
3. Një ofrues i mundshëm i FCR do të paraqesë një aplikim formal tek OST ku lidhet rezerva së bashku me informacionin e kërkuar të njërive të mundshme ofruese të FCR ose grupeve ofruese të FCR. Brenda 8 javëve nga marrja e aplikimit, OST do të konfirmojë nëse aplikimi është i plotë. Kur OST e konsideron që aplikimi është i paplotë, ofruesi i mundshëm i FCR duhet të dorëzojë informacionin shtesë të kërkuar brenda 4 javëve nga marrja e kërkesës për informacion shtesë. Kur ofruesi i mundshëm FCR nuk e dërgon informacionin e kërkuar brenda këtij afati, aplikimi do të konsiderohet i tërhequr.
4. Brenda 3 muajve nga konfirmimi se aplikimi është i plotë, OST do të vlerësojë informacionin e ofruar dhe do të vendosë nëse njësitë e mundshme ofruese të FCR ose grupet ofruese të FCR përmbushin kriteret për një parakualifikim të FCR. OST do të njoftojë vendimin e saj për ofruesin e mundshëm të FCR.
5. Kur pajtueshmëria me kërkesat e caktuara të këtij kodi është tashmë e verifikuar nga OST, parakualifikimi do të konsiderohet i njohur.
6. Kualifikimi i njërive ofruese të FCR ose grupet ofruese të FCR do të rivlerësohen:
 - a. të paktën një herë në 5 vjet;
 - b. në rast së kanë ndryshuar kushtet teknike, disponueshmëria ose pajisjet; dhe
 - c. në rast të modernizimit të pajisjeve që lidhen me aktivizimin e FCR.

Neni 225. Dispozita e FCR

1. OST duhet të sigurojë disponueshmërinë e të paktën detyrimeve të FCR të rënë dakord midis të gjithë OST-ve të zonës sinkrone në përputhje me nenet 222 dhe 232.

2. Të gjithë OST-të e zonës sinkrone do të përcaktojnë, të paktën në baza vjetore, madhësinë e faktorit K të zonës sinkrone, duke marrë parasysh të paktën faktorët e mëposhtëm:
 - a. kapacitetin rezervë në FCR pjesëtuar me devijimin maksimal të frekuencës së gjendjes së qëndrueshme;
 - b. auto-kontrollin e gjenerimit;
 - c. vetë-rregullimin e ngarkesës, duke marrë parasysh kontributin në përputhje me nenet 27 dhe 28 të “Kodit të Rrjetit për Lidhjen e Ngarkesës” i miratuar me vendimin ERE Nr.128, datë 04.06.2018;
 - d. përgjigjen e frekuencës së interkonektorëve HVDC; dhe
 - e. aktivizimin i LFSM dhe FSM në përputhje me nenet 13 dhe 15 të kodit “Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin të Gjeneruesve” i miratuar me vendimin ERE Nr. 129 Datë 04.06.2018.
3. OST-të e zonës sinkrone, në marrëveshjen e operimit të zonës sinkrone, përcaktojnë ndarjet e faktorit K për secilën zonë LFC, që duhet të bazohet të paktën në:
 - a. detyrimet fillestare të FCR;
 - b. auto-kontrollin e gjenerimit;
 - c. vetë-rregullimin i ngarkesës;
 - d. lidhjen e frekuencave nëpërmjet HVDC midis zonave sinkrone;
 - e. shkëmbimin e FCR.
4. Një ofrues i FCR do të garantojë disponueshmërinë e vazhdueshme të FCR, me përjashtim të një ndërprerjeje të detyruar të një njësie ofruese të FCR, gjatë periudhës kohore në të cilën është i detyruar të ofrojë FCR.
5. Çdo ofrues i FCR duhet të informojë OST ku lidhet rezerva, sa më shpejt të jetë e mundur, lidhur me ndryshimet në disponueshmërinë aktuale në tërësi ose pjesërisht të njësisë së tij ofruese të FCR dhe/ose grupit të tij ofrues të FCR që janë të rëndësishme për rezultatet e parakualifikimit.
6. OST do të kërkojë nga ofruesit e tij të FCR që të sigurojnë që humbja e një njësie ofruese të FCR nuk rrezikon sigurinë e operimit duke:
 - a. kufizuar ndarjen e FCR së ofruar për çdo njësi ofruese të FCR në 5% të kapacitetit rezervë të FCR të kërkuar për gjithë zonën sinkrone;
 - b. zëvendësuar FCR që është i padisponueshëm për shkak të një ndërprerjeje të detyruar ose padisponueshmërinë e një njësie ofruese të FCR ose grupit ofrues të FCR sa më shpejt të jetë e mundur teknikisht dhe në përputhje me kushtet që do të përcaktohen nga OST ku lidhet rezerva.

7. Një njësi ofruese e FCR ose një grup ofrues FCR me një rezervuar të energjisë që nuk kufizon aftësinë e tij për të ofruar FCR duhet të aktivizojë FCR-në e saj për aq kohë sa devijimi i frekuencës vazhdon.
8. Një njësi ofruese e FCR ose një grup ofrues i FCR me një rezervuar të energjisë që kufizon aftësinë e tij për të ofruar FCR duhet të aktivizojë FCR-në e saj për aq kohë sa devijimi i frekuencës të vazhdojë, përveç nëse rezervari i saj i energjisë ka shteruar në drejtimin pozitiv ose negativ.
9. Ofruesi i FCR duhet të specifikojë kufizimet e rezervuarit të energjisë të njësisë të veta ofruese të FCR ose grupet ofruese të FCR në procesin e parakualifikimit në përputhje me nenin 224.
10. Një ofrues i FCR që përdor njësi ofruese të FCR ose grup ofrues të FCR me një rezervuar të energjisë që kufizon aftësinë e tyre për të ofruar FCR duhet të sigurojë rikuperimin e rezervuarëve të energjisë në drejtime pozitive ose negative sa më shpejt që të jetë e mundur, brenda 2 orëve pas përfundimit të gjendjes së alarmit.

Titulli 6 – Rezervat e rivendosjes së frekuencës

Neni 226. Dimensionimi i FRR

1. Të gjithë OST-të e një blloku LFC do të përcaktojnë rregullat e dimensionimit të FRR në marrëveshjen e operimit të bllokut LFC.
2. Rregullat e dimensionimit të FRR duhet të përfshijnë të paktën sa më poshtë:
 - a. OST-të e bllokut do të përcaktojnë kapacitetin rezervë të kërkuar të FRR të bllokut LFC bazuar në të dhënat historike të njëpasnjëshme që përfshijnë të paktën vlerat historike të disbalancës së bllokut LFC. Marrja e këtyre të dhënave historike duhet të mbulojë të paktën kohën për rivendosjen e frekuencës. Periudha kohore e shqyrtuar për këto të dhëna do të jetë përfaqësuese dhe do të përfshijë të paktën një periudhë të vitit të plotë që përfundon jo më herët së 6 muaj para datës së llogaritjes;
 - b. OST-të e bllokut do të përcaktojnë kapacitetin rezervë të kërkuar të FRR të bllokut LFC e njaftueshme për të respektuar parametrat aktual të synuar të FRCE në nenin 200 për periudhën kohore të përmendur në pikën (a) bazuar të paktën në një metodologji probabilitare. Në përdorimin e kësaj metodologjie probabilitare, OST-të do të marrin në konsideratë kufizimet e përcaktuara në marrëveshjet për ndarjen ose shkëmbimin e rezervave për shkak të cenimeve të mundshme të sigurisë së operimit dhe kërkesave të disponueshmërisë së FRR. Të gjithë OST-të e bllokut LFC duhet të marrin parasysh çdo ndryshim të pritur të rëndësishëm në shpërndarjen e disbalancave të bllokut LFC ose do të marrin në konsideratë faktorët e tjerë ndikues të rëndësishëm lidhur me periudhën kohore të shqyrtuar;
 - c. OST-të e bllokut LFC do të përcaktojnë shkallën e FRR automatike, FRR manuale, kohën e aktivizimit të plotë të FRR automatike dhe kohën e aktivizimit të plotë të FRR manuale në mënyrë që të jenë pajtueshëm me kërkesat e paragrafit (b). Për këtë qëllim, koha e aktivizimit të plotë të FRR automatike të një blloku LFC dhe

koha e aktivizimit të plotë të FRR manuale të bllokut LFC nuk duhet të jetë më e madhe se koha për rivendosjen e frekuencës;

- d. OST-të e bllokut LFC do të përcaktojnë madhësinë e incidentit të referencës, i cili do të jetë disbalanca më e madhe që mund të rezultojë nga një ndryshim i menjëhershëm i fuqisë aktive të një moduli të vetëm gjenerues, një objekt i vetëm konsumator ose një interkonektori të vetëm HVDC ose nga stakimi i një linje AC brenda bllokut LFC;
- e. OST-të e bllokut LFC do të përcaktojnë kapacitetin rezervë pozitiv të FRR, i cili nuk duhet të jetë më i vogël se incidenti pozitiv i dimensionimit të bllokut LFC;
- f. OST-të e bllokut LFC do të përcaktojnë kapacitetin rezervë negativ të FRR, i cili nuk duhet të jetë më i vogël se incidenti negativ i dimensionimit të bllokut LFC;
- g. OST-të e bllokut LFC do të përcaktojnë kapacitetin rezervë të FRR të një blloku LFC, çdo kufizim të mundshëm gjeografik për shpërndarjen e tij brenda bllokut LFC dhe çdo kufizim të mundshëm gjeografik për çdo shkëmbim rezervash ose ndarjen e rezervave me blloqe të tjera LFC për të qenë pajtueshëm me kufijtë e sigurisë së operimit;
- h. OST-të e bllokut LFC duhet të sigurojnë që kapaciteti rezervë pozitiv i FRR ose një kombinim i kapacitetit rezervë të FRR dhe RR është i mjaftueshëm për të mbuluar disbalancat pozitive të bllokut LFC për të paktën 99% të kohës, bazuar në të dhënat historike të përmendura në pikën (a);
- i. OST-të e bllokut LFC do të sigurojnë që kapaciteti rezervë negativ i FRR ose një kombinim i kapacitetit rezervë të FRR dhe RR është i mjaftueshëm për të mbuluar disbalancat negative të bllokut LFC për të paktën 99% të kohës, bazuar në të dhënat historike të përmendura në pikën (a);
- j. OST-të e bllokut LFC mund të zvogëlojnë kapacitetin rezervë pozitiv të FRR të bllokut LFC që rezulton nga procesi i dimensionimit të FRR duke nënshkruar një marrëveshje ndarjeje të FRR me blloqet e tjera LFC në përputhje me dispozitat në Titullin 8. Në marrëveshjen e ndarjes, reduktimi i kapacitetit rezervë pozitiv të FRR të një blloku LFC do të kufizohet në diferencën, nëse është pozitiv, midis madhësisë së incidentit pozitiv të dimensionimit dhe kapacitetit rezervë të FRR që kërkohet për të mbuluar disbalancat pozitive të bllokut LFC gjatë 99% të kohës, bazuar në të dhënat historike të përmendura në pikën (a). Reduktimi i kapacitetit rezervë pozitiv nuk duhet të kalojë 30% të madhësisë së incidentit pozitiv të dimensionimit;
- k. OST-të e bllokut LFC mund të zvogëlojnë kapacitetin rezervë negativ të FRR të bllokut LFC, që rezulton nga procesi i dimensionimit të FRR duke përfunduar një marrëveshje ndarjeje të FRR me blloqe të tjera të LFC në përputhje me dispozitat e Titullit 8. Në marrëveshjen e ndarjes, reduktimi i kapacitetit rezervë negativ të FRR të një blloku LFC do të kufizohet në diferencën, nëse është pozitiv, midis madhësisë së incidentit negativ të dimensionimit dhe kapacitetit rezervë të FRR që kërkohet për të mbuluar disbalancat negative të bllokut LFC gjatë 99% të kohës, bazuar në të dhënat historike të përmendura në pikën (a).

3. OST-të e bllokut LFC do të përcaktojnë në marrëveshjen e operimit të bllokut LFC, ndarjen specifike të përgjegjësisë ndërmjet OST-ve të zonave LFC për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në paragrafin 2.
4. OST-të e bllokut LFC duhet të kenë kapacitet rezervë të FRR të mjaftueshëm në çdo kohë në përputhje me rregullat e dimensionimit të FRR dhe, do të specifikojnë në marrëveshjen e operimit të bllokut LFC një procedurë të përshkallëzuar për rastet e riskut të pamjaftueshmerisë së kapacitetit rezervë të FRR në bllokun LFC.

Neni 227. Kërkesat teknike minimale të FRR

1. Kërkesat minimale teknike të FRR-së janë:
 - a. secila njësi ofruese e FRR dhe çdo grup ofrues i FRR duhet të lidhet vetëm me një OST ku lidhet rezerva;
 - b. njësia ofruese e FRR ose grupi ofrues i FRR do të aktivizojë FRR në përputhje me pikën e dhënë të punës e parashikuar nga OST urdhëruese e rezervës;
 - c. OST urdhëruese e rezervës është OST ku lidhet rezerva ose një OST e caktuar nga OST ku lidhet rezerva në një marrëveshje të shkëmbimit të FRR në përputhje me nenin 234 (3);
 - d. një njësi ofruese e FRR ose një grup ofrues i FRR, për FRR automatike do të ketë vonesë të aktivizimit të FRR automatike që nuk i kalon 30 sekonda;
 - e. një ofrues i FRR do të sigurojë që mund të monitorohet aktivizimi i FRR i njësive ofruese të FRR brenda një grupi ofrues të rezervës. Për këtë qëllim, ofruesi i FRR duhet të jetë në gjendje të vendosë në dispozicion të OST ku lidhet rezerva dhe OST urdhëruese të rezervës matjet në kohë reale të pikës së lidhjes ose një pike tjetër ndërveprimi të rënë dakord me OST ku lidhet rezerva, lidhur me:
 - i. prodhimin e fuqisë aktive të skeduar;
 - ii. fuqinë aktive e çastit për:
 - çdo njësi ofruese të FRR,
 - çdo grup ofrues të FRR, dhe
 - çdo modul gjenerues ose njësi konsumatore të një grupi ofrues të FRR me një fuqi maksimale të fuqisë aktive më të madhe ose të barabartë me 1,5 MW;
 - f. një njësi ofruese e FRR ose grupi ofrues i FRR për FRR automatike duhet të jetë në gjendje të aktivizojë kapacitetin e saj të plotë të rezervës të FRR automatike brenda kohës së aktivizimit të plotë të FRR automatike;
 - g. një njësi ofruese e FRR ose grupi ofrues i FRR për FRR manuale duhet të jetë në gjendje të aktivizojë kapacitetin e saj të plotë të rezervës të FRR manuale brenda kohës së aktivizimit të plotë të FRR manuale;
 - h. një ofrues i FRR duhet të përmbushë kërkesat e disponueshmërisë së FRR; dhe

- i. një njësi ofruese e FRR ose grupi ofrues i FRR do të përmbushë kërkesat e normës së rampimit të bllokut LFC.
2. OST-të e bllokut LFC duhet të specifikojnë kërkesat e disponueshmërisë së FRR dhe kërkesat për cilësinë e kontrollit të njërive ofruese të FRR dhe grupeve ofruese të FRR për bllokun e tyre LFC në marrëveshjen e operimit të bllokut LFC në përputhje me nenin 213.
3. OST ku lidhet rezerva do të miratojë kërkesat teknike për lidhjen e njërive ofruese të FRR dhe grupeve ofrues të FRR për të siguruar shpërndarjen e sigurtë të FRR.
4. Çdo ofrues i FRR duhet të:
 - a. sigurojë që njësitë ofruese të FRR-së dhe grupet që ofrojnë FRR-në përmbushin kërkesat teknike minimale të FRR, kërkesat e disponueshmërisë së FRR dhe kërkesat e normës së rampimit në paragrafët 1 deri 3; dhe
 - b. informojë OST urdhëruese të rezervës për një zvogëlim të disponueshmërisë aktuale të njësisë së tij ofruese të FRR ose grupit të tij ofrues të FRR-së ose një pjesë të grupit të tij ofrues të FRR sa më shpejt të jetë e mundur.
5. Çdo OST urdhëruese e rezervës duhet të sigurojë monitorimin e pajtueshmërisë me kërkesat teknike minimale të FRR në paragrafin 1, kërkesat e disponueshmërisë së FRR në paragrafin 2, kërkesat e shkallës e rampimit në paragrafin 1 dhe kërkesat e lidhjes në paragrafin 3 nga njësitë e tij ofruese të FRR dhe grupet e tij ofruese të FRR.

Neni 228. Procesi i parakualifikimit të FRR

1. Pas hyrjes në fuqi të këtij kodi, OST do të zhvillojë një proces parakualifikimi të FRR si dhe do të sqarojë dhe do të bëjë publike detajet e tij.
2. Një ofrues i mundshëm i FRR duhet t'i demonstrojë OST ku lidhet rezerva ose OST të caktuar nga OST ku lidhet rezerva në marrëveshjen e shkëmbimit të FRR, që ai është në pajtueshmëri me kërkesat teknike minimale të FRR të përcaktuara në nenin 227 (1), kërkesat e disponueshmërisë së FRR të përcaktuara në nenin 227 (2), kërkesat e shkallës së rampimit të përcaktuara në nenin 227 (1) dhe kërkesat e lidhjes të përcaktuara në nenin 227 (3), duke plotësuar me sukses procesin e parakualifikimit të njërive ofruese të FRR ose grupeve ofruese të FRR, të përshkruara në paragrafët 3 deri 6 të këtij neni.
3. Një ofrues i mundshëm i FRR duhet të paraqesë një aplikim formal te OST ku lidhet rezerva ose së bashku me OST e caktuar (instruktuese), informacionin e kërkuar të njërive të mundshme ofruese të FRR ose grupeve ofruese të FRR. Brenda 8 javëve nga marrja e aplikimit, OST ku lidhet rezerva ose OST e caktuar do të konfirmojnë nëse aplikimi është i plotë. Kur OST ku lidhet rezerva ose OST e caktuar konsideron se aplikimi është jo i plotë, ata do të kërkojnë informacion shtesë dhe ofruesi i mundshëm i FRR do të dorëzojë informacionin shtesë të kërkuar brenda 4 javëve nga marrja e

- kërkesës. Kur ofruesi i mundshëm i FRR nuk jep informacionin e kërkuar brenda këtij afati, aplikimi do të konsiderohet i tërhequr.
4. Brenda 3 muajve pasi OST ku lidhet rezerva ose OST e caktuar konfirmon se aplikimi është i plotë, OST ku lidhet rezerva ose OST e caktuar do të vlerësojë informacionin e ofruar dhe do të vendosë nëse njësitë ose grupet ofruese të FRR plotësojnë kriteret për një parakualifikim të FRR. OST ku lidhet rezerva ose OST e caktuar duhet ta njoftojë vendimin e tyre tek ofruesi i mundshëm i FRR.
 5. Kualifikimi i njësive ofruese të FRR ose grupeve ofruese të FRR nga OST ku lidhet rezerva ose OST e caktuar do të jenë të vlefshme për të gjithë bllokun LFC.
 6. Kualifikimi i njësive ofruese të FRR ose grupeve ofruese të FRR duhet të rivlerësohen:
 - a. të paktën një herë në 5 vjet; dhe
 - b. kur kërkesat teknike ose ato të disponueshmërisë ose pajisjet kanë ndryshuar.
 7. Për të garantuar sigurinë e operimit, OST ku lidhet rezerva do të ketë të drejtën të përjashtojë grupet ofruese të FRR nga ofrimi i FRR bazuar në argumente teknike të tilla si shpërndarja gjeografike e moduleve gjeneruese ose njësitë konsumatore që i përkasin një grupi ofrues të FRR.

Titulli 7 – Rezervat zëvendësuese

Neni 229. Dimensionimi i RR

1. OST-të e bllokut LFC kanë të drejtë të implementojnë një proces zëvendësimi të rezervës.
2. Për të qenë në pajtueshmëri me parametrat e synuar të FRCE të përmendura në nenin 200, OST-të e bllokut LFC me një RRP, kryejnë një proces të kombinuar të dimensionimit të FRR dhe RR për të përmbushur kërkesat e nenit 226 (2), duke përcaktuar rregullat e dimensionimit të RR në marrëveshjen e operimit të bllokut LFC.
3. Rregullat e dimensionimit të RR duhet të përmbajnë të paktën kërkesat e mëposhtme:
 - a. duhet të ketë kapacitet rezervë pozitiv të mjaftueshëm të RR për të rivendosur sasinë e kërkuar të FRR pozitive;
 - b. duhet të ketë kapacitet rezervë negativ të mjaftueshëm të RR për të rivendosur sasinë e kërkuar të FRR negative;
 - c. do të ketë kapacitet rezervë të mjaftueshëm të RR, kur kjo merret parasysh për dimensionimin e kapacitetit rezervë të FRR, në mënyrë që të respektojë objektivin e cilësisë së FRCE për periudhën kohore në fjalë; dhe
 - d. pajtueshmëria me sigurinë e operimit brenda bllokut LFC për të përcaktuar kapacitetin rezervë në RR.

4. OST-të e bllokut LFC mund të zvogëlojnë kapacitetin rezervë pozitiv të RR të bllokut LFC, që rezulton nga procesi i dimensionimit të RR, duke zhvilluar një marrëveshje për ndarjen e RR për atë kapacitet rezervë pozitiv të RR me blloqet e tjera LFC në përputhje me dispozitat e Titullit 8 të Pjesës IV. OST që merr aftësinë e kontrollit do të kufizojë zvogëlimin e kapacitetit rezervë pozitiv të tij të RR për të:
 - a. garantuar se ai ende mund të plotësojë parametrat e synuar të FRCE të përcaktuara në nenin 200;
 - b. garantuar që siguria e operimit nuk është e rrezikuar; dhe
 - c. siguruar që reduktimi i kapacitetit rezervë pozitiv të RR nuk e tejkalon kapacitetin rezervë pozitiv të mbetur të RR të bllokut LFC.

5. OST-të e bllokut LFC mund të reduktojnë kapacitetin rezervë negativ të RR të bllokut LFC, që rezulton nga procesi i dimensionimit të RR, duke zhvilluar një marrëveshje për ndarjen e RR për atë kapacitet rezervë negativ të RR me blloqe të tjera LFC në përputhje me dispozitat e Titullit 8 të Pjesës IV. OST që merr aftësinë e kontrollit do të kufizojë zvogëlimin e kapacitetit rezervë negativ të tij të RR për të:
 - a. garantuar se ai ende mund të plotësojë parametrat e synuar të FRCE të përcaktuara në nenin 200;
 - b. garantuar që siguria e operimit nuk është e rrezikuar; dhe
 - c. siguruar që reduktimi i kapacitetit rezervë negativ të RR nuk e tejkalon kapacitetin rezervë negativ të mbetur të RR të bllokut LFC.

6. OST-të e bllokut LFC duhet të specifikojnë në marrëveshjen e operimit të bllokut LFC alokimin e përgjegjësive ndërmjet OST-ve të zonave të ndryshme LFC për zbatimin e rregullave të dimensionimit të përcaktuara në paragrafin 3.

7. Çdo OST do të ketë kapacitet të mjaftueshëm rezervë të RR në përputhje me rregullat e dimensionimit të RR në çdo kohë. OST-të e bllokut LFC do të specifikojnë në marrëveshjen e operimit të bllokut LFC një procedurë përshkallëzimi për rastet e riskut të pamjaftueshmerisë së kapacitetit rezervë të RR në bllokun LFC.

Neni 230. Kërkesat teknike minimale të RR

1. Njësitë ofruese RR dhe grupet ofruese të RR duhet të përmbushin kërkesat teknike minimale si në vijim:
 - a. lidhje me vetëm një OST ku lidhet rezerva;
 - b. aktivizimi i RR sipas pikës së caktuar të marrë nga OST urdhëruese e rezervës;
 - c. OST urdhëruese e rezervës duhet të jetë OST ku lidhet rezerva ose OST i caktuar nga OST ku lidhet rezerva në marrëveshjen e shkëmbimit të RR në përputhje me nenin 234 (3);

- d. aktivizimi i kapacitetit rezervë të plotë të RR brenda kohës së aktivizimit të përcaktuar nga OST urdhëruese e rezervës;
 - e. deaktivizimi i RR sipas pikave të parashikuara nga OST urdhëruese e rezervës;
 - f. një ofrues i RR duhet të sigurojë që mund të monitorohet aktivizimi i RR të njësive ofruese të RR brenda një grupi ofrues të rezervës. Për këtë qëllim ofruesi i RR duhet të jetë në gjendje të furnizojë OST ku lidhet rezerva dhe OST urdhëruese të rezervës matjet në kohë reale të pikës së lidhjes ose një pikë tjetër ndërveprimi të rënë dakord me OST ku lidhet rezerva lidhur me:
 - i. prodhimin e skeduar të fuqisë aktive, për çdo njësi dhe grup ofrues të RR dhe për çdo modul gjenerues ose njësi konsumatore të një grupi ofrues të RR me një prodhim maksimal të fuqisë aktive më të madh ose të barabartë me 1,5 MW;
 - ii. prodhimin e fuqisë aktive të çastit, për çdo njësi dhe grup ofrues të RR dhe për çdo modul gjenerues ose njësi konsumatore të një grupi ofrues të RR me një prodhim maksimal të fuqisë aktive më të madh ose të barabartë me 1,5 MW;
 - g. përmbushjen e kërkesave të disponueshmërisë të RR.
2. OST-të e bllokut LFC duhet të specifikojnë kërkesat e disponueshmërisë së RR për cilësinë e kontrollit të njësive ofruese të RR dhe grupeve ofruese të RR në marrëveshjen e operimit të bllokut LFC.
 3. OST ku lidhet rezerva do të miratojë kërkesat teknike për lidhjen e njësive ofruese të RR dhe grupeve ofruese të RR për të siguruar livrimin e sigurtë të RR në përshkrimin e procesit të parakualifikimit.
 4. Çdo ofrues i RR do të:
 - a. sigurojë që njësitë ofruese të RR dhe grupet ofruese të RR të përmbushin kërkesat teknike minimale të RR dhe kërkesat e disponueshmërisë së RR të përmendura në paragrafët 1 deri 3; dhe
 - b. informojnë OST urdhëruese të rezervës për një reduktim të disponueshmërisë aktuale ose një ndërprerje të detyruar të njësisë së tij ofruese të RR ose grupit të tij ofrues të RR ose një pjese të grupit të tij ofrues të RR sa më shpejt që të jetë e mundur.
 5. Çdo OST urdhëruese e rezervës do të sigurojë pajtueshmërinë me kërkesat teknike të RR, kërkesat e disponueshmërisë së RR dhe kërkesat e lidhjes të përmendura në këtë nen lidhur me njësitë ofruese të RR dhe grupet ofruese të RR.

Neni 231. Procesi i parakualifikimit të RR

1. Secila OST e bllokut LFC që ka implementuar një RRP do të zhvillojë një proces parakualifikimi të RR pas hyrjes në fuqi të këtij kodi dhe duhet t'i sqarojë dhe t'i bëjë publike detajet e tij.
2. Një ofrues i mundshëm i RR do t'i demonstrojë OST ku lidhet rezerva ose OST të caktuar nga OST ku lidhet rezerva në marrëveshjen e shkëmbimit të RR, që ai është në pajtueshmëri me kërkesat teknike minimale të RR, kërkesat e disponueshmërisë së RR dhe kërkesat e lidhjes të përmendura në nenin 230 duke plotësuar me sukses procesin e parakualifikimit të njërive ofruese të RR ose grupeve ofruese të RR, të përshkuara në paragrafët 3 deri 6.
3. Një ofrues i mundshëm i RR duhet të paraqesë një aplikim formal të OST ku lidhet rezerva ose të OST i caktuar bashkë me informacionin e kërkuar të njërive të mundshme ofruese të RR ose grupeve ofruese të RR. Brenda 8 javëve nga marrja e aplikimit, OST ku lidhet rezerva ose OST i caktuar do të konfirmojë nëse aplikimi është i plotë. Kur OST ku lidhet rezerva ose OST i caktuar konsideron se aplikimi është jo i plotë, ata do të kërkojnë informacion shtesë dhe ofruesi i mundshëm i RR do të dorëzojë informacionin shtesë të kërkuar brenda 4 javëve nga marrja e kërkesës. Kur ofruesi i mundshëm i RR nuk jep informacionin e kërkuar brenda këtij afati, aplikimi do të konsiderohet i tërhequr.
4. Brenda 3 muajve pasi OST ku lidhet rezerva ose OST i caktuar konfirmon se aplikimi është i plotë, OST ku lidhet rezerva ose OST i caktuar do të vlerësojë informacionin e ofruar dhe do të vendosë nëse njësitë ose grupet ofruese të RR plotësojnë kriteret për një parakualifikim të RR. OST ku lidhet rezerva ose OST i caktuar duhet ta njoftojë vendimin e tyre të ofruesi i mundshëm i RR.
5. Kualifikimi i njërive ofruese të FRR ose grupeve ofruese të RR duhet të rivlerësohen:
 - a. të paktën një herë në 5 vjet; dhe
 - b. kur kërkesat teknike ose ato të disponueshmërisë ose pajisjet kanë ndryshuar.
6. Për të garantuar sigurinë e operimit, OST ku lidhet rezerva do të ketë të drejtën të përjashtojë grupet ofruese të RR nga ofrimi i RR bazuar në argumente teknike të tilla si shpërndarja gjeografike e moduleve gjeneruese ose njësitë konsumatore që i përkasin një grupi ofrues të RR.

Titulli 8 – Shkëmbimi dhe ndarja e rezervave

Kapitulli 1 – Shkëmbimi dhe ndarja e rezervave brenda një zone sinkrone

Neni 232. Shkëmbimi i FCR brenda një zone sinkrone

1. Të gjithë OST-të e përfshirë në shkëmbimin e FCR brenda një zone sinkrone do të jenë në pajtueshmëri me kërkesat e përcaktuara në paragrafët 2 deri 9. Shkëmbimi i FCR nënkupton transferimin e një detyrimi të FCR nga OST që merr rezervën të OST ku lidhet rezerva për kapacitetin rezervë korrespondues të FCR.

2. Të gjithë OST-të e përfshirë në shkëmbimin e FCR brenda një zone sinkrone do të respektojnë kufijtë dhe kërkesat për shkëmbimin e FCR brenda zonës sinkrone të specifikuar në Tabelën e Aneksit VI.
3. Në rast të shkëmbimit të FCR, OST ku lidhet rezerva dhe OST që merr rezervën do ta njoftojnë këtë shkëmbim në përputhje me nenin 219.
4. Çdo OST ku lidhet rezerva, OST që merr rezervën ose OST e prekur e përfshirë në shkëmbimin e FCR mund të refuzojë shkëmbimin e FCR nëse do të rezultonte që flukset e fuqisë çënojnë kufijtë e sigurisë së operimit kur aktivizojnë kapacitetin rezervë të FCR, subjekt i shkëmbimit të FCR.
5. Secili OST i prekur do të verifikojë që marxhina e tij e besueshmërisë, e vendosur në përputhje me nenin 22 të Rregullores BE 2015/1222, është e mjaftueshme për të pranuar flukset e fuqisë që rezultojnë nga aktivizimi i kapacitetit rezervë të FCR, subjekt i shkëmbimit të FCR.
6. Të gjithë OST-të e një zone LFC duhet të rregullojnë parametrat e llogaritjes së tyre të FRCE për shkëmbimin e FCR.
7. OST ku lidhet rezerva do të jetë përgjegjës për kërkesat e përmendura në nenet 223 dhe 225 për sa i përket kapacitetit rezervë të FCR, subjekt i shkëmbimit të FCR.
8. Njësia ose grupi ofrues i FCR do të jetë përgjegjës ndaj OST ku lidhet rezerva për aktivizimin e FCR.
9. OST-të përkatëse duhet të sigurojnë që shkëmbimi i FCR nuk pengon ndonjë OST të përmbushë kërkesat e rezervës në nenin 225.

Neni 233. Ndarja e FCR brenda një zone sinkrone

1. OST nuk duhet të ndajë FCR me OST-të e tjera të zonës sinkrone për të përmbushur detyrimet e tij të FCR dhe për të zvogëluar sasinë totale të FCR të zonës sinkrone në përputhje me nenin 222.

Neni 234. Kërkesat e përgjithshme për shkëmbimin e FRR dhe RR brenda një zone sinkrone

1. Të gjithë OST-të e zonës sinkrone do të përcaktojnë në marrëveshjen e operimit të zonës sinkrone rolet dhe përgjegjësitë e OST ku lidhet rezerva, OST që merr rezervën dhe OST e prekur për shkëmbimin e FRR dhe/ose RR.
2. Kur ndodh një shkëmbim i FRR/RR, OST ku lidhet rezerva dhe OST që merr rezervën duhet të njoftojnë këtë shkëmbim në përputhje me kërkesat e nenit 219.
3. OST ku lidhet rezerva dhe OST që merr rezervën që marrin pjesë në shkëmbimin e FRR/RR duhet të specifikojnë në marrëveshjen e shkëmbimit të FRR ose RR rolet dhe përgjegjësitë e tyre, duke përfshirë:

- a. përgjegjësinë e OST urdhëruese të rezervës për kapacitetin rezervë të FRR dhe RR, subjekt i shkëmbimit të FRR/RR;
 - b. sasinë e kapacitetit rezervë të FRR dhe RR, subjekt i shkëmbimit të FRR/RR;
 - c. implementimin e procesit të aktivizimit ndërkufitar të FRR/RR në përputhje me nenet 216 dhe 217;
 - d. kërkesat teknike minimale të FRR/RR lidhur me procesin e aktivizimit ndërkufitar të FRR/RR kur OST ku lidhet rezerva nuk është OST urdhëruese e rezervës;
 - e. implementimin e parakualifikimit të FRR/RR për kapacitetin rezervë të FRR dhe RR subjekt i shkëmbimit në përputhje me nenet 228 dhe 231;
 - f. përgjegjësinë për të monitoruar përmbushjen e kërkesave teknike të FRR/RR dhe kërkesave të disponueshmërisë së FRR/RR për kapacitetin rezervë të FRR dhe RR, subjekt i shkëmbimit në përputhje me nenet 227 (5) dhe 230 (5); dhe
 - g. procedurat për të siguruar që shkëmbimi i FRR/RR nuk të çon në flukse fuqie që çenojnë kufijtë e sigurisë së operimit.
4. Çdo OST ku lidhet rezerva, OST që merr rezervën ose OST e prekur të përfshira në shkëmbimin e FRR ose RR mund të refuzojë shkëmbimin e përmendur në paragrafin 2, nëse rezulton në flukse fuqie që çenojnë kufijtë e sigurisë së operimit kur aktivizojnë kapacitetin rezervë të FRR dhe RR, subjekt i shkëmbimit të FRR ose RR.
 5. OST-të përkatëse do të sigurojnë që shkëmbimi i FRR/RR nuk pengon ndonjë OST që të përmbushë kërkesat e rezervës të përcaktuara në rregullat e dimensionimit të FRR ose RR në nenet 226 dhe 229.
 6. Të gjithë OST-të e një blloku LFC duhet të specifikojnë në marrëveshjen e operimit të bllokut LFC rolet dhe përgjegjësitë e OST ku lidhet rezerva, OST që merr rezervën ose OST e prekur për shkëmbimin e FRR dhe/ose RR me OST-të e blloqeve të tjera LFC.

Neni 235. Kërkesa të përgjithshme për ndarjen e FRR dhe RR brenda një zone sinkrone

1. Të gjithë OST-të e një zone sinkrone do të specifikojnë në marrëveshjen e operimit të zonës sinkrone, rolet dhe përgjegjësitë e OST që ofron aftësinë kontrolluese, OST që merr aftësinë kontrolluese dhe OST e prekur për ndarjen e FRR/RR.
2. Kur bëhet ndarja e FRR/RR, OST që ofron aftësinë kontrolluese dhe OST që merr aftësinë kontrolluese do të njoftojnë ndarjen sipas kërkesave të nenit 219.
3. OST që ofron aftësinë kontrolluese dhe OST që merr aftësinë kontrolluese të përfshira në ndarjen e FRR/RR duhet të specifikojnë në marrëveshjen për ndarjen e FRR ose RR rolet dhe përgjegjësitë e tyre, duke përfshirë:
 - a. sasinë e kapacitetit rezervë të FRR dhe RR, subjekt i ndarjes së FRR/RR;
 - b. implementimin e procesit të aktivizimit ndërkufitar të FRR/RR në përputhje me nenet 216 dhe 217;

- c. procedurat për të siguruar që aktivizimi i kapacitetit rezervë të FRR dhe RR, subjekt i ndarjes së FRR/RR, nuk do të çojë në flukse fuqie që shkelin kufijtë e sigurisë së operimit.
4. Çdo OST që ofron aftësinë kontrolluese dhe OST që merr aftësinë kontrolluese ose OST e prekur të përfshira në ndarjen e FRR/RR mund të refuzojë ndarjen e FRR/RR nëse do të rezultojnë flukse fuqie që çënojnë kufijtë e sigurisë së operimit kur aktivizojnë kapacitetin rezervë të FRR dhe RR, subjekt i ndarjes së FRR/RR.
 5. Në rast të ndarjes së FRR/RR, OST që ofron aftësinë kontrolluese do të vendosë në dispozicion të OST që merr aftësinë kontrolluese një pjesë të kapacitetit të vet rezervë të FRR dhe RR të kërkuar për të përmbushur kërkesat e tij rezervë të FRR dhe/ose RR që rezultojnë nga rregullat e dimensionimit të FRR/RR në nenet 226 dhe 229. OST që ofron aftësinë kontrolluese mund të jetë:
 - a. OST urdhëruese e rezervës për kapacitetin rezervë të FRR dhe RR, subjekt i ndarjes së FRR/RR; ose
 - b. OST që ka qasje në kapacitetin e vet rezervë të FRR dhe RR, duke iu nënshtruar ndarjes së FRR/RR përmes një procesi të aktivizimit ndërkuftar të FRR/RR, si pjesë e një marrëveshjeje shkëmbimi të FRR/RR.
 6. Çdo OST që merr aftësinë kontrolluese do të jetë përgjegjës për përballimin e incidenteve dhe disbalancave në rast të kapaciteti rezervë i FRR dhe RR subjekt i ndarjes së FRR/RR nuk është i disponueshëm për shkak të:
 - a. kufizimeve për rivendosjen e frekuencës ose rregullimin e programit të kontrollit lidhur me sigurinë e operimit; dhe
 - b. përdorimit të pjesshëm ose të plotë të kapacitetit rezervë të FRR dhe RR nga OST që ofron aftësinë kontrolluese.
 7. OST-të e bllokut LFC do të specifikojnë në marrëveshjen e operimit të bllokut LFC rolet dhe përgjegjësitë e OST që ofron aftësinë kontrolluese, OST që merr aftësinë kontrolluese dhe OST e prekur për ndarjen e FRR dhe RR me OST-të e blloqeve të tjera LFC.

Neni 236. Shkëmbimi i FRR brenda një zone sinkrone

1. Të gjithë OST-të në një zonë sinkrone të përbërë nga më shumë se një bllok LFC të përfshirë në shkëmbimin e FRR brenda zonës sinkrone duhet të jenë në përputhje me kërkesat dhe kufijtë për shkëmbimin e FRR të paraqitur në Tabelën e Aneksit VII.

Neni 237. Ndarja e FRR brenda një zone sinkrone

1. Çdo OST i një blloku LFC do të ketë të drejtën të ndajë FRR me blloqet e tjera LFC të zonës sinkrone brenda kufijve të përcaktuar nga rregullat e dimensionimit të FRR në nenin 226 (1) dhe në përputhje me nenin 235.

Neni 238. Shkëmbimi i RR brenda një zone sinkrone

1. Të gjithë OST-të në një zonë sinkrone të përbërë nga më shumë se një bllok LFC të përfshirë në shkëmbimin e RR brenda zonës sinkrone do të jenë në përputhje me kërkesat dhe kufijtë për shkëmbimin e RR të paraqitur në Tabelën e Aneksit VIII.

Neni 239. Ndarja e RR brenda një zone sinkrone

1. Secili OST i një blloku LFC do të ketë të drejtën të ndajë RR me blloqet e tjera LFC të zonës sinkrone brenda kufijve të përcaktuar nga rregullat e dimensionimit të RR në nenin 229 (4) dhe (5) dhe në përputhje me nenin 235.

Kapitulli 2 – Procesi i aktivizimit ndërkufitar për FRR/RR

Neni 240. Procesi i aktivizimit ndërkufitar për FRR/RR

1. Të gjithë OST-të e përfshira në aktivizimin ndërkufitar të FRR dhe RR në zonat sinkrone të njëjta ose të ndryshme duhet të përmbushin kërkesat e përcaktuara në nenet 216 dhe 217.

Titulli 9 – Procesi i kontrollit të kohës

Neni 241. Procesi i kontrollit të kohës

1. Qëllimi i procesit të kontrollit kohës elektrike është të kontrollojë vlerën mesatare të frekuencës së sistemit krahasuar me frekuencën nominale.
2. OST-të e zonës sinkrone do të përcaktojnë në marrëveshjen e operimit të zonës sinkrone metodologjinë për korrigjimin e devijimit të kohës elektrike, i cili duhet të përfshijë:
 - a. kohëzgjatjet brenda të cilave OST-të do të përpiqen të mbajnë devijimin e kohës elektrike;
 - b. rregullimet e frekuencës për të rikthyer devijimin e kohës elektrike në zero; dhe
 - c. veprimet për të rritur ose ulur frekuencën mesatare të sistemit me anë të rezervave të fuqisë aktive.
3. Monitoruesi i zonës sinkrone do të:
 - a. monitorojë devijimin e kohës elektrike;
 - b. llogarisë madhësinë e rregullimit të frekuencës; dhe
 - c. koordinojë veprimet e procesit të kontrollit të kohës.

Titulli 10 – Bashkëpunimi me OSSH

Neni 242. Grupet ose njësitë ofruese të rezervës të lidhura në rrejetin e OSSH

1. OST dhe OSSH duhet të bashkëpunojë në mënyrë që të lehtësojnë dhe mundësojnë shpërndarjen e rezervave të fuqisë aktive nga grupet ofruese të rezervës ose njësitë ofruese të rezervës në sistemin e shpërndarjes.
2. Për qëllimet e proceseve të parakualifikimit për FCR në nenin 224, FRR në nenin 228 dhe RR në nenin 231, OST do të zhvillojë dhe specifikojë, në një marrëveshje me OSSH kushtet e shkëmbimit të informacionit të kërkuar për këto procese të parakualifikimit për njësitë ose grupet ofruese të rezervës në sistemin e shpërndarjes dhe për shpërndarjen e rezervave të fuqisë aktive. Proceset e parakualifikimit duhet të specifikojnë informacionin që duhet të sigurohet nga njësitë ose grupet e mundshme ofruese të rezervës, të cilat përfshijnë:
 - a. nivelet e tensionit dhe pikat e lidhjes së njësive ose grupeve ofruese të rezervës;
 - b. lloji i rezervave të fuqisë aktive;
 - c. kapacitetin rezervë maksimal të ofruar nga njësitë ose grupet ofruese të rezervës në çdo pikë lidhje; dhe
 - d. shkallën maksimale të ndryshimit të fuqisë aktive për njësitë ose grupet ofruese të rezervës.
3. Procesi i parakualifikimit mbështetet në afatet kohore të rëna dakord dhe rregullat në lidhje me shkëmbimin e informacionit dhe shpërndarjen e rezervave të fuqisë aktive midis OST dhe OSSH. Procesi i parakualifikimit do të ketë një kohëzgjatje maksimale prej 3 muajsh nga dorëzimi i një aplikimi formal të plotë nga njësia ose grupi ofrues i rezervës.
4. Gjatë parakualifikimit të një njësie ose grupi ofrues të rezervës që lidhet me sistemin e shpërndarjes OSSH, në bashkëpunim me OST, ka të drejtë të caktojë kufizime ose të përjashtojë shpërndarjen e rezervave të fuqisë aktive në sistemin e shpërndarjes, bazuar në arsye teknike si vendndodhja gjeografike e njësive dhe grupeve ofruese të rezervës.
5. OSSH do të ketë të drejtë, në bashkëpunim me OST, të vendosë, para aktivizimit të rezervave, kufizime të përkohshme për shpërndarjen e rezervave të fuqisë aktive në sistemin e shpërndarjes. OST dhe OSSH do të bien dakord për procedurat që do të aplikohen.

Titulli 11 - Transparenca e informacionit

Neni 243. Kërkesat e përgjithshme të transparencës

1. OST duhet të sigurojë që informacioni i listuar në këtë Titull të publikohet në një kohë dhe në një format që nuk krijon një avantazh ose disavantazh konkurrimi aktual ose të mundshëm për cilëndo palë ose kategori dhe duke marrë parasysh ndjeshmërinë e informacionit tregtar.

2. OST do të përdorë njohuritë dhe mjetet në dispozicion për të tejkaluar kufizimet teknike dhe për të siguruar disponueshmërinë dhe saktësinë e informacionit të vënë në dispozicion të ENTSO-E në përputhje me nenin 245 (3).
3. OST do të sigurojë disponueshmërinë dhe saktësinë e informacionit të vënë në dispozicion të ENTSO-E në përputhje me nenet 244 deri 250.
4. Të gjithë materialet për publikim të përmendura në nenet 244 deri në 256 do të vihen në dispozicion të ENTSO-E e cila do ta publikojë këtë material në platformën e transparencës së informacionit të krijuar në përputhje me Nenin 3 të Rregullores BE Nr. 543/2013¹¹.

Neni 244. Informacion mbi marrëveshjet e operimit

1. OST do të dërgojë përmbajtjen e marrëveshjes së operimit të zonës sinkrone në ERE jo më vonë së 1 muaj para hyrjes së saj në fuqi.
2. Të gjitha OST-të e secilës zonë sinkrone do të dërgojnë përmbajtjen e marrëveshjes së operimit të zonës sinkrone në ENTSO-e për publikim jo më vonë së 1 javë pas hyrjes së saj në fuqi.
3. OST do të dërgojë përmbajtjen e marrëveshjes së operimit të bllokut LFC në ERE.

Neni 245. Informacioni mbi cilësinë e frekuencës

1. Kur OST-të e zonës sinkrone vendosin të modifikojnë vlerat për parametrat e përcaktues të cilësisë së frekuencës ose parametrin e synuar të cilësisë së frekuencës në përputhje me nenin 199, duhet të dërgojnë vlerat e modifikuara në ENTSO-E për publikim të paktën 1 muaj para hyrjes në fuqi të marrëveshjes së operimit të zonës sinkrone.
2. OST-të e zonës sinkrone do të dërgojnë vlerat e parametrave të synuar të FRCE për çdo bllok LFC dhe secilën zonë LFC tek ENTSO-E për publikim të paktën 1 muaj para aplikimit të tyre.
3. OST-të e zonës sinkrone do të dërgojnë periudhën e rampimit të specifikuar në përputhje me nenin 206 në ENTSO-E për publikim të paktën 3 muaj përpara hyrjes së tyre në fuqi.

¹¹ Commission Regulation (Eu) No 543/2013 Of 14 June 2013 On Submission And Publication Of Data In Electricity Markets And Amending Annex I To Regulation (Ec) No 714/2009 Of The European Parliament And Of The Council

Neni 246. Informacioni mbi strukturën e kontrollit ngarkesë-frekuencë

1. OST-të e zonës sinkrone do të dërgojnë në ENTSO-e për publikim të paktën 3 muaj para aplikimit të marrëveshjes operacionale të zonës sinkrone:
 - a. informacionin mbi strukturën e procesit të aktivizimit të zonës sinkrone, duke përfshirë të paktën informacionin mbi zonat e monitorimit, zonat LFC dhe blloqet LFC të përcaktuara dhe OST-të përkatëse; dhe
 - b. informacionin mbi strukturën e përgjegjësisë së procesit të zonës sinkrone, duke përfshirë të paktën informacionin mbi proceset e zhvilluara në përputhje me nenin 209 (1) dhe (2).
2. Të gjithë OST-të që zbatojnë një proces të netimit të disbalancave duhet të publikojnë informacione lidhur me atë proces, i cili duhet të përfshijë të paktën listën e OST-ve pjesëmarrëse dhe datën e fillimit të procesit të netimit të disbalancave.

Neni 247. Informacioni mbi FCR

1. OST-të e zonës sinkrone do të dërgojnë metodën e dimensionimit për FCR në [;përputhje me nenin 222 (2) tek ENTSO-E për publikim të paktën 1 muaj para aplikimit të saj.
2. OST-të e zonës sinkrone do të dërgojnë sasinë totale të kapacitetit rezervë të FCR dhe ndarjen e kapacitetit rezervë të FCR të kërkuar për secilin OST të specifikuar në përputhje me nenin 222 (1) si detyrim fillestar i FCR te ENTSO-E për publikim të paktën 1 muaj para aplikimit të tyre.
3. OST-të e zonës sinkrone do të dërgojnë vetitë e FCR të përcaktuara në përputhje me nenin 223 (2) dhe kërkesat shtesë për grupet ofruese të FCR në përputhje me nenin 223 (3) te ENTSO-E për publikim të paktën 3 muaj para aplikimit të tyre.

Neni 248. Informacioni mbi FRR

1. OST-të e bllokut LFC duhet të dërgojnë kërkesat e disponueshmërisë së FRR dhe kërkesat për cilësinë e kontrollit të specifikuar në përputhje me nenin 227 (2) si dhe kërkesat teknike për lidhjen të specifikuar në përputhje me nenin 227 (3) për bllokun e tyre LFC te ENTSO-E për publikim të paktën 3 muaj para aplikimit të tyre.
2. OST-të e bllokut LFC do të dërgojnë rregullat e dimensionimit të FRR të specifikuar për bllokun e tyre LFC në përputhje me nenin 226 (1) te ENTSO-E për publikim të paktën 3 muaj para hyrjes në fuqi të marrëveshjes së operimit të bllokut LFC.
3. OST-të e zonës sinkrone do të dërgojnë, deri më 30 nëntor të çdo viti, një parashikim të kapaciteteve rezervë të FRR të secilit bllok LFC për vitin e ardhshëm te ENTSO-E për publikim.

4. OST-të e zonës sinkrone do të dërgojnë, brenda 30 ditëve pas përfundimit të tremujorit, kapacitetet rezervë aktuale të FRR të çdo bllok LFC të tremujorit të fundit të ENTSO-E për publikim.

Neni 249. Informacioni mbi RR

1. OST-të e bllokut LFC që operojnë një proces të zëvendësimit të rezervës duhet të dërgojnë kërkesat e disponueshmërisë së RR të përcaktuara në përputhje me nenin 230 (2) dhe kërkesat teknike për lidhjen të specifikuar në përputhje me nenin 230 (3) për bllokun e tyre LFC të ENTSO-E për publikim brenda 3 muajve para zbatimit të tyre.
2. OST-të e zonës sinkrone do të dërgojnë, deri më 30 nëntor të çdo viti, një parashikim të kapaciteteve rezervë të RR të secilit bllok LFC për vitin e ardhshëm të ENTSO-E për publikim.
3. OST-të e zonës sinkrone do të dërgojnë, brenda 30 ditëve pas përfundimit të tremujorit, kapacitetet rezervë aktuale të RR të secilit bllok LFC të tremujorit të fundit të ENTSO-E për publikim.

Neni 250. Informacioni mbi ndarjen dhe shkëmbimin

1. OST-të e zonës sinkrone do të dërgojnë përmbledhjet vjetore të marrëveshjeve për ndarjen e FRR dhe për ndarjen e RR për çdo bllok LFC brenda zonës sinkrone të ENTSO-E për publikim në përputhje me nenet 248 (3) dhe 249 (2). Këto përmbledhje duhet të përfshijnë informacionin e mëposhtëm:
 - a. identitetin e blloqeve LFC ku ka një marrëveshje për ndarjen e FRR ose RR; dhe
 - b. pjesën e FRR dhe RR që reduktohet për shkak të çdo marrëveshjeje për ndarjen e FRR ose RR.
2. Të gjithë OST-të e secilës zonë sinkrone do të dërgojnë informacionin për ndarjen e FCR midis zonave sinkrone të ENTSO-E për publikim në përputhje me nenin 247 (1). Ky informacion duhet të përfshijë:
 - a. sasinë e kapacitetit rezervë të FCR të ndarë midis OST-ve që kanë hyrë në marrëveshje për ndarjen e FCR; dhe
 - b. efektet e ndarjes së FCR në kapacitetin rezervë të FCR të OST-ve të përfshira.
3. Aty ku është e aplikueshme, të gjithë OST-të do të publikojnë informacionin për shkëmbimin e FCR, FRR dhe RR.

Aneksi I

Nivelet e tensionit të përmendura në nenin 108:

Tabela 1. Diapazonet e tensionit në pikën e lidhjes midis 110 kV dhe 300 kV

Zona sinkrone	Niveli i tensionit
Evropa kontinentale	0,90 pu-1,118 pu

Tabela 2. Diapazonet e tensionit në pikën e lidhjes midis 300 kV dhe 400 kV

Zona sinkron	Niveli i tensionit
Evropa kontinentale	0,90 pu-1,05 pu

Aneksi II

Parametrat përcaktues të cilësisë së frekuencës të përmendura në nenin 199:

Tabela 1. Parametrat e përcaktimit të cilësisë së frekuencës së zonës sinkrone

	Evropa kontinentale
Diapazoni i frekuencës standarde	± 50 mHz
Devijimi maksimal i frekuencës së çastit	800 mHz
Devijimi maksimal i frekuencës së gjendjes së qëndrueshme	200 mHz
Koha rivendosjen e frekuencës	15 minuta
Koha e aktivizimit të gjendjes së alarmit	5 minuta

Parametrat e synuar të cilësisë së frekuencës të përmendura në nenin 199:

Tabela 2. Parametrat e synuar të cilësisë së frekuencës

	Evropa kontinentale
Numri maksimal i minutave jashtë diapazonit të frekuencës standarde	15 000

Aneksi III

Kërkesat teknike minimale të FCR të përmendura në nenin 223:

Karakteristikat e FCR

Saktësia minimale e matjes së frekuencës	10 mHz ose standardi industrial nëse është më i mirë
Efekti maksimal i kombinuar i pandjeshmërisë së përgjigjes së frekuencës dhe nivelit minimal të përgjigjes së mundshme të frekuencës të njëjësive ofruese të FCR ose grupeve ofruese të FCR.	10 mHz
Koha e aktivizimit të plotë FCR	30 s
Devijimi i plotë i frekuencës së aktivizimit FCR.	± 200 mHz

Aneksi IV

Kufizimet dhe kërkesat për shkëmbimin e FCR të përmendura në nenin 232:

Kufizimet dhe kërkesat për shkëmbimin e FCR

Shkëmbimi i FCR lejohet midis:	Kufizimet për shkëmbimin e FCR
OST-të e blloqeve LFC fqinje	<ul style="list-style-type: none"> ○ OST-të e një blloku LFC duhet të sigurojnë se të paktën 30% e detyrimeve të tyre totale të kombinuara fillestare të FCR ofrohen fizikisht brenda bllokut të tyre LFC; dhe ○ sasia e kapacitetit rezervë të FCR, e vendosur fizikisht në një bllok LFC si rezultat i shkëmbimit të FCR me blloqe të tjera LFC, do të kufizohet në maksimum prej: <ul style="list-style-type: none"> ▪ 30% detyrimeve totale të kombinuara fillestare të FCR të OST-ve të bllokut LFC në të cilin kapaciteti rezervë i FCR është i lidhur fizikisht; dhe ▪ 100 MW kapacitet rezervë të FCR.
OST-të e zonave LFC të të njëjtit bllok LFC	<ul style="list-style-type: none"> ○ OST-të e zonave LFC që përbëjnë një bllok LFC kanë të drejtë të specifikojnë në marrëveshjen e operimit të bllokut LFC kufizime të brendshme për shkëmbimin e FCR midis zonave LFC të të njëjtit bllok LFC në mënyrë që të: <ul style="list-style-type: none"> ▪ pengohen konxhestionet e brendshme në rast të aktivizimit të FCR; ▪ sigurohet një shpërndarje e barabartë e kapacitetit rezervë të FCR për rastin e ndarjes së rjetit; dhe ▪ shmanget cënimi i qëndrueshmërisë së FCP ose sigurisë së operimit

Aneksi V

Kërkesat dhe kufizimet për shkëmbimin e FRR brenda zonës sinkrone të përmendura në nenin 236:

Kërkesat dhe kufizimet për shkëmbimin e FRR

Shkëmbimi i FRR lejohet midis	Kufizimet për shkëmbimin e FRR
OST të blloqeve LFC të ndryshme	<ul style="list-style-type: none"> ○ OST-të e një blloku LFC duhet të sigurojnë se të paktën 50% e kapacitetit rezervë total të tyre të kombinuar të FRR që rezultojnë nga rregullat e dimensionimit të FRR në nenin 226 (1) dhe para çdo reduktimi për shkak të ndarjes së FRR në përputhje me nenin 226 (2) mbetet brenda bllokut të tyre LFC.
OST të zonave LFC të të njëjtit bllok LFC	<ul style="list-style-type: none"> ○ OST-të e zonave LFC që përbëjnë një bllok LFC do të kenë të drejtë, nëse është e nevojshme, të përcaktojnë kufizime të brendshme, për shkëmbimin e FRR midis zonave LFC të bllokut LFC në marrëveshjen e operimit të bllokut LFC që të: <ul style="list-style-type: none"> ▪ pengohen konxhestionet e brendshme për shkak të aktivizimit të kapacitetit rezervë të FRR, subjekt i shkëmbimit të FRR; ▪ sigurohet një shpërndarje e barabartë e FRR në të gjithë zonën sinkrone dhe blloqet LFC në rast të ndarjes së rjetit; ▪ shmanget cënimi i qëndrueshmërisë së FRP ose sigurisë së operimit.

Aneksi VI

Kërkesat dhe kufizimet për shkëmbimin e RR brenda zonës sinkrone të përmendura në nenin 238:

Kërkesat dhe kufizimet për shkëmbimin e RR

Shkëmbimi i RR lejohet midis	Kufizimet për shkëmbimin e RR
OST të blloqeve LFC të ndryshme	<ul style="list-style-type: none">○ OST-të e zonave LFC që përbëjnë një bllok LFC duhet të sigurojnë se të paktën 50% e kapacitetit rezervë total të tyre të kombinuar të RR që rezulton nga rregullat e dimensionimit të RR sipas nenit 229 (3) para çdo reduktimi të kapacitetit rezervë të RR si rezultat i ndarjes së RR sipas nenit 229 (4) dhe nenit 229 (5), mbetet brenda bllokut të tyre LFC.
OST të zonave LFC të të njëjtit bllok LFC	<ul style="list-style-type: none">○ OST-të e zonave LFC që përbëjnë një bllok LFC do të kenë të drejtë, nëse kërkohet, të përcaktojnë kufizime të brendshme për shkëmbimin e RR midis zonave LFC të bllokut LFC në marrëveshjen e operimit të bllokut LFC që të:<ul style="list-style-type: none">▪ pengohen konxhestionet e brendshme për shkak të aktivizimit të kapacitetit rezervë të RR, subjekt i shkëmbimit të RR;▪ sigurohet një shpërndarje të barabartë e RR në të gjithë zonën sinkrone në rast të ndarjes së rrjetit; dhe▪ shmanget cënimi i qëndrueshmërisë së FRP ose sigurisë së operimit

KODI I EMERGJENCËS DHE RESTAURIMIT

Pjesa I – Dispozita të përgjithshme

Neni 251. Objekti

1. Për ruajtjen e sigurisë operationale dhe parandalimin e përhapjes së një incidenti në shkallë të gjerë dhe rënien e plotë të sistemit, si dhe për të lejuar rikthimin e shpejtë dhe efikas në gjendjen normale të sistemit nga gjendja e alarmit ose black-out-it, nenet në vijim përcaktojnë kërkesat mbi:
 - a. menaxhimin nga OST të gjendjes së emergjencës, black-out-it dhe rivendosjes;
 - b. koordinimin e sistemit të operimit në zonën sinkrone në gjendjet e emergjencës, black-out-it dhe rivendosjes;
 - c. simulimet dhe testimet e nevojshme për të garantuar rivendosjen e besueshme dhe të shpejtë të sistemit në gjendjen normale;
 - d. mjetet dhe pajisjet e nevojshme për të garantuar rivendosjen në gjendjen normale nga gjendja e emergjencës ose black-out-it.

Neni 252. Fushëveprim

1. Dispozitat në vijim zbatohen mbi: OST, OSSH, SGU-të, ofruesit e shërbimeve të mbrojtjes, ofruesit e shërbimeve të rivendosjes, palët përgjegjëse të balancimit, ofruesit e shërbimeve të balancimit, operatorin e emëruar të tregut (NEMO) dhe subjektet e tjera të caktuara për të kryer funksionet e tregut në përputhje me Rregulloren e Komisionit (BE) 2015/1222¹² dhe Rregulloren e Komisionit (BE) 2016/1719¹³.

Neni 253. Koordinimi rajonal

1. Gjatë hartimit/rishikimit të planit të mbrojtjes dhe rivendosjes, OST sigurohet që masat e planit të tij të mbrojtjes dhe rivendosjes janë në konsistencë me masat dhe planet e OST-ve fqinje së paku për:
 - a. asistencën dhe koordinimin në gjendjen e emergjencës me OST-të fqinje, në përputhje me nenin 257;
 - b. procedurën e menaxhimit të frekuencës, duke përjashtuar vendosjen e frekuencës target, në rastin e një strategjie të ri-energizimit nga poshtë-lart para çdo ri-sinkronizimi në sistemin e transmetimit të interkonektuar në pajtim me nenin 261 dhe nenin 271;
 - c. suportin për procedurën e fuqisë aktive, sipas nenit 264;
 - d. strategjinë e ri-energizimit nga lart-poshtë, sipas nenit 270.

¹² Commission Regulation (EU) 2015/1222 of 24 July 2015 establishing a guideline on capacity allocation and congestion management

(OJ L 197, 25.7.2015, p. 24).

¹³ Commission Regulation (EU) 2016/1719 of 26 September 2016 establishing a guideline on forward capacity allocation (OJ L 259, 27.9.2016, p. 42)

2. Vlerësimi i qëndrueshmërisë së planit të mbrojtjes dhe të rivendosjes së sistemit në përputhje me paragrafin 1 do të përfshijë detyrat e mëposhtme:
 - a. shkëmbimin e informacionit dhe të dhënave që lidhen me masat e përmendura në paragrafin 1 ndërmjet OST-ve në fjalë;
 - b. identifikimin e papajtueshmërisë së masave të përmendura në paragrafin 1, në planet e OST-ve të përfshira;
 - c. identifikimin e çënimeve të mundshme të sigurisë operationale në rajonin e llogaritjes së kapacitetit. Këto çënime përfshijnë, ndër të tjera, avaritë e regjimit të përbashkët rajonal me ndikim të rëndësishëm në sistemet e transmetimit të OST-ve të përfshira;
 - d. konsultimet me RSC-të për të analizuar konsistencën e masave të përmendura në paragrafin 1 brenda gjithë zonës përkatëse sinkrone;

Pjesa II – Plani i mbrojtjes

Titulli 1 – Hartimi, implementimi dhe aktivizimi

Neni 254. Hartimi i planit të mbrojtjes së sistemit, masat teknike, organizative dhe parimet e zbatimit të masave

1. OST në konsultim me OSSH dhe SGU-të, harton planin e mbrojtjes së sistemit.
2. Gjatë hartimit të planit të mbrojtjes, OST merr parasysh elementet e mëposhtëm:
 - a. kufijtë e sigurisë operationale të përcaktuar në përputhje me nenin 106 të kodit;
 - b. sjelljen dhe aftësitë e ngarkesës dhe gjenerimit;
 - c. nevojat specifike të përdoruesve të rëndësishëm të rrjetit me prioritet të lartë;
 - d. karakteristikat e sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes.
3. Plani i mbrojtjes duhet të përmbajë, të paktën, dispozitat e mëposhtme:
 - a. kushtet në të cilat aktivizohet plani i mbrojtjes së sistemit, në përputhje me nenin 256;
 - b. udhëzimet e planit të mbrojtjes që jepen nga OST;
 - c. masat që duhet të merren, subjekt i konsultimit ose koordinimit në kohë reale me palët e identifikuar.
4. Plani i mbrojtjes së sistemit përfshin edhe elementet e mëposhtëm:
 - a. listën e masave që duhet të zbatohet nga OST në instalimet e tij;
 - b. listën e masave që do të zbatohet nga OSSH, përgjegjëse për zbatimin e këtyre masave në instalimet e tij;
 - c. listën e SGU-ve për zbatimin në instalimet e tyre të masave si rrjedhojë e kërkesave të detyrueshme të përcaktuara në kodet e lidhjes të miratuara nga ERE ose legjislacioni kombëtar;

- d. listën e përdoruesve të rëndësishëm të rrjetit me prioritet të lartë, me afatet dhe kushtet për shkyçjen e tyre; si dhe
 - e. kohën e zbatimit për secilën masë të listuar në planin e mbrojtjes së sistemit.
5. Plani i mbrojtjes së sistemit duhet të përfshijë të paktën masat e mëposhtme teknike dhe organizative:
- a. skemat e mbrojtjes së sistemit duke përfshirë:
 - i. skemën automatike të kontrollit në nën-frekuencë, në përputhje me nenin 258;
 - ii. skemën automatike të kontrollit në mbi-frekuencë, në përputhje me nenin 259;
 - b. skemën automatike të kontrollit kundrejt kolapsit të tensionit, në përputhje me nenin 260.
 - c. procedurat e planit të mbrojtjes së sistemit, duke përfshirë:
 - i. procedurën e menaxhimit të devijimit të frekuencës në përputhje me nenin 261;
 - ii. procedurën e menaxhimit të devijimit të tensionit në përputhje me nenin 262;
 - iii. procedurën e menaxhimit të flukseve të fuqisë në përputhje me nenin 263;
 - iv. procedurën për suportin e fuqisë aktive në përputhje me nenin 264;
 - v. procedurën e shkyçjes manuale të kërkesës në përputhje me nenin 265.
6. Hartimi i masave që duhet të zbatohen në planin e mbrojtjes bëhet sipas parimeve të mëposhtme:
- a. impakti i tyre në përdoruesit e sistemit duhet të jetë minimal;
 - b. ato duhet të jenë ekonomikisht efikase;
 - c. aktivizohen vetëm masat e nevojshme;
 - d. zbatimi i masave nuk çon OST ose OST-të fqinje në gjendje emergjence ose gjendje black-out.

Neni 255. Implementimi i planit të mbrojtjes

- 1. OST njofton OSSH për afatet për implementim, të cilat do të zbatohen mbi:
 - a. instalimet e OSSH;
 - b. instalimet e SGU-ve të lidhur me sistemin e shpërndarjes; ose
 - c. instalimet e ofruesve të shërbimit të mbrojtjes të lidhur në OSSH (nëse ka).

2. OST njofton SGU-të të lidhur drejtpërdrejtë në transmetim ose ofruesit e shërbimit të mbrojtjes të lidhur drejtpërdrejt në transmetim për masat dhe afatet që duhet të zbatohen në instalimet e tyre.
3. OSSH, SGU ose ofruesi i shërbimit të mbrojtjes duhet:
 - a. të zbatojë masat e njoftuara për zbatim jo më vonë së 12 muaj nga data e njoftimit;
 - b. të mirëmbajë masat e zbatuara mbi instalimet e tij;
 - c. t'i konfirmojë operatorit të rrjetit implementimin e masave.
4. OST do të mirëmbajë masat e zbatuara.

Neni 256. Aktivizimi i planit të mbrojtjes së sistemit

1. OST do të aktivizojë procedurat e planit të mbrojtjes së sistemit në përputhje me pikën (b) të nenit 254 (5) në koordinim me OSSH dhe SGU-të të identifikuar sipas nenit 254 (4) dhe siguruesve të shërbimit të mbrojtjes.
2. Përveç skemave të aktivizuara automatikisht të planit të mbrojtjes së sistemit, në përputhje me pikën (a) të nenit 254 (5), OST do të aktivizojë procedurën e planit të mbrojtjes së sistemit nëse:
 - a. sistemi është në gjendje emergjence në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 99 të kodit dhe nuk ka veprime korrigjuese në dispozicion për të rikthyer sistemin në gjendjen normale; ose
 - b. bazuar në analizën e sigurisë operacionale, siguria e sistemit të transmetimit kërkon aktivizimin e një mase të planit të mbrojtjes në përputhje me nenin 254 (5), përveç veprimeve korrigjuese në dispozicion.
3. OSSH dhe SGU i identifikuar sipas nenit 254 (4), si dhe çdo ofrues i shërbimeve të mbrojtjes duhet të zbatojë pa vonesa të panevojshme udhëzimet e planit të mbrojtjes të sistemit të lëshuara nga OST në përputhje me pikën (c) të nenit 254 (3), në përputhje me procedurat e planit të mbrojtjes të sistemit të parashikuara në pikën (b) të nenit 254 (5)
4. OST do të aktivizojë procedurat e planit të mbrojtjes së sistemit të përmendur në pikën (b) të nenit 254 (5) që kanë një ndikim të rëndësishëm ndërkufitar në koordinim me OST-të e prekura.

Neni 257. Ndhima dhe koordinimi në gjendjen e emergjencës me OST-të fqinje

1. OST do të ofrojë nëpërmjet interkonektorëve çdo ndihmë të mundshme për OST-në fqinje që është në gjendje emergjence, nëse kjo ndihmë nuk shkakton hyrjen në gjendje emergjence ose black-out-i të vetë OST-së.
2. OST procedon me shkyçjen manuale të çdo elementi të sistemit të transmetimit që ka ndikim të rëndësishëm ndërkufitar, përfshirë një interkonektor, pasi:
 - a. Koordinon me OST-të fqinje; dhe

- b. Sigurohet që veprimi nuk çon sistemin e transmetimit të mbetur të ndërlidhur, në gjendje emergjence ose black-out-i.
3. Në rrethana të jashtëzakonshme ku nënkuptohet çënimi i kufijve të sigurisë operacionale, parandalimi i rrezikut dhe sigurisë së personelit ose dëmtimit të pajisjeve, OST mund të shkyçë manualisht pa koordinim çdo element të sistemit të transmetimit që ka ndikim të konsiderueshëm ndërkufitar, duke përfshirë një interkonektor. Brenda 30 ditëve nga incidenti, OST harton një raport me një shpjegim të detajuar të arsyeve, zbatimit dhe ndikimit të këtij veprimi dhe ia dorëzon atë ERE, OST-ve fqinje dhe përdoruesve të sistemit të prekur në mënyrë të konsiderueshme.

Titulli 2 - Masat e planit të mbrojtjes së sistemit

Neni 258. Skema e kontrollit automatik në nënfrekuencë

1. Skema për kontrollin automatik në nën-frekuencë të planit të mbrojtjes së sistemit duhet të përfshijë një skemë për shkyçjen automatike të kërkesës dhe tarimet e frekuencës së limituar në modalitetin sensitiv LFSM-U, në zonën kontrollit LFC të OST.
2. Në hartimin e planit të mbrojtjes së sistemit, OST duhet të sigurojë aktivizimin në modalitetin LFSM-U, para aktivizimit të skemës së shkyçjes automatike të kërkesës nga frekuenca e ulët, me kusht që gradienti i ndryshimit të frekuencës ta lejojë atë.
3. Para aktivizimit të skemës automatike të shkyçjes së kërkesës në frekuencë të ulët, OST dhe OSSH duhet të sigurojnë që njësitë e rezervimit të energjisë që veprojnë si ngarkesë të lidhur me sistemin e tij:
 - a. kalon automatikisht në modalitetin gjenerim brenda kufirit kohor dhe në pikën e caktuar të fuqisë aktive të përcaktuar nga OST në planin e mbrojtjes së sistemit; ose
 - b. kur njësia e rezervimit të energjisë nuk është në gjendje të shkyçet brenda afatit kohor të përcaktuar nga OST në planin e mbrojtjes së sistemit, automatikisht shkyçet njësia e rezervimit të energjisë që vepron si ngarkesë.
4. OST duhet të përcaktojë në planin e mbrojtjes së tij pragjet e frekuencës në të cilat do të ndodhë kyçja ose shkyçja automatike e njësive të rezervimit të energjisë. Këto pragje frekuence duhet të jenë më të ulta ose të barabarta me kufirin e frekuencës së sistemit të përcaktuar për gjendjen e emergjencës në nenin 99 (3) të kodit dhe më të larta së kufiri i frekuencës për shkyçjen e kërkesës duke filluar nga niveli i detyrueshëm të përcaktuar në Aneks I.
5. OST do të hartojë skemën e shkyçjes automatike të kërkesës për frekuencë të ulët në përputhje me parametrat për shkarkimin e ngarkesës në kohë reale të përcaktuar në Aneks I. Skema duhet të përfshijë shkyçjen e kërkesës në frekuenca të ndryshme, nga "niveli fillestar i detyrueshëm" në një "nivel përfundimtar të detyrueshëm", brenda një rangu zbatimi, duke respektuar një numër minimal dhe përmasa maksimale të hapave. Rangu i zbatimit do të përcaktojë devijimin maksimal të lejuar të ngarkesës neto të shkyçur nga ngarkesa neto e synuar që do të shkyçet për një frekuencë të caktuar, i

- llogaritur nëpërmjet një interpolimi linear ndërmjet niveleve fillestare dhe përfundimtare të detyrueshme.
6. OST ose OSSH duhet të instalojnë reletë e nevojshme për shkyçjen e ngarkesës në frekuencë të ulët, duke marrë parasysh të paktën sjelljen e ngarkesës dhe gjenerimin e lidhur në shpërndarje.
 7. Gjatë implementimit të skemës për shkyçje automatike të ngarkesës për frekuencë të ulët në pajtim me Nenin 6 (2), OST ose OSSH duhet:
 - a. të shmangë vendosjen e vonesës së qëllimshme të kohës, përveç kohës së funksionimit të releve dhe çelësave;
 - b. të minimizojë shkyçjen e moduleve gjeneruese të energjisë, veçanërisht ata që sigurojnë inerci;
 - c. të kufizojë rrezikun që skema të çojë në devijime të flukseve të energjisë dhe devijime të tensionit jashtë kufijve të sigurisë operacionale.
 8. Nëse OSSH nuk mund të përmbushë kërkesat sipas pikave (b) dhe (c), ai duhet të njoftojë OST-në dhe të propozojë se cila kërkesë do të zbatohet. OST, në konsultim me OSSH do të përcaktojë kërkesat e zbatueshme në bazë të një analize të përbashkët kosto-përfitimi.
 9. Skema e planit të mbrojtjes së sistemit për shkyçjen automatike të ngarkesës në nën frekuencë mund të sigurojë shkyçjen e ngarkesës së netuar bazuar në gradientin e frekuencës me kusht që:
 - a. aktivizohet vetëm nëse:
 - i. kur devijimi i frekuencës është më i lartë së devijimi maksimal i frekuencës së gjendjes së qëndrueshme dhe gradienti i frekuencës është më i lartë së ai i shkaktuar nga incidenti referent;
 - ii. derisa frekuenca të arrijë frekuencën e shkyçjes së ngarkesës duke filluar nga niveli i detyrueshëm;
 - b. është në përputhje me Aneksin I; dhe
 - c. është e nevojshme dhe e justifikuar për të ruajtur në mënyrë efikase sigurinë operacionale.
 10. OST mund të përfshijë në skemën e planit të mbrojtjes për shkyçjen automatike të ngarkesës në nën- frekuencë, hapa shtesë për shkyçjen e ngarkesës së netuar, nën nivelin e detyrueshëm përfundimtar të shkyçjes së ngarkesës të përcaktuar në Aneks I.
 11. OST do të ketë të drejtë të implementojë skema shtesë të mbrojtjes së sistemit që shkaktohen nga një frekuencë më e vogël ose e barabartë me frekuencën e nivelit përfundimtar të detyrueshëm të shkyçjes së ngarkesës dhe që synojnë një proces më të shpejtë të rivendosjes. OST do të sigurohet që skema të tilla shtesë të mos përkeqësojnë më tej frekuencën.

Neni 259. Skema e kontrollit automatik në mbi-frekuencë

1. Skema për kontrollin automatik në mbi-frekuencë e planit të mbrojtjes së sistemit duhet të çojë në një ulje automatike të fuqisë totale aktive të injektuar në zonën e kontrollit LFC.
2. Në konsultim me OST-të e tjera të zonës sinkrone, OST do të përcaktojë parametrat e mëposhtëm të skemës së tij për kontrollin automatik në mbi-frekuencë:
 - a. pragjet e frekuencës për aktivizimin e tij;
 - b. raportin e reduktimit të injektimit të fuqisë aktive.
3. OST duhet të përcaktojë skemën e tij automatike të kontrollit të frekuencës duke marrë parasysh aftësitë e moduleve gjeneruese të energjisë në lidhje me modalitetin në LFSM-O dhe të njërive të rezervimit të energjisë, në zonën e tij të LFC-së. Nëse modaliteti në LFSM-O nuk ekziston ose nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur kërkesat e përcaktuara në pikat (a) dhe (b) të paragrafit 2, OST mund të bëjë shkyçjen me hapa lineare të gjenerimit në zonën e tij LFC. OST do të përcaktojë madhësinë maksimale të hapave për shkyçjen e moduleve gjeneruese të energjisë dhe / ose të sistemeve HVDC në konsultim me OST-të e tjera të zonës sinkrone.

Neni 260. Skema automatike kundrejt kolapsit të tensionit

1. Skema automatike kundrejt kolapsit të tensionit të planit të mbrojtjes së sistemit mund të përfshijë një ose më shumë nga skemat e mëposhtme në varësi të rezultateve të vlerësimit të sigurisë së sistemit të OST:
 - a. Skema e shkyçjes së ngarkesës nga tensioni i ulët në përputhje me nenin 19(2) të kodit “Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin të Objekteve të Ngarkesës” i miratuar me Vendimin ERE Nr. 128 Datë 04.06.2018;dhe
 - b. Skema e bllokimit automatik e rregullatorit të tensionit në ngarkesë në pajtim me nenin 19 (3) të Kodit “Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin të Objekteve të Ngarkesës” i miratuar me Vendimin ERE Nr. 128 Datë 04.06.2018;
 - c. Skemat e mbrojtjes së sistemit për menaxhimin e tensionit.
2. Përveç nëse në pajtim me paragrafin 1, vlerësimi demonstroi që implementimi i skemës së bllokimit automatik të rregullatorit të degëzimeve nuk është i nevojshëm për të parandaluar një kolaps të tensionit, OST do të përcaktojë kushtet nën të cilat rregullatori automatik do të bllokojë degëzimet në pajtim me nenin 13 (3) të Kodit “Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin të Objekteve të Ngarkesës” i miratuar me Vendimin ERE Nr. 128 Datë 04.06.2018;dhe duke përfshirë së paku:
 - a. metodën e bllokimit (lokale apo në distancë nga dhoma e kontrollit);
 - b. pragun e nivelit të tensionit në pikën e lidhjes;
 - c. drejtimin e flukseve të fuqisë reaktive;
 - d. maksimumin e vonës në kohë ndërmjet detektimit të pragut dhe bllokimit.

Neni 261. Procedura e menaxhimit të devijimit të frekuencës

1. Procedura për menaxhimin e devijimeve të frekuencës e planit të mbrojtjes së sistemit duhet të përmbajë një grup masash për të menaxhuar devijimin e frekuencës jashtë kufijve të frekuencës të përcaktuar për gjendjen e alarmit në nenin 99 (2) të kodit. Procedura e menaxhimit të devijimit të frekuencës duhet të jetë në përputhje me procedurat e përcaktuara për veprimet përmirësuese të cilat duhet të menaxhohen në mënyrë të koordinuar në përputhje me nenin 157 (2) të kodit dhe duhet të përmbushin të paktën kërkesat e mëposhtme:
 - a. zvogëlimi i gjenerimit duhet të jetë më i vogël se zvogëlimi i ngarkesës gjatë ngjarjeve në nën-frekuencë;
 - b. zvogëlimi i gjenerimit duhet të jetë më i madh se zvogëlimi i ngarkesës gjatë ngjarjeve në mbi-frekuencë.
2. OST duhet të përshtatë mënyrën e operimit të LFC-së së tij për të parandaluar ndërhyrjen në aktivizimin manual ose çaktivizimin e fuqisë aktive siç përcaktohet në paragrafët 3 dhe 5.
3. OST ka të drejtën të përcaktojë një set-point të fuqisë aktive që çdo SGU e identifikuar sipas pikës (c) të nenit 254 (4) duhet të mbajë, me kusht që set-point të përmbushë kufizimet teknike të SGU. OST ka të drejtë të përcaktojë një set-point të fuqisë aktive që secili ofrues i shërbimit të mbrojtjes duhet të mbajë, me kusht që kjo masë të zbatohet mbi ta sipas termave dhe kushteve kontraktuale dhe set-point i tij respekton kufizimet teknike të ofruesit të shërbimit të mbrojtjes. SGU-të dhe ofruesit e shërbimit të mbrojtjes duhet të zbatojnë pa vonesë të panevojshme udhëzimet e dhëna nga OST direkt ose indirekt nëpërmjet OSSH dhe do të qëndrojnë në atë gjendje deri në lëshimin e udhëzimeve të mëtejshme. Kur udhëzimet jepen drejtpërdrejt, OST do të informojë OSSH pa vonesë të panevojshme.
4. OST ka të drejtë të shkyçë SGU-të dhe ofruesit e shërbimit të mbrojtjes, drejtpërdrejt ose tërthorazi nëpërmjet OSSH. SGU-të dhe ofruesit e shërbimit të mbrojtjes do të mbeten të shkëputur deri në lëshimin e udhëzimeve të mëtejshme. Kur SGU-të shkyçen direkt, OST do të informojë OSSH pa vonesë të panevojshme. Brenda 30 ditëve nga incidenti, OST do të përgatisë një raport që përmban një shpjegim të hollësishëm të arsyesimit, zbatimit dhe ndikimit të këtij veprimi dhe t'ia dorëzojë atë ERE-s në përputhje me nenin 37 të Direktivës 2009/72 / EC, si dhe e bëjnë atë të disponueshme për përdoruesit e sistemit të prekur ndjeshëm.
5. Para aktivizimit të skemës automatike të shkyçjes së ngarkesës në nën-frekuencë të përcaktuar në nenin 258 dhe me kusht që gradienti i ndryshimit të frekuencës ta lejojë atë, OST direkt ose indirekt nëpërmjet OSSH, do aktivizojë përgjigjen e kërkesës nga ofruesit respektivë të shërbimit të mbrojtjes dhe:
 - a. kalojnë njësitë e rezervimit të energjisë që veprojnë si ngarkesë në regjimin në gjenerim në një set-point të fuqisë aktive të përcaktuar nga OST në planin e mbrojtjes së sistemit; ose

- b. kur njësia e rezervimit të energjisë nuk është e aftë të kyçet shpejt sa duhet për të stabilizuar frekuencën, manualisht shkëput njësinë e rezervimit të energjisë.

Neni 262. Procedura e menaxhimit të devijimit të tensionit

1. Procedura e menaxhimit të devijimit të tensionit e planit të mbrojtjes së sistemit do të përmbajë një grup masash për të menaxhuar tensionin jashtë limiteve të sigurisë operacionale të përcaktuar në nenin 106 të kodit.
2. OST ka të drejtë të përcaktojë diapazonin e fuqisë reaktive ose diapazonin e tensionit dhe të udhëzojë OSSH dhe përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit të identifikuar për këtë masë në pajtim me neni 254 (4) për ta mirëmbajtur atë, në pajtim me nenin 109 dhe 110 të kodit.
3. Me kërkesë të OST-se fqinje në gjendje emergjence, OST do të bëjë të disponueshme të gjitha aftësitë për fuqi reaktive që nuk e çojnë sistemin në gjendje emergjence ose black-out-i.

Neni 263. Procedura e menaxhimit të flukseve të fuqisë

1. Procedura e planit të mbrojtjes së sistemit për menaxhimin e flukseve të fuqisë duhet të përfshijë një grup masash për të menaxhuar flukset e fuqisë jashtë kufijve të sigurisë operacionale të përcaktuara në nenin 106 të kodit.
2. OST ka të drejtën të përcaktojë një set-point të fuqisë aktive që secili SGU i identifikuar sipas pikës (c) të nenit 254 (4) duhet të mbajë, me kusht që set-pointi i caktuar të respektojë kufizimet teknike të SGU-së. SGU-të dhe ofruesit e shërbimit të mbrojtjes duhet të zbatojnë pa vonesë të panevojshme udhëzimet e dhëna nga OST direkt ose indirekt nëpërmjet OSSH dhe do të qëndrojnë në atë gjendje deri në lëshimin e udhëzimeve të mëtejshme. Kur udhëzimet jepen drejtpërdrejt, OST do të informojë OSSH pa vonesë të panevojshme.
3. OST ka të drejtë të shkyçë SGU-të dhe ofruesit e shërbimit të mbrojtjes, drejtpërdrejt ose indirekt nëpërmjet OSSH. SGU-të dhe ofruesit e shërbimit të mbrojtjes do të mbeten të shkëputur deri në lëshimin e udhëzimeve të mëtejshme. Kur SGU-të shkyçen drejtpërdrejt, OST do të informojë OSSH pa vonesë të panevojshme. Brenda 30 ditëve nga incidenti, OST do të përgatisë një raport që përmban një shpjegim të detajuar të arsyesimit, zbatimit dhe ndikimit të këtij veprimi dhe ia dorëzon atë autoritetit përkatës rregullator në përputhje me nenin 37 të Direktivës 2009/72 / EC.

Neni 264. Procedura për suportin e fuqisë aktive

1. Në rast të mungesës së mjaftueshmërisë së zonës së kontrollit për periudhën kohore të ditës në avancë ose brenda ditës, të identifikuar sipas paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 185 të kodit dhe para çdo pezullimi të mundshëm të aktiviteteve të tregut në pajtim me nenin 278, OST do të ketë të drejtë të kërkojë suport për energji aktive nga:
 - a. çdo ofrues shërbimi balancues, i cili, me kërkesën e OST, do të ndryshojë statusin e tij të disponueshmërisë për të vënë në dispozicion të gjithë fuqinë aktive të tij, me

- kusht që ajo të mos jetë e aktivizuar akoma në tregun balancues dhe në përputhje me kufizimet e tij teknike;
- b. çdo SGU i lidhur në zonën e LFC-së, i cili tashmë nuk ofron shërbim balancues për OST-në dhe i cili, me kërkesën e OST, do të bëjë të disponueshme të gjithë fuqinë e tij aktive, në përputhje me kufizimet e tij teknike; dhe
 - c. OST të tjerë që janë në gjendje normale ose alarmi.
2. OST mund të aktivizojë suportin për energji aktive nga një ofrues i shërbimit balancues ose një SGU, sipas pikës (a) dhe (b) të paragrafit 1, vetëm nëse ai ka aktivizuar të gjitha ofertat e energjisë balancuese në dispozicion, duke marrë parasysh kapacitetin ndër-zonal në dispozicion në momentin e mungesës së mjaftueshmerisë së zonës së kontrollit.
 3. Çdo OST i cili ka qenë subjekt i një kërkesë për suport për fuqi aktive sipas paragrafit 1 (c) duhet të:
 - a. vendosë në dispozicion ofertat e tij të pashpërndara;
 - b. të ketë të drejtën të aktivizojnë energjinë balancuese në dispozicion, në mënyrë që të sigurojë fuqinë korresponduese të OST-së që e kërkon; dhe
 - c. të ketë të drejtën të kërkojë asistencë për fuqi aktive nga ofruesit e shërbimit të balancimit dhe nga çdo SGU i lidhur në zonën e tij të LFC-së i cili nuk ofron shërbim balancues për OST, me qëllim që të sigurojë asistencën përkatëse për fuqinë aktive tek OST që e kërkon.
 4. Kur aktivizon fuqinë aktive të kërkuar sipas paragrafit 1 (c), OST kërkuese dhe marrëse do të kenë të drejtë të përdorin:
 - d. kapacitetin ndër-zonal në dispozicion në rast se aktivizimi bëhet përpara kohës së mbylljes së portës ndër-zonale brenda ditës dhe nëse sigurimi i kapaciteteve ndër-zonale në fjalë nuk është pezulluar sipas nenit 278;
 - e. kapacitetin shtesë që mund të jetë i disponueshëm për shkak të statusit në kohë reale të sistemit, në cilin rast OST-të kërkuese dhe OST-të që e kërkojnë duhet të koordinojnë me OST-të e tjera të prekura në mënyrë të ndjeshme në përputhje me nenin 253 (5).
 5. Pasi OST-të kërkuese dhe atyre që iu kërkohet kanë rënë dakord mbi kushtet për dhënien e suportit për energji aktive, shumica e rënë dakord e fuqisë aktive dhe kohëzgjatja e ofrimit duhet të jenë të qëndrueshme, përveç nëse sistemi i transmetimit i OST që siguron suportin hyn në gjendje emergjence ose black-out.

Neni 265. Procedura e shkyçjes manuale të kërkesës

1. Përveç masave të përcaktuara në nenet 261 deri 264, OST mund të përcaktojë një sasi të kërkesës neto për tu shkëputur manualisht, direkt nga OST ose në mënyrë të tërthortë nëpërmjet OSSH, kur nevojitet për të parandaluar përhapjen ose përkeqësimin e

- gjendjes së emergjencës. Kur ngarkesa duhet të shkyçet drejtpërdrejt, OST do të informojë pa vonësë OSSH-në.
2. OST do të aktivizojë shkyçjen manuale të kërkesës neto të përmendur në paragrafin 1 për:
 - a. të zgjidhur mbingarkesat ose situatat në nën-tension; ose
 - b. të zgjidhur situatat në të cilat është kërkuar suport për fuqinë aktive sipas nenit 264, por që nuk është e mjaftueshme për ruajtjen e mjaftueshmerisë për periudhat kohore një ditë para dhe brenda ditës në zonën e saj të kontrollit, në përputhje me nenin 185 të kodit, duke çuar në rrezik të përkeqësimit të frekuencës në zonën sinkrone.
 3. OST do të njoftojë OSSH-në për sasinë e kërkesës neto të caktuar për t'u shkyçtur në sistemin e shpërndarjes sipas paragrafit 1. OSSH do të shkyçë shumën e njoftuar të kërkesës neto, pa vonësë të panevojshme.
 4. Brenda 30 ditëve nga incidenti, OST do të përgatisë një raport që përmban një shpjegim të detajuar të arsyesimit, zbatimit dhe ndikimit të këtij veprimi dhe t'ia dorëzojë atë autoritetit përkatës rregullator në përputhje me nenin 37 të Direktivës 2009/72 / EC.

Pjesa III – Plani i rivendosjes

Titulli 1 – Hartimi, implementimi dhe aktivizimi

Neni 266. Hartimi i planit të rivendosjes

1. OST harton/rishikon planin e rivendosjes në konsultim me OSSH, SGU-të, dhe koordinon me OST-të fqinje.
2. Në planin e rivendosjes, OST merr parasysh:
 - a. sjelljen dhe aftësinë e ngarkesës dhe gjenerimit;
 - b. nevojat specifike të SGU-ve me prioritet të lartë të listuar në përputhje me paragrafin 4; dhe
 - c. karakteristikat e rrjetit të transmetimit dhe atij të OSSH.
3. Plani i rivendosjes duhet të përmbajë të paktën dispozitat e mëposhtme:
 - a. kushtet nën të cilat aktivizohet plani i rivendosjes, siç parashikohet në nenin 268;
 - b. udhëzimet e planit të rivendosjes që do të lëshohen nga OST; dhe
 - c. masat që i nënshtrohen konsultimit ose koordinimit në kohë reale me palët e identifikuar.
4. Në veçanti, plani i rivendosjes duhet të përfshijë elementët e mëposhtme:
 - a. një listë të masave që do të zbatohen nga OST në instalimet e tij;
 - b. një listë të masave që do të zbatohen nga OSSH në instalimet e tij;

- c. një listë e SGU-ve përgjegjëse për zbatimin në instalimet e tyre të masave që rezultojnë nga kërkesat e detyrueshme të përcaktuara në Rregulloren e miratuar nga ERE me anë të vendimeve 128 “Mbi miratimin e Kodit të Rrjetit për Ngarkesën” dhe 129” Mbi miratimin e Kodit të Rrjetit mbi kërkesat për lidhjen me rrjetin e gjeneruesve” të datës 04/06/2018 ose nga legjislacioni kombëtar dhe listën e masave që do të zbatohen nga këta SGU;
 - d. listën e përdoruesve të rrjetit me prioritet të lartë si dhe termat dhe kushtet për shkyçjen dhe ri-energizimin e tyre;
 - e. një listë të nënstacioneve të cilat janë thelbësore për procedurat e planit të rivendosjes;
 - f. numri i burimeve të energjisë në zonën e kontrollit të OST-së të nevojshme për të ri-energizuar sistemin e tij me strategjinë poshtë-lart me aftësinë për black-start, aftësi të ri-sinkronizimit të shpejtë (nëpërmjet operimit hous-load) dhe aftësisë së operimit në ishull; dhe
 - g. afatet e zbatimit për secilën masë të listuar.
5. Plani i rivendosjes përfshin masat e mëposhtme teknike dhe organizative:
- a. procedurën e ri-energizimit;
 - b. procedurën e menaxhimit të frekuencës;
 - c. procedurën e ri-sinkronizimit;
6. Masat e planit të rivendosjes duhet të jenë në përputhje me parimet e mëposhtme:
- a. ndikimi në përdoruesit e sistemit të jetë minimal;
 - b. masat të jenë efçente ekonomikisht;
 - c. të aktivizohen vetëm masat e nevojshme; dhe
 - d. nuk duhet të çojnë sistemin e transmetimit të interkonektuar në gjendje emergjence ose black-out.

Neni 267. Implementimi i planit të rivendosjes

1. OST do të njoftojë OSSH-në mbi masat të cilat do të zbatohen, duke përfshirë afatet për zbatimin, për:
 - a. instalimet e OSSH sipas nenit 266 (4);
 - b. instalimet e SGU-ve të identifikuar në përputhje me nenin 266 (4) dhe të lidhura me sistemin e shpërndarjes; dhe
 - c. instalimet e ofruesve të shërbimit të rivendosjes të lidhur me sistemin e shpërndarjes.
2. OST do të njoftojë SGU-të e identifikuar në përputhje me nenin 266 (4) dhe ofruesit e shërbimit të rivendosjes të lidhur drejtpërdrejt me sistemin e transmetimit mbi masat

- që do të zbatohen në instalimet e tyre, duke përfshirë afatet për zbatim sipas pikës (g) të nenit 266 (4).
3. OSSH dhe çdo SGU ose ofruesi i shërbimit të rivendosjes i njoftuar nga OST duhet:
 - a. të zbatojë masat e njoftuara jo më vonë se 3 muaj nga data e njoftimit;
 - b. të konfirmojë zbatimin e masave tek OST;
 - c. të mirëmbajë masat e zbatuara në instalimet e saj.

Neni 268. Aktivizimi i planit të rivendosjes

1. OST do të aktivizojë procedurat e planit të tij të rivendosjes në koordinim me OSSH-në dhe SGU-të e identifikuara në përputhje me nenin 266 (4) si dhe me ofruesit e shërbimit të rivendosjes si më poshtë:
 - a. kur sistemi është në gjendje emergjence në përputhje me kriteret e nenit 99 (3) të kodit, menjëherë pas stabilizimit të sistemit pas aktivizimit të masave të planit të mbrojtjes; ose
 - b. kur sistemi është në gjendje black-out-i në përputhje me kriteret e nenit 99 (4) të kodit.
2. Gjatë rivendosjes të sistemit, OST do të identifikojë dhe monitorojë:
 - a. shkallën dhe kufijtë e rajonit të sinkronizuar të cilit i përket zona e kontrollit;
 - b. OST-të me të cilat ai ndan një rajon të sinkronizuar; dhe
 - c. rezervat e disponueshme të energjisë aktive në zonën e saj të kontrollit.
3. OSSH dhe SGU-te e identifikuar sipas nenit 266 (4), si dhe çdo ofrues i shërbimit të rivendosjes duhet të zbatojë pa vonesë të panevojshme udhëzimet e planit të rivendosjes të lëshuara nga OST, në përputhje me pikën (b) të nenit 266 (3) në përputhje me procedurat e planit të rivendosjes.

Titulli 2 – Ri-energizimi

Neni 269. Procedura e ri-energizimit

4. Procedura e ri-energizimit të planit të rivendosjes duhet të përmbajë një sërë masash që i lejojnë OST-së të zbatojë:
 - a. një strategji ri-energizimit nga lart-poshtë; dhe
 - b. një strategji ri-energizimit nga poshtë-lart.
5. Lidhur me strategjinë e ri-energizimit nga poshtë-lart, procedura e ri-energizimit duhet të përmbajë të paktën masat për:
 - a. menaxhimin e devijimeve të tensionit dhe frekuencës për shkak të ri-energizimit;
 - b. monitorimin dhe menaxhimin e operimit në ishull; dhe
 - c. ri-sinkronizimin e zonave të operimit në ishull.

Neni 270. Aktivizimi i procedurës së ri-energizimit

1. Kur aktivizon procedurën e ri-energizimit, OST do të përcaktojë strategjinë që do të zbatohet duke marrë parasysh:
 - a. disponueshmërinë e burimeve të energjisë në zonën e saj të kontrollit që janë në gjendje të ri-energizojnë;
 - b. kohëzgjatjen e pritshme dhe riskun e mundshëm të strategjive të ri-energizimit;
 - c. kushtet e sistemeve energjetike;
 - d. kushtet e sistemeve të lidhura direkt, duke përfshirë së paku statusin e interkonektorëve;
 - e. SGU-të me prioritet të lartë të renditur sipas nenit 266 (4); dhe
 - f. mundësinë për të kombinuar strategjitë e energjizimit nga lart-poshtë dhe nga poshtë-lart.
2. Kur zbatohet një strategji e ri-energizimit nga lart-poshtë, OST do të menaxhojë lidhjen e ngarkesës dhe gjenerimit me qëllim që të rregullojë frekuencën drejt frekuencës nominale me një tolerancë maksimale të devijimit maksimal të frekuencës në gjendje të qëndrueshme. OST do të zbatohet kushtet për lidhjen e ngarkesës dhe gjenerimit të përcaktuar nga lideri i frekuencës, kur emërohet në përputhje me nenin 272.
3. Kur zbatohet një strategji e ri-energizimit nga poshtë-lart, OST do të menaxhojë lidhjen e ngarkesës dhe gjenerimit me synimin e rregullimit të frekuencës drejt frekuencës së synuar të përcaktuar në përputhje me pikën (c) të nenit 271 (3).
4. Gjatë ri-energizimit, OST pas konsultimit me OSSH-në, duhet të përcaktojë dhe njoftojë sasinë e kërkesës neto për t'u rilidhur në rrjetin e shpërndarjes. OSSH do të rilidhë sasinë e njoftuar të kërkesës neto, duke respektuar ngarkimin e bllokut dhe duke marrë parasysh lidhjen automatike të ngarkesës dhe gjenerimit në rrjetin e saj.
5. OST do të informojë OST-të fqinje për aftësinë e tij për të suportuar një strategji të ri-energizimit nga lart-poshtë.
6. Për aktivizimin e një strategjie ri-energizimi nga lart-poshtë, OST do të kërkojë nga OST-të fqinje të mbështesin ri-energizimin. Kjo mbështetje mund të konsistojë në suportin për fuqi aktive, në përputhje me paragrafët 3 deri në 5 të nenit 264.

Titulli 3 – Menaxhimi i frekuencës

Neni 271. Procedura e menaxhimit të frekuencës

1. Procedura e menaxhimit të frekuencës e planit të rivendosjes duhet të përmbajë një grup masash që synojnë rivendosjen e frekuencës së sistemit në frekuencën nominale.
2. OST do të aktivizojë procedurën e tij të menaxhimit të frekuencës:

- a. në përgatitjen e procedurës së ri-sinkronizimit, kur një zonë sinkrone është e ndarë në disa rajone të sinkronizuara;
 - b. në rast të devijimit të frekuencës në zonën sinkrone; ose
 - c. në rast të ri-energizimit
3. Procedura e menaxhimit të frekuencës duhet të përfshijë së paku:
- a. një listë veprimesh në lidhje me parametrat e rregullatorit ngarkesë-frekuencë përpara caktimit të liderave të frekuencës;
 - b. emërimin e liderave të frekuencës;
 - c. përcaktimin e frekuencës së synuar në rastet e strategjisë së ri-energizimit nga poshtë-lart;
 - d. menaxhimin e frekuencës pas devijimit të frekuencës; dhe
 - e. menaxhimi i frekuencës pas ndarjes së zonës sinkrone.
 - f. përcaktimin e sasisë së ngarkesës dhe gjenerimit që do të ri-kyçet, duke marrë parasysh rezervat e fuqisë aktive brenda rajonit të sinkronizuar në mënyrë që të shmangen devijime të mëdha të frekuencës.

Neni 272. Caktimi i liderit të frekuencës

1. Gjatë rivendosjes së sistemit, kur zona sinkrone është e ndarë në disa rajone të sinkronizuara, OST-të e çdo rajoni të sinkronizuar duhet të caktojnë një lider të frekuencës në përputhje me paragrafin 3.
2. Gjatë rivendosjes së sistemit, kur zona sinkrone nuk ndahet, por frekuenca e sistemit tejkalon kufijtë e frekuencës për gjendjen e alarmit, siç përcaktohet në nenin 99 (2) të kodit, të gjitha OST-të e zonës sinkrone do të caktojnë një lider të frekuencës, në përputhje me paragrafin 3.
3. OST me K-faktorin më të lartë të vlerësuar në kohë reale do të caktohet si lider i frekuencës, përveç nëse OST-të e rajonit të sinkronizuar bien dakord të caktojnë një OST tjetër si lider frekuence. Në këtë rast, OST-të e rajonit të sinkronizuar, do të marrin në konsideratë kriteret e mëposhtme:
 - a. sasinë e rezervave aktive në dispozicion dhe veçanërisht rezervat e rivendosjes të frekuencës;
 - b. kapacitetet e disponueshme në dispozicion në interkonektorë;
 - c. disponueshmërinë e matjeve të frekuencës së OST-ve të rajonit të sinkronizuar;
 - d. disponueshmërinë e matjeve në elementet kritikë brenda rajonit të sinkronizuar;
4. Atje ku madhësia e zonës sinkrone në fjalë dhe gjendja në kohë reale e lejojnë, pavarësisht paragrafit 3, OST-të e zonës sinkrone mund të përcaktojnë një udhëheqës të paracaktuar të frekuencës.

5. OST i caktuar si lider i frekuencës në përputhje me paragrafët 1 dhe 2 do të informojë pa vonesë OST-të e tjera të zonës sinkrone për emërimin e tij.
6. Lideri i caktuar i frekuencës vepron si i tillë deri në:
 - a. caktimin e një udhëheqësi tjetër të frekuencës për rajonin e tij të sinkronizuar;
 - b. një lider i ri i frekuencës është caktuar si rezultat i ri-sinkronizimit të rajonit të tij sinkronizuar me një rajon tjetër të sinkronizuar; ose
 - c. zona sinkrone është ri-sinkronizuar plotësisht, frekuenca e sistemit është brenda diapazonit të frekuencave standarde dhe LFC e operuar nga secili OST i zonës sinkrone është ri-kthyer në mënyrën normale të operimit të tij, në përputhje me nenin 99 (1) të kodit.

Neni 273. Menaxhimi i frekuencës pas devijimit të frekuencës

1. Gjatë rivendosjes së sistemit, kur një lider i frekuencës është caktuar në përputhje me nenin 272 (3), OST-të e zonës sinkrone, përveç liderit të frekuencës, si masë të parë do të pezullojnë aktivizimin manual të rezervave të rivendosjes të frekuencës dhe rezervave zëvendësuese.
2. Pas konsultimit me OST-të e tjera të zonës sinkrone, lideri i frekuencës duhet të përcaktojë mënyrën e funksionimit që do të zbatohet në LFC të operuar nga secili OST i zonës sinkrone.
3. Lideri i frekuencës do të menaxhojë aktivizimin manual të rezervave të rivendosjes të frekuencës dhe rezervave zëvendësuese brenda zonës sinkrone duke synuar rregullimin e frekuencës së zonës sinkrone drejt frekuencës nominale dhe duke marrë parasysh kufijtë e sigurisë operationale të përcaktuar në përputhje me nenin 261 të kodit. OST-të e zonës sinkrone, sipas kërkesës do të mbështesë liderin e frekuencës.

Neni 274. Menaxhimi i frekuencës pas ndarjes së zonës sinkrone

1. Gjatë rivendosjes së sistemit, kur është caktuar një lider i frekuencës sipas nenit 272 (3), OST-të e çdo rajoni të sinkronizuar, me përjashtim të liderit të frekuencës, si masë e parë do të pezullojnë aktivizimin manual të rezervave të rivendosjes të frekuencës dhe rezervave zëvendësuese.
2. Lideri i frekuencës duhet të përcaktojë, mënyrën e operimit që do të zbatohet në LFC-të të operuar nga secili OST i rajonit të sinkronizuar, pas konsultimit me OST-të e tjera të rajonit të sinkronizuar.
3. Lideri i frekuencës duhet të menaxhojë aktivizimin manual të rezervave të rivendosjes të frekuencës dhe rezervave zëvendësuese brenda rajonit të sinkronizuar, duke synuar rregullimin e frekuencës të rajonit të sinkronizuar drejt frekuencës së synuar të përcaktuar nga lideri i ri-sinkronizimit, nëse ka, sipas pikës (a) të nenit 277 (1) dhe duke marrë parasysh kufijtë e sigurisë operationale të përcaktuar në përputhje me nenin 106 të kodit. Nëse nuk caktohet një lider ri-sinkronizimi për rajonin e sinkronizuar, lideri i frekuencës do të synojë rregullimin e frekuencës drejt frekuencës nominale.

Sipas kërkesës, secili OST i rajonit të sinkronizuar do të mbështesë udhëheqësin e frekuencës.

Titulli 4 – Ri -sinkronizimi

Neni 275. Procedura e ri-sinkronizimit

1. Procedura e ri-sinkronizimit e planit të rivendosjes duhet të përfshijë të paktën:
 - a. caktimin e liderit të ri-sinkronizimit;
 - b. masat që lejojnë OST-në të zbatojnë strategjinë e ri-sinkronizimit;
 - c. kufijtë maksimale për këndin e fazës, diferencat e frekuencës dhe tensionit për linjat lidhëse.

Neni 276. Caktimi i liderit të ri-sinkronizimit

1. Gjate rivendosjes së sistemit, kur dy rajone të sinkronizuara mund të sinkronizohen pa rrezikuar sigurinë operationale të sistemeve të transmetimit, liderat e frekuencës të këtyre rajoneve sinkrone do të caktojnë një lider sinkronizimi në konsultim me së paku OST(të) të identifikuar si lider potencial ri-sinkronizimi dhe në përputhje me paragrafin 2. Çdo lider i frekuencës do të informojë pa vonesë OST-të nga rajoni i tij i sinkronizuar për liderin e caktuar të ri-sinkronizimit.
2. Për çdo palë të rajoneve sinkrone që do të sinkronizohen, lideri i ri-sinkronizimit do të jetë OST-ja që:
 - a. Ka në operim së paku një nënstacion të pajisur me pajisje kyçëse paralele në kufirin ndërmjet dy rajoneve sinkrone që do të risinkronizohen;
 - b. Ka qasje në matjet e frekuencës për të dy rajonet sinkrone;
 - c. Ka qasje në matjet e tensionit në nënstacionet ndërmjet të cilëve gjenden pikat potenciale të ri-sinkronizimit; dhe
 - d. Është në gjendje të kontrollojë tensionin e pikave potenciale të ri-sinkronizimit.
3. Kur më shumë së një OST përmbush kriteret sipas paragrafit 2, OST me numrin më të madh të pikave potenciale të ri-sinkronizimit ndërmjet dy rajoneve të sinkronizuara do të caktohet si lider i ri-sinkronizimit, përveç nëse liderat e frekuencës së dy rajoneve të sinkronizuara bien dakord të caktojnë një tjetër OST si lider ri-sinkronizimi.
4. Lideri i ri-sinkronizimit do të veprojë si i tillë deri në:
 - a. caktimin e një lideri tjetër të ri-sinkronizimit për dy rajonet e sinkronizuara; ose
 - b. janë risinkronizuar të dy rajonet e ri-sinkronizimit dhe janë kryer të gjithë hapat në nenin 277.

Neni 277. Strategjia e ri-sinkronizimit

1. Para ri-sinkronizimit, lideri i ri-sinkronizimit duhet të:
 - a. përcaktojë në përputhje me kufijtë maksimalë të përmendur në nenin 275:

- i. vlerën e synuar e frekuencës për ri-sinkronizim;
 - ii. diferencën maksimale të frekuencës ndërmjet dy rajoneve të sinkronizuara;
 - iii. shkëmbimin maksimal të fuqisë aktive dhe reaktive;
 - iv. mënyrën e operimit që do zbatohet në LFC.
- b. të zgjedhë pikën e ri-sinkronizimit, duke marrë parasysh kufijtë e sigurisë operative në rajonet e sinkronizuara;
 - c. të përcaktojë dhe të përgatisë të gjitha veprimet e nevojshme për ri-sinkronizimin e dy rajoneve të sinkronizuara në pikën e ri-sinkronizimit;
 - d. të përcaktojë dhe të përgatisë grupin e veprimeve pasuese për të krijuar lidhje shtesë midis rajoneve të sinkronizuara;
 - e. të vlerësojë gatishmërinë e rajoneve të sinkronizuara për ri-sinkronizim, duke marrë parasysh kushtet e përcaktuara në pikën (a).
2. Gjatë kryerjes së detyrave të renditura në paragrafin 1, lideri i ri-sinkronizimit duhet të konsultohet me liderat e frekuencës së rajoneve të sinkronizuar të përfshirë dhe, për detyrat e renditura në pikat (b) deri (e), gjithashtu duhet të konsultohet me OST-të që operojnë nënstationet e përdorura për ri-sinkronizim.
 3. Çdo lider i frekuencës duhet të informojë OST-të brenda rajonit të tij të sinkronizuar të ri-sinkronizimit të planifikuar pa vonesë të panevojshme.
 4. Kur janë përmbushur të gjitha kushtet e përcaktuara në paragrafin 1(a), lideri i ri-sinkronizimit do të ekzekutojë ri-sinkronizimin duke aktivizuar veprimet e përcaktuara në përputhje me paragrafët 1(c) dhe (d).

Pjesa IV – Ndërveprimet e tregut

Neni 278. Procedura për pezullimin e aktiviteteve të tregut

1. OST mund të pezullojë përkohësisht një ose më shumë aktivitete të tregut të përcaktuara në paragrafin 2 nëse:
 - a. sistemi i transmetimit të OST është në gjendje black-out; ose
 - b. OST ka shteruar të gjitha mundësitë e ofruara nga tregu dhe vazhdimësia e aktiviteteve të tregut gjatë gjendjes së emergjencës do të përkeqësonte një ose më shumë nga kushtet e përmendura në nenin 99 (3) të kodit; ose
 - c. vazhdimësia e aktivitetit të tregut zvogëlon në mënyrë të konsiderueshme efektivitetin e procesit të rivendosjes në gjendjen normale ose në gjendjen e alarmit; ose
 - d. nuk janë të disponueshme mjetet dhe pajisjet e komunikimit të nevojshme për OST-të për të lehtësuar aktivitetin e tregut.
2. Aktivitetet e tregut që mund të pezullohen janë:

- a. sigurimi i kapacitetit ndër-zonal për alokimin e kapacitetit në kufi të zonave ofertuese korresponduese për secilën njësi kohe të tregut, nëse është e pritshme që sistemi i transmetimit nuk rikthehet në gjendjen normale ose gjendjen e alarmit;
 - b. paraqitja e ofertave të kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese nga një ofrues i shërbimit të balancimit;
 - c. sigurimi nga një palë përgjegjëse balancuese të një pozicioni të balancuar në fund të periudhës së ditës në avancë nëse kërkohet nga termat dhe kushtet lidhur me balancimin;
 - d. modifikimi i pozicionit të palëve përgjegjëse balancuese;
 - e. njoftimi e skeduleve të jashtme brenda zonës së skedulimit; dhe
 - f. aktivitete të tjera të tregut, pezullimi i të cilëve konsiderohet i nevojshëm për të ruajtur dhe/ose rivendosur sistemin.
3. Në rast të pezullimit të aktivitetit të tregut sipas paragrafit 1, nëse është teknikisht e mundur secili SGU duhet të operojë në set-pointin e fuqisë aktive të përcaktuar nga OST sipas udhëzimit të lëshuar dhe aftësive të tyre.
 4. Nëse aktivitetet e tregut të renditura në paragrafin 1 pezullohen, OST mundet të pezullojë plotësisht ose pjesërisht operimin e proceseve të tij të ndikuara nga ky pezullim.
 5. Në rastin e pezullimit të aktivitetit të tregut në përputhje me paragrafin 1, OST koordinon me:
 - a. OST-të e rajonit të llogaritjes së kapacitetit ku OST është anëtar;
 - b. OST-të me të cilat OST ka marrëveshje për koordinimin e balancimit;
 - c. NEMO (bursën) dhe subjektet e tjera të caktuara ose të deleguara për të kryer funksionet e tregut në përputhje me Rregulloren (BE) 2015/1222¹⁴ brenda zonës së tij të kontrollit;
 - d. OST-të e bllokut LFC ku OST është anëtar; dhe
 - e. Llogaritësin e kapacitetit të koordinuar të rajonit ku OST është anëtar.
 6. Në rast të pezullimit të aktivitetit të tregut, OST duhet të nisë procedurën e komunikimit për rivendosjen e aktivitetit të tregut në përputhje me nenin 281.

Neni 279. Rregullat për pezullimin dhe rivendosjen e aktiviteteve të tregut

1. OST duhet të hartojë një propozim për rregullat në lidhje me pezullimin dhe rivendosjen e aktiviteteve të tregut.

¹⁴ Commission Regulation (EU) 2015/1222 of 24 July 2015 establishing a guideline on capacity allocation and congestion management

(OJ L 197, 25.7.2015, p. 24).

2. OST duhet t'i publikojë këto në faqen e tij të internetit pas miratimit të tyre nga ERE në përputhje me nenin 37 të Direktivës 2009/72/EC.
3. Rregullat për pezullimin dhe rivendosjen e aktiviteteve të tregut duhet të jenë pajtueshëm në masën e mundshme me:
 - a. rregullat mbi sigurimin e kapacitetit ndër-zonal brenda rajonit të llogaritjes së kapacitetit;
 - b. rregullat për paraqitjen nga ofruesit e shërbimit balancues të ofertave për kapacitet balancues dhe energji balancuese nga marrëveshjet me OST-të e tjera për koordinimin e balancimit;
 - c. rregullat për sigurimin nga pala përgjegjëse e balancimit të një pozicioni të balancuar në fund të periudhës së ditës në avancë nëse kërkohet nga termat dhe kushtet në lidhje me balancimin;
 - d. rregullat për garantimin e modifikimeve të pozicionit të palëve përgjegjëse balancuese; dhe
 - e. rregullat për sigurimin e skeduleve të përmendura në nenin 189(1) dhe (2) të kodit.
4. Gjatë hartimit të rregullave për pezullimin dhe rivendosjen e aktiviteteve të tregut, OST duhet të konvertojë rrethanat e përmendura në nenin 278 (1) në parametra të përcaktuar objektivisht duke marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:
 - a. përqindja e shkyçjes së ngarkesës në zonën LFC të OST që i korrespondon:
 - i. paaftësisë të një pjese të rëndësishme të palëve përgjegjëse balancuese për të mbajtur balancën e tyre; ose
 - ii. nevojës së OST për të mos ndjekur proceset e zakonshme të balancimit për të kryer një ri-energizim eficient;
 - b. përqindja e shkyçjes së gjenerimit në zonën LFC të OST që i korrespondon paaftësisë së një pjese të rëndësishme të palëve përgjegjëse të balancimit për të mbajtur balancën e tyre;
 - c. shpërndarja gjeografike e elementëve të padisponueshëm të sistemit të transmetimit që i korrespondon:
 - i. desinkronizimi i një pjese të konsiderueshme të zonës LFC duke bërë që proceset e zakonshme të balancimit të mos jenë produktive; ose
 - ii. reduktimin në zero të kapacitetit ndër-zonal në kufijtë e zonës ofertuese;
 - d. pa-aftësia e subjekteve të mëposhtme të prekur, në ekzekutimin e aktiviteteve të tyre të tregut për shkaqe jashtë kontrollit të tyre:
 - i. palët përgjegjëse balancuese,
 - ii. ofruesit e shërbimit të balancimit,

- iii. NEMO dhe subjektet e tjera të caktuara ose të deleguara për të kryer funksionet e tregut në përputhje me Rregulloren (EU) 2015/1222¹⁵,
 - iv. OSSH.
- e. mungesa e funksionimit të duhur e mjeteve dhe pajisjeve të komunikimit, të nevojshme për të kryer:
- i. bashkimin e tregut në DA dhe ID ose çdo mekanizëm eksplicit të alokimit të kapacitetit; ose
 - ii. procesin e rivendosjes së frekuencës; ose
 - iii. procesin e zëvendësimit të frekuencës; ose
 - iv. sigurimin nga pala përgjegjëse balancuese të një pozicioni të balancuar në ditën në avancë dhe sigurimin e ndryshimit të pozicionit të tij; ose
 - v. sigurimin e skeduleve të përmendura në nenin 95(1) dhe (2) të Kodit të Operimit.
5. Rregullat për pezullimin dhe rivendosjen e aktiviteteve të tregut duhet të përcaktojnë një kohë vonese për t'u respektuar nga çdo parametër i vendosur në përputhje me paragrafin 4, para nisjes së procedurës për pezullimin e aktiviteteve të tregut.
6. OST duhet të vlerësojë në kohë reale parametrat e përcaktuar në përputhje me paragrafin 4, bazuar në informacionin në dispozicion të saj.

Neni 280. Procedura për rivendosjen e aktiviteteve të tregut

1. OST në koordinim me NEMO n aktive në zonën e tij të kontrollit dhe me OST-të fqinje, duhet të nisë procedurën për rivendosjen e aktiviteteve të tregut të pezulluara në përputhje me nenin 278 (1) kur:
 - a. situata që shkaktoi pezullimin ka përfunduar dhe nuk ka asnjë situatë tjetër të përmendur në nenin 278(1); dhe
 - b. subjektet e përmendura në nenin 281(2) janë informuar në kohë paraprakisht në përputhje me nenin 281.
2. OST në koordinim me OST-të fqinje, duhet të nisë rivendosjen e proceseve të OST të ndikuara nga pezullimi i aktiviteteve të tregut kur plotësohen kushtet e paragrafit 1 ose më parë, nëse është e nevojshme për rivendosjen e aktiviteteve të tregut.
3. NEMO (t) respektive, në koordinim me OST-të dhe subjektet e përmendura në nenin 278(5), duhet të nisin rivendosjen e proceseve të bashkimit të tregut për DA dhe/ose ID sa më shpejt që OST njofton që proceset e OST janë rivendosur.

¹⁵ Commission Regulation (EU) 2015/1222 of 24 July 2015 establishing a guideline on capacity allocation and congestion management

(OJ L 197, 25.7.2015, p. 24).

4. Kur sigurimi i kapacitetit ndër-zonal është pezulluar dhe më pas rivendosur, çdo OST në fjalë duhet të përditësojë kapacitetet ndër-zonale për alokimin e kapacitetit duke përdorur, mundësinë më fisibël dhe efçente për çdo njësi kohë tregu si më poshtë:
 - a. duke përdorur kapacitetet ndër zonale më të fundit në dispozicion të llogaritura nga llogaritësi i koordinuar i kapacitetit;
 - b. duke nisur proceset e llogaritjes së kapacitetit rajonal të zbatueshme në përputhje me nenin 29 dhe 30 të Rregullores (EU) 2015/1222¹⁶; ose
 - c. duke përcaktuar, në koordinim me OST-të e rajonit të llogaritjes së kapacitetit, kapacitetet ndër-zonale bazuar në kushtet fizike aktuale të rrjetit.
5. Kur pjesë e zonës totale të bashkuar është kthyer në gjendjen normale ose gjendjen e alarmit, aty ku aktivitetet e tregut ishin pezulluar, NEMO (t) e kësaj zone do të kenë të drejtën të kryejë një bashkim tregu në një pjese të zonës totale të bashkuar, në konsultim me OST-të dhe subjektet e përmendura në nenin 278(5), me kusht që OST të ketë rivendosur procesin e llogaritjes së kapacitetit.
6. Jo më vonë së 30 ditë pas rivendosjes së aktiviteteve të tregut, OST nëse ka pezulluar dhe rivendosur aktivitetet e tregut duhet të përgatisin një raport që përmban shpjegim të detajuar të arsyetimit, implementimit dhe ndikimit të pezullimit të tregut dhe një referencë për pajtueshmërinë me rregullat për pezullimin dhe rivendosjen e aktiviteteve të tregut dhe duhet ta dorëzojë atë në ERE në përputhje me nenin 281(2).

Neni 281. Procedura e komunikimit

1. Rregullat për pezullimin dhe rivendosjen e aktiviteteve të tregut të hartuara në përputhje me Nenin 30 gjithashtu duhet të përmbajnë një procedurë komunikimi ku detajohen detyrat dhe veprimet e pritshme nga çdo palë në rolet e tij të ndryshme gjatë pezullimit dhe rivendosjes së aktiviteteve të tregut.
2. Procedura e komunikimit duhet të sigurojë që informacioni i dërgohet, njëherësh, subjekteve të mëposhtme:
 - a. palëve të përmendura në nenin 278 (5);
 - b. palëve përgjegjëse balancuese;
 - c. ofruesve të shërbimit të balancimit;
 - d. OSSH-se;
 - e. ERE, në përputhje me nenin 37 të direktivës 2009/72/EC.
3. Procedura e komunikimit duhet të përmbajë të paktën hapat e mëposhtëm:

¹⁶ Commission Regulation (EU) 2015/1222 of 24 July 2015 establishing a guideline on capacity allocation and congestion management

(OJ L197, 25.7.2015, p. 24).

- a. njoftimin nga OST që aktivitetet e tregut janë pezulluar në përputhje me nenin 278;
 - b. njoftimin nga OST të vlerësimit më të mirë për kohën dhe datën për rivendosjen e sistemit të transmetimit;
 - c. njoftimin nga NEMO dhe subjektet e tjera të caktuara për të kryer funksionet e tregut në përputhje me Rregulloren (BE) 2015/1222¹⁷ dhe Rregulloren (BE) 2016/1719 mbi pezullimin e aktiviteteve të tyre, nëse ka;
 - d. përditësimet nga OST-të mbi procesin e rivendosjes së sistemit të transmetimit;
 - e. njoftimin nga subjektet e përmendura në pikat (a) deri (d) të paragrafit 2, që mjetet dhe sistemet e komunikimit e tyre të tregut janë në operim;
 - f. njoftimin nga OST që sistemi i transmetimit është rikthyer në gjendjen normale ose gjendjen e alarmit;
 - g. njoftimin nga NEMO dhe subjektet e tjera të caktuara ose të deleguara për të kryer funksionet e tregut në përputhje me Rregulloren (BE) 2015/1222 për vlerësimin më të mirë për kohën dhe datën kur do të rivendosen aktivitetet e tregut; dhe
 - h. konfirminin nga NEMO dhe subjektet e tjera të caktuara ose të deleguara për të kryer funksionet e tregut në përputhje me Rregulloren (BE) 2015/1222 që aktivitetet e tregut janë rivendosur.
4. Të gjitha njoftimet dhe përditësimet nga OST, NEMO dhe subjekte të tjera të caktuara ose të deleguara për të kryer funksione të tregut të përmendura në paragrafin 3, duhet të publikohen në faqen e internetit të këtyre subjekteve. Kur njoftimi ose përditësimi në faqen e internetit nuk është i mundur, subjekt i detyrimit për të njoftuar, duhet të njoftojë nëpërmjet email-it ose nëpërmjet çdo mjeti tjetër të disponueshëm, të paktën ato palë që marrin pjesë direkt në aktivitetet e pezulluara të tregut.
5. Njoftimi në përputhje paragrafin 3 pika (e), njoftimi duhet të bëhet nëpërmjet e-mail-it ose nëpërmjet çdo mjeti tjetër të disponueshëm të OST-së.

Neni 282. Rregullat për shlyerjet në rast të pezullimit të aktiviteteve të tregut

- 1. OST harton dhe bën publike rregullat për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese të cilat zbatohen për periudhat e shlyerjes së disbalancës gjatë të cilave aktivitetet e tregut ishin pezulluar. OST mundet të propozojë të njëjtat rregulla që zbatohen për operimin normal.

¹⁷ Commission Regulation (EU) 2015/1222 of 24 July 2015 establishing a guideline on capacity allocation and congestion management

(OJ L 197, 25.7.2015, p. 24).

2. Rregullat e hartuara në përputhje me paragrafin 1 duhet të:
 - a. sigurojnë neutralitetin financiar të OST-së;
 - b. shmangin deformimin e incentivave ose incentivat antiproduktive për palët përgjegjëse balancuese, ofruesit e shërbimit të balancimit dhe OST-në;
 - c. nxisë palët përgjegjëse balancuese për të qenë të balancuar ose të ndihmojnë sistemin të rivendosë balancën e tij;
 - d. shmangë çdo penaltet financiar të imponuar mbi palët përgjegjëse të balancimit dhe ofruesit e shërbimit të balancimit për shkak të kryerjes së veprimeve të kërkuara nga OST;
 - e. shkurajojë OST-në nga pezullimi i aktiviteteve të tregut, nëse nuk është i nevojshëm, dhe të stimulojë OST-në të rivendosin aktivitetet e tregut sa më shpejt të jetë e mundur; dhe
 - f. të stimulojë ofruesit e shërbimit balancues për të ofruar shërbime në OST që ndihmojnë në rivendosjen e sistemit në gjendjen normale.

Pjesa V – Shkëmbimi i informacionit dhe komunikimi, mjetet dhe pajisjet
Neni 283. Shkëmbimi i informacionit

1. Përveç dispozitave të nenit 121 deri 134 të kodit, OST, gjatë gjendjes së emergjencës, black-out apo të rivendosjes, ka të drejtën të mbledhë informacionin e mëposhtëm:
 - a. nga OSSH, informacionin e nevojshëm për të paktën:
 - i. pjesën e rrjetit të tyre që operon si ishull;
 - ii. aftësinë për të sinkronizuar pjesët e rrjetit të tyre që operojnë ishull;
 - iii. aftësinë për të nisur operimin ishull.
 - b. nga SGU-të e identifikuara në përputhje me nenin 266 (4) dhe ofruesit e shërbimit të rivendosjes, informacionin për të paktën kushtet e mëposhtme:
 - i. gjendjen aktuale të instalimit;
 - ii. kufijtë operacionalë;
 - iii. kohën e aktivizimit të plotë dhe kohën për rritjen e gjenerimit.
2. Gjatë gjendjes së emergjencës, black-out ose rivendosjes, OST duhet të sigurojë në kohën e duhur dhe kur është i disponueshëm për OST, për qëllime të procedurave të planit të mbrojtjes së sistemit dhe procedurave të planit të rivendosjes, informacionin e mëposhtëm,:
 - a. te OST-të fqinje, informacionit për të paktën:
 - i. shtrirjen dhe kufijtë e rajonit të sinkronizuar të cilit i përket zona e tij e kontrollit;
 - ii. kufizimet për operimin e rajonit të sinkronizuar;

- iii. kohëzgjatjen maksimale dhe sasinë e fuqisë aktive dhe reaktive që mund të furnizohet nëpërmjet interkonektorëve; dhe
 - iv. çdo kufizim tjetër teknik apo organizativ;
 - b. te lideri i frekuencës i rajonit të tij të sinkronizuar, informacionin për të paktën:
 - i. kufizimin për të mbajtur operimin ishull;
 - ii. ngarkesën dhe gjenerimin shtesë të disponueshëm; dhe
 - iii. disponueshmërinë e rezervave operacionale.
 - c. te OSSH, informacionin për të paktën:
 - i. gjendjen e sistemit të tij të transmetimit;
 - ii. kufijtë e fuqisë aktive dhe reaktive, ngarkesën në bllok, pozicioni i degëzimit dhe i çelësit në pikat e lidhjes;
 - iii. informacionin mbi statusin aktual dhe të planifikuar të moduleve gjeneruese të energjisë të lidhura në OSSH; dhe
 - iv. të gjithë informacionin e nevojshëm që çon në koordinim të mëtejshëm me palët e lidhura në shpërndarje;
 - d. te ofruesit e shërbimit të mbrojtjes, informacionin për të paktën:
 - i. gjendjen e sistemit të tij të transmetimit; dhe
 - ii. masat e planifikuara që kërkojnë pjesëmarrjen e ofruesve të shërbimit të mbrojtjes.
 - e. te SGU-të e identifikuara në përputhje me nenin 266 (4) dhe të ofruesit e shërbimit të rivendosjes, informacionin për të paktën:
 - i. gjendjen e sistemit të tij të transmetimit;
 - ii. aftësinë dhe planet për të ri-energizuar bashkimet (zbaralidhesit);
 - iii. masat e planifikuara që kërkojnë pjesëmarrjen e tyre.
- 3. OST-të në gjendjen e emergjencës, black-out apo rivendosjes duhet të shkëmbejnë midis tyre informacion në lidhje me të paktën:
 - a. rrethanat që çuan në gjendjen aktuale të sistemit të tij të transmetimit, në masën që ato janë të njohura; dhe
 - b. problemet e mundshme që kërkojnë nevojën e asistencës për fuqi aktive.
- 4. OST në gjendjen e emergjencës, black-out apo rivendosjes duhet të sigurojë, në kohën e duhur, informacionin për gjendjen e sistemit të tij të transmetimit dhe nëse është e disponueshme informacione shtesë duke shpjeguar situatën mbi sistemin e transmetimit:
 - a. te NEMO, që duhet ta bëjnë këtë informacion të disponueshëm për pjesëmarrësit e tyre të tregut siç parashikohet në nenin 281;

- b. te ERE në përputhje me nenin 37 të Direktivës 2009/72/EC; dhe
 - c. te çdo palë tjetër përkatëse, sipas rastit.
5. OST duhet të informojnë çdo palë të prekur për planin e testimin të hartuar në përputhje me nenin 286 (2) dhe (3).

Neni 284. Sistemet e komunikimit

1. OSSH dhe SGU e identifikuar në përputhje me pikat (b) dhe (c) të nenit 266 (4), çdo ofrues i shërbimit të rivendosjes dhe OST duhet të kenë një sistem komunikimi zanor me pajisjet shtesë të mjaftueshme dhe burime rezervë për furnizimin me energji, për të lejuar shkëmbimin e informacionit të nevojshëm për planin e rivendosjes për të paktën 24 orë, në rast të mungesës totale të furnizimit të jashtëm me energji ose në rast të dështimit të çdo pajisje individuale të sistemit të komunikimit zanor.
2. OST duhet të hartojë, në konsultim me OSSH dhe SGU-të e identifikuar në përputhje me nenin 266 (4) dhe me ofruesit e shërbimit të rivendosjes, kërkesat teknike që duhen plotësuar nga sistemet e tyre të komunikimit zanor njëkohësisht edhe nga sistemi i vetë OST-së në mënyrë që të lejohet ndërveprimi i tyre dhe të garantohet që thirrja hyrëse e OST të identifikohet nga pala tjetër dhe të përgjigjet menjëherë.
3. OST duhet të hartojë, në konsultim me OST-të e tij fqinje dhe OST-te e tjera të zonës sinkrone, kërkesat teknike që duhen plotësuar nga sistemet e tyre të komunikimit zanor njëkohësisht edhe nga sistemi vetjak i OST i komunikimit zanor në mënyrë që të lejohet ndërveprimi i tyre dhe të garantohet që thirrja hyrëse e OST të identifikohet nga pala tjetër dhe të përgjigjet menjëherë.
4. Pavarësisht nga paragrafi 1, ato SGU të identifikuar në përputhje me nenin 266 (4) që janë module gjenerues të tipit B dhe ata ofrues të shërbimit të rivendosjes që janë module gjeneruese të tipit A ose B duhet të kenë mundësinë të kenë vetëm një sistem komunikimi të dhënash, në vend të sistemit të komunikimit zanor, nëse dakordësohet me OST. Ky sistem komunikimi të dhënash duhet të plotësojë kërkesat e përcaktuara në paragrafin 1 dhe 2.
5. OST mund të kërkojë që, përveç sistemit të komunikimit zanor, të përdoret një sistem komunikimi plotësues për të mbështetur planin e rivendosjes; në këtë rast, sistemi plotësues i komunikimit duhet të përfshijë kërkesat e përcaktuara në paragrafin 1.

Neni 285. Mjetet dhe pajisjet

1. OST duhet të bëjë të disponueshme mjetet dhe pajisjet kritike të përmendura në nenin 105 të kodit për të paktën 24 orë, në rastin e humbjes së furnizimit primar me energji.
2. OSSH dhe SGU-të e identifikuar në përputhje me nenin 266 (4) njëkohësisht edhe ofruesit e shërbimit të rivendosjes duhet të bëjnë të disponueshme mjetet dhe pajisjet kritike të përmendura në nenin 105 të kodit dhe të përdorura në planin e rivendosjes për të paktën 24 orë, në rast të humbjes së furnizimit primar me energji.

3. OST duhet të ketë të paktën një dhomë kontrolli rezervë gjeografikisht të ndarë. Dhoma rezervë e kontrollit duhet të përfshijë të paktën mjetet dhe pajisjet kritike të përmendura në nenin 105 të kodit. OST duhet të caktojë një furnizim rezervë energjie për dhomën rezervë të kontrollit për të paktën 24 orë, në rast të humbjes së furnizimit primar me energji.
4. OST duhet të përgatisë një procedure transferimi për funksionet e lëvizjes nga dhoma kryesore e kontrollit në dhomën rezervë të kontrollit sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në çdo rast në kohën maksimale prej 3 orësh. Procedura duhet të përfshijë operimin e sistemit gjatë transferimit.
5. Nënstacionet e identifikuar si themelore për procedurat e planit të rivendosjes në përputhje me nenin 266 (4) duhet të jenë në operim në rast të humbjes së furnizimit primar me energji për të paktën 24 orë.

Pjesa VI – Pajtueshmëria dhe rishikimi

Titulli 1 – Testimi i pajtueshmërisë së aftësive të OST, OSSH dhe SGU-ve

Neni 286. Parime të përgjithshme

1. OST, periodikisht do të vlerësojë funksionimin e duhur të të gjitha pajisjeve dhe aftësive të marra parasysh në planin e mbrojtjes dhe rivendosjes të sistemit. Për këtë qëllim OST do të verifikojë periodikisht pajtueshmërinë e tillë të pajisjeve dhe aftësive, në përputhje me paragrafin 2 dhe me nenin 41 (2) të Kodit “Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin të Gjeneruesve” i miratuar me Vendimin ERE Nr. 129 Datë 04.06.2018, Neni 35 (2) të Kodit “Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin të Objekteve të Ngarkesës” i miratuar me Vendimin ERE Nr. 128 Datë 04.06.2018 dhe nenit 69 (1) dhe (2) të Kodit “Kërkesat Për Lidhjen Me Rrjetin Të Sistemeve Me Tension Të Lartë Me Rrymë Të Vazhduar Dhe Parqet Me Module Të Energjisë Të Lidhur Me Rrymë Të Vazhduar” i miratuar me Vendimin e ERE Nr.127, datë 04.06.2018 .
2. OST do të përcaktojë një plan testimi në konsultim me OSSH, SGU-të e identifikuar në përputhje me nenet 254 (4) dhe 266 (4), ofruesit e shërbimit të mbrojtjes dhe ofruesit e shërbimit të rivendosjes. Plani i testimit do të identifikojë pajisjet dhe aftësitë respektive që duhet të testohen për planin e mbrojtjes së sistemit dhe planin e rivendosjes të tij.
3. Plani i testimit duhet të përfshijë periodicitetin dhe kushtet e testeve, duke ndjekur kërkesat minimale të përshkruara në nenet nga 287 deri 290. Plani i testimit duhet të ndjekë metodologjinë e përcaktuar në kodin “Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin të Gjeneruesve”, kodin “Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin të Objekteve të Ngarkesës” dhe kodit “Kërkesat Për Lidhjen Me Rrjetin Të Sistemeve Me Tension Të Lartë Me Rrymë Të Vazhduar Dhe Parqet Me Module Të Energjisë Të Lidhur Me Rrymë Të Vazhduar” për aftësinë përkatëse të testuar. Për SGU-të që nuk i nënshtrohen tre kodeve të lidhjes , plani i testimit do të ndjekë dispozitat e legjislacionit kombëtar.

4. Gjatë testimit, OST, OSSH, SGU, ofrues i shërbimit të mbrojtjes dhe ofrues i shërbimit të rivendosjes nuk duhet të rrezikojë sigurinë operationale të sistemit të transmetimit dhe të sistemit të ndërlidhur. Testi duhet të kryhet në mënyrën që minimizon ndikimin në përdoruesit e sistemit.
5. Testi konsiderohet i suksesshëm kur plotëson kushtet e përcaktuara nga operatori i sistemit respektiv në përputhje me paragrafin 3. Për sa kohë që një test nuk i përmbush këto kritere, OST, OSSH, SGU, ofruesi i shërbimit të mbrojtjes dhe ofruesi i shërbimit të rivendosjes do të përsërisë testin.

Neni 287. Testimi i pajtueshmërisë së aftësive të moduleve gjeneruese të energjisë

1. Çdo ofrues i shërbimit të rivendosjes, i cili është një modul gjenerues i energjisë që ofron shërbimin e black-start, duhet të kryejë testin e aftësisë së black-startit, të paktën çdo tre vjet, sipas metodologjisë së përcaktuar në nenin 45 (5) të Kodit “Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin të Gjeneruesve”.
2. Çdo ofrues i shërbimit të rivendosjes i cili është një modul gjenerues i energjisë që ofron shërbimin e ri-sinkronizimit të shpejtë, duhet të ekzekutojë testin e ndarjes nga rrjeti dhe kalimin në gjendjen me ngarkesën vetjake, pas çdo ndryshimi të pajisjes që ndikon në aftësinë e saj të operimit në vetë ngarkese ose pas dy stakimeve të pasuksesshme të njëpasnjëshme në operimin real, sipas metodologjisë së përcaktuar në Nenin 45 (6) të Kodit “Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin të Gjeneruesve”.

Neni 288. Testimi i pajtueshmërisë së objekteve të kërkesës që sigurojnë përgjigje të ngarkesës

1. Secili ofrues i shërbimit të mbrojtjes që ofron përgjigje të ngarkesës, do të ekzekutojë testin e modifikimit të ngarkesës, pas dy përgjigjeve të pasuksesshme radhazi të operimit në kohë reale ose së paku çdo vit, sipas metodologjisë së përcaktuar në nenin 41, pika 1, të kodit “Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin të Objekteve të Ngarkesës”.
2. Secili ofrues i shërbimit të mbrojtjes që ofron përgjigje të kërkesës për shkyçjen e ngarkesës në frekuencë të ulët, duhet të kryejë testin e shkyçjes së kërkesës në frekuencë të ulët sipas metodologjisë së përcaktuar në nenin 286 (4) të Kodit “Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin të Objekteve të Ngarkesës” për objektet e kërkesës të lidhur në transmetim ose sipas një metodologjie të ngjashme të përcaktuar nga operatori i sistemit përkatës për objektet e tjera të ngarkesës.

Neni 289. Testimi i pajtueshmërisë së aftësive të HVDC

1. Secili ofrues i shërbimit të rivendosjes, i cili është një sistem HVDC që ofron shërbimin e black-start, duhet të ekzekutojë testin e aftësisë për black-start të paktën çdo tre vjet, sipas metodologjisë së përcaktuar në nenin 70 (11) të kodit “Kërkesat Për Lidhjen Me Rrjetin Të Sistemeve Me Tension Të Lartë Me Rrymë Të Vazhduar Dhe Parqet Me Module Të Energjisë Të Lidhur Me Rrymë Të Vazhduar”.

Neni 290. Testimi i pajtueshmërisë së rrethës së shkyçjes së ngarkesës në frekuencë të ulët

1. OSSH dhe OST do të kryejnë testimin në rrethës të shkyçjes së kërkesës në frekuencë të ulët, të zbatuar në instalimet e tyre brenda një periudhe tre vjeçare dhe sipas metodologjisë së përcaktuar në nenin 37 (6) dhe nenin 39 (5) të Kodit “Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin të Objekteve të Ngarkesës”.

Neni 291. Testimi i sistemeve të komunikimit

1. OSSH dhe SGU-të e identifikuar në përputhje me nenin 266 (4), OST dhe secili ofrues i shërbimit të rivendosjes do të testojë sistemet e komunikimit të përcaktuara në nenin 284, të paktën çdo vit.
2. OSSH dhe SGU-të e identifikuar në përputhje me nenin 266 (4), OST dhe çdo ofrues i shërbimit të rivendosjes do të testojë furnizimin rezervë me energji të sistemeve të tyre të komunikimit të paktën çdo pesë vjet.
3. OST, në konsultim me OST-të e tjera, do të përcaktojë një plan testimi për testimin e komunikimit ndër-OST.

Neni 292. Testimi i mjeteve dhe pajisjeve

1. OST do të testojë aftësinë e burimeve kryesore dhe rezervë të energjisë për të furnizuar qendrat kryesore dhe rezervë të kontrollit, të parashikuara në nenin 285, të paktën çdo vit.
2. OST do të testojë funksionalitetin e mjeteve dhe pajisjeve kritike të përmendura në nenin 118 të kodit, të paktën çdo tre vjet, që mbulon mjetet dhe pajisjet kryesore dhe rezervë. Aty ku këto mjetë dhe pajisje përfshijnë OSSH-në ose SGU-të, këto palë do të marrin pjesë në këtë test.
3. OST do të testojë aftësinë e burimeve rezervë të energjisë për të furnizuar shërbimet kryesore të nënstacioneve të identifikuar si kryesorë për procedurat e planit të rivendosjes sipas nenit 266 (4), të paktën çdo pesë vjet. Kur këto nënstacione janë në sistemin e shpërndarjes, testin duhet ta ekzekutojë OSSH.
4. OST do të testojë procedurën e transferimit për lëvizjen nga qendra kryesore e kontrollit në qendrën rezervë të kontrollit, të parashikuar në nenin 285 (4), të paktën çdo vit.

Titulli 2 – Testimi i pajtueshmërisë dhe rishikimi i planeve të mbrojtjes dhe rivendosjes së sistemit

Neni 293. Testimi i pajtueshmërisë dhe rishikimi periodik i planit të mbrojtjes së sistemit

1. OSSH i përfshirë në implementimin e shkyçjes së kërkesës në frekuencë të ulët në instalimet e tij, një herë në vit përditëson komunikimin e njoftimit të operatorit të sistemit të parashikuar në pikën (b) të nenit 255 (6). Ky komunikim do të përfshijë tarimet e frekuencës në të cilat fillohet shkyçja e kërkesës neto dhe përqindja e kërkesës neto të shkyçur për çdo vlerë të këtij set-point.

2. OST do të monitorojë zbatimin e duhur të shkyçjes së kërkesës në frekuencë të ulët në bazë të komunikimit vjetor me shkrim të përmendur në paragrafin 1 dhe në bazë të detajeve të implementimit në instalimet e OST-se kur zbatohet.
3. OST do të rishikojë, të paktën çdo pesë vjet, planin e tij të plotë të mbrojtjes së sistemit për të vlerësuar efektivitetin e tij. OST në këtë rishikim duhet të marrë parasysh të paktën:
 - a. zhvillimin dhe evoluimin e rrjetit të tij që nga rishikimi i fundit;
 - b. aftësitë e pajisjeve të reja të instaluara në sistemet e transmetimit dhe shpërndarjes që nga rishikimi i fundit;
 - c. SGU-të e komisionuar që nga rishikimi i fundit, aftësitë e tyre dhe shërbimet respektive të ofruara;
 - d. testet e kryera dhe analizat e incidenteve të sistemit në përputhje me nenin 137 (5) të kodit; dhe
 - e. të dhënat operative të grumbulluara gjatë operimit normal dhe pas incidentit në sistem.
4. OST duhet të rishikojë masat përkatëse të planit të mbrojtjes së sistemit në përputhje me paragrafin 3 përpara çdo ndryshimi thelbësor në konfigurimin e rrjetit.
5. Kur OST identifikon nevojën për të përshtatur planin e mbrojtjes së sistemit, ai ndryshon planin e mbrojtjes së sistemit dhe i zbaton këto ndryshime në përputhje me nenet 255 dhe 256.

Neni 294. Testimi i pajtueshmërisë dhe rishikimi periodik i planit të rivendosjes

1. OST do të rishikojë masat e planit të rivendosjes duke përdorur testet të simulimit kompjuterik, duke përdorur të dhëna nga OSSH sipas nenit 266 (4) dhe ofruesit e shërbimit të rivendosjes, të paktën çdo pesë vjet. OST do t'i përcaktojë këto teste simulimi në një procedure testimi dedikuar që mbulon së paku:
 - a. rruga e energjizimit e rivendosjes nga ofruesit e shërbimit të rivendosjes me aftësi për black-start ose operim në ishull;
 - b. furnizimin e nevojave vetjake kryesore të moduleve gjeneruese;
 - c. procesi i ri-kyçjes së ngarkesës; dhe
 - d. procesi i ri-sinkronizimit të rrjeteve në operim ishull.
2. Përveç kësaj, kur nga OST konsiderohet e nevojshme për efektivitetin e planit të rivendosjes, OST do të kryejë testimin operacional të pjesëve të planit të rivendosjes, në koordinim me OSSH-në dhe ofruesit e shërbimit të rivendosjes.
3. Të paktën çdo pesë vjet, çdo OST do të rishikojë planin e tij të rivendosjes për të vlerësuar efektivitetin e tij.

4. OST do të rishikojë masat përkatëse të planit të tij të rivendosjes në përputhje me paragrafin 1 dhe do të rishikojë efektivitetin e tyre përpara çdo ndryshimi thelbësor në konfigurimin e rrjetit.
5. Kur OST identifikon nevojën për të përshtatur planin e rivendosjes, ai ndryshon planin e rivendosjes dhe i zbaton këto ndryshime në përputhje me nenet 266 dhe 267.

Aneks I

Karakteristikat e skemës së shkyçjes automatike të kërkesës në frekuencë të ulët, për zonën sinkrone të Evropës Kontinentale:

Parametri	Vlera	Njësia matëse
Niveli fillestar i shkyçjes së detyrueshme: Frekuenca	49	Hz
Niveli i fillimit të shkyçjes së detyrueshme: Kërkesa për tu shkyçur	5	% e ngarkesës totale në nivel nacional
Niveli i final i çkyçjes së detyrueshme: Frekuenca	48	Hz
Niveli i final i shkyçjes së detyrueshme: Kërkesa kumulative për tu shkyçur Frekuenca	45	% e ngarkesës totale në nivel nacional
Diapazoni i implementimit	± 7	% e ngarkesës totale në nivel nacional për një frekuencë të dhënë
Numri minimal i hapave për arritjen e nivelit final të detyrueshëm	6	Numri i hapave
Maksimumi i Kërkesës së shkyçur për secilin hap	10	% e ngarkesës totale në nivel nacional për një hap të dhënë

OPERIMI I TREGUT DHE RREGULLAT E MATJES

Pjesa I – Operimi i tregut të energjisë elektrike

Neni 295. Objekti dhe qëllimi

1. Ky kod përmban rregulla të përgjithshme mbi çështjet që lidhen me funksionimin e Operatorit të Tregut, operimin e tregut, si dhe marrëdhëniet midis OT dhe OST, OSSH dhe përdoruesve të rrjetit të transmetimit.
2. Dispozitat e këtij kodi interpretohen në bashkërendim me Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike apo Rregullat e Tregut të Balancimit.
3. Dispozitat e kodit në lidhje me rregullat e matjes (përfshirë matësin, sistemin e matjes dhe veprimtarinë e matjes) përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet për OST, përdoruesit e sistemit të transmetimit si dhe të pjesëmarrësve të tregut.

Neni 296. Operatori i Tregut dhe funksionimi i tij

1. Operatori i Tregut është struktura përgjegjëse për menaxhimin dhe administrimin e tregut të organizuar ndërmjet platformës së tregut, në bazë të ditës në avancë (D-1) dhe brenda ditës (D), si dhe për të gjitha aktivitetet e lidhura me të, duke përfshirë edhe aktivitetin e kompensimit financiar (*clearing*) mes pjesëmarrësve të tregut, në përputhje me rregullat dhe modelin e tregut.
2. Operatori i tregut do të jetë Bursa Shqiptare e Energjisë.
3. Operatori i tregut funksionon në përputhje me rregullat e tregut të energjisë elektrike dhe parashikimet e ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.
4. Në modelin e tregut miratuar me VKM nr. 519, datë 13.07.2016 “Modeli Tregut të Energjisë Elektrike”, përcaktohen:
 - a. mënyrat e bashkëpunimit ndërmjet pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike;
 - b. marrëdhëniet kontraktore të nevojshme;
 - c. informacioni dhe shkëmbimi i të dhënave kryesore, të kërkuara midis pjesëmarrësve të tregut.

Neni 297. Operatori i Tregut dhe Tregu Balancues

1. Tregu i balancimit është menaxhimi, i bazuar në treg, i funksioneve të balancimit të sistemit të energjisë elektrike, nga Operatori i Sistemit të Transmetimit.
2. Pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike mund të rregullojnë përgjegjësinë për balancimin, nëpërmjet një kontrate me OST duke marrë statusin e PPB (Palë Përgjegjëse për Balancim) ose duke nënshkruar një kontratë për transferimin e

përgjegjësisë së balancimit ndaj një pale tjetër përgjegjëse për balancimin, duke u bërë pjesëtar i një grupi balancues, në përputhje me rregullat e tregut të balancimit.

3. Operatori i Tregut është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare për shlyerjen e detyrimeve të ndërsjella për disbalancat e shkaktuara nga pjesëmarrësit e tregut.

Neni 298. Rolet e OT, OST, OSSH dhe përdoruesve të sistemit të transmetimit sipas Modelit të Tregut

1. OST përveç funksioneve të tjera, kryen operimin e tregut të balancimit nëpërmjet:
 - a. parashikimit dhe blerjes në treg të shërbimeve ndihmëse të ndara në energji balancuese dhe kapacitet rezervë, nga të gjithë ofruesit e shërbimeve të balancimit, në afatet kohore javore, në ditën në avancë dhe në kohë reale.
 - b. kryerjes së veprimeve të nevojshme për balancimin e sistemit, duke aktivizuar rregullimin sekondar në rritje ose në ulje nga rezervat balancuese dhe/ose rezervat shtesë balancuese të ofruara në treg për balancimin e energjisë.
 - c. blerjes së energjisë për humbjet në sistemin e transmetimit në tregun e organizuar të ditës në avancë. Për periudhën kalimtare para hyrjes në operim të tregut të energjisë, OST i lejohen procedurat e prokurimit të energjisë sipas rregullave të miratuara nga ERE.
 - d. kompensimit të tij për shërbimet balancuese, duke siguruar likuidimin financiar në baza mujore, nëpërmjet shlyerjes së disbalancave bazuar në mekanizmin e shlyerjes së disbalancave dhe Rregullave të Tregut Balancues.
 - e. menaxhimit të të dhënave të matjes për të kryer një menaxhim efikas të disbalancave të energjisë dhe shlyerjes financiare të tyre.
 - f. çmimit të disbalancave të energjisë që do të paguhet nga palët përgjegjëse balancuese, i cili do të përcaktohet në bazë të kostos reale për OST për të balancuar sistemin për periudhën përkatëse dhe që mbulon rezervat e balancimit dhe energjinë.
2. OSSH kryen blerjen e humbjeve teknike dhe jo-teknike në tregun e organizuar të ditës në avancë. Për periudhën kalimtare para hyrjes në operim të tregut të energjisë OSSH i lejohen procedurat e prokurimit të energjisë sipas rregullave të miratuara nga ERE.
3. “Pala përgjegjëse për balancimin” është një pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike ose përfaqësuesi i zgjedhur prej tij, përgjegjës përballë Operatorit të Sistemit të Transmetimit për disbalancat e krijuara gjatë operimit të tij.
4. “Pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike” është një person juridik, i regjistruar si pjesëtar i tregut të energjisë elektrike, që përfshin prodhuesit, tregtarët, furnizuesit, klientët, Operatori i Sistemit të Transmetimit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, sistemet e mbyllura të shpërndarjes dhe operatori i tregut. Operatori i Sistemit të

Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes janë pjesëmarrës të tregut të energjisë elektrike vetëm për qëllim të sigurimit të energjisë elektrike të nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjet, balancimin dhe shërbimet ndihmëse.

5. Termat dhe kushtet për t'u bërë një PPB përcaktohen nga OST dhe rregullohen me marrëveshje midis tyre bazuar në Rregullat e Tregut të Balancimit.
6. Të gjitha PPB janë përgjegjëse për parashikimin e tyre të prodhimit dhe konsumit si dhe për llogaritjet e disbalancave. Një PPB mund të marrë përgjegjësitë e PPB-ve të tjera ose të njësisve të prodhimit dhe konsumit nën një kapacitet të miratuar.
7. Ofruesi i shërbimeve të balancimit (OSB) është një PPB që ofron shërbime balancimi për OST. Kushtet dhe kriteret për t'u bërë OSB përcaktohen nga OST dhe rregullohen me marrëveshje ndërmjet OSB-së dhe OST-së.
8. Bursa Shqiptare e Energjisë (BSHE) operohet nga OT dhe kryen këto funksione:
 - a. siguron të gjitha sistemet dhe ndërveprimet e nevojshme për operimin e tregut të ditës në avancë dhe brenda ditës;
 - b. pranon aplikime dhe oferta për të blerë dhe shitur energji nga pjesëmarrësit e tregut;
 - c. merr dhe proceson kapacitetet e interkoneksionit nga OST, si dhe informacione të tjera përkatëse;
 - d. kryen ankandet e nevojshme dhe operacionet tregtare, në përputhje me rregullat e miratuara, duke përdorur për këtë qëllim algoritmat evropiane të bashkimit të tregut;
 - e. i dërgon pjesëmarrësve të tregut dhe OST, sipas afateve të përcaktuara, konfirmimet tregtare, duke përfshirë sasinë e alokuara dhe çmimet;
 - f. publikon sasinë e shpërndara dhe çmimet përkatëse, sipas afateve të përcaktuara;
 - g. i dërgon pjesëmarrësve të tregut dhe OST, në përputhje me afatin e rënë dakord, njoftimet e kredive, llogaritë financiare;
 - h. ekzekuton mjetet e shtrëngimit dhe pagesat për pjesëmarrësit e tregut, në përputhje me rregullat dhe afatet e përcaktuara;
 - i. respekton kërkesat për transparencë dhe ushtron kompetenca të monitorimit të tregut;

Neni 299. Operatori i Tregut dhe marrëdhëniet midis tij dhe OST, OSSH dhe përdoruesve të sistemit

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes janë pjesëmarrës të tregut të energjisë elektrike vetëm për qëllim të sigurimit të energjisë

elektrike të nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjet, balancimin dhe shërbimet ndihmëse.

2. Operatori i Tregut do të vërë në dispozicion të OST dhe OSSH çdo informacion të nevojshëm për kryerjen e funksioneve të menaxhimit të sistemeve respektive.
3. OST dhe OSSH do të vendosin në dispozicion të Operatorit të Tregut çdo informacion të nevojshëm për operimin efektiv të tregut të energjisë.
4. Informacioni reciprok i dhënë sipas pikës 2 dhe 3 të këtij neni është konfidencial dhe në asnjë rast nuk duhet të përmbajë informacion të ndjeshëm tregtar.
5. Në përputhje me Modelin e Tregut, Rregullat e Tregut dhe kodet, përveç detyrimeve të përcaktuara në licencat përkatëse dhe/apo rregulla të tjera çdo pjesëmarrës tregu ka detyrim të paraqesë për OST/OSSH dhe Operatorin e Tregut informacionin e kërkuar në përputhje me këtë kod dhe me Rregullat e Tregut në fuqi.

Neni 300. Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)

1. Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) i referohet një subjekti ligjor i përcaktuar nga ERE për të kryer detyrat që kanë lidhje me bashkimin e tregut të ditës në avancë dhe atij brenda ditës;
2. NEMO vepron si operator tregu në Shqipëri ose tregje rajonale për të kryer, në bashkëpunim me OST, bashkimin e tregut të ditës në avancë dhe atij brenda ditës.
3. Detyrat respektive janë përcaktuar në rregulloren e miratuar me Vendim të ERE nr.40, datë 6.3.2020. Sipas kësaj rregullore OST ndër të tjera:
 - a. do të bashkëpunojë me OST-të e tjera për të siguruar funksionimin e algoritmeve të bashkimit të çmimit dhe përputhjes së tregtimit të vazhdueshëm për të gjitha aspektet në lidhje me alokimin e kapacitetit ndër – kufitare ne te njëjtën kohe (simultane). Me gjithë krijimin e një algoritmi të besueshëm për të përputhur kërkesat dhe ofertat dhe proceset e duhura te back-up-it, mund të ketë situata kur procesi i bashkimit të çmimeve nuk është në gjendje të prodhojë rezultate. Si rrjedhim, është e nevojshme të parashikohen zgjidhje për rezultatet në nivel kombëtar dhe rajonal për të siguruar që kapaciteti mund të alokohet gjithsesi;
 - b. do të kryejë, në koordinim me OST-të e tjera, llogaritjen e kapacitetit neto të transmetimit në D-2 për të mbështetur bashkimin e tregut;
 - c. do të llogarisë, konfirmojë me OST-të e tjera dhe dërgojë kapacitetet ndër-zonale dhe limitet e alokimit te NEMO-t përkatëse jo më vonë se 1 orë para mbylljes së portës së tregut të ditës në avancë.
 - d. nëse nuk është në gjendje t'i ofrojë të dhënat e pikës (c), duhet të njoftojë NEMO-t respektive dhe duhet t'i ofrojë të dhëna hyrëse jo më vonë se 30 minuta para mbylljes së portës së tregut të ditës në avancë;

- e. do të verifikojë rezultatet e bashkimit të tregut të vetëm të ditës në avancë sipas kapaciteteve ndër-zonale dhe limiteve të alokimit të vlerësuara;
- f. do të hartojë dhe operojë procedurat mbështetëse (fallback procedures) sipas rastit për alokimin e kapacitetit;

Pjesa II – Rregullat e matjes

Neni 301. Përgjegjësitë e palëve

1. Rregullat për matjen e energjisë elektrike përcaktojnë të drejtat dhe përgjegjësitë OST, përdoruesve të sistemit të transmetimit dhe pjesëmarrësve në tregun e energjisë, ne lidhje me:
 - a. matjen e të gjithë flukseve hyrëse / dalëse të energjisë elektrike në rrjet,
 - b. leximet e matësave, dhe marrjen e të dhënave nga matësat e energjisë elektrike;
 - c. përpunimin e të dhënave dhe shpërndarja për proceset në tregun e energjisë.
2. Rregullat përcaktojnë kërkesat teknike për transformatorët, matësat e energjisë elektrike dhe pajisjet ndihmëse në të gjitha pikat e lidhjes me sistemin e transmetimit ose interkoneksionit, si dhe të përcaktojë të gjitha të dhënat e nevojshme në një pikë matje.
3. Operatori i Sistemit të Transmetimit është përgjegjës për veprimtarinë matëse dhe shërbimin e leximit të matësve në rrjet në përputhje me ndarjen e pronësisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit sikurse është përcaktuar me ligj.
4. Dispozitat e këtyre rregullave zbatohen për pikat matëse në të gjitha vendet e ofrimit të energjisë elektrike në objektet e transmetimit të OST, apo në objektet e përdoruesve të lidhur me sistemin e transmetimit.
5. Dispozitat e këtyre rregullave zbatohen edhe për pikat matëse në 400/220 kV, 400/110 kV dhe traktet e transformatorëve 220/110 kV, në anën e tensionit të mesëm brenda rrjetit të transmetimit.
6. Energjia elektrike e hedhur në rrjet ose e furnizuar te klientët fundorë matet nëpërmjet pajisjeve matëse, në përputhje me parashikimet legjislativë në fuqi për metrologjinë.
7. OST duhet të marrë masa që matësi dhe/ose sistemi matës duhet të jenë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë”, Nenin 76, pika 3 në lidhje me vulën, vuloşjen dhe klasën e saktësisë.
8. OST dhe përdoruesit do të zbatojnë kushtet e përdorimit të pikës së matjes sikurse përcaktohen në këtë kod, duke respektuar parimet e transparencës dhe mosdiskriminimit.

9. OST dhe përdoruesit do të zbatojnë kushtet teknike për funksionimin e sigurtë dhe të besueshëm të sistemit të matjes duke garantuar cilësinë e shërbimit sipas përgjegjësisë dhe kompetencave të OST dhe përdoruesve.
10. OST do të bëjë publike karakteristikat teknike dhe teknologjike të pajisjeve dhe sistemit të matjes të cilat duhet të përmbushen për çdo pikë matje të përdoruesve të lidhur në sistemin e transmetimit.

Neni 302. Pika e matjes dhe pika e dhënies/marrjes së energjisë

1. Pika e matjes përfaqëson vendndodhjen fizike në sistem ku regjistrohet dhe matet sasia e energjisë elektrike.
2. Pika e matjes mund të vendoset në ambientet ose pjesë të ambienteve në pronësi të:
 - a. OST,
 - b. Përdoruesit gjenerues,
 - c. Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, ose
 - d. Përdoruesit ngarkesë.
3. Pika e dhënies/marrjes së energjisë është pika në të cilën njësitë gjeneruese, konsumatorët dhe sistemi i shpërndarjes janë të lidhur në sistemin e transmetimit në të cilën OST jep/merr energji nga/për përdoruesit e sistemit të transmetimit.
4. Pika e matjes dhe pika e dhënies/marrjes përcaktohen në studimin e pikës së lidhjes dhe marrëveshjen midis palëve për lidhjen me sistemin e transmetimit.
5. Nëse për rrethana të caktuara, pa rënë në kundërshtim me kuadrin në fuqi, studimi nuk ekziston apo nuk trajton pikën e matjes dhe pikën e dhënies/marrjes së energjisë, OST do të përcaktojë vendndodhjen e pikës së matjes, pikën e lidhjes me sistemin si dhe vendndodhjen e matësit të kontrollit dhe matësit kryesor të përdoruesit.

Neni 303. Vendndodhja e pikës së matjes

1. Pika e matjes është pika e dhënies/marrjes së energjisë nga sistemet fqinje (pikat e matjes të ineterkoneksioneve) të cilat ndodhen në nënstacionet 400/x kV, 220/x kV, 154/x kV ose 110/x kV pronë e OST.
2. OST është përgjegjëse për instalimin, mirëmbajtjen dhe kontrollin periodik sipas kuadrit në fuqi, të sistemit të matjes, matësit kryesor dhe atij të kontrollit. Sistemi i matjes, matësi kryesor dhe i kontrollit instalohen në të njëjtën pikë matje. Karakteristikat teknike duhet të jene identike, në përputhje me kërkesat teknike të kërkuara nga Kodi Matjes.
3. Matja e energjisë së interkoneksionit në dhënie/marrje rregullohet nga kontratat/marrëveshjet përkatëse të interkonjeksionit me operatorët fqinjë.

4. Për përdoruesit gjenerues pika e matjes është pika e dhënies së energjisë nga objekti gjenerues në sistemin e transmetimit dhe përcaktohet në studimin për lidhjen me sistemin e transmetimit.
5. Përdoruesi (objekti gjenerues) ka mundësinë për të instaluar dhe mirëmbajtur pajisje shtesë matje për kontroll, në pronën e tij, për matjen e energjisë së dhënë/marrë në linjat e lidhjes në nënstacion, si rezerve për matësit e kontrollit dhe kryesor të OST.
6. OST ka mundësinë për të instaluar dhe mirëmbajtur pajisje shtesë matje për kontroll, në pronën e OST, për matjen e energjisë së dhënë/marrë në linjat e lidhjes në nënstacion, si rezerve për matësit e kontrollit dhe kryesor.
7. Pika e matjes është pika e dhënies/marrjes së energjisë elektrike nga OST drejt OSSH sipas përcaktimeve në studimet e lidhjes me sistemin e transmetimit.
8. OSSH është e detyruar të instalojë, kontrollojë periodikisht sipas kuadrit në fuqi dhe mirëmbajë matësa shtesë kontrolli për matjen e energjisë së dhënë/marrë. Këto pajisje installohen në anën e tensionit të ulet të transformatorit.
9. Pika e matjes dhe pika e lidhje e dhënies/marrjes së energjisë nga OST drejt përdoruesit ngarkese të lidhur në sistemin e transmetimit përcaktohen në studimin e lidhjes me rrjetin e transmetimit.
10. OSSH është përgjegjëse për instalimin, mirëmbajtjen, kontrollin periodik të matësit kryesor dhe të kontrollit.
11. Konsumatorët e lidhur direkt në sistemin e transmetimit janë të detyruar të instalojnë dhe mirëmbajnë matësa kontrolli shtesë në pronën e tyre për matjen e energjisë në dhënie/marrje.
12. Konsumatorët e lidhur direkt në sistemin e transmetimit janë përgjegjës për instalimin, mirëmbajtjen, kontrollin periodik sipas kuadrit në fuqi të sistemit të matjes të kontrollit.
13. OST mund të instalojë dhe mirëmbajë matësa shtesë kontrolli për matjen e energjisë në linja që lidhen në nënstacionet e saj si rezerve e matësive kryesorë.

Neni 304. Instalimi i një pike matje, vulosja dhe faktori korrigjues

1. Nëse plotësohen të gjitha kushtet teknike pika e matjes vendoset në të njëjtin nivel tensioni si pika e lidhjes.
2. Pas instalimit dhe vënies në operim, sistemi i matjes (pajisjet matëse, kaseta e lidhjes së matësit, dhe pajisje të tjera që mund të influencojnë saktësinë e matjes dhe faturimit të energjisë) duhet të bashkëvulosen nga operatori i sistemit dhe DPM-ja. Vula duhet të vendoset në një pozicion të përcaktuar për vulosjen e sistemit të matjes.

3. Vula duhet të jetë e identifikueshme me logo të subjektit i cili bën vulosjen dhe me përbërje materiale dhe mënyrë instalimi e cila nuk ndikon në matësin kryesor apo të kontrollit dhe në vlerat e matura.
4. Vulosja e sistemit matës duhet të kryhet në përputhje me përcaktimet ligjore dhe duke zbatuar rregullat si vijon:
 - a. Pajisjet e matjes dhe pajisjet përkatëse të komunikimit do të vendosen në një kabinet të dedikuar dhe të sigurt të vendosura në një zonë lehtësisht të arritshme, të lirë nga pengesat dhe të ndriçuar mirë sipas nevojës edhe me ndriçim artificial nga përdoruesi që kërkon të lidhet në sistemin transmetimit.
 - b. Kabineti do të jetë në përputhje me rekomandimet e prodhuesit të matjes për kushtet mjedisore dhe projektimi i tij duhet të paktën të përfshijë mbrojtje nga lagështia dhe pluhuri dhe nga dëmtimi fizik, duke përfshirë dridhjet dhe të sigurojë kontroll të duhur të temperaturës.
 - c. Kabineti do të jetë i pajisur me çelës dhe kapak transparent dhe i vulosur. OST kontrollon vulosjen kohe pas kohe në përputhje me procedurat përkatëse praktike. Vula mund të thyhet/hapet vetëm nga ose me miratimin e subjekteve që kanë kryer vulosjen.
5. Aty ku pika e livrimit/marrjes dhe pika e matjes nuk janë në të njëjtin nivel tensioni, ose në qoftë se ata janë në të njëjtin nivel tensioni, por në një distancë nga njëri-tjetri aq sa humbjet e energjisë në mes tyre nuk mund të neglizhohen, duhet të përcaktohen një faktor korigjues i aplikuar për të dhënat e matjes për vlerën e humbjeve të energjisë nga pika e livrimit deri në pikën e matjes (e transferuar në pikën e livrimit). Përdorimi i faktorit korigjues kryhet gjatë procesit të shlyerjes dhe është pjesë përbërëse e saj.
6. Faktori i korigjues në ato raste ku është i nevojshëm të përdoret do jetë pjesë e marrëveshjes së lidhjes midis palëve para se linjat të vihen në operim.
7. Faktori i korigjimit përcaktohet nga OST bazuar në specifikimin teknik të pajisjes, llogaritjes së humbjeve në mes pikës së livrimit dhe pikës matëse nën kushte mesatare operationale. Faktori korigjimit përcaktohet në:
 - a. Marrëveshjen e lidhjes së objektit të përdoruesit fundor apo gjeneruesit;
 - b. Kontrata për interkoneksionit e sistemit të transmetimit/shpërndarjes;
 - c. Marrëveshjen operimit për objektet e përdoruesit fundor ose gjeneruesit, kur faktori i korigjimit është ndryshuar gjatë operimit të objektit;
8. Çdo ndryshim në kushtet teknike mbi të cilat është kryer llogaritja e koeficientit të korigjimit do të reflektohet me verifikimin, rillogaritjen dhe sipas nevojës ndryshimin e koeficientit të korigjimit si dhe amendimin e dokumenteve përkatës dhe reflektimin në procedurat përkatëse ku ky koeficient përdoret.

Neni 305. Pajisjet e matjes

1. Në çdo pikë matje, pajisjet e sistemit të matjes përfshijnë:
 - a. Transformatorët matës;
 - b. Matësat e energjisë elektrike (matësi kryesor dhe matësi kontrollues);
 - c. Qarqet elektrike sekondare të matjes dhe ndihmëse;
 - d. Pajisjet e komunikimi
 - e. Pajisjet ndihmëse (boksi i terminalit të matjes dhe kabineti i matjes për lidhjen e matësve, siguresa, pajisjet e mbrojtjes, pajisjet e furnizimit me energji elektrike etj.);
 - f. Pajisje të sinjalizimit dhe mbikëqyrjes;
2. Në çdo pikë matje kryesore dhe kontrolli të energjisë elektrike transformatorët e tensionit të matjes (VMT) dhe transformatorët e rrymës së matjes (CMT) instalohen dhe plotësojnë standardet sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 482, datë 17.6.2020 “Për miratimin e rregullës teknike “Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së linjave elektrike me tension të lartë mbi 1 kV” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 483, datë 17.6.2020 “Për miratimin e rregullës teknike, “Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së instalimeve elektrike të tensionit të lartë, mbi 1 kV”.
3. Transformatorët e matjes duhet të shoqërohen nga protokoli i testimit në fabrikë nga prodhuesi si dhe vulosjen nga subjektet e autorizuar ose institucioni përkatës.
4. Klasa e saktësisë së transformatorëve të matjes përcaktohet në tabelën në vijim:

	Fuqia e Kërkuar	CMT	VMT
Linjat e interkonjeksionit	Pa limit vlere	$0,2 S + 0,2 S^*$	$0,2 + 0,2^*$
Gjeneruesit, OSSH, përdorues të sistemit të transmetim	1÷10 MW	0,5S	0,5
	10÷50 MW	0.2S	0.5
	>50MW	0.2S	0.2
Skema e furnizimit për pajisjet ndihmëse		$\leq 0,5$	$\leq 0,5$

(*) dy bërthama matje

Neni 306. Transformatorët e matjes së rrymës

1. Rryma e lejuar primare e transformatorëve të matjes së rrymës përcaktohet në përputhje me rrymën e lejuar të pajisjeve të tjera të traktit ku ndodhet transformatori i rrymës.

2. OST përcakton koeficientin e anës primare të transformatorëve që përdoren në sistemin e matjes. Përdoruesi është i detyruar të zbatojë kërkesat e OST të cilat i paraqiten me njoftim zyrtar ose të cilat përcaktohen në studimin për lidhjen në sistemin e transmetimit.
3. Në bërthamën e matjes së transformatorëve të rrymës lidhen vetëm matësit e energjisë elektrike.
4. Në pikat e matjes së interkonjeksioneve dhe në pikat e matjes të përdoruesve gjenerues, transformatorët e rrymës duhet të jenë të pajisur me dy bërthama me karakteristika teknike identike. Në bërthamën e parë lidhet vetëm matësi kryesor ndërsa në bërthamën e dytë lidhet matësi kontrollues.
5. Ngarkesa totale e çdo bërthame matje të transformatorëve të rrymës përfshirë dhe qarqet elektrike sekondare duhet të jetë 25 – 100 % të fuqisë së lejuare të bërthamës së matjes.
6. Seksioni i përcjellësve i qarqeve sekondare të matjes nga terminali i transformatorit të rrymës në kasetën/boksin e lidhjes së matjes duhet të jetë të paktën 2.5 mm² për përcjellës me gjatësi 100 m/faze, dhe 4 mm² për përcjellës me gjatësi më shumë se 100 m/faze.
7. Qarqet elektrike të matjes duhet të kenë mbrojtje të përshtatshme nga shqetësimet mekanike dhe elektrike. Tipi i përcjellësve për qarqet sekondare duhet të jetë NYCY.
8. Karakteristikat teknike të detajuara të transformatorëve të rrymës të matjes përcaktohen në studimin e lidhjes në sistemin e transmetimit.
9. Nëse nuk ka një studim për lidhjes në sistemin e transmetimit, karakteristikat e transformatorit të rrymës të matjes përcaktohet nga OST me njoftim zyrtar.
10. OST ka të drejtë të kërkojë plotësimin e kushteve për transformatorët e rrymës të matjes në përputhje me kushtet e sistemit të transmetimit.

Neni 307. Transformatorët e matjes së tensionit

1. Si rregull në bërthamën e matjes së transformatorëve të matjes së tensionit (VMT) lidhen vetëm matësit e energjisë.
2. Në kushte të veçanta dhe me lejen e OST në bërthamën e matjes mund të lidhen edhe pajisje të tjera, vetëm nëse ngarkesa totale në bërthamë nuk kapërcen fuqinë e lejuare të saj.
3. Termialet sekondare të VMT duhet të pajisen me sisteme speciale automatike me kontakt për sinjalizimin. Pajisjet automatike vendosen sa më pranë të jetë e mundur me termialet sekondare të VMT (në panelin e kontrollit në traktin ku ndodhen VMT).

4. Rënia e tensionit nga VMT në matësin e energjisë (ΔU) duhet të jetë $\leq 0,05\%$ e tensionit të lejuar sekondar të VMT nëse furnizon matësin me klasë saktësie 0.2s, dhe $\Delta U \leq 0,1\%$ nëse furnizon matësin me klasë saktësie 0.5s. Seksioni i përcjellësve të qarqeve të matjes së tensionit duhet të përcaktohet në përputhje me rëniet e lejuara të tensionit.
5. Ngarkesa totale e bërthamës sekondare të VMT, përfshirë përcjellësit e lidhjes, duhet të jetë 25%-100% i fuqisë së lejuar të bërthamës.
6. Qarqet e matjes së tensionit duhet të realizohen me mbrojtje të përshtatshme nga shqetësimi mekanike dhe elektrike. Tipi i përcjellësve për qarqet sekondare duhet të jetë NYCY.
7. Detajet e karakteristikave teknike të VMT përcaktohen në studimin për lidhjen në sistemin e transmetimit.
8. Nëse nuk ka një studim për lidhjen në sistemin e transmetimit, karakteristikat e transformatorit të matjes së tensionit përcaktohen nga OST me njoftim zyrtar.
9. OST ka të drejtë të kërkojë plotësimin e kushteve për transformatorët e matjes të tensionit në përputhje me kushtet e sistemit të transmetimit.

Neni 308. Matësit

1. Pajisjet e matjes (matësit) duhet të regjistrojnë energjinë aktive dhe reaktive dhe duhet të jenë në përputhje me kuadrin ligjor për matjen si dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 482, datë 17.6.2020 “Për miratimin e rregullës teknike “Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së linjave elektrike me tension të lartë mbi 1 kV” dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 483, datë 17.6.2020 “Për miratimin e rregullës teknike, “Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së instalimeve elektrike të tensionit të lartë, mbi 1 kV”.
2. Matësit duhet të jenë statik, trefazor, dy drejtimesh, katër përcjellës, me katër tarifa për matjen e fuqisë dhe energjisë aktive dhe reaktive dhe me aftësinë për shkëmbimin e të dhënave në distancë.
3. Matësit duhet të afishojnë lokalisht dhe në distancë leximet të kW, kWh, kVAr, kVArh si dhe të konsumit total, regjistrimit të ngjarjeve dhe stampimin e kohës së ngjarjeve.
4. Pajisjet e matjes duhet të përfshijnë regjistra matje për çdo madhësi të matur.
5. Matësit duhet të kenë të paktën dy vula të veçanta. Një vule nga struktura përkatëse shtetërore (DPM) dhe vula tjetër nga OST. Përdoruesi mund të bëjë vulosje me një vule të tij në koordinim me OST dhe institucionin shtetëror. Në kapakun e terminaleve të matësit dhe në butonin reset vendosen vula e OST, DPM dhe përdoruesit nëse kërkohet nga ky i fundit.
6. Çela/boksi i matjes do të mbyllet dhe vuloset për të parandaluar aksesin e paautorizuar.

7. Për pajisjet e matjes duhet të sigurohet furnizim rezerve me energji nga një burim i jashtëm.
8. Në pikat e matjes së interkonjeksionit dhe në pikat e matjes së gjeneruesve përveç matësit kryesor instalohet dhe matësi i kontrollit me të njëjtat karakteristika teknike dhe klasë saktësie si matësi kryesor. Për qëllim të rakordimeve dhe faturimit përdoren të dhënat e matjes që merren nga matësi kryesor.
9. Në rast dështimi ose keqfunksionimi të matësit kryesor ose një pjese të sistemit të matjes, për qëllim të rakordimeve dhe faturimit përdoren të dhënat e matjes që merren nga matësi i kontrollit.
10. Klasa e saktësisë së matësit

	Fuqia e kërkuar	Klasa saktësisë	
		Energjia-Aktive	Energjia-Reaktive
Linjat e interkonjeksionit	Pa limit vlere	$0,2 S + 0.2S^*$ (Klasa C)	$\leq 1 + \leq 1^*$
Gjeneruesit, OSSH, përdorues i sistemit të transmetim	1 ÷ 10 MW	$0,5 S + 0.5S^*$ (Klasa C)	$\leq 1 + \leq 1^*$
	10 ÷ 50 MW	$0,5 S + 0.5S^*$ (Klasa C)	$\leq 1 + \leq 1^*$
	>50MW	$0,2 S + 0.2S^*$ (Klasa C)	$\leq 1 + \leq 1^*$
Skema e furnizimit për pajisjet ndihmëse		$\leq 0,5$	$\leq 1 + \leq 1^*$

(*) instalim i detyrueshëm i një matësi kryesor dhe një kontrolli

11. Detajet e karakteristikave teknike të matësve përcaktohen në studimin për lidhjen në sistemin e transmetimit.
12. Çdo pajisje matje duhet të emërtohet me një numër unik identifikimi.
13. Numri i identifikimit së bashku me karakteristikat teknike dhe specifikimet duhet të regjistrohen nga OST në regjistrin e matjes dhe data bazën e matjes.

Neni 309. Sinjalizimi dhe mbikëqyrja

1. Përdoruesit duhet të sigurojnë mbikëqyrjen dhe sinjalizimin e ngjarjeve si vijon në një vend të përshtatshëm në objektin e tij:
 - a. Mungesa e tensionit në pajisjet e matjes;
 - b. Ndërprerja e furnizimit ndihmës;
 - c. Ndërhyrje e paautorizuar në pajisjen e matjes;

- d. Dështim i operimit normal te pajisjeve të matjes;
2. Të gjithë alarmet e mësipërme duhet të regjistrohen me stampim kohe ne një regjistër ngjarjesh të matësit.
 3. Nëse regjistrohet shfaqja e çdo alarmi nga qarqet e rrymës apo tensionit ose cenim i matësit (akses i paautorizuar në терминаlet e lidhjes të matësit, mungesa e tensionit ose rrymës, dështimi i lidhjes me sistemin, etj.), ky informacion duhet te jetë i disponueshëm për OST në kohe reale.

Neni 310. Komunikimi, protokoli i komunikimit dhe ndërfaqja

1. Të gjithë sasi të e matura dhe të gjithë të dhënat që regjistrohen me matës duhet të lexohen lokalisht dhe në distancë në përputhje me një nga standardet ndërkombëtare dhe protokollet si vijon:
 - a. IEC 62056-42 / 46/53/61/62 (DLMS) – metering device (IR port, electrical port RS 485, serial port RS 232);
 - b. IEC 61107 – metering device
2. Ndërfaqja e komunikimit (niveli fizik i komunikimit me pajisjen e matjes) duhet te ketë standardet në vijim:
 - a. IEC 62056-21 – IR port/metering device;
 - b. ISO 8482 – RS 485 port/metering device;

Neni 311. Kanalet e komunikimit

1. Për të gjithë sasi të e matura të cilat regjistrohen nga pajisjet e matjes dhe që lexohen në distance duhet të sigurohet një nga kanalet e mëposhtme të komunikimit:
 - a. GSM/GPRS/3G/4G/LTE/5G network;
 - b. Fibër optike (Ethernet)
 - c. FTTH/ADSL/VDSL/L2L/ne rrjetin publik

Neni 312. Prokurimi, instalimi, vendosja në operim, demontimi i pajisjeve të sistemit të matjes

1. Prokurimi, instalimi dhe vënia në operim e pajisjeve të sistemit të matjes kryhet në përputhje me dispozitat përkatëse në këtë kod që rregullojnë çështjet e lidhjeve të reja.
2. Përdoruesi, pronari ose përfaqësuesi ligjor për pikën e lidhjes janë përgjegjës për prokurimin e pajisjeve të sistemit të matjes. Instalimi dhe vënia në operim kryhet nën mbikëqyrjen dhe praninë e OST.
3. Parashikimet e mësipërme aplikohen për:

- a. transformatorët e matjes;
 - b. sistemet e kabllimit ndërmjet matësit dhe terminaleve sekondare të transformatorëve të matjes;
 - c. furnizimi me energji elektrike dhe pajisjet e mbrojtjes;
 - d. matësit;
 - e. pajisjet e komunikimit;
 - f. pajisjet për sinjalizim dhe mbikëqyrje;
 - g. ndërfaqja me përdoruesin dhe integrimi i pajisjeve të matjes me sistemet e OST.
4. Nëse përdoruesi krijon një pikë matje kryesore do të informojë OST me shkrim në lidhje me komisionimin e pikës së matjes. Përdoruesi është i detyruar të paraqesë në OST të gjithë protokollet e testimit, të dhënat e konfigurimit të pajisjeve të matjes dhe testimet e pranimit në objekt. OST do të jetë e pranishme në procedurat për instalimin, testimet e pranimit dhe komisionimit të pajisjeve të matjes.
 5. Në përputhje me dokumentacioni teknik të paraqitur si dhe prezencën në testimet e pranimit në objekt dhe komisionimit, OST do të njoftojë zyrtarisht me shkrim përdoruesin nëse sistemi i matjes është në konformitet dhe i pranueshëm për OST ose jo duke sqaruar pozicionin dhe mangësitë që duhen plotësuar. Përdoruesi është i detyruar të veprojë në përputhje me udhëzimet e OST.
 6. Transferimi i pronësisë së pikës së lidhjes ose transferimi i pronësisë vetëm i pikës së matjes kryhet pasi:
 - a. kontrollit të të gjithë protokolleve të testimit nga shitësi dhe instaluesi/zbatuesi i punimeve;
 - b. administrimi dhe kontrolli i të gjithë dokumentacionit;
 - c. kontrolli i konfigurimit të pajisjeve të matjes;
 - d. kontrollit të qarqeve sekondare të rrymës dhe tensionit;
 - e. kontrollit të funksionimit të komunikimit dhe kanaleve të komunikimit;
 - f. kontrollit të ndërfaqes dhe komunikimit në distancë të pajisjes matëse me sistemet e OST;
 - g. kontrollit e vlefshmërisë të të gjitha vulave të pajisjeve të matjes;
 - h. regjistrimi i pajisjeve dhe pikës së matjes në regjistrin unik të matjes të OST.

7. Pas komisionimit çdo ndërhyrje apo ndryshim në pajisjet e matjes nuk lejohet të kryhet pa leje me shkrim nga OST. Çdo ndërhyrje apo ndryshim i paautorizuar do të shoqërohet me përsëritje të procesit të kontrollit të pajisjeve të matjes sipas parashikimeve më sipër dhe kostot do të mbulohen nga pala që ka shkaktuar ndërhyrjen/ndryshimin e paautorizuar përfshirë dhe penalitetet përkatëse sipas kuadrit në fuqi.

Neni 313. Parametrizimi i pajisjeve të matjes

1. Parametrizimi i pajisjeve të matjes do të kryhet me qëllim:
 - a. përcaktimin e koeficientit të transformatorit të transformatorëve të matjes në vendin e matjes;
 - b. përcaktimin e matësit që do të montohet në vendin e matjes;
2. Karakteristikat e transformatorëve të matjes dhe koeficientet e transformimit përcaktohen nga OST në përputhje me tensionet e lejuara dhe kapacitetin e transmetimit të pajisjeve.
3. Parametrizimi merr në konsideratë karakteristikat e brendshme të matësit të cilat duhet të jenë në përputhje me karakteristikat teknike të pajisjeve të sistemit të matjes.
4. Parametrizimi i pajisjeve të matjes do të kryhet në anën primare ose sekondare në varësi të madhësive që do të maten.
5. Parametrat bazë të pajisjeve të matjes të tilla si koeficientet e transformimit të transformatorëve të rrymës dhe tensionit, koeficientet e korrektimit etj. mbahen në regjistrin unik të OST të pikave të matjes.
6. Parametrizimi i pajisjeve të matjes kryhet për çdo pikë matje.
7. OST është i vetmi subjekt i autorizuar për të ndryshuar konfigurimin e parametrave të pajisjes së matjes.
8. OST është përgjegjëse për përditësimin dhe mirëmbajtjen e parametrizimit të pajisjeve të matjes.
9. OST njofton përdoruesin nëse kryhen ndryshime në parametrizimin e pajisjeve të matjes.
10. Si rregull parametrizimi do të kryhet nga OST në anën primare të pajisjeve të matjes. Nëse pajisja e matjes parametrizohet në anën sekondare atëherë koeficiente korrektues për energjinë dhe fuqinë duhet të futen në algoritmin e faturimit në mënyrë të qartë dhe eksplicite. Ndryshimi i tyre është i mundur vetëm me njoftim me shkrim nga OST.
11. OST evidenton dhe arshivon në dokumentacionin e parametrizimit të gjithë të dhënat për pajisjet e matjes dhe koeficientet e korrektimit për energjinë dhe fuqinë.

Neni 314. Inspektimi dhe kontrolli i pajisjeve të matjes

1. Me qëllim për të siguruar saktësi dhe besueshmëri të operimit të pajisjeve të matjes kontrolli i përshtatshëm i tyre është i nevojshëm. Inspektimi dhe kontrolli i pajisjeve të matjes kryhet nga OST, institucionet e autorizuar dhe përdoruesi.
2. Nëse OST dhe/ose përdoruesit kanë dyshime nëse saktësia e pajisjeve matëse nuk është brenda limiteve të përcaktuara, do të kryhet një inspektim jashtë radhës i pajisjeve të matjes.
3. Nëse inspektimi konfirmon se pajisja matëse e inspektuar nuk është në klasën e përshtatshme të saktësisë, të gjitha kostot për inspektimin do të mbulohen nga pronari i pikës së lidhjes. Pronari i aseteve të traktit të matjes është i detyruar të zëvendësojë matësin e inspektuar me një tjetër me karakteristika teknike të duhura.
4. Nëse inspektimi konfirmon që matësi i inspektuar është në klasën e përshtatshme të saktësisë të gjitha kostot për inspektimin duhet të mbulohen nga pala që kërkoi inspektimin.
5. Nëse inspektimet kryhen nga pajisje etalon në vend, inspektimet kryhen në prezencë të personelit të autorizuar nga DPM, OST dhe përdoruesi.

Neni 315. Inspektimi i pajisjeve të matjes që kryhet nga OST

1. OST do të kryej inspektime për të verifikuar pajisjet e matjes në çdo matës kryesor sipas një grafiku të përcaktuar më parë.
2. OST mund të kryej inspektime të njëpasnjëshme në një kohë më të shkurtër se një vit nëse bazuar në të dhëna në lidhje me operimin e sistemit të matjes vlerëson se është e nevojshme verifikimi i saktësisë së matjes.
3. Matësi i kontrollit mund të inspektohet gjithashtu nëse vlerësohet e nevojshme nga OST.
4. Inspektimi i pajisjeve të matjes do të përfshijë:
 - a. verifikimi dhe testimi i gjendjes fizike të të gjitha vulave, targeteve dhe emërtimeve të pajisjeve të matjes;
 - b. testimi i koeficienteve të transformimit të transformatorëve të rrymës dhe tensionit;
 - c. testimi i të gjithë qarqeve sekondare të kabllimit nga pajisja matëse tek transformatorët e matjes;
 - d. testimi i ekranit/afishimit të matjeve;
 - e. testimi i parametrizimit të pajisjes së matjes;
 - f. testimi i komunikimit lokal dhe në distancë;

- g. testimi i klasës së saktësisë së matësit.
 - h. analizën e vlerave trefazore të matura
 - i. kontrollin e sinjalizimit dhe alarmit dhe analizën e sinjaleve dhe alarmeve të regjistruar në regjistrin e eventeve;
 - j. analizën e diagramës së fazës të tensionit dhe rrymës
 - k. krahasimin e regjistrimeve ndërmjet matësit kryesor dhe atij të kontrollit. Devijimi duhet të jetë brenda kufijve të përcaktuar nga klasa e saktësisë së matësit;
5. Nëse OST konstaton dështime të pajisjes/sistemit të matjes, dokumenton gjetjen dhe kërkon marrjen e masave për zëvendësimin e pajisjes me një të re me karakteristikat teknike të duhura brenda një periudhe jo me shume se 30 ditë kalendarike.
 6. Nëse OST ose përdoruesi dyshojnë për saktësinë e pajisjes matëse, OST do të organizojë brenda 30 ditëve një inspektim jashtë radhës të pajisjes matëse në vend.
 7. Të gjitha kostot për inspektimin jashtë radhës duhet të mbulohen nga përdoruesi nëse inspektimi vërteton dështimin e matjes. Nëse dështimi nuk konfirmohet kostot duhet të mbulohen nga subjekti që ka kërkuar inspektimin.
 8. Të gjitha veprimet që kryhen gjatë inspektimit përfshirë dhe rezultatet e tij dokumentohen me shkrim.

Neni 316. Inspektimi i pajisjeve të matjes nga institucioni i autorizuar

1. Institucioni i autorizuar, kryen inspektime periodike dhe verifikime të pajisjeve të matjes në laboratorë të certifikuar, në afate kohore të përcaktuara nga kuadri ligjor, në funksion të tipit të pajisjes matëse dhe klasës së deklaruar të saktësisë.
2. OST ka detyrim që të gjitha pajisjet e matjes kryesore dhe të kontrollit duhet të verifikohen dhe vulosen nga institucioni i autorizuar.

Neni 317. Aksesimi në sistemin e matjes

1. OST është e detyruar, që me kërkesë të përdoruesit, të sigurojë akses në ambientet e saj për lexim vizual të matësve kryesore dhe të kontrollit, si dhe inspektimin e pajisjeve të matjes. Prezenca e përbashkët e OST dhe përdoruesit është e detyrueshme.
2. Përdoruesi është i detyruar që, me kërkesë të OST të sigurojë akses në ambientet e tij për leximin lokal të matësit kryesor dhe të kontrollit si dhe inspektimin e sistemit të matjes. Prezenca e përbashkët e OST dhe përdoruesit është e detyrueshme.
3. Aksesimi në matje dhe pajisje të brendshme të matjes, qarqet dhe pajisje të lidhura të komunikimit behet vetëm me miratim të OST sipas udhëzimeve të përcaktuara nga OST.

4. Përdoruesit do ti lejojnë OST ose përfaqësuesve të saj, të drejtat e hyrjes, kalimit dhe qëndrimit mbi çdo pjesë të pronës së përdoruesve në masën e nevojshme për qëllime të kryerjes së funksioneve sipas Kodi të Transmetimit. Përdoruesit do të bëjë të gjitha rregullimet e arsyeshme dhe do të ofrojnë të gjitha lehtësitat e nevojshme për OST ose përfaqësuesve të saj në ushtrimin e këtyre të drejtave.
5. Të drejtat në përputhje me pikën më sipër do të përfshijë edhe të drejtën për të përdorur automjete, impiante, makineri për mirëmbajtje apo materiale të tjera që mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga OST për kryerjen e funksioneve të saj në lidhje me matjen në kuadër të kodit.
6. Të gjitha rezultatet e testimit, programet e mirëmbajtjes dhe të dhënat e vulosjes do të mbahen gjatë gjithë periudhës që pajisjet janë në punë dhe për pesë vjet pas daljes së tyre nga inventari i aseteve. Të dhënat e pajisjeve dhe të dhënat e testeve do t'u vihen në dispozicion palëve të interesuara në përputhje me kriteret e konfidencialitetit.
7. Pas çdo ndërhyrje në sistemin matës për arsye të mirëmbajtjes së planifikuar apo në rast defekti, si dhe në mënyrë periodike, sipas nevojës, do të kryhet verifikimi i matjes në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë”, i ndryshuar, neni 77.

Neni 318. Mirëmbajtja parandaluese/preventive e sistemit të matjes

1. OST është e detyruar të kryej kontrole efeciente dhe mbikëqyrje të matjes kryesore në çdo pikë matje nëpërmjet aktiviteteve si vijon:
 - a. kontrolli i sistemit trefazor të matjes;
 - b. identifikimi/gjetja e çdo mospërputhje në matje;
 - c. kontrolli fizik i pikës së matjes;
 - d. kontrolli dhe konfirmimi i saktësisë së të dhënave të matjes;
 - e. arshivimi dhe ruajtja e dokumentacionit për pikat e matjes kryesore.
2. OST dhe përdoruesit kanë detyrimin të sigurojnë mirëmbajtjen e sistemit të matjes në mënyrë që të garantohet saktësia dhe besueshmëria e operimit.
3. Nëse një ose më shumë pjesë të sistemit të matjes kanë karakteristika teknike që nuk i korrespondojnë me ato të miratuara me pikën e lidhjes, përdoruesi është i detyruar që sa më parë dhe jo më vonë se 30 ditë të zëvendësojë pajisjen jo në pajtueshmëri.
4. Çdo ndryshim, kontroll i rregullt apo jashtë radhës apo ndërhyrje në çdo pjesë të sistemit të matjes duhet të kryhet vetëm në prezencë të stafit të autorizuar të OST dhe përdoruesit. Këto procese dokumentohen në çdo rast me procesverbal përkatës të sigluar nga palët.

5. OST është e detyruar me kostot e saj të mirëmbajtje pajisjet e matjes në pronësi të saj.
6. OST mirëmban sistemin e matjes në përputhje me ligjin, rregullat teknike, dhe kodet.
7. Në rastet kur pikat e matjes dhe pajisjet e sistemit të matjes (VMT, CMT, qarqet sekondare, etj.) janë në pronësi të përdoruesit, përdoruesi është përgjegjës për kostot e mirëmbajtjes të pajisjeve të matjes dhe gjendjen e tyre. Pajisjet e matjes në pikën e lidhjes do të mirëmbahen nga OST në praninë e përdoruesit. Në këtë rast OST do të riparojë sistemin e matjes sapo të jetë praktike nëse një sistem matje nuk funksionon si duhet ose kërkon mirëmbajtje. OST do të faturojë si është e përshtatshme për shërbimet e ofruara.
8. Çdo ndërhyrje ose dështim të riparimit të pajisjes raportohet me shkrim nga përdoruesi për OST duke dhënë të gjitha detajet e nevojshme.
9. Nëse përdoruesi ndryshon një pjesë të caktuar të sistemit të matjes në pronësi të tij, është i detyruar të informojë OST brenda 30 ditëve me shkrim.
10. Njoftimi me shkrim konsiston në:
 - a. arsyen e zëvendësimit;
 - b. tipin e pajisjes që zëvendësohet dhe pajisjes që është në funksion;
 - c. protokollet e testimit nga prodhuesi për klasën e saktësisë dhe protokollet e testimit nga inspektimet e pajisjeve të kryera nga subjektet e autorizuar;
 - d. protokollet e testimit për vënien në operim të pajisjeve.

Neni 319. Riparimet në sistemin e matjes

1. Nëse OST përcakton dështimin ose informohet për dështimin në çdo pikë të sistemit të matjes, OST do të:
 - a. informojë përdoruesin për sa konstatohet;
 - b. nëse është e nevojshme të kryej marrjen e të dhënave të matjes në mënyrë lokale;
 - c. gjetjen dhe riparimin e problemit në pjesën e sistemit në pjesën e saj të pronësisë.
2. Nëse konstatohen dështime në pajisjen e matjes kryesore, ose në çdo pjesë tjetër të sistemit të matjes, të shkaktuara nga përdoruesi, OST informon përdoruesin me shkrim. Përdoruesi ka detyrim të marrë masa për kostot e riparimit të dëmtimit sa më shpejt të jetë e mundur por jo më vonë se 30 ditë, në pjesën e sistemit në pronësi të tij.
3. Nëse përdoruesi konstaton dëmtim të sistemit të matjes në pikën e matjes në pronësi të tij, njofton OST për konstatimin brenda 48 orëve.

4. Përdoruesi ka detyrim të mbulojë kostot e riparimit të dëmtimit sa më shpejt të jetë e mundur por jo më vonë se 30 ditë, në pjesën e sistemit në pronësi të tij.
5. Nëse dështimi konstatohet në sistemin trefazor të matjes, mungesën e matjes/afishimit të një sasive, regjistrimin e sasive të matura në mënyrë jo-korrekte, etj., përdoruesi ka për detyrë të informojë OST brenda 48 orëve dhe të mbulojë kostot e riparimit të dëmtimit sa më shpejt të jetë e mundur por jo më vonë se 30 ditë, në pjesën e sistemit në pronësi të tij.
6. Sistemi i matjes duhet të riparohet dhe të kthehet në kushte normale operimi brenda 15 ditëve nëse dëmtimi / dështimi i konstatuar ndikon në procesin dhe saktësinë e faturimit.
7. Kthimi në kushte normale operimi pas kryerjes së riparimeve të nevojshme në sistemin e matjes konfirmohet dhe lejohet me shkrim nga OST.

Neni 320. Të dhënat e matjes

1. Për çdo pike matje do të kryhen dhe afishohen matjet e madhësive si vijoj:
 - a. livrimi i energjisë aktive (A-);
 - b. konsumi i energjisë aktive (A+);
 - c. livrimi i energjisë reaktive (Q-);
 - d. konsumi i energjisë reaktive (Q+);
2. Drejtimi i livrimit (-) dhe konsumit (+) të energjisë elektrike përcaktohen në raport me OST.
3. Në çdo pikë matje diagrama e ngarkesës regjistrohet si mesare 15 minutëshe e fuqisë aktive dhe fuqisë reaktive për çdo periudhe faturimi.
4. Periudhat ditore fillon në 00:00 h CET për pikat e matjes të interkonjeksionit dhe përfundon në 24:00. Për të gjitha pikat e tjera të matjes periudha ditore fillon në 00:00 h sipas orës lokale dhe përfundon në 24:00 sipas orës lokale.
5. Periudha e faturimit për pikat e matjes së interkonjeksionit përkon me muajin kalendarik me leximin e matësit kryesorë ditën e parë të muajit në orën 00:00 dhe ditën e fundit të muajit në orën 24:00 CET. Për të gjitha pikat e tjera të matjes periudha fillon me leximin ditën e parë të muajit në orën 00:00 h dhe përfundon në ditën e fundit të muajit në orën 24:00 me orën lokale.
6. Çdo informacion/e dhënë e matjes shoqërohet me stampim kohe (minuta, ora, dita, viti). Këto të dhëna duhet të ruhen në pajisjen e matjes për nevoja të leximit në distancë.

7. Të dhënat e marra për energjinë e livruar/konsumuar nga regjistrat në pajisjen e matjes për periudhën e faturimit dhe të dhënat për diagramet 15 minutëshe të fuqisë përbëjnë të dhënat bazike të matjes.
8. Çdo pajisje matje duhet të mundësojë leximin e të dhënave në vijim të cilat duhet të shfaqen dhe në pajisjen e matjes:
 - a. gjendjen aktuale komulative të regjistrat të pajisjes së matjes për energjinë aktive (kWh) dhe energjinë reaktive (kVArh) për çdo drejtim të konfiguruar;
 - b. maksimumin e mesatares 15 minutëshe të aktives (kW) dhe reaktives (kVAr) për çdo drejtim të konfiguruar për periudhën aktuale të faturimit dhe periudhën e mëparshme të faturimit;
 - c. kuadrantin e drejtimin aktual të fuqisë aktive dhe reaktive;
 - d. prezencën e tensionit të matjes;
 - e. orën dhe datën aktuale në pajisjen e matjes;
 - f. tarifën aktuale aktive.

Neni 321. Përdorimi i të dhënave të matjes

1. Të dhënat e matjes do të përdoren në proceset dhe aktivitetet si vijon duke respektuar parimet e konfidencialitetit, transparencës për atë që parashikohet nga kuadri në fuqi, mos diskriminimit dhe duke garantuar saktësinë e tyre:
 - a. bilancin e energjisë për hyrjet dhe daljet e flukseve në sistemin e transmetimit për një periudhë të caktuar faturimi. Bilanci mund të detajohet për çdo pike matje, nivel tensioni dhe për interkonjeksionet sipas sasive në kufi;
 - b. diagramën e fuqisë dhe energjisë për hyrjet në sistemin e transmetimit për një periudhë faturimi të caktuar të llogaritur si shumë e diagramës së fuqisë (vlerat mesatare 15-minutëshe) për të gjitha hyrjet në sistemin e transmetimit. Kjo diagramë mund të gjenerohet për gjeneruesit, interkonjeksionit etj;
 - c. diagramën e fuqisë dhe energjisë për daljet nga sistemi i transmetimit për një periudhë faturimi të caktuar të llogaritur si shumë e diagramës së fuqisë (vlerat mesatare 15-minutëshe) për të gjitha daljet e sistemit të transmetimit. Kjo diagramë mund të gjenerohet për gjeneruesit, interkonjeksionet etj;
 - d. diagrama e humbjeve të energjisë në sistemin e transmetimit për një periudhë faturimi të caktuar;
 - e. raporte për shkëmbimet e energjisë në OST;

- f. të dhënat për humbjet totale të energjisë në sistemin e transmetimit për periudhë faturimi të caktuar të cilat janë të nevojshme për përcaktimin e sasive të prokuruar me qëllim mbulimin e këtyre humbjeve;
- g. faturimin për aksesin dhe përdorimin e sistemit të transmetimit për çdo përdorues;
- h. përgatitjen e bilanceve financiare për shkëmbimet e energjisë dhe faturimin për operatorët fqinje të përfshirë në shkëmbime;
- i. të gjitha livrimet/tërheqjet nëpërmjet OST dhe ndërmjet përdoruesve/pjesëmarrësve të tregut të energjisë.

Neni 322. Data baza dhe përpunimi i të dhënave të matjes

1. OST menaxhon databazen e të dhënave të matjes dhe matjet e sasive të marra nga pajisjet e matjes në të gjithë pikat e matjes të cilat parashikohen në këtë kod.
2. Databaza duhet të përmbajë të paktën informacion/fusha të cilat konsistojnë në:
 - a. titulli/emërtimit i përdoruesit të sistemit të transmetimit;
 - b. vendndodhja e objektit të lidhur në sistemin e transmetimit;
 - c. linja/feederi i përdoruesit;
 - d. tipi i pajisjes së matjes;
 - e. kanali i komunikimit;
 - f. protokoli i komunikimit;
 - g. formatimi i regjistrit/databases.
3. OST proceson të dhënat e marra nga pajisjet e matjes, sipas nevojave të saj dhe sipas nevojave të përdoruesve të sistemit të transmetimit.
4. Informacioni mbi origjinën e të dhënave të matjes duhet të jetë i disponueshëm në çdo moment.
5. Databaza e të dhënave duhet të përmbajë të gjitha vlerat e mbledhura në distancë ose lokalisht nga pajisjet e matjes si dhe korrektimin e të dhënave sipas koeficienteve përkatës të korrektimit në funksion të humbjeve në transformim dhe transmetim sipas rastit.
6. Databaza e matjes dhe të dhënat do të mundësojnë:
 - a. identifikimin e pajisjes së matjes dhe sistemit të matjes;
 - b. përcaktimin madhësisë së matur (kW, kWh, kVAr, kVArh);

- c. identifikimin unik dhe të qartë të vlerave të matura;
 - d. lidhjen ndërmjet vlerës së matur dhe vlerës së korrektuar si dhe korrektimin e kryer;
 - e. stampimin e kohës të vlerës së matur për kohën kur është kryer matja.
7. OST ju vë në dispozicion përdoruesve sipas një protokolli të caktuar, të dhënat e matjes dhe faturimit nga databaza e të dhënave, të përshtatshme me nevojat e tyre.
 8. Përdoruesi mund të aksesojë të dhënat e matjes dhe faturimit nga web server i cili siguron të gjitha të dhënat e grumbulluara nëpërmjet leximit në distancë të pajisjeve të matjes si dhe të dhënat e faturimit për përdoruesin. Përdoruesi do të ketë akse për leximin dhe shkarkimin vetëm për të dhënat që lidhen me të.
 9. Koha e lejuar ndërmjet datës së vendosjes në operim të një pajisje matje apo çdo ndryshim/zëvendësim të pajisjeve të sistemit të matjes dhe datës së përditësimit të të dhënave përkatëse në databaze është jo më shumë se 15 dite.
 10. Databaza përmban të dhëna operative që lidhen me operimin e pajisjeve të sistemit të matjes për 12 muajt e fundit dhe të dhëna të arshivuara që nga data e vendosjes së sistemit të matjes dhe deri një vit më parë.

Neni 323. Marrja e të dhënave të matjes

1. Të dhënat e matjes përfshijnë:
 - a. vlera të matura në kohë të energjisë elektrike aktive dhe reaktive nga pikat e matjes;
 - b. përlllogaritjet e OST bazuar në vlerat e matura;
 - c. të dhëna të vlerësuara, ndryshuara ose zëvendësuara në rast të të dhënave të humbura ose jo të sakta, të cilat përdoren me pas për faturimin.
2. OST është e detyruar të grumbullojë të dhëna nga pikat e matjes duke përdorur protokollin standart për transmetimin e të dhënave. OST duhet të konfirmojë, procesojë dhe të ngarkojë të dhënat e mbledhura në databazën e të dhënave duke ruajtur dhe mbrojtur ato për llogaritjen e pagesave, transaksionet e tregut dhe tarifatat për përdorimin e sistemit.
3. Përdoruesi duhet të sigurojë operim të sigurtë të kanalit/lidhjes së komunikimit të të dhënave për transmetimin në distancë të të dhënave nga pajisja e matjes në databazën e matjes të OST.
4. Nëse për një arsye të caktuar leximi në distancë është i pamundur (ose marrja e të dhënave) OST dhe përdoruesi duhet të sigurojë marrjen e të dhënave lokalisht.
5. Në rast se të dhënat për shkak të rrethanave merren lokalisht, OST do të transmetojë menjëherë në databazën e të dhënave brenda një periudhe të tillë që lejon që të gjithë

të dhënat e nevojshme të matjes të jenë në dispozicion për proceset e tjera që lidhen me faturimin dhe tregun.

Neni 324. Vlefshmëria e të dhënave

1. OST kryen kontrolle të përshtatshme dhe konfirmon besueshmërinë e të dhënave të matjes të grumbulluara si dhe konfirmon vlefshmërinë e të dhënave para se ato të ngarkohen në databazë.
2. Qëllimi i kontrollit dhe konfirmimit të vlefshmërisë së të dhënave të matjes është si vijon:
 - a. verifikimi nëse mungojnë të dhëna ose janë të paplota pas leximit të pajisjeve të matjes;
 - a. verifikimi nëse gjatë leximit ka pasur ndërhyrje në pajisjet e sistemit të matjes, riparime etj.;
 - b. përcaktimi nëse ka devijime të kohës lokale të pajisjeve të matjes në raport me orën reference gjatë gjithë periudhës së faturimit;
 - c. përcaktimi nëse ka sinjalizime nga sistemet e mbikëqyrjes për mungesë të furnizimit nga sistemet ndihmëse, mungesë afishimi, regjistrimi të ndonjë parametri etj.;
 - d. përcaktimi nëse të dhënat e marra janë të besueshme dhe në përputhje me ngarkesat në pikën e matjes;
3. Gjatë konfirmimit të vlefshmërisë, të dhënat e matjes të marra nga pajisjet e matjes së kontrollit dhe kryesore duhet të krahasohen si dhe energjia e marrë nga diferenca ndërmjet statusit në regjistër me energjinë e përlllogaritur nga integrimi i diagramve të ngarkesës. Të dhënat duhet të krahasohen me të dhënat nga periudha pararendëse e faturimit dhe me të dhënat për të njëjtën periudhe faturimi në vitin e mëparshëm/fundit.
4. Nëse paraqiten diferenca ndërmjet vlerave të regjistruara nga pajisjet e matjes së kontrollit dhe kryesore ato duhet të jenë në limitet e përcaktuara nga klasa e saktësisë së pajisjes së matjes.
5. Diferenca ndërmjet vlerës së energjisë të marre si shumë e vlerave të regjistruara dhe vlerës së energjisë së përlllogaritur nga diagramat e ngarkesës në një periudhe faturimi të caktuar, në kushtet e sinkronizimit kohor, nuk duhet të jenë më të mëdha se 0.1%.

Neni 325. Zëvendësimi i të dhënave

1. Në rast të mos vlefshmërisë së të dhënave ose dështimit të konfirmimit të vlefshmërisë së tyre, OST do të zëvendësojë të dhënat e matjes si dhe të dhënat që mungojnë.
2. OST do të bëjë zëvendësimin e të dhënave të matjes të pavlefshme sipas përcaktimeve në vijim:

- a. me të dhëna të marra nga matësi i kontrollit nëse ka një të tillë dhe është pjesë e sistemit të matjes me kusht që kontrolli i tij të jetë kryer më parë;
 - b. me të dhëna të marra nga matësi i përdoruesit i cili lidhet me matësin kryesor të pikës së matjes duke marrë në konsideratë humbjet mesatare në transformim dhe linjë;
 - c. me të dhëna të marra nga algoritmet e faturimit të OST në bazë të matjeve të vlefshme ose përlogaritjes së madhësive elektrike;
 - d. me të dhëna të marrra nga sistemi SCADA, nëse ka të dhëna për pikën e matjes;
3. OST dokumenton zëvendësimin e të dhënave të matjes për qëllim arshivimi, kontrolli dhe rishikimi në çdo kohë të faturimit.
 4. Nëse gjatë inspektimit ose kontrollit periodik apo jashtë radhës të sistemit të matjes vërehet se matësi ka pasaktësi atëherë të dhënat e matjes në databazen e matjes do të zëvendësohen sipas rregullave për zëvendësimin e të dhënave të matjes të përshkruara më sipër për periudhën:
 - a. nga dita e ndodhjes së difektit nëse mund të përcaktohet;
 - b. e përcaktuar bazuar në të dhënat e disponueshme;
 5. Nëse zëvendësimi i të dhënave të matjes kryhet pas përfundimit të faturimit, atëherë është e nevojshme që të kryhen korrektime të nevojshme në faturim dhe të dhënat ti dërgohen përdoruesit.

Neni 326. Aksesit në të dhënat e matjes

1. Aksesit i drejtpërdrejtë dhe i pakufizuar në të dhënat e matjes të grumbulluara nga pajisjet e matjes nëpërmjet komunikimit lokal apo në distancë lejohet vetëm për personat e autorizuar të OST sipas procedurave të brendshme të OST, të cilët janë përgjegjës për konfigurimin, mirëmbajtjen, marrjen, konfirmimin e vlefshmërisë dhe zëvendësimin e të dhënave të matjes. Përdoruesit nuk kanë akses të drejtpërdrejtë në të dhënat e matjes përveç se në raste të nevojshme të argumentuara dhe me autorizim të veçantë nga OST.
2. Aksesit në të dhënat e matjes nga matësi kryesor në mënyrë lokale ose në distancë duhet të sigurohet me të drejta dhe attribute të caktuara në avancë për:
 - a. marrjen e të dhënave të matjes;
 - b. ndryshimi/përditësimi i datës dhe orës;
 - c. parametrizimi dhe konfigurimi, vendosja e tarifave dhe funksione të tjera;
 - d. protokollet e komunikimit dhe parametrat e komunikimit.

3. Përdoruesit e të dhënave të matjes janë:
 - a. përdoruesit e sistemit të transmetimit ose përfaqësuesit e tyre;
 - b. operatori i tregut apo çdo strukturë tjetër në funksion të operimit të tregut të energjisë;
 - c. furnizuesit e përdoruesve;
 - d. palët përgjegjëse të balancimit;
 - e. subjekte të tjera të autorizuara në funksion të tregut të energjisë sipas kuadrit ligjor në fuqi.
4. OST është përgjegjës për organizimin dhe dhënien e aksesit në të dhënat e matjes, lëshimin e licencave të përshtatshme për akses dhe për përcaktimin e të drejtave të aksesit të përdoruesit, duke pasur parasysh sigurinë e të dhënave lokale në objekt dhe në bazën e të dhënave të matjes në përputhje me politikat përkatëse të OST për sigurinë kibernetike dhe të informacionit.
5. OST duhet të delegojë të drejtën e aksesit në distancë në të dhënat e matjes me anë të përcaktimit të listës së përdoruesve të autorizuar të të dhënave të matjes me qëllim parandalimin e konflikteve midis palëve të autorizuara. OST do të shpërndajë diapazonin/hapësirën kohore për qasje në të dhënat e matjes duke marrë në konsideratë nevojat për marrjen e të dhënave nga OST dhe përdoruesit e tjerë të të dhënave matëse në përputhje me parimin e mosdiskriminimit.
6. Mosrespektimi i dispozitave që rregullojnë hapësirën e ndarë kohore për akses në të dhënat e matjes do të rezultojë në anulimin e të drejtave për akses në to.
7. OST i cakton përdoruesve të të dhënave të matjes të drejtën për leximin nëpërmjet aksesit të ruajtur me fjalëkalim si dhe intervalin kohor në të cilin përdoruesi mund të kryej leximin.
8. Është detyrim i përdoruesit të të dhënave të matjes të përdori software të licencuar, aplikime për komunikimin në distancë dhe transferimin e të dhënave, si dhe për të përdorur fjalëkalimet ekskluzive për vetë-lexim të ofruara nga OST.
9. OST ka akses të përhershëm dhe të garantuar në të dhënat e sistemit të matjes të përdoruesve të sistemit të transmetimit.
10. OST ka detyrim të garantojë sigurinë e informacionit në regjistrat e pajisjeve të matjes, si dhe sigurinë e databazës së të dhënave të matjes. Të gjithë të dhënat e matjes brenda sistemit të matjes duhet të mbrohen nga aksesit lokal apo në distancë në rrugë elektronike me sistemet hardware dhe software si dhe procedurat e politikat e përshtatshme për sigurinë kibernetike dhe të informacionit.

11. OST nuk ka autorizim për të ndryshuar të dhënat e regjistruara në vend në matësa, përveç gjatë periudhës së testimit të matësave dhe kontrollit të instalimit (vetëm për periudhën e kohëzgjatjes së testimit). Për çdo ndërhyrje në terren në matësat e energjisë elektrike përgatitet një raport i cili duhet të përmbajë të dhënat e energjisë elektrike të paregjistruar ose të regjistruar gabimisht.
12. Në çdo rast, në lidhje me askesin e të dhënave të matjes dhe të telematjes do të respektohen kërkesat si vijon:
 - a. Të dhënat zyrtare të matjes do të vihet në dispozicion nga OST për përdoruesit e autorizuar siç përcaktohet nga kodi ose rregullatori në një format të përshtatshëm.
 - b. OST do të publikojë të gjitha formatet në të cilat ajo mund të sigurojë të dhëna për përdoruesit. OST do të ruajë të gjitha të dhënat e konsumatorëve në një bazë të dhënash qendrore duke siguruar që baza e të dhënave është e ruajtur dhe e përditësuar vazhdimisht.
 - c. OST do të sigurojë të dhëna të matjes sipas kërkesës së palëve të interesuara në format jo standard kundrejt kostove përkatëse të cilat mbulohen nga pala e interesuar.
 - d. OST do të administrojë skedulet kohore të aksesit të bazës së të dhënave të matjes si dhe specifikimet e kërkesave të sigurisë.
 - e. Të dhënat e matjes për përdorim në tregtimin e energjisë dhe faturim përbëjnë informacion konfidencial.
13. OST duhet të zbatojë procedurën në vijim në lidhje me rakordimin e matjes:
 - a. OST do të bëjë rregullimet e nevojshme për të lexuar nga distanca vlerat kumulative të energjisë çdo muaj për qëllime kontrolli.
 - b. Nëse vlera kumulative të energjisë nuk janë në dispozicion apo nuk mund të merren nga distanca, atëherë OST do të marrë leximet manualisht çdo muaj për qëllimet e mësipërme.
 - c. Brenda tri javëve të leximit manual të matjes, OST do të përgatisë një deklaratë rakordimi të matjes në të cilën ajo do të regjistrojë dallimin në mes dy leximeve të njëpasnjëshme të matjes manuale dhe do ta krahasojë atë me energjinë totale të regjistruara për të njëjtën periudhë kohore.
 - d. Nëse vërehet ndonjë dallim ndërmjet leximit manual dhe lexim të regjistruar elektronikisht prej më shumë së 0.1% ky informacion do të theksohet dhe referohet për kontroll të mëtejshëm.
 - e. Nëse si rezultat i kontrollit të mësipërm, mospërputhja konfirmohet, atëherë OST do të informojë përdoruesin përkatës dhe do të marrë masat e duhura për të trajtuar situatën në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore dhe rregullatore.

- f. Të dhënat e matjes të padisponueshme ose paarrtshme për më shumë së një muaj zëvendësohen me vlera referuese, sipas metodologjisë përkatëse të miratuar nga Enti Rregullator i Energjisë, të aplikueshme për një periudhe jo më të gjatë së tre muaj.